




Raporti i analizës së rrezikut dhe vlerësimit të riskut të fatkeqësive natyrore për Bashkinë e Lezhës

Korrik 2020





Raporti i analizës së rrezikut dhe vlerësimit të riskut të fatkeqësive natyrore për Bashkinë e Lezhës

Korrik 2020

Autorë, MetroPOLIS Sh.p.k & Co-Plan

Vladimir Malkaj, Specialist Programi- Qeverisja Demokratike, *PNUD*

Maksimiljan Dhima, Ekspert i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Mbrojtjes Civile

Jak Gjini, Ekspert Lokal

Grupi i Punës MetroPOLIS Sh.p.k & Co-PLAN

Dritan Shutina, Ekspert Institucional dhe Qeverisje

Rudina Toto, Drejtues Projekti

Ledio Allkja, Ekspert Planifikim Territori

Kejt Dhrami, Eksperte Planifikim Territori

Imeldi Sokoli, Ekspert Planifikim Territori

Merita Toska, Ekspert Zhvillimi Ekonomik dhe Financa

Edlira Xhafaj, Ekspert GIS

Gerti Delli, Ekspert GIS

Rodion Gjoka, Ekspert Mjedis

Merita Guri, Ekspert Inxhinier Ndërtimi (Universiteti POLIS)

Endri Duro, Ekspert Inxhinier Ndërtimi (Universiteti POLIS)

Skënder Allkja, Ekspert Gjeologji dhe Hidro-gjeologji (A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000)

Shyqyri Aliaj, Ekspert Sizmiolog (A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000)

Kontribues

Pjerin Ndreu, Kryetar *Bashkia Lezhë*

Ermal Pacaj, Nën-kryetar *Bashkia Lezhë*

Bardhyl Kaçorri, Drejtor *Emergjencat Civile*

Grupi i Punës Prefektura Lezhë

Ndrek Mhillaj, Përgjegjës Emergjencat Civile

Strategjia për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkinë Lezhë është porositur nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), dhe përgatitur nga Co-PLAN-Instituti për Zhvillimin e Habitati. Pikëpamjet e shprehura në raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të PNUD, apo partnerëve të saj.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1. HYRJE	12
1.1 Konteksti i Përgjithshëm	12
1.2 Metodologjia e Punës për Vlerësimin e Rrezikut të Fatkeqësive Natyrore	21
1.3 Komisioni i Mbrojtjes Civile Bashkia Lezhë	25
1.4 Përmbledhje e Kontekstit Lokal dhe Rreziqeve në Bashkinë Lezhë	85
KAPITULLI 2. ANALIZA E RREZIQEVE DHE VLERËSIMI I RISKUT	88
2.1 Metodologjia	89
KAPITULLI 3. ANALIZA E RREZIQEVE TË FATKEQËSIVE NATYRORE NË BASHKINË LEZHË	96
3.1 Dukuritë Sizmike	96
3.1.1 Vështrim Historik mbi Tërmetet	96
3.1.2 Rreziku ndaj Tërmetit	101
3.1.2 Strukturat Ndërtimore dhe Rreziku Sizmik	103
3.1.3 Përmbledhje e Objekteve	105
3.1.4 Kalendar Historik	117
3.2 Gjeologjia, Gjeomorfologjia dhe Hidrogjeologjia	118
3.2.1 Karakteristikat Fizike, Gjeologjike dhe Gjeodinamike	118
3.2.2 Struktura Gjeologjike dhe Hidrogjeologjike	119
3.2.3 Kushtet Hidro-Gjeologjike	120
3.2.4 Rreziqe Gjeologjike dhe Gjeoteknike	121
3.2.5 Kalendar Historik	123
3.3 Sistemi Hidrik	124
3.3.1 Vështrim Historik i Përmytjeve nga Burimet Ujore Tokësore	125
3.3.2 Kalendar Historik	130
3.4 Rreziqet nga Ndryshimet Klimatike	132
3.4.1 Zjarri në Pyje	132
3.4.2 Kalendar Historik i Rrezikut nga Zjarri	134
3.4.3 Borë dhe Stuhi	135
3.4.4. Kalendar Historik i Stuhive të Erës dhe Borës	137
3.4.5 Avancimi i Detit	138
3.4.6 Thatësira	143
3.5 Sistemi Shëndetësor dhe Përballimi i Covid-19 në Bashkinë Lezhë	144
3.5.1 Aksesimi në Shërbime Shëndetësore	144
3.5.2 Përballimi i Covid-19 në Bashkinë Lezhë	147

KAPITULLI 4. ANALIZA E CËNUESHMËRISË ME SHUMË-RREZIQE 148

4.1 Analiza e Cënueshmërisë Rrezikut Sizmik.....	148
4.2 Analiza e Cënueshmërisë nga Përmbytjet	150
4.3 Analiza e Cënueshmërisë nga Zjarret	153
4.4 Analiza e Cënueshmërisë nga Bora dhe Era.....	156
4.5 Analiza e Cënueshmërisë ndaj Rrezikut të Pandemisë	158
4.6 Analiza e Cënueshmërisë ndaj Ndryshimeve Klimatike	159
4.7 Analiza e Cënueshmërisë Multi-Rrezik	162

KAPITULLI 5. VLERËSIMI I RISKUT 166

5.1 Risku Sizmik.....	166
5.2 Risku Gjeologjik	166
5.3 Risku nga Përmbytjet.....	167
5.4 Risku nga Zjarri.....	169
5.5 Risku Meteorologjik.....	169
5.6 Risku nga Pandemia.....	171
5.7 Risku nga Ndryshimet Klimaterike.....	171
5.8 Kalendarit Sezonal.....	171
5.9 Detajim i Tabelave të Pikëzimit	173

REFERENCA 179

SHTOJCA 183

SHTOJCA1. KONTEKSTI LOKAL DHE RREZIQET NË BASHKINË LEZHË 26

1 Pozicioni Gjeografik.....	26
2 Popullsia	27
3 Zhvillimi Socio-Ekonomik	27
3.1 Zhvillimi Ekonomik.....	27
3.2 Bujqësia në Bashkinë Lezhë.....	29
3.3 Turizmi.....	30
3.4 Arsimiti	31
3.5 Shëndetësia	31
4 Infrastruktura.....	32
4.1 Infrastruktura Rrugore	32
4.2 Infrastrukturat Kritike	36
4.3 Infrastruktura Ujësjellës Kanalizime	37
4.4 Infrastruktura Energji.....	38

4.5	Infrastruktura në Shërbim të Bujqësisë dhe Përballimin e Përmbytjes.....	39
4.6	Kanalet Kulluese dhe Vaditëse	42
5	Mjedisi.....	44
5.1	Zonat e Mbrojtura.....	45
5.2	Monumentet e Natyrës.....	48
5.3	Lumenjtë	53
5.3	Ujërat Nëntokësorë	55
5.4	Cilësia e Ujrave	55
5.5	Deti Adriatik.....	57
5.6	Gjendja në Mjedis	59
6	Zhvillimi Urban	65
6.1	Tipologjitë Hapësinore	65
6.2	Densiteti i Banimit	66
6.3	Lidhshmëria Aksiale.....	67
6.4	Vlerësimi i Hapësirave.....	69
6.5	Zonat Informale.....	70
7	Trashëgimia Kulturore dhe Historike.....	71
8	Analiza e Financave Vendore në Bashkinë Lezhë.....	72
9	Dokumente Strategjike dhe Studime të Mëparshme në Bashkinë Lezhë	75
9.1	Dokumente Strategjike në Nivel Kombëtar	75
9.2	Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Lezhë.....	79
9.3	Plane të mëparshme Emergjencash.....	82
9.4	Studime në Bashkinë Lezhë	82

SHTOJCA 2- KOMISIONI MBROJTJES CIVILE BASHKIA LEZHË 183

SHTOJCA 3- VIZITA NË TERREN 183

**SHTOJCA 4- INTERVISTA/TAKIME/ FOKUS GRUPE ME AKTORË NË BASHKINË LEZHË DHE
AKTORË TË TJERË RAJONALË E JO-QEVERITARË.....** 183

SHTOJCA 5- RAPORTI GJEOLOGJIK DHE SIZMILOGJIK 183

**SHTOJCA 6- RAPORTI INXHINIERI STRUKTUROR MBI CËNUESHMËRINË E STRUKTURAVE NGA
RREZIKU SIZMIK** 183

SHTOJCA 7- MATERIAL I DETAJUAR HARTOGRAFIK 183

LISTA E FIGURAVE

Fig 1- Kuadri Metodologjik	23
Fig 2- Imazhe me Dron në Lezhë	23
Fig 3- Metodologjia për Vlerësimin me Shumë Rreziqe	25
Fig 4- Shpërndarja e Institucioneve të Kujdesit Shëndetësor dhe Arsimor në Lezhë.....	33
Fig 5- Lezha në Raport me Korridoret Kryesore Kombëtare e Rajonale.....	34
Fig 6- Hierarkia e Sistemit Rrugor	35
Fig 7- Hierarkia e Sistemit Rrugor sipas Kodit Rrugor në Qytetin Lezhë	36
Fig 8- Cilësia e Infrastrukturës Rrugore Bashkia Lezhë	37
Fig 9- Cilësia e Infrastrukturës Rrugore Bashkia Lezhë	38
Fig 10- Harta e Zonave të Mbrojtura Lezhë.....	48
Fig 11- Harta e Zonimit Kune- Vain- Tale	49
Fig 12- Foto Rëra e Hedhur	51
Fig 13- Foto Suka e Vogël.....	52
Fig 14- Foto Rivat e Drinit	53
Fig 15- Foto Këneta e Kashtës	53
Fig 16- Rrapi i Pirajve	54
Fig 17- Foto Lisi Markatomaj	54
Fig 18- Foto Pylli i Shënmisë.....	55
Fig 19- Foto nga Lumi Matit.....	56
Fig 20- Foto Deti Adriatik.....	59
Fig 21- Ndryshimi i Vijës Bregdetare.....	60
Fig 22- Biodiversiteti.....	62
Fig 23- Evidentimi i Tipologjive Hapësinore në Qytet.....	67
Fig 24- Vlerësimi i Ruajtjes së Distancës Ndërtesë-Ndërtesë: Tipologjia Mikse Qendrore	68
Fig 25- Analiza e Lidhshmërisë Aksiale në Qytetin e Lezhës	69
Fig 26- Lidhshmëria Hapësinore (Connectivity).....	70
Fig 27- Integrimi Vizual (Visual Integration) dhe Zgjedhja e Distances më të Shkurtër (Through Vision).....	71
Fig 28- Arritshmëria e Hapësirave Publike.....	72
Fig 29- Korniza e Vlerësimit të Riskut sipas 3 Shtyllave.....	92
Fig 30- Shembull i Vlerësimit të Bazuar në Indikatorë.....	93
Fig 31- Matrica e Riskut.....	93
Fig 32- Shembull i Pemës së Ngjarjeve	94
Fig 33- Harta Sizmotektonike e Shqipërisë	99
Fig 34- Harta e Izoseistëve të Tërmetit të 1 Qershorit 1905.....	100

Fig 35- Harta e Izoseisteve të Tërmetit të 17 Dhjetorit 1926	101
Fig 36- Harta e Isoiseteve të Tërmetit të 30 Nëntorit 1967	101
Fig 37- Harta e Isoseisteve të Tërmetit të 15 Prillit 1979	102
Fig 38- Harta e Përshpejtitimit për Shqipërinë në Varësi të Kushteve të Truallit me Probabilitet 10/50 Vjet Ose 475 Vjet Periudhë Kthimi	104
Fig 39- Harta e PGA për Bashkinë Lezhë në Varësi të Klasifikimit të Truallit me Probabilitet 10% në 50 Vjet ose 475 Vjet Kthim	105
Fig 40- Zonimi Sizmik sipas Intensitetit në 1963 dhe 1978; Zonimi Sizmik sipas Intensitetit të Përdorur që nga 1989	108
Fig 41- Harta e Nxitimit Maksimal në Bashkinë Lezhë	109
Fig 42- Harta e Klasifikimit të Tokës Bazuar në EN-1998 e Bashkisë Lezhë	109
Fig 43- Shembuj Struktura nga Viti 1945 deri në 1960	110
Fig 44- Shembuj Struktura 1960-1979	111
Fig 45- Shembuj Struktura 1979-1990	111
Fig 46- Shembuj Struktura 90-2000	112
Fig 47- Shembuj Struktura 2000- në Vazhdim	112
Fig 48- Degradimi nga Mirëmbajtja e Ulët; Ngrirja-Shkrirja	114
Fig 49- Shembuj Ndërhyrje në Ndërtesa me Muraturë që Shkaktuan Dëmtimin e Strukturës	115
Fig 50- Dëmtime nga Uljet Diferenciale	115
Fig 51- Dëmtime nga Aktiviteti Sizmik	116
Fig 52- Shembuj të Degradimit të Ndërtesave të Parafabrikuara	116
Fig 53- Shembuj të Ndërhyrjeve nga Njerëzit	117
Fig 54- Shembuj të Dëmtimeve nga Aktiviteti Sizmik	117
Fig 55- Shembuj Dëmtimi i Armaturës	118
Fig 56- Dëmtimet në Ndërtesa prej Betoni të Armuar për Shkak të Tërmetit: Dëmtim i Kolonës; Dëmtim i Mureve Ndarës; Fenomeni i Kolonës Së Shkurtër	118
Fig 57- Shkolla Filllore në Lezhë (Muraturë e Papërforcuar; Dëmtime Strukturore të Murit Mbajtës (DS5)	119
Fig 58- Gjeologjia	123
Fig 59- Harta e Rrezikut Gjeologjik	125
Fig 60- Sistemi Hidrik në Bashkinë Lezhë	127
Fig 61- Zjarr në Shëngjin	135
Fig 62- Skenarët e Ndryshimit të Temperaturave	136
Fig 63- Foto Lezha Borë	138
Fig 64- Foto Dëme të Shkaktuara nga Era	139
Fig 65- Ndryshimi i Vijës Bregdetare	141
Fig 66- Përmbajtje Detare	143

Fig 67- Përmblytje Ishull Shëngjin.....	144
Fig 68- Foto Përmblytje Detare Shëngjin	144
Fig 69- Rreshjet Vjetore	146
Fig 70- Distanca në Km Dhe në Kohë e NJ-VA nga QSUT Tiranë	147
Fig 71- Distanca në Km dhe në Kohë e NJA Drejt Spitalit Rajonal Lezhë	147
Fig 72- Analiza e Distancës së Vendbanimeve nga Qendra Shëndetësore më e Afërt	148
Fig 73- Analiza e Cënueshmërisë nga Rreziku Sizmik.....	150
Fig 74- Përmbledhëse Cënueshmëria nga Rreziku Sizmik	151
Fig 75- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Përmblytjet.....	152
Fig 76- Cënueshmëria nga Përmblytjet.....	153
Fig 77- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Rrëshqitja e Tokës dhe Rënia e Gurëve.....	154
Fig 78- Cënueshmëria Nga Rrëshqitja E Tokës Dhe Rënia E Gurëve	155
Fig 79- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Rreziku i Zjarrit	156
Fig 80- Cënueshmëria nga Rreziku i Zjarrit.....	157
Fig 81- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Era dhe Bora.....	159
Fig 82- Cënueshmëria ndaj Rrezikut të Erës dhe Borës	159
Fig 83- Cënueshmëria në Aktivitete Ekonomike nga Rreziku i Pandemisë	160
Fig 84- Cënueshmëria Sociale ndaj Pandemive	161
Fig 85- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore ndaj Rritjes së Nivelit të Detit Dhe Ndryshimit Të Regjimit Të Rreshjeve.....	162
Fig 86- Cënueshmëria Fizike, Ekonomike, Sociale, Mjedisore E Kulturore ndaj Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike në Thatësira, Zjarre e Rritje të Temperaturave	163
Fig 87- Harta Përmbledhëse ndaj Ndryshimeve Klimatike	164
Fig 88- Analiza Multi-Rrezik Sociale, Ekonomike, Fizike, Mjedisore, Kulturore	165
Fig 89- Analiza Multi-Rrezik	166
Fig 90- Konkluzione Analiza sipas Njërive Administrative dhe Rrezikut.....	167
Fig 91- Harta e Riskut Sizmik (i moderuar).....	169
Fig 92- Harta e Riskut Gjeologjik (i ulët).....	170
Fig 93- Harta e Riskut nga Përmblytjet (i lartë).....	171
Fig 94- Harta e Riskut nga Zjarri (Shumë i lartë).....	172
Fig 95- Harta E Riskut Meteorologjik (Shumë I Lartë)	172
Fig 96- Harta Multirisk Në Territor, Ekspozimi Dhe Elementët E Riskuar	174
Fig 97- Harta Multirisk Në Territor, Ekspozimi Dhe Elementët E Riskuar	175

LISTA E GRAFIKËVE

Grafik 1- Ecuria e Burimeve Financiare në Periudhën 2010-2018.....	75
Grafik 2- Burimet Financiare sipas Kategorive	75
Grafik 3- Të Ardhurat nga Taksat (majtas) dhe nga Tarifat Vendore (djathtas).....	76
Grafik 4- Struktura e Shpenzimeve (majtas); Ecuria e Shpenzimeve Kapitale (djathtas)	76
Grafik 5- Shembuj të Spektrit të Reagimi Bazuar në EN-1998.....	110

LISTA E TABELAVE

Tabela 1- Nr i Çadrave dhe Familjeve të Strehuara gjatë Tërmetit 26 Nëntor 2019.....	101
Tabela 2- Vlerat e PGA për Njësi të Ndryshme Administrative të Bashkisë Lezhë në Kushtet e Truallit me Probabilitet 10% / 10 Vjet dhe 10% / 50 Vjet.....	103
Tabela 3- Klasifikimi i Tipologjisë së Sistemit Struktural.....	111
Tabela 4- Kalendarit i Eventeve Sizmike, Lezhë	118
Tabela 5- Kalendarit i Gjeorrezive Lezhë 2017-2020.....	124
Tabela 6- Ngjarje Historike Përmbajtje (evente masive).....	131
Tabela 7- Ngjarje Historike, Zjarre.....	135
Tabela 8- Ngjarje Historike, Stuhi Ere/Bore	139
Tabela 9- Skenarët e Rritjes së Nivelit të Detit	144
Tabela 10- Tabela Finale e Pikëzimit për Secilin Rrezik, nisur nga Indikatorët dhe 4 Komponentët e Riskut.....	167
Tabela 11- Matrica për Vlerësimin e Rriskut	167
Tabela 12- Tabela e Kalendarit Sezonal.....	172
Tabela 13- Probabiliteti i Rrezkut.....	174
Tabela 14- Vlerësimi i Elementëve të Riskut.....	175
Tabela 15- Vlerësimi i Cenueshmërisë	177
Tabela 16- Vlerësimi i Kapaciteteve	178
Tabela 17- Popullsia sipas Njësive Administrative.....	27
Tabela 18- Kontributi ndër vite i VSHB së Qarkut Lezhë në Raport me Totalin.....	28
Tabela 19- Ndërmarrjet Aktive në Qark sipas Peshës në Raport me Nivelin Kombëtar në %	28
Tabela 20- Aktivitete Ekonomike sipas Sektorit dhe Njësive Administrative	28
Tabela 21- Numri i Fermave sipas NjA.....	29
Tabela 22- Prodhimi sipas Kulturave në Ton	30
Tabela 23- Struktura Akomoduese në Bashkinë Lezhë	31
Tabela 24- Institucione Arsimore në Bashkinë Lezhë	31
Tabela 25- Infrastruktura Rrugore e Bashkisë Lezhë Sipas Kodit Rrugor	33
Tabela 26- Gjendja e Rezervuareve në Bashkinë Lezhë	40

Tabela 27- Hidrovorët në Bashkinë Lezhë	41
Tabela 28- Kanelet Kulluese dhe Vaditëse sipas Kategorisë në KM Linear	43
Tabela 29- Gjendja e Kanaleve Kulluese dhe Vaditëse	44
Tabela 30- Kanalet sipas Llojit	44
Tabela 31- Llojet e Përmbytjeve sipas Shkakut dhe Sipërfaqes në Ha	45
Tabela 32- Rezultatet e Monitorimit të Ujrave të Lumit Drin në Stacionin e Lezhës.....	57
Tabela 33- Gjendje e Cilesisë së Lumit Drin ndër Vite.....	57
Tabela 34- Numri i Automjeteve në Bashkinë Lezhë.....	63
Tabela 35- Rezultatet e Monitorimit të Zhurmave në Qytetin e Lezhës.....	63
Tabela 36- Sasia e Mbetjeve Urbane	65
Tabela 37- Lista e Plotë e Monumenteve Kulturore dhe Trashëgimisë Historike	72

SHKURTESAT

AdZM	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
BE	Bashkimi Evropian
INSTAT	Instituti i Statistikave
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (International Union for Conservation of Nature)
KRRTRSH	Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (Sot Këshilli Kombëtar i Territorit)
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
Nj.E.F	Njësi Ekonomike Familjare
NJA	Njësi Administrative
OBSH	Organizata Botërore e Shendetësisë
PAK	Person me Aftësi të Kufizuar
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PGA	Harta e Vlerave të Përshpejtitimit
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
SPA	Zonë Veçanërisht e Mbrojtur (Specially Protected Area)
VSHB	Vlera e Shtuar Bruto

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE


UNDP në bashkëpunim me MetroPOLIS, Co-PLAN dhe Bashkinë Lezhë kanë hartuar raportin për vlerësimin e risqeve të fatkeqësive natyrore. Ky raport është një hap i parë dhe i rëndësishëm në plotësimin e kërkesave ligjore në nivelin vendor në fushën e mbrojtjes civile.

Kuadri i ri ligjor, që filloi me miratimin në 18/07/2019 të ligjit “Për Mbrojtjen Civile” përcakton se autoritetet në nivel vendor duhet të hartojnë vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë, strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planet vendore të emergjencave civile. Baza ligjore është ende e re dhe e pa testuar në zbatimin e saj në Shqipëri. Si rrjedhojë, ky projekt pilot, ndihmon në zbatimin e parashikimeve ligjore dhe ngritjen e një metodologjie dhe procedure institucionale në plotësimin e kërkesave.

Duke parë shumëllojshmërinë e rreziqeve me të cilat përballen Bashkia Lezhë, u dakordësua që ky projekt pilot të zhvillohet në këtë bashki për të testuar edhe metodologjinë në kushte të ndryshme rreziqesh. Gjithashtu, ky projekt përtej faktit që do t'i shërbejë Bashkisë Lezhë për të përmirësuar më tej masat dhe kërkesat ligjore në Mbrojtjen Civile do të shërbejë dhe si model metodologjik e praktik për bashkitë e tjera. Projekti ka në qendër të vëmendjes bashkëpunimin e lartë institucional dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme komunitare me qëllim institucionalizimin e kulturës së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe ngritjen e kapaciteteve vendore në këtë fushë.


Raporti është hartuar nëpërmjet një procesi të hapur, transparent e gjithëpërfshirës, me një pjesëmarrje të gjerë institucionale e komunitare me qëllim që të ngrihen kapacitetet vendore institucionale e komunitare në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive. Aftësia ripërtëritëse (Resilience) tashmë është kthyer në një koncept drejtues për politikëbërjen e lidhur me zhvillimin hapësinor dhe veçanërisht përsa i përket riskut të fatkeqësive. Koncepti i aftësisë ripërtëritëse ka evoluar në kohë dhe ka përkufizime të ndryshme, por një gjë e cila është konvergjente në të gjitha rastet është aftësia e një vendi, autoriteteve dhe sistemeve socio-ekologjike për t'u rimëkëmbur pas një krize (Davoudi, 2019).

Nga pikëpamja metodologjike projekti aplikon një qasje gjithëpërfshirë dhe të integruar. Planifikimi me pjesëmarrje shihet si një metodë optimale, pasi a) mundëson evidentimin e problematikave specifike në territor në një situatë mungese të dhënash vjetore dhe mikro; b) ka qëllimin e dyfishtë të trajnimit të komunitetit dhe instancave të tjera institucionale nëpërmjet përfshirjes në projekt. Projekti ka në qendër të vëmendjes bashkëpunimin institucional dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme komunitare me qëllim institucionalizimin e kulturës së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive edhe ngritjen e kapaciteteve vendore në këtë fushë. Nga pikëpamja metodologjike janë duke u përdorur këto instrumente: a) Vizita dhe vëzhgime të drejtpërdrejta në terren; b) Intervista të gjysmë-strukturuara me palë interesi (qytetarë, ekspertë, biznese, etj.); c) Hartëzim me pjesëmarrje i rrezikut; ç) Fokus grupe tematike (varësisht llojit të rrezikut, riskut dhe sektorit); d) Hartimi me pjesëmarrje i kalendarëve sezonale dhe Historik të rrezikut; e) Vlerësimi i rrezikut në platformën GIS. Ky vlerësim është kryer në bazë të 5 kriterëve:



- ndikimit fizik (ndikimi në ndërtesa, mjedis të ndërtuar, struktura socio-ekonomike; infrastruktura etj)
- ndikimi social (analizë e vulnerabilitetit social kundrejt rrezikut nga një rrezik i caktuar)
- ndikimi ekonomik (ndikimi që një fatkeqësi e caktuar natyrore/ biologjike mund të ketë mbi strukturat që zhvillojnë aktivitete ekonomike në Lezhë)
- ndikimi mjedisor (ndikimi që një fatkeqësi e caktuar mund të ketë në zona mjedisore, zona të mbrojtura, monumente natyre, brigje ujore, trupa ujorë, dhe çdo element tjetër mjedisor)
- ndikimi kulturë (ndikimi në trashëgiminë kulturore dhe historike)

Për secilin prej komponentëve të mësipërm janë përcaktuar një sërë indikatorësh. Pasi është kryer vlerësimi në secilimin prej pesë faktorëve, më pas është kryer vlerësimi kumulativ për secilin rrezik. Në fund, rreziqet janë përmbledhur në një finale me shumë-risqe. Si konkluzion, në mënyrë të sintetizuar, nga analizat e vlerësimit të rrezikut dhe të çënueshmërisë, për secilën njësi administrative mund të thuhet sa më poshtë:



Siç mund të dallohet nga më sipër, cënueshmëria më e lartë nga përmbytjet është në njësitë administrative Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Ballëdren dhe në qytet Lezhë. Cënueshmëria më e lartë nga rrëshqitjet dhe rrëshqitjet e tokës është në zonën e njësive administrative Kolsh, Zejmen, Lezhë dhe në Shëngjin e Ballëdren përveçse i përket rënies së gurëve. Riskut më i madh nga zjarret është në njësitë administrative Kallmet e Ungrej. Kjo vjen si rezultat i masiveve të mëdha pyjore dhe duke faktorizuar rritjen e thatësirave e të temperaturave si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Vulnerabiliteti më i madh nga rreziku i erës gjendet në njësitë administrative Ballëdren, Shënkoll e Shëngjin, ndërkohë që nga dëborat është në njësinë administrative Ungrej. Përveçse i përket riskut të pandemisë, cënueshmëria më e madhe është në njësitë administrative Ungrej, Kolsh, Zejmen si rezultat i kombinimit të faktorëve moshë popullore, aksesueshmëri dhe ndihmë ekonomike.

HYRJE

1.1 KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM

Në periudhën 2019-2020 Shqipëria është përballur me dy ngjarje të rëndësishme e katastrofike në fushën e mbrojtjes Civile. Tërmeti i Shtatorit 2019 dhe veçanërisht ai i 26 Nëntorit 2019 u shoqëruan me pasoja të mëdha materiale dhe në jetë njëjërëzish për vendin dhe kryesisht qarqet Tiranë e Durrës. Këto ngjarje risollën në vëmendje të autoriteteve vendore e qendrore nevojën për tu përgatitur dhe kushtuar vëmendje të veçantë në fushën e mbrojtjes civile dhe në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive (Toto, 2020). Ndërkohë, fillim viti 2020 u shoqëruar me shpërhapjen e pandemisë COVID-19 e cila u përhap edhe në Shqipëri duke sfiduar sa sistemin shëndetësor ashtu dhe atë qeverisës në përballimin e krizës (Toto, et al., 2020).

Zvogëlimi i Riskut të fatkeqësive dhe rritja e aftësisë ripërtëritëse të komuniteteve është kthyer në një prioritet global. Në këtë aspekt, autoritetet vendore pritet të luajnë një rol të rëndësishëm duke qënë se janë ato të cilat përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me komunitetin dhe fatkeqësitë. Si rrjedhojë, PNUD në bashkëpunim me MetroPOLIS, Co-PLAN dhe Bashkinë Lezhë kanë hartuar raportin për vlerësimin e risqeve të fatkeqësive natyrore dhe të prioriteteve strategjike për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive. Ky raport është një hap i parë dhe i rëndësishëm në plotësimin e kërkesave ligjore në nivelin vendor në fushën e mbrojtjes civile. Kuadri i ri ligjor, që filloi me miratimin në 18/07/2019 të ligjit “Për Mbrojtjen Civile” përcakton se autoritetet në nivel vendor duhet të hartojnë vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë, strategjinë vendore për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planet vendore të emergjencave civile. Baza ligjore është ende e re dhe e pa testuar në zbatimin e saj në Shqipëri. Si rrjedhojë, ky projekt pilot, ndihmon në zbatimin e parashikimeve ligjore dhe ngritjen e një metodologjie dhe procedure institucionale në plotësimin e kërkesave.

Bashkia Lezhë përballlet me një shumëllojshmëri rreziqesh nga fatkeqësitë natyrore të cilat vijnë si rrjedhojë e pozicionit të saj gjeografik. Lezha është e rrezikuar nga përmbytjet e lumenjve Drin e Mat dhe njëkohësisht nga përmbytjet detare. Po ashtu, përshpejtimi i ndikimeve të ndryshmeve klimatike, të manifestuara me një rritje të nivelit detar dhe ndryshim të regjimit të rreshjeve, rrit probabilitetin e shtimit të fatkeqësive natyrore në të ardhmen në formën e përmbytjeve (Le Tissier, et al., 2013). Tërmeti i nëntorit 2019, edhe pse nuk e ka dëmtuar Lezhën në të njëjtin nivel me bashkitë e qarqeve Durrës e Tiranë, risolli në vëmendje një rrezik permanent. Ndërkohë, rreziqe të tjera si rrëshqitja e tokës, rënia e gurëve dhe shkëmbinjve, zjarret apo bllokimi nga dëbora (Bashkia Lezhë, 2018) edhe pse më të vogla në dëme që shkaktajnë janë gjithmonë prezente në territorin e bashkisë.

Duke parë shumëllojshmërinë e rreziqeve me të cilat përballlet Bashkia Lezhë, u dakordësua që ky projekt pilot të zhvillohet në këtë bashki për të testuar edhe metodologjinë në kushte të ndryshme rreziqesh. Gjithashtu, ky projekt përtej faktit që do t'i shërbejë Bashkisë Lezhë për të përmirësuar më tej masat dhe kërkesat ligjore në Mbrojtjen Civile do të shërbejë dhe si model metodologjik e praktik për bashkitë e tjera. Projekti ka në qendër të vëmendjes bashkëpunimin e lartë institucional dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme komunitare me qëllim institucionalizimin e kulturës së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe ngritjen e kapaciteteve vendore në këtë fushë.

Ky raport përmban vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore në Bashkinë Lezhë. Raporti është bazuar në metodologji dhe eksperiencë ndërkombëtare në fushën e zvogëlimit të riskut të zhvilluara kryesisht nga UNDP. Raporti bazohet në parimet dhe objektivat e kuadrit Sendai (UNISDR, 2015), të cilat janë të përfshira në kuadrin e ri ligjor Shqiptar, dhe në disa përvoja ndërkombëtare të suksesshme në fushën e zvogëlimit të riskut si ato të Armenisë, Kroacisë e Italisë.

Sa më sipër, raporti është hartuar nëpërmjet një procesi të hapur, transparent e gjithëpërfshirës, me një pjesëmarrje të gjerë institucionale e komunitare me qëllim që të ngrihen kapacitetet vendore institucionale e komunitare në reduktimin e rrezikut të fatkeqësive.

1.2 METODOLOGJIA E PUNËS PËR VLERËSIMIN E RISKUT TË FATKEQËSIVE NATYRORE

Aftësia ripërtëritëse (Resilience) tashmë është kthyer në një koncept drejtues për politikëbërjen e lidhur me zhvillimin hapësinor dhe veçanërisht për sa i përket riskut të fatkeqësive. Koncepti i aftësisë ripërtëritëse ka evoluar në kohë dhe ka përkufizime të ndryshme, por një gjë e cila është konvergjente në të gjitha rastet është aftësia e një vendi, autoriteteve dhe sistemeve socio-ekologjike për t'u rimëkëmbur pas një krize (Davoudi, 2019). Në këtë sens, koncepti është gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional duke përfshirë jo vetëm rimëkëmbjen inxhinierike në territor por edhe faktorë të shumtë socialë dhe ekologjikë. Aftësia ripërtëritëse dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive kanë marrë një vëmendje të rëndësishme në nivel global. Kjo gjë vërehet në prioritetet e Kuadrit Sendai, në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara ashtu edhe në Anxhendën e Re Urbane (UN Habitat, 2016) dhe Axhendën Urbane të Bashkimit Evropian (Informal Meeting of EU Ministers Responsible for Urban Matter, 2016). Të gjitha këto dokumente strategjike globale vendosin një theks të rëndësishëm dhe tek autoritetet vendore duke qënë se impakti më i madh i krizave është gjithmonë në nivel lokal. Si rrjedhojë, institucionet vendore duhet të jenë të përgatitura si nga ana e kapaciteteve njerëzore, financiare e teknike ashtu dhe nga pikëpamja e instrumentave të cilët përdoren për të qeverisur territorin.


Duke marrë në konsideratë sfidat në të cilat gjendet Shqipëria për sa i përket ZRF apo dhe aplikimit të konceptit të aftësisë ripërtëritëse, ku nga njëra anë ka një ligj të ri dhe nga ana tjetër ka një mungesë eksperiencë (Toto, 2020) dhe kulture në nivel vendor për sa i përket ZRF, atëherë metodologjia e zbatimit të projektit kthehet në një instrument shumë të rëndësishëm jo vetëm për përgatitjen e instrumentave por edhe për trajnimin e stafit të bashkisë. Përtej këtij aspekti, një tjetër sfidë e cila kushtëzon zbatimin e projektit është gjetja e të dhënave dhe databazave të cilat janë të përditësuara dhe të plota si në nivel vendor ashtu dhe në atë qëndror. Edhe pse gjatë procesit të hartimit të Planeve të Përgjithshme Vendore pati një angazhim të mirë për të unifikuar dhe krijuar disa databaza fillestare, çështja e të dhënave vijon të mbetet ende problematike.

Nga pikëpamja metodologjike projekti aplikon një qasje gjithëpërfshirë dhe të integruar. Planifikimi me pjesëmarrje shihet si një metodë optimale, pasi a) mundëson evidentimin e problematikave specifike në territor në një situatë mungese të dhënash vjetore dhe mikro; b) ka qëllimin e dyfishtë të trajnimit të komunitetit dhe instancave të tjera institucionale nëpërmjet përfshirjes në projekt. Projekti ka në qendër të vëmendjes bashkëpunimin institucional dhe pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme komunitare me qëllim institucionalizimin e kulturës së zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe ngritjen e kapaciteteve vendore në këtë fushë.

Nga pikëpamja metodologjike janë duke u përdorur këto instrumente: a) Vizita dhe vëzhgime të drejtpërdrejta në terren; b) Intervista të gjysmë-strukturuara me palë interesi (qytetarë, ekspertë, biznese, etj.); c) Hartëzim me pjesëmarrje i riskut; ç) Fokus grupe tematike (varësisht llojit të

rrezikut, rrezikut dhe sektorit); d) Hartimi me pjesëmarrje i kalendarëve sezonale dhe Historikë të rrezikut; e) Vlerësimi i riskut në platformën GIS. Kjo metodologji është hartuar në përputhje me kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe njohurinë shkencore e praktike të platformës përkatëse të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive. Vizitat në terren janë kryer në bashkëpunim me përfaqësues të Bashkisë Lezhë dhe në disa raste

FIG 1- Kuadri Metodologjik



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

me përfaqësues të sektorit të Mbrojtjes Civile në Prefekturën Lezhë. Këto vizita janë fokusuar në evidentimin e problematikave në terren dhe në skanimin e situatës aktuale. Është e rëndësishme që të përmendet, që janë zhvilluar dhe vizita specifike në terren nga inxhinierë specialistë të fushës së gjeologjisë, hidro-gjeologjisë, sizmikës dhe inxhinierisë së ndërtimit për të dhënë një opinion të informuar në lidhje me rreziqet e ndryshme. Ekspertiza gjeologjike, sizmike dhe inxhinierisë së ndërtimit paraqitet si në tekstin e këtij raporti ashtu edhe të bashkangjitura si Shtojca si raporte të veçanta ekspertize.

Gjatë vizitave në terren, për të krijuar një panoramikë sa më të qartë të zonës, apo për të vëzhguar dhe zona të cilat nuk ishin të aksesueshme për grupin e ekspertëve janë kryer dhe matje me dron. Këto matje janë kryer kryesisht në zonën e Ultësirës Perëndimore për të kuptuar situatën në lidhje me kanalet e kullimit dhe të vadiqes apo problematika të tjera të lidhura me rrjetin hidrik të zonës.

FIG 2- Imazhe me Dron në Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, PNUD, Bashkia Lezhë (2020)


Përtej kësaj, gjatë vizitave në terren janë kryer intervista me administratorët e njësive administrative, përfaqësues dhe inxhinierë në njësi administrative, anëtarë të komunitetit. Në shtojcë, mund të gjendet një kopje e formatit të intervistave të përdorura. Gjatë intervistave janë marrë dhe informacione në lidhje me kalendarin historik dhe sezonal të frekuencës së fatëkeqësive të ndryshme natyrore. Gjithashtu, këto vizita kanë shërbyer për të bërë dhe hartëzimin e rreziqeve me pjesëmarrje. Ky lloj hartëzimi ka qënë një kombimin midis informacioneve të marra nga ekspertët lokalë të njësive administrative dhe banorëve të zonës. Pas marrjes së informacionit nëpërmjet intervistave gjysëm të strukturuar, të dhënat janë hartëzuar dhe hedhur në databazën GIS nga ekspertët e MetroPOLIS, Co-PLAN. Më pas këto të dhëna janë validuar dhe një herë të dytë me ekspertët e Bashkisë Lezhë.

Në kuadër të planifikimit me pjesëmarrje janë kryer intervista dhe fokus grupe me institucione të lokale, rajonale dhe me organizata të ndryshme të cilat operojnë në territorin e Bashkisë Lezhë. Qëllimi i këtyre intervistave dhe diskutimeve ka qënë jo vetëm të kuptohet dhe të hartëzohen aktorët e ndryshëm në kuadër të ZRF por edhe të validohen gjetjet nga vizitat në terren. Pra në këtë rast, janë përdorur për qëllime të dyfishta. Gjithashtu, në fund është zhvilluar një fokus grup për të diskutuar gjetjet e analizës së vlerësimit shumë-dimensional të riskut me përfaqësues të Bashkisë Lezhë.

Një ndër aspektet më të rëndësishme të metodologjisë së përdor është ai i lidhur me Sistemet Informatike Gjeografike (GIS). Në këtë rast, fillimisht është bërë mbledhja dhe plotësimi i databazave me të dhënat e nevojshme për kryerjen e analizave. Në disa raste, si për shembull PPV databaza ka qënë ekzistuese, ndërkohë që në raste të tjera, është digjitalizuar nga grupi i punës, si për shembull në rastin e Kanaleve Kulluese e Vaditëse.

Vlerësimi i riskut është kryer duke u bazuar në metodat cilësore dhe sasiore të pikëzimit të riskut, si dhe vlerësimi bazuar në shumë rreziqe (multi-hazard). Një përshkrim të detajuar për metodologjinë e vlerësimit të riskut gjendet në kapitullin 3.

FIG 3- Metodologjia për Vlerësimin me Shumë Rreziqe



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Ndërkaq, për të kryer vlerësimin me shumë rreziqe është përdorur metodologjia e mëposhtme: Për secilin prej rreziqeve fillimisht është kryer analiza e thelluar. Kjo analizë synon të kuptojë rrezikun në komponentët e brendshëm të tij, si frekuencë, madhësi, intensitet, etj. Më tej është kryer një vlerësim i rrezikut bazuar në cënueshmëri / dhe ekspozim të elementëve të rrezikuar. Ky vlerësim është kryer në bazë të 5 kriterëve:

- ndikimit fizik (ndikimi në ndërtesa, mjedis të ndërtuar, struktura socio-ekonomike; infrastruktura etj)
- ndikimi social (analizë e vulnerabilitetit social kundrejt rrezikut nga një rrezik i caktuar)
- ndikimi ekonomik (ndikimi që një fatkeqësi e caktuar natyrore/ biologjike mund të ketë mbi strukturat që zhvillojnë aktivitete ekonomike në Lezhë)
- ndikimi mjedisor (ndikimi që një fatkeqësi e caktuar mund të ketë në zona mjedisore, zona të mbrojtura, monumente natyre, brigje ujore, trupa ujqorë, dhe çdo element tjetër mjedisor)
- ndikimi kulturë (ndikimi në trashëgiminë kulturore dhe historike)

Për secilin prej komponentëve të mësipërm janë përcaktuar një sërë indikatorësh. Pasi është kryer vlerësimi në secilimin prej pesë faktorëve, më pas është kryer vlerësimi kumulativ për secilin rrezik. Në fund, rreziqet janë përmbledhur në një finale me shumë-rreziqe. Vlerësimet janë kryer si në bazë indikatorësh ashtu edhe nëpërmjet përfaqësimit hartografik.

Më tej, ky vlerësim rreziku është përdorur si bazë për vlerësimin dhe pikëzimin e riskut, duke hartëzuar gjithashtu riskun në territor. Ky dokument furnizon më tej Strategjinë për Zvogelimin e Riskut, e cila merr në konsideratë gjetjet për të hartuar një plan të mirëfilltë investimesh dhe hapash që duhen ndërmarrë për të zvogëluar riskun e fatkeqësive.

1.3 KOMISIONI I MBROJTJES CIVILE BASHKIA LEZHË

Ngritja e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Bashki është një detyrim që rrjedh prej ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, specifikisht nga pikat 2 dhe 3 të nenit 29 të tij, Ky komisioni është vijimi i Komisionit Vendor të Emergjencave Civile të bashkisë i cili ka qenë detyrim ligjor në zbatim të nenit 16 të ligjit 8756, datë 26.03.2001, të ndryshuar. Ndërsa përbërja, detyrat dhe funksionimi i Komisionit Vendor të Emergjencave Civile të bashkisë ka qenë i përcaktuar me Udhëzimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit Nr. 15 datë 10.07.2003 “Për ngritjen e Komisionit Vendor të Emergjencave Civile, në Bashki dhe Komunë”, sipas pikës 3 të nenit 29 të ligjit 45/2019, “Përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisionit të Mbrojtjes Civile në bashki, miratohen me urdhër të kryetarit të bashkisë”.

Komisioni i Mbrojtjes Civile i Bashkisë Lezhë, përveçse një detyrim ligjor, do të përbënte edhe grupin respektiv të punës në bashki që do të bashkëpunonte ngushtë gjatë gjithë periudhës së implementimit të projektit me stafin e PNUD dhe MetroPOLIS, Co-PLAN të ngarkuar me implementimin e tij. Sipas nevojës, në takimet e Komisionit të Mbrojtjes Civile, për qëllime të implementimit të projektit pilot, do të thirreshin përfaqësues të institucioneve qendrore dhe degëve të tyre territoriale, Prefekti i qarkut, organizatat e ndryshme ndërkombëtare, subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare si dhe ekspertët private. Specifikisht për qëllime të implementimit të projektit, Komisioni do të ishte i përfshirë në:

- Vlerësimin e riskut në nivel vendor, dhe rekomandimet e hartuara për integrimin e RRF në planet e zhvillimit.
- Zhvillimin e Planit Vendor të Emergjencës Civile.
- Vlerësimin e Riskut GIS me shumë rreziqe të bazuar në shkencë.

Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Lezhë “Për ngritjen e Komisionit të Emergjencave Civile” u bazua në ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile” sikurse edhe në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile/PKEC të miratuar me VKM Nr.835, date 3.12.2004;

Anëtarët e Komisionit u caktuan nga struktura e administratës së Bashkisë Lezhë, duke përfshirë edhe 9 Kryetarët e Njësisve Administrative.

Në detyrat e Komisionit të Mbrojtjes Civile u përfshinë: roli si organ këshillues për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin në nivelin vendor nga Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive, Axfenda e Re Urbane, Axfenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Marrëveshja e Parisit për Ndryshimet Klimatike; roli si organ këshillues për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, Plani i qarkut për emergjencat si edhe Plani vendor për emergjencat civile; rolin si organ këshillues për të siguruar që të gjitha politikat dhe dokumentet strategjike të bashkisë të jenë të informuara rreth riskut nga fatkeqësitë dhe të jenë të pajisura me masa për ta zvogëluar atë sikurse edhe detyra të tjera.

Urdhëri shoqërohet edhe me një rregullore për funksionimin e brendshëm të Komisionit të Mbrojtjes Civile e cila ka si qëllim funksionimin e brendshëm të tij, të sekretarisë teknike, si edhe të marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të Komisionit. Shtojca 1 e rregullores përmban një listë të institucioneve qendrore dhe degëve territoriale, Prefektin e qarkut, organizatat e ndryshme ndërkombëtare, subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare si dhe ekspertët private që janë përmendur më lart.

1.5 PËRMBLEDHJE E KONTEKSTIT LOKAL DHE RREZIQEVE NË BASHKINË LEZHË

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e kontekstit lokal dhe rreziqeve në Bashkinë Lezhë. Analiza e plotë gjendet në Aneksin 1.


Pozicioni Gjeografik	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Lezhë ka 10 njësi administrative të cilat janë: Lezha, Shëngjini, Zejmeni, Shënkolli, Balldreni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi, me qendër Qytetin e Lezhës. Bashkia përbëhet nga dy zona urbane (Lezhën dhe Shëngjini) dhe 65 fshatra me një sipërfaqe prej 508.9 km². Kjo bashki ka një popullsi 106,245 banorë sipas të dhënave të Regjistrat Civil. Bashkia shtrihet në një zonë të ulët dhe bregdetare, me lartësi 5 metra mbi nivelin e detit dhe si pasojë një pjesë e territorit të Lezhës vazhdon të kërcënohet nga përmbytjet, të cilat shkaktojnë herë pas here dëme të konsiderueshme. Rreshjet lëkundën nga 950-1200mm shi në vit, temperaturat minimale absolute arrijnë vlerë -3 deri në -5°C maksimale absolute arrijnë vlerën 35-36°C, erërat arrijnë shpejtësitë maksimale në këtë zonë deri në 25 deri 30 m/s.
Popullsia	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Lezhë përbën rreth 49% të popullsisë të Qarut lezhë me një popullsi prej 65633 banorë sipas INSTAT 2011, sipas Gjendjes Civile kjo popullsi është rreth 43% më e lartë. Zona e Lezhës karakterizohet me një normë emigracioni të lartë që është shkak i ndryshim kaq të madh ndërmjet INSTAT dhe Gjendjes Civile. 21.4% e popullsisë është nën moshën 15 vjeç dhe 11.5% është mbi moshën 65 vjeç që do të thotë që kemi një popullsi kryesisht të re me një koeficient varësie të ulët në krahë me nivelin kombëtarë.
Zhvillimi Ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> PBB-ja në nivel kombëtar u rrit me 2.2% në vitin 2015 dhe kjo 0.4 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin e mëparshëm. Qarku Lezhë ka një kontribut mjaft të ulët në PBB Kombëtare diku tek 3% në raport me qarqet e tjera të Shqipërisë. Spektori më i zhvilluar është "Bujqësia, gjuetia dhe pyjet, peshkimi" me rreth 32.0% ndaj totalit në vitin 2015. Numri i ndërmarrjeve aktive ka pësuar rritje nga 2.8% në 3.5% të totalit kombëtarë.
Bujqësia	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Lezhë ka 18,496 hektarë tokë bujqësore dhe rreth 53% e sipërfaqes së bashkisë dhe 3% e totalit në nivel vendi. Çdo fermer mesatarisht disponon rreth 0.75ha tokë bujqësore tregues i cili është më i lartë se meatarja kombëtare me 0.6 ha tokë për fermer. Zona e Lezhës dallohet për prodhimtarinë e bimëve të arave dhe të pemtarisë me rendimente mjaft të larta në krahasim me nivelin kombëtar.
Turizmi	<ul style="list-style-type: none"> Spektori I turizmit ka njohur një rritje të konsiderueshme me rreth 15.2% të VSHB së mëparshme sektoriale. Bashkia Lezhë ka një kapacitet prej 3517 shtreterish dhe 120 stukturash akomoduese ku rreth 108 janë hotele. Turizmi luan rol të rëndësishëm në ekonominë lokale kryesisht turizmi bregdetar në zonë e Shëngjinit.

Arsimi	<ul style="list-style-type: none"> Në bashkinë Lezhë ne total 128 institucione arsimore ku 14 janë private. Në bashki ndodhen gjithashtu 47 objekte të arsimit parashkollor dhe 11 objekte të arsimit parauniversitar. Objektet e arsimit kanë një shpërndarje të mire territor por ato përgjithësisht nuk plotesojnë parametrat Teknik të tyre dhe janë të amrotizuara.
Shëndetësia	<ul style="list-style-type: none"> Qendrat shëndetsore kanë një shpërndarje të mire në territor por përgjithësisht nuk plotesojnë standardet teknike dhe inxhinierike. Bashkia Lezhë ka dy spitale dhe kapacitet 162 shtretër Sa i përket aksesit në qendra shëndetsore dhe në spital vetëm NjA Ungrej paraqet nivel aksesueshmërie të ulët si pasojë e aksesit rrugor mjaft të dobët. Sa i përket Pandemisë së Covid 19 Bashkia rrezulton në rreth 24 persona të prekur në momentin kur është zhvilluar analiza. Bashkia Lezhë ka ndërmarre masa lehtësuese për bizneset dhe është angazhuar në luftën kundër covid 19 me anë të ndihmave të ndryshme si dhe në ndihmën e shtresave në nevojë.
Infrastruktura Rrugore	<ul style="list-style-type: none"> Infrastruktura rrugore në këtë bashki zë 1216.2 km linear ku afërsisht 80% e mbulojnë rrugët lokale. Rrugët bujqësore zënë 45% të infrastrukturës rrugore dhe shtrihen në ultësirën perëndimore. Bujqësia është një potencial mjaft i rëndësishëm i cili nuk shfrytëzohet në maksimum sepse banorët kanë frikë të investojnë sepse përmbytjet janë një fenomen me rrezik të lartë në këtë bashki duke parë që disa zona ndodhen në nivelin e detit Në qytet mbizotërojnë urbane kryesore, urbane dytesore dhe urbane lokale që në nivel bashkie nuk zënë një rol të rëndësishëm (1.7% të të gjithë infrastrukturës rrugore). 20% e infrastrukturës rrugore është e shtruar me asfalt ku mund të përmendim rrugën nacionale si dhe rrugët që ndodhen në qytet. 80% e infrastrukturës përbën problem për zhvillimin normal të qarkullimit duke parë dhe rrezikun e përmbytjeve kryesisht në periudhën e dimrit. Infrastrukturat problematike sic janë urat në aksin rrugor Pllanë-Manati-Lezhë janë kryesisht të amortizuara në shumë raste këto ura bëhen shkaktare të përmbytjeve në zona të caktuara sepse pengojnë sasinë e ujit të kalojë në të.
Ujësjellës Kanalizimet	<ul style="list-style-type: none"> Sistemi i ujësjellësit shërben rreth 85% të popullatës me ujë dhe rreth 15% nuk kanë ujë në shtëpitë e tyre ku pjesa më e madhe ndodhen në zonën rurale të Bashkisë Lezhë. Pavarësisht ndërhyrjeve të kryera në pjesë të veçanta të tij, rrjeti shpërndarës i ujit të pijshëm në gjithë territorin e Bashkisë Lezhë paraqitet i amortizuar NJA Lezhë dhe Shëngjin përgjithësisht kanë sisteme të kanalizimeve të ujërave të zeza ndërsa zonat e tjara ky sistem mungon në masën 90%.
Infrastruktura Energjitike	<ul style="list-style-type: none"> Shërbimi i furnizimit me energji elektrike është i vazhdueshëm gjatë 24 orëve për qytetarët dhe bizneset. Problematikat e furnizimit me energji në TL për shkak të ndërtimit të tij në ultësirë, ka bërë që nënstationi të përmbytet disa herë nga vërshimet e ujrave duke bërë që energjia elektrike të nderpritet për arsye sigurie. Linjat e tensionit të mesëm përbehen në 16 fidëra nga të cilat pjesa dërmuese është me linjë ajrore. Gjendja aktuale e linjave ajrore paraqitet në kushte të këqija dhe jashtë normave të sigurimit teknik.

<p>Infrastruktura Bujqësore dhe Mbrojtëse</p>	<ul style="list-style-type: none"> Në Bashkinë Lezhë ndodhen 5 Rrezervuarë, prej të cilëve katë janë në gjendje të dobët dhe mesatare, dhe vetëm një është në gjendje të mirë. Hidrovorët në Bashkinë Lezhë, janë të instaluar në zonat informale, ku sipërfaqja e tokës bujqësore që kullohet është rreth 7000ha. Gjithashtu është e domosdoshme vendosja e linjave direkt me N/stacionin elektrik Lezhë, për hidrovorin e Ishull-Shëngjinit, pasi në rastet e shkëputjes së energjisë elektrike në zonë, rrezikohen nga përmbytja mbi 100 banesa në fshatin Ishull-Shëngjin, lagjet Shaljanë dhe ajo Xhenio. Në Qarkun Lezhë ka rreth 123.5 km linear argjinatura nga të cilat rreth 85% e tyre ndodhet në Bashkinë Lezhë. Argjinaturat janë 3 llojesh: argjinaturat detare të cilat mbrojnë tokën nga ujërat detar; argjinaturat e lumenjve; dhe argjinatura e kanaleve kulluese dhe kanaleve të ujrave të larta. Në Bashkinë Lezhë gjendja e sistemit të kullimit dhe e veprave mbrojtëse nga përmbytjet nuk është e mirë si rezultat i amortizimit në vite.
<p>Kanalet Kulluese dhe Vaditëse</p>	<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Lezhë ka rreth 1183 m linear kanale kulluese dhe vaditëse ku 12.8% janë kanale të parë 28.9% kanale te dytë dhe 58.3% kanale te tretë. Kanalet e parë janë të mirëmbajtur në masën 29.88%, pjesërisht të mirëmbajtur në masën 47.88% dhe të pamirëmbajtur në masën 22.85%. Kanalet e dytë janë të mirëmbajtur në masën 13.36%, pjesërisht të mirëmbajtur në masën 39.93% dhe të pamirëmbajtur në masën 46.72%. Kanalet e tretë janë të mirëmbajtur në masën 8.78%, pjesërisht të mirëmbajtur në masën 21.35% dhe të pamirëmbajtur në masën 69.82%.
<p>Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës</p>	<ul style="list-style-type: none"> Zonat e mbrojtura natyrore që ndodhen në territorin e Bashkisë së Lezhës përbejnë 15 % të sipërfaqes së saj ku permendim Zonën e mbrojtur të Kune-Vain-Tale dhe Zonën e mbrojtur të Bërzanës si dhe 11 monuente natyre të shpërndara në territor. Kryesisht këto zona natyrore ndodhen në kërcënim të vazhdueshëm nga veprimtaria njerzore të cilat kanë efekte negative në këto zona natyrore. Këtu vlen të përmendim nertimet në zonën e Kune-Vainit.
<p>Zhvillimet Urbane</p>	<ul style="list-style-type: none"> Përgjithësisht qyteti i Lezhës ka densitet të ulët, me intensitet mesatar 1.5. Zona e tipologjisë mikse qendrore arrin intensitet 3.5, ndërsa zonat e tjera mesatarisht nga 0.8 në 1.5. Në pjesën më të madhe të qendrës së qytetit distancat rrespektohen por evidentohen edhe raste te shumta ku distancat ndërmjet ndërtimeve nuk respektohen. Në zona të tilla me distanca minimale rrezikohen nga evente të mundshme sizmike, për shkak të efektit domino të rënies së ndërtesave, aksesin më të dobët në to nga mjetet e emergjencës, si dhe mundësive më të kufizuara të evakuimit. Analiza e kryer për qytetin e Lezhës tregon se ka dy kategori rezultatesh: lidhshmëri aksiale e mirë dhe normale për zonën qendrore të qytetit, si dhe lidhshmëri të dobët për pothuajse gjithë pjesën tjetër të qytetit.

Burimi: Autorët

ANALIZA E RREZIQEVE DHE VLERËSIMI I RISKUT



Ky raport adreson 4 hapat e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive natyrore: parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen, me theks të veçantë në 2 pikat e para. Për të programuar masat që duhet të ndërmerren bashkia për parandalimin e risqeve dhe përgatitjen ndaj tyre, është e nevojshme të kryhet vlerësimi i riskut, bazuar në 3 hapa kryesorë¹ (të shprehur në 3 kapitujt në vijim në këtë raport):

- Identifikimi i rreziqeve dhe përshkrimi i tyre
- Analiza e thelluar e rreziqeve (vlerësimi i cënueshmërisë)
- Vlerësimi i riskut (sipas metodave të parashtruara në seksionin më poshtë)

Ndërkaq, faza e përgjigjes dhe rimëkëmbjes afatshkurtër mbulohet plotësisht nga Plani i Emergjencave Civile.

Parandalimi i riskut të fatkeqësive është shumë-dimensional dhe lidhet me disa procese, si:

- Krijimi i një database të thelluar territoriale mbi elementët që ndikohen nga rreziqet: popullsia, ndërtesat, infrastruktura kritike, etj.
- Evidentimin e rreziqeve dhe periodicitetit të tyre në mënyrë të saktë dhe gjithëpërfshirëse: hartim i kalendarëve historike e sezonale, intervista me eksperte dhe përfaqësues të komunitetit, etj.
- Vlerësimin e impaktit të rreziqeve në territor, bazuar në mjetet GIS, si dhe hartëzim me pjesëmarrje
- Ngritja e një sistemi shumë-kriterësh për të konvertuar rrezikun në risk. Ky hap është domethënës për parashikim të bazuar në fakte, si dhe për hartimin e prioritarizimit të masave për ZRF.

Më tej, me vlerësimin dhe hartëzimin e riskut, bashkia ka zhvilluar vizionin dhe objektivat për ZRF, të konkretizuar më tej në masa dhe plan veprimi. Në vazhdim, bazuar në vlerësimin e riskut dhe planin e masave, ky dokument propozon disa skenare të zvogëlimit të riskut, bazuar në 2-3 alternativa për secilin.

2.1 METODOLOGJIA

Risku i fatkeqësive përcaktohet si humbja e mundshme e jetës, lëndimi ose pasuritë e shkatërruara ose të dëmtuara që mund t'i ndodhin një sistemi, shoqërie ose një komuniteti në një periudhë specifike kohore, të përcaktuar në mënyrë të mundshme si një funksion i rrezikut, ekspozimit, cënueshmërisë dhe kapacitetit. (Raporti i Grupit të Hapur Ndërqeveritar të Punës së Ekspertëve për treguesit dhe terminologjinë në lidhje me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë. 2016). Mënyrat e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë natyrore janë të shumta, por përgjithësisht dakordësohet që risku është produkt i probabilitetit të një rreziku, me impaktin e tij.

Risk = Impakt x Probabilitet i ndodhjes

Ky raport konsideron ekuacionin e mësipërm, duke e zbërthyer në 3 shtylla kryesore, për të mundësuar një kategorizim më gjithëpërfshirës të riskut, bazuar në metoda vlerësimi cilësore dhe sasiore.

¹ Bazuar në Risk Assessment and Mapping Guidelines for Disaster Management përbëhet nga risk identification, risk analysis and risk evaluation (Brussels, 21.12.2010 SEC(2010))

1. Rreziku

Evidentimi i rreziqeve është hapi kryesor për vlerësimin e riskut. Së pari bëhet klasifikimi i rreziqeve, me fokus kryesor në lidhjen shkak-pasojë mes tyre. Më tej, bazuar në databazën e krijuar me pjesëmarrje, me studime të thelluara, apo rishikim dokumentesh relevante, bëhet hartëzimi i rrezikut në territor. Në vijim ky informacion plotësohet me detaje mbi periodicitetin e rrezikut, normën e kthimit, kohëzgjatjen, etj. Bazuar në hartëzim, kryhet dhe shtrirja e efekteve të rrezikut nga pikëpamja fizike, duke identifikuar zonat e mundshme të impaktit.

2. Elementet në risk


Këta janë elementët e ekspozuar ndaj rrezikut. Bazuar në klasifikimin e kryer në studimin e vulnerabilitetit, për Bashkinë Lezhë këto elemente janë klasifikuar si: fizikë, socialë, ekonomikë, natyrorë dhe kulturorë. Nënkatëgoritë përfshijnë: objektet e banimit, objektet socio-kulturore, zonat e mbrojtura, grupet vulnerabël, popullsinë banuese, etj.

3. Cënueshmëria

Duke kombinuar rrezikun dhe elementët në risk, bëhet dhe vlerësimi i cënueshmërisë, ose relevancës së rrezikut mbi elementet në risk. Në thelb, ky indikator mat se sa dëmtohen elementet në risk prej rrezikut të shfaqur. Ky vlerësim është kryesisht cilësor, por bazohet mbi metodologji empirike dhe pjesërisht analitike, matje nëpërmjet GIS, si dhe analiza 'overlay'. Vlerësimi mund të bëhet me pikëzim, ose rankim nga 'e lartë' në 'pa cënueshmëri'

Këto 3 shtylla kombinohen për të kryer vlerësimin e riskut ndaj fatkeqësive. Duke ditur elementët e riskuar, vetë probabilitetin dhe madhësinë e rrezikut, si dhe shkallën e cënueshmërisë, gjenerohet harta e riskut në përputhje me gjurmën e ekspozimit të rrezikut. Një përmbledhje e kësaj metodologjie gjendet në figurën e mëposhtme:

FIG 4- Korniza e Vlerësimit të Riskut sipas 3 Shtyllave



Burimi: ACP-EU Natural Disaster Risk Reduction Program, 2020; përshtatur nga autorët

Metodat e përdorura për të vlerësuar elementët e mësipërm, përfshirë dhe riskun, janë si më poshtë:


A. VLERËSIMI BAZUAR NË INDIKATORË

Kjo është qasja bazë që është përdorur për vlerësimin e riskut, nisur nga vetë komponentët kryesorë të tij. Ky system është gjysëm-numerik, dhe lejon që të zhvillohet një vlerësim më gjithëpërfshirës, duke përfshirë vulnerabilitetin dhe kapacitetin social, ekonomik dhe mjedisor. Procesi i vlerësimit ndahet në komponentë, si:

- Rreziku
- Ekspozimi ndaj rrezikut
- Vulnerabiliteti
- Kapaciteti

Për secilin element, caktohet një numër indikatorësh që do përbëjnë bazën e vlerësimit, psh për rrezikun, tipi, probabiliteti dhe shkalla e madhësisë së rrezikut, për ekspozimin: numri i ndërtesave, popullsia, etj, e kështu me rradhë. Për secilin indikator bëhet një vlerësim nga 0 në 1, bazuar mbi të dhëna sasiore, ose cilësore / subjektive. Në fund bëhet pikëzimi i riskut dhe hartëzimi respektiv i tij.

FIG 5- Shembull i Vlerësimit të Bazuar në Indikatorë



Burimi: ACP-EU Natural Disaster Risk Reduction Program, përshtatur nga autorët

B. MATRICA E RISKUT

Vlerësimi i riskut shpesh është kompleks dhe nuk lejon një qasje të pastër numerike, për shkak të pamundësisë për të matur disa aspekte, si dhe pasigurisë së lartë. Për këtë, shpesh përdoren matricat e riskut, ose matricat e frekuencës së pasojave, të cilat klasifikojnë riskun bazuar në njohuri, dhe të dhëna cilësore. (Haimes, 2008; Jaboyedoff et al., 2014).

Kjo matricë ka dy shtylla, rrezikun (me frekuencën e tij) nga njëra anë, dhe impaktin nga ana tjetër. Mënyra si përcaktohen ngjyrat vlerësohet në bazë të ekspertizës së grupit të punës, varësisht rrezikut.

FIGURA 6- Shembull i Matrices se Riskut

		Impakti			
		Pa impakt	I Ulet	I Mesem	I Larte
Frekuenca	Shume e larte		I Larte	Shume i larte	Shume i larte
	E Larte		I Mesem	I Larte	Shume i larte
	E Mesme		I Ulet	I Mesem	I Larte
	E Ulet		I Ulet	I Ulet	I Mesem
	Pa frekuence	Pa risk			

Burimi: ACP-EU Natural Disaster Risk Reduction Program, përshtatur nga autorët

C. VLERËSIMI NUMERIK I RISKUT

Kjo mënyrë bazohet në vlerësimin e riskut sipas formulës

$$Risk = \sum_{i=1}^{K+1} \left(\int_{t=0}^{T+1} P_{T+1,t} * \left(\sum_{s=0}^{S+1} P_{S+1,s} * (A_{S+1,s} * V_{S+1,s}) \right) \right)$$

Ku:

P (T | HS) = probabiliteti kohor i një rreziku (sa shpesh, magnitude, etj)

P (S | HS) = probabiliteti hapësinor i një rreziku (sa shtrihet, ku)

A (ER | HS) = kuantifikimi i elementëve të rrezikuar (sa banorë preken, sa ndërtesa, etj)


V (ER | HS) = vulnerabiliteti i elementëve të rrezikuar, në shkallë nga 0 në 3

Metoda e mësipërme është përdorur në këtë dokument për të kryer vlerësimin 'multirisk' – pra për të kuptuar totalin e risqeve në secilën njësi territori, të shkaktuar nga rreziqe të shumta.

D. QASJA E PEMËS SË ‘EVENTEVE’

Kjo analizë ka të bëjë me rreziqet që ndodhin zinxhir në formë shkak-pasoje. Pema e eventit është një sistem që analizon gjithë kombinimet e mundshme (dhe probabilitetin respektiv) të parametrave që ndikojnë territorin në studim. Ky lloj risku është më i vështiri për të analizuar. Në vlerësimin e risqeve për bashkinë Lezhë pema e eventeve merret në konsideratë për rreziqet që shkaktojnë njëri-tjetrin, si psh: përmbytjet e rrëshqitjet e dheut; thatësira dhe zjarret, etj. Probabiliteti i rreziqeve është hartuar sipas metodës së indikatorëve.

FIGURA 7- Shembull i Pemës së Ngjarjeve



Burimi: ACP-EU Natural Disaster Risk Reduction Program

Për të vlerësuar zvogëlimin e riskut në rastin e Planeve të ZRF, është e mundur të kombinohen 4 mënyrat e mësipërme. Me rendësi të vecantë janë kombini i metodës së matricës, dhe asaj të indikatorëve.

Indikatorët e përdorur për vlerësimin e riskut në këtë dokument gjenden më poshtë:

	Indikatorë	Mënyra e matjes	Burimi	Përshkrim	Vlera referente
Indikatorë të rrezikut	Frekuenca normale	Sa herë shfaqet rreziku në vit (ose në njësi kohore, varësisht llojit të rrezikut)	Kalendari historik	Bazuar në mesataren e periodicitetit të rrezikut në 5 vitet e fundit (ose 30 vite për tërmetet)	0 - 4, ku 0 = nuk ka rrezik, dhe 4 është maksimal rreziku
	Frekuenca e fatalitetit	Sa herë shfaqet rrezik me pasoja fatale	Kalendari historik / intervista	Bazuar në mesataren historike të fataliteteve	0 - 4, ku 0 = nuk ka rrezik, dhe 4 është maksimal rreziku
	Periudha e qëndrimit	Sa kohë ka ndikim rreziku mbi elementet e riskut	Intervistat	Aplikohet kryesisht për rreziqe si përmbytja, thatësira, stuhitë e borës, etj.	0 - 4, ku 0 = nuk ka rrezik, dhe 4 është maksimal rreziku
	Probabiliteti	Sa gjasa ka të rishfaqet rreziku nëse nuk merren masa (brenda kohës së frekuencës)	Intervista / dokumente reference	Vlerësuar nga intervistat bazuar në periodicitet dhe pritshmëritë e banorëve	0 - 4, ku 0 = nuk ka rrezik, dhe 4 është maksimal rreziku
	Shtirja e rrezikut	Kufiri ku ndodh rreziku ndaj sip të territorit	Dokumente reference, hartëzim me pjesëmarrje	Gjurma e rrezikut, dixhitalizuar në workshopet me pjesëmarrje apo na dokumente reference	0 - 4, ku 0 = nuk ka rrezik, dhe 4 është maksimal rreziku
	Ekspozimi ndaj rrezikut	Zona e ndikimit të rrezikut në territor / sip territori	Dokumente reference dhe intervista	Bazohet në sa sipërfaqe ndikohet nga vetë gjurma e rrezikut.	0 - 4, ku 0 = nuk ka rrezik, dhe 4 është maksimal rreziku

Tregues total për rrezikun				Mesatare e vlerave referente për rrezik	
Indikatorë të elementëve në risk	Nr ndërtesash në zonën e rrezikut (ose në rrezik)	Nr ndërtesave që janë të ndikuara nga gjurma e rrezikut (ose që kanë veti që mund të rrezikohen nga rreziku), ndaj totalit	Llogaritje në GIS, bazuar mbi databazë nga Planet vendore	Për tërmetin: ndërtesat mbi 30 vjecare	0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Infrastruktura në zonën e rrezikut	Km linear rrugë në zonë rreziku ndaj totalit	Llogaritje në GIS, bazuar mbi databazë nga Planet vendore	Për rrezikun e zjarrit, dëborës	0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Ndërtesa shërbimi në zonë rreziku	Nr ndërtesa shërbime ndaj totalit të shërbimeve	Llogaritje në GIS, bazuar mbi databazë nga Planet vendore	Për pandeminë dhe tërmetet - shërbimet hotelieri të evidentuara më vete	0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Zonë industriale në zonë rreziku	Zonë industriale e rrezikuara ndaj totalit të zonave industriale	Llogaritje në GIS, bazuar mbi databazë nga Planet vendore		0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Popullsi banuese në zonat e rrezikut	Popullsi ndaj totalit	Llogaritje në GIS bazuar në grid të popullsisë (Instat)	Llogaritur për NjA	0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Monumente natyrore të rrezikuara	Ndaj totalit	Llogaritje në GIS bazuar në databazën e Min. Mjedisit	Aplikueshme për rrezikun nga zjarri	0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Sip zona të mbrojtura të rrezikuara	Ndaj totalit	Llogaritje në GIS bazuar në databazën e Min. Mjedisit	Klasifikuara sipas ligjit shqiptar, rrjet Emerald dhe rrjet IBA	0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Sip pyje të rrezikuara	Ndaj totalit	Llogaritje në GIS, bazuar mbi databazë nga Planet vendore	Evidentuar për rrezikun nga zjarri dhe nga ndryshimet klimatike	0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Sip bujqësore e rrezikuara	Ndaj totalit	Llogaritje në GIS, bazuar mbi databazë nga Planet vendore		0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Institucione arsimore të rrezikuara	Ndaj totalit	Llogaritje në GIS bazuar në databazën e Min. Arsimit		0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Monumente kulturore të rrezikuara	Ndaj totalit	Llogaritje në GIS bazuar në databazën e IMK		0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë
	Ndërtesa me relevancë kulturore (fetare, adm, etj)	Ndaj totalit	Llogaritje në GIS, bazuar mbi databazë nga Planet vendore		0 - 4, ku 0 = nuk ka impakt, dhe 4 është impakti më i lartë

Tregues total për elementët në risk				Mesatare e vlerave referente për elementët në risk	
Indikatorët e cënueshmërisë / vulnerabilitetit	Varësia nga ndihma sociale	Përqindje ndaj totalit të popullsisë për NJA	Bazuar në Instat dhe të dhëna GIS	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Mosha e tretë e vetmuar	Përqindje ndaj totalit të popullsisë për NJA	Bazuar në Instat dhe të dhëna GIS	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Vjetërsia e popullsisë	Përqindje ndaj totalit të popullsisë për NJA	Bazuar në Instat dhe të dhëna GIS	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Përqindja e PAK	Përqindje ndaj totalit të popullsisë për NJA	Bazuar në Instat dhe të dhëna GIS	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Distanca mesatare drejt qendrës së bashkisë	koha mesatare e vajtjes nga secili fshat në qendër të Lezhës	Bazuar në Google maps		1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Distanca mesatare drejt qendrës së NJA	koha mesatare e vajtjes nga secili fshat në qendër të NJA respektive	Bazuar në Google maps		1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Punësimi në shërbime	përqindje ndaj forcës punëtore totale në NJA	Instat dhe përpunime të autorëve	Për rrezikun nga pandemia: punësimi në sektor shërbimesh konsiderohet vulnerabilitet	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Lëvizjet vajtje-ardhje për vendet e punës	Numri i personave që punojnë jashtë vendbanimit ndaj totalit të forcës punëtore	Instat dhe përpunime të autorëve	Për rrezikun nga pandemia: konsiderohet vulnerabilitet	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Përqindja e të rinjve në moshë shkolle	Numri i personave që frekuentojnë ende shkollën ciklet 1-2 ndaj totalit	Instat dhe përpunime të autorëve	Për rrezikun nga pandemia: konsiderohet vulnerabilitet	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
	Mungesa e sistemit sanitar në familje	Përqindja e familjeve pa një sistem sanitar brenda shtëpisë	Instat dhe përpunime të autorëve		1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë
Punësimi në bujqësi	përqindje ndaj forcës punëtore totale në NJA	Instat dhe përpunime të autorëve	Për rrezikun nga përmbytjet, zjarri, thatësira dhe ndryshimet klimatike	1 - 3, ku 1 = vulnerabilitet I ulët dhe 3 - I lartë	

Tregues total për cënueshmërinë					Mesatare e vlerave referente për cënueshmërinë
Indikatorë të kapaciteteve	Kapacitete të autoriteteve vendore	Sa të afta janë autoritetet të parandalojnë dhe përgjigjen ndaj rrezikut	Intervista me autoritetet vendore	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = kapacitet I ulët, dhe 3 = kapacitet I lartë
	Kapacitete të komunitetit	Sa I aftë është komuniteti te parandalojnë dhe përgjigjet ndaj rrezikut	Intervista gjysëm-struktururara	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = kapacitet I ulët, dhe 3 = kapacitet I lartë
	Ndërgjegjësim nga Autoritetet vendore	Sa e njohin autoritetet vendore rrezikun dhe ndikimin e tyre	Intervista me autoritetet vendore	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = kapacitet I ulët, dhe 3 = kapacitet I lartë
	Ndërgjegjësim nga Komuniteti	Sa e njeh komuniteti rrezikun dhe përgjegjësinë e tij	Intervista gjysëm-struktururara	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = kapacitet I ulët, dhe 3 = kapacitet I lartë
	Koordinim me autoritete rajonale	Në c'nivel bashkëpunohet nga autoritetet vendore me nivelin rajonal për parandalim, përgjigje, rimëkëmbje	Intervista me autoritetet vendore dhe rajonale	Për të gjithë rreziqet	1 - 3, ku 1 = kapacitet I ulët, dhe 3 = kapacitet I lartë

Burimi: Autorët

Kapitulli 3 në vijim jep një pasqyrë të gjithë rreziqeve të Bashkisë Lezhë, duke evidentuar frekuencën, impaktin, madhësinë, dhe elemente të tjera identifikuese të tyre. Ky kapitull do furnizojë me informacion seksionin ' Indikatorë të rrezikut' në matricën e mësipërme.

Në kapitullin 4 kryhet vlerësimi i elementëve në risk, dhe cënueshmërisë së tyre ndaj rreziqeve. Këto dy komponentë realizojnë

Kapitulli 5 në vijim kryen vlerësimin dhe pikëzimin final të riskut për Bashkinë Lezhë, bazuar në 4 metodat e vlerësimit të riskut të sugjeruara në sipër, si dhe duke marrë në konsideratë: Analizën e rrezikut, Analizën e elementëve të rrezikuar; Vlerësimin e Cënueshmërisë, si dhe Vlerësimin e Kapaciteteve. Ky i fundit është kryer bazuar në intervistat me aktorët rajonalë/lokalë dhe komunitetin, në lidhje me përgjigjen dhe përgatitjen ndaj fatkeqësive natyrore.

ANALIZA E RREZIQEVE TË FATKEQËSIVE NATYRORE NË BASHKINË LEZHË

3



3.1 DUKURITË SIZMIKE

3.1.1 Vështrim historik mbi tërmetet

Shqipëria pozicionohet në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar. Në këtë brez, pjesa më aktive nga pikpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon ($34-43^{\circ}$ N; $18-30^{\circ}$ E), ndodh të paktën një tërmet me $M > 6.5$. Shqipëria është një ndër vendet më sizmoaktive në Evropë. Shumica e tërmeteve të fortë ndodhin në 3 breza sizmike mirë të përcaktuar, si vijon:

- Brezi tërmetor Adriatiko-Jonik në buzën lindore të mikroplakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje;
- Brezi tërmetor Peshkopi-Korçë me shtrirje veri-jug, dhe
- Brezi tërmetor Lushnjë-Elbasan-Dibër me shtrirje veri-lindore

Epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M \leq 5.0$), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Përgjithësisht tërmetet e Shqipërisë dhe rajoneve përreth kanë vatra të cekta, thellësia e të cilave shkon nga 10-25 km.

Territori i Bashkisë të Lezhës zë vend në shtrirje përgjatë bregdetit të brezit tërmetor Adriatiko-Jonik, tërmetet e fuqishëm të të cilit kanë kushtezuar potencialin sizmik të saj. Më posht po japim përshkrime të shkurtra për disa nga tërmetet më të fortë që kanë goditur Shqipërinë nga rajoni i Durrësit deri në Shkodër e nga deti Adriatik në kufirin lindor. Zonat e shkëputjeve aktive janë pikërisht zonat sizmoaktive (zonat ku gjenerohen herë pas here tërmetet), të konfirmuara nga fakti se epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive.

Në hartën sizmotektonike përvijohen qartë zonat e shkëputjeve kryesore sizmoaktive në Shqipëri me potencialin e pritshëm sizmik. Dy nga zonat e shkëputjeve sizmoaktive gjatësore: Joniko-Adriatike dhe Peshkopi-Korçë (zona sizmoaktive e Drinit, siç quhet ndryshe), dhe zona e shkëputjeve tërthore Lushnjë-Elbasan-Dibër paraqesin zonat sizmoaktive me potencialin sizmik më të lartë. Zona e Bashkisë të Lezhës, që bën pjesë në zonën sizmoaktive Joniko-Adriatike, vlerësohet me potencial sizmik me magnitudë 6.0-7.0 shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64.

Tërmetet e vitit 1905 (Tërmetet e Shkodrës)

Përfaqësojnë një nga seritë më të mëdha të tërmeteve të fortë të zonës së Shkodrës. Intensiteti i lartë, numri i madh i pasgoditjeve, pasojat e goditjes kryesore dhe pasgoditjeve më të forta kanë qënë objekt i shumë studimeve sizmologjike.

FIG 8- Harta Sizmotektonike e Shqipërisë



Burimi: Sulstarova, Muço, Aliaj, Kuka, & Duni, (2003)

Goditja më e fortë ka ndodhur në 1 qershor 1905. Magnituda e këtij tërmeti është përcaktuar $MS=6.6$; dhe intensitet mbi 9 balle. Ky tërmet shkaktoi dëmtime të rënda në njerëz dhe pasuri në Shkodër dhe fshatrat përreth (veçanërisht në fshatrat në jug- perëndim të Shkodrës). Janë shkatëruar plotësisht rreth 1500 shtëpi banimi vetëm në qytetin e Shkodrës; të gjitha shtëpitë e tjera të këtij qyteti u dëmtuan rëndë; u demtua edhe kalaja e Rozafes.


Ky tërmet shkaktoi rreth 200 të vdekur dhe 500 të plagosur. Lëkundjet e këtij tërmeti në zonën e Bashkisë të Lezhës janë vlerësuar me intensitet 8 ballë.

Tërmeti i 18 Dhjetorit 1926

Në dhjetor të vitit 1926 Durrësi dhe rajonet rreth tij u goditën nga një seri tërmetesh shumë të fortë. Goditja e parë e fortë ndodhi më 16 dhjetor; ajo u pasua nga goditje të tjera të forta më 17 dhjetor. Më 17 dhjetor, ndodhi një goditje e fortë, e cila u pasua nga një goditje më e fuqishme që dëmtoi Durrësin, Shijakun e Ishmin. U shkatërruan dhe u dëmtuan shumë shtëpi. Kjo goditje kishte magnitudë $Ms=5.8$. Ajo u shoqërua me shumë goditje të tjera. Me 18 dhjetor u regjistrua një goditje tjetër me magnitudë $Ms=6.2$. Kjo goditje shkatërroi e dëmtoi shumë ndërtesa në Durrës, Kavajë e Shijak dhe në fshatrat rreth tyre. Në shkallën e dëmtimit padyshim kanë influencuar dhe goditjet e forta që paraprinë atë. Në Kavajë u dëmtuan rëndë të gjitha shtëpitë dhe u këputën minaret e xhamive. Midis Durrësit e Shijakut pati dukuri të lëngëzimit të truallit të shfaqura me shatërvane me ujë të nxehtë e sulfur dhe pseudovullkane balte, rëre e ujë.

Tërmeti u ndje shumë fort në Tiranë në Shkodër, Berat, Lushnjë, Elbasan. Në Itali u ndje 5 ballë në Pulje ndërsa në Greqi 4 ballë në Janinë e Korfuz. Intensiteti i tërmetit është vlerësuar 9 ballë të shkallës MSK-1964, Ky tërmet është shoqëruar nga shumë pasgoditje të cilat vazhduan edhe gjatë vitit 1927. Intensiteti i këtij tërmeti në zonën e Bashkisë të Lezhës ka qenë deri 7 ballë të shkallës MSK-1964.

FIG 9- Harta e Izoseisteve të Tërmetit të 1 Qershorit 1905



Burimi: Sulstarova, Muço, Aliaj, Kuka, & Duni, (2003)

FIG 10- Harta e Izoseisteve të Tërmetit të 17 Dhjetorit 1926



Burimi: Sulstarova, Muço, Aliaj, Kuka, & Duni, (2003)

Tërmeti i 30 Nëntorit 1967

Tërmeti i 30 Nëntorit 1967 pati një magnitudë $MS=6.6$ dhe intensitet 9 ballë dhe dëmtoi rëndë rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit si dhe një pjesë të territorit të Maqedonisë perëndimore. Në rrethet e Dibrës dhe të Librazhdit nga ky tërmet u prekën 13 lokalitete me 177 fshatra, vdiqën 12 veta dhe u plagosën 174 të tjerë.

Viktima në njerëz pati edhe në territorin e Maqedonisë Perëndimore. Ky tërmet është shoqëruar nga më shumë se 1200 pasgoditje. Ky tërmet është ndjerë në zonën e Bashkisë të Lezhës si një lëkundje 5-6 ballëshe.


Tërmeti i 15 Prillit 1979

Tërmeti i 15 Prillit 1979 (tërmeti i zones kufitare Shqiperi-Mali i Zi), është një nga më të fortët që ka goditur gadishullin e Ballkanit gjatë shekullit të XX-të. Magnituda e tij është llogaritur $Ms=7.2$ dhe intensiteti në epiqendër është vlerësuar 9-10 ballë të shkallës MSK-1964. Epikendra e këtij tërmeti është në bregdetin Adriatik, pranë Petrovacit, në Mal të Zi. Shumë paragoditje e kanë paraparirë këtë tërmet rreth dy javë para goditjes kryesore të 15 Prillit, kurse pasgoditjet vazhduan për rreth 9 muaj. Pasgoditja më e fortë është ajo e 24 Majit 1979, me magnitudë $MS=6.3$. Intensiteti i këtij tërmeti në epiqendër është 8 ballë (MSK-64). Goditja kryesore e 15 Prillit shkaktoi 35 të vdekur dhe 382 të plagosur në Shqipëri. Më shumë se 100,000 banorë (shumica në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës) mbetën pa shtëpi. U shkatëruan pothuajse plotësisht 17122 shtëpi banimi dhe objekte social-kulturore. Dëmet më të mëdha në njerëz dhe të mira materiale u shkaktuan në bregdetin Malazez. Tërmeti i 15 Prillit 1979 u ndie fort në të gjithë territorin e Shqipërisë. Lëkundjet e këtij tërmeti shkaktuan dëmtime edhe në rrethin e Krujës; intensiteti i lëkundjeve në Bashkinë e Lezhës ka arritur 8 ballë.

Tërmeti i 26 Nëntor 2019

Në 26 Nëntor 2019, Shqipëria u godit nga një tërmet me magnitudë 6.4 Rihter. Tërmeti kishte si epiqendër detin Adriatik, në afërsi të qytetit të Durrësit, dhe një thellësi rreth 27km. Si pasojë, dëme të shumta janë shkaktuar

FIG 11- Harta e Isoiseteve të Tërmetit të 30 Nëntorit 1967



Burimi: Sulstarova, Muço, Aliaj, Kuka, & Duni, (2003)

FIG 12- Harta e Isoseisteve të Tërmetit të 15 Prillit 1979



Burimi: Sulstarova, Muço, Aliaj, Kuka, & Duni, (2003)

në ndërtesa në Qarkun Durrës, Tiranë e Lezhë. Bashkia Lezhë është prekur gjithashtu nga ky tërmet. Nuk janë raportuar humbje në jetë njerëzore por dëme në të gjithë territorin e bashkisë në ndërtesa.

Si rezultat, në bashkinë Lezhë janë 76 familje, ose 288 banorë të cilët u detyruan të strehohen në çadra. Tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të familjeve dhe shpërndarjes së tyre sipas njësive administrative:

TABELA 1- Nr i Çadrave dhe Familjeve të Strehuara gjatë Tërmetit 26 Nëntor 2019

Bashkia	Njësia Administrative	Nr. Çadrave	Nr. Familjeve	Nr. Banorëve
LEZHË	Ungrej	2	2	3
	Shënkoll	14	14	57
	Kallmet	7	7	27
	Blinisht	2	2	10
	Dajç	1	1	4
	Zejmen	9	9	39
	Shëngjin	16	16	46
	Kolsh	16	16	66
	Balldren	9	9	36
	Total Lezhë	76	76	288

Burimi: Prefektura Lezhë 2020, intervista të zhvilluara nga grupi i punës


Përtej kësaj, në bashkinë Lezhë janë dy shkolla të cilat kanë dalë jashtë funksioni, përkatësisht shkolla Gjergj Kastrioti në Lezhë dhe shkolla Llesh Nik Daka në Shënkoll. Përtej kësaj, në bashkinë Lezhë ka patur dëme të shumta në ndërtesa.

3.1.2 Rreziku ndaj tërmetit

Ky vlerësim i rrezikut sizmik bazuanë studimin e mëposhtëm: "Sizmizmi, Sizmotektonika dhe rreziku Sizmik në Shqipëri" (Aliaj et al., 2010). Qëllimi për vlerësimin e rrezikut sizmik të Bashkisë Lezhë fokusohet në:

- Vlerësimet e pikut të akselerimit të truallit (PGA- peak ground acceleration) në kushtet e shkëmbit për një periudhë kthimi prej 475 vjet (kjo barazohet me një probabilitet 10% të një vlere të tejkaluar në një periudhë 50 vjeçare) dhe për një periudhë kthimi prej 95 vjetësh (kjo barazohet me një 10% probabiliteti i një vlere të tejkalohet në një periudhë 50 vjeçare) duke përdorur Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikut Sizmik Probabilistik

FIG 13- Harta e Përshejimit për Shqipërinë në Varësi të Kushteve të Truallit me Probabilitet 10/50 Vjet ose 475 Vjet Periudhë Kthimi



Burimi: (Aliaj et al., 2010).

të Cornell-McGuire (PSHA).

- Parametrat e rrezikut sizmik të mundshëm të PGA në kushtet e vendndodhjes së shkëmbinjve për Shqipërinë llogariten duke përdorur marrëdhënie dobësimi të Sadigh et al., 1997 dhe Spudich et al., 1999 (Aliaj et al., 2010, shiko Fig. 45). Rreziku sizmik për Bashkinë Lezhë në kushtet e vendndodhjes së shkëmbinjve, llogaritet sipas kërkesave të Eurocode 8: me gjasë 10% / 10 vjet dhe 10/50 vjet ose në periudhat e kthimit 95 dhe 475 vjet.

Për Bashkinë Lezhë parametrat e mëposhtëm të rrezikut sizmik në kushtet e truallit u përcaktuan sipas Eurokodit 8. Përshpejtimi i pikut në tokë (PGA) në gjendjen e shkëmbinjve me gjasë 10% / 10 vjet dhe 10% / 50 vjet.

TABELA 2- Vlerat e PGA për Njësi të Ndryshme Administrative të Bashkisë Lezhë në Kushtet e Truallit me Probabilitet 10% / 10 vjet dhe 10% / 50 vjet.

Njësitë Administrative	10 %/10 vjet	10 %/50 vjet
	Probabiliteti	Probabiliteti
Lezha	0.176	0.338
Shengjini	0.176	0.338
Zejmeni	0.125	0.238
Shenkolli	0.147	0.285
Balldreni	0.176	0.338
Kallmeti	0.143	0.274
Blinishti	0.199	0.373
Dajci	0.199	0.373
Ungrej	0.114	0.208
Kolshi	0.143	0.274


Burimi: Shyqyri Aliaj 2020, raport i përgatitur për ZRF Bashkia Lezhë

Harta e vlerave të përshpejtitimit (PGA) për Bashkinë Lezhë është përpiluar duke përdorur vlerat PGA të njësive të ndryshme administrative të saj me gjasë 10% / 50 vjet. Paraqitet në sfond gjeologjik (shiko Figurën 45). Për përpilimin e tij përdoren edhe vlerat PGA të disa njësive të bashkive fqinje si Mirdita dhe Kurbini. Bashkia Lezhë ka një rrezik të lartë sizmik të shprehur në vlerat PGA, që varion nga 0.20 g në pjesën verilindore të saj deri në 0.35 g në pjesën veriore, ku vlera më e lartë është 0.375 g (shiko Fig. 45).

Bazuar në vlerësimin e rrezikut sizmik për Bashkinë Lezhë, Shqipëri, ne mund të nxjerrim këto përfundime kryesore:

- 1- Rreziku sizmik për Bashkinë Lezhë llogaritet duke përdorur Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikut Sizmik Probabilistik të Cornell-McGuire.
- 2- Rreziku sizmik për Bashkinë Lezhë në kushtet e vendndodhjes së gurëve llogaritet sipas kërkesave të Eurokodit 8: me gjasë 10% / 10 vjet dhe 10/50 vjet ose në periudhat e kthimit 95 dhe 475 vjet.
- 3- Bashkia Lezhë karakterizohet nga një rrezik shumë i lartë sizmik i shprehur në vlerat maksimale

FIG 14- Harta e PGA për Bashkinë Lezhë në Varësi të Klasifikimit të Truallit me Probabilitet 10% në 50 Vjet ose 475 Vjet Kthim



Burimi: Shyqyri Aliaj 2020, raport i përgatitur për ZRF Bashkia Lezhë

të përshejtit në tokë, i cili varion nga 0.20 g deri në 0.35 g. Bashkia Shkodër, në veri të Lezhës, ka rrezikun më të madh sizmik (deri në 0.4 g).

3.1.3 Strukturat Ndërtimore dhe Rreziku Sizmik

Në kuadër të projektit “Local Disaster Rrezik Reduction in the Municipality of Lezhe” është e nevojshme një vlerësim i vulnerabilitetit dhe dëmtimeve të stukturave në këtë zonë. Për të arritur një analizë të tillë, një metodologji specifike duhet të strukturohet dhe përdoret që të trajtojë të gjitha kërkesat e nevojshme për vlerësimin e duhur. Kjo metodologji në përgjithësi përfshin pikat e mëposhtme:

1- Kërkesat juridike (Juridiksionale)

Faza e pare ka orientim ligjor dhe lidhet me procedurat e marrjes së lejeve të nevojshme nga bashkia apo institucione të tjera kompetente.

2- Zgjidhja e inxhinierëve stukturor dhe arkitektëve të kualifikuar.

Inxhinierët të cilët do të meren me këtë problem duhet të jenë të regjistruar si inxhinier strukturis me licensën e duhur sipas legjislacionit shqipëtar. Profesionistët duhet të kenë një experience të provuar në analizën, projektimin dhe në retrofitin e strukturave në rajone me sizmicitet të lartë. Ekspertët gjithashtu duhet të jenë të familjarizuar me principet e performances sizmike inxhinierike dhe të projektimit. Në mënyrë që të arrijmë një analizë të tillë, është e nevojshme eksperianca me procedurat e analizës jo elastike dhe të kuptuarit të sjelljes së materialeve të ndryshëm strukturor. Së fundmi është e nevojshme, një kuptim themelor i dinamikës së strukturave dhe sjelljes së strukturave të ndryshme që i nënshtrohen lëkundjeve të tokës.

3. Vendosja e objektivave të përformacës

Kjo etapë është e lidhur me përcaktimin e objektivave të performances së strukturës bazuar në metoda empirike ose analitike të cilat janë:

- Stabiliteti strukturor
- Siguria e kufizuar
- Sigurimi i jetës
- Kontrolli i dëmtimeve
- Përdorim i menjëhershëm

4. Inspektimi i ndërtesës

Objektivi është që përmes inspektimit të duhur të mblidhen të dhënat në lidhje me projektet strukturore ekzistuese, rezistencës materiale, ndërhyrjeve të mundshme ose dëmtimet nga ngjarjet e mëparshme. Mënyra se si mund të bëhet ky inspektim është përmes njërës nga sa vijon:

- Kontrollit të vizatimeve
- Inspektimi vizual
- Llogaritjet paraprake

5. Karakterizimi i Kapacitetit Sizmik

Duke përdorur modelimin e avancuar dhe teknikat analitike, merren kurbat e kapacitetit dhe me anë të tyre mund të bëhet një vlerësim i detajuar i projektimit të ndërtesave sipas kapaciteteve. Metodot e përdorura janë metoda empirike të cilat bazohen në inspektimin visual për dëmtimet e elementëve strukturorë kryesor ose metoda analitike e cila bazohet në karakteristikat e materialeve, detajet konstruktive, rruga e modelimit dhe rezultatet e këtij modeli (kurbat forcë-zhvendosje)

6. Përcaktimi i kërkesave sizmike

Kjo faze është e lidhur me rreziqet sizmike, ndërveprimi me kapacitetin dhe zhvendosjet target.

7. Verifikimi i performances sizmike

Pasi të jetë bërë vlerësimi i pikës së performancës, inxhinieri kontrollon performance e ndërtesës duke përdorur kriterin e pranueshmërisë (acceptability-criteria), gjithashtu rezultatet janë përdorur si informacione në procesin e marjes së vendimeve nga qeveria duke marrë në konsideratë sigurinë dhe rrezikun

8. Përcaktimi në rast se duhet riparuar, përforcuar apo shembur

Bazuar në rezultatet e fazave të përmendura më lart, grupi i inxhinierëve vendos në qoftë se objekti i studiuar do të riparohet, do të përforcohet duke përdorur teknika të ndryshme ose do të shembet. Zgjedhja e teknikës së përforcimit bazohet në teknika tradicionale ose moderne.

9. Përgatitja e dokumentacionit konstruktiv dhe monitorimi i cilësisë

Faza finale është e lidhur me cilësinë e ndërtimit duke përdorur dokumentacionet, testimet dhe inspektimet. Verifikimi i kushteve ekzistuese dhe mbikqyrja e ndërtimit nga projektuesi.

3.1.3 Përmbledhje e Objekteve

Kodet e projektimit

Që nga periudha e komunizmit deri tani kodet e projektimit në Shqipëri kanë ndryshuar dhe janë përditësuar bazuar në kërkesa të ndryshme. Në një aspekt të përkohshëm situata e Shqipërisë në çështjet e ndërtimit dhe kodeve është si më poshtë:

Kodet e ndërtimit para viteve 90-të

Spektori i ndërtimit ishte publik dhe rregullohej dhe kontrollohej nga niveli qendror. Ministria e ndërtimit dhe katër institutet ndërkombëtare ishin përgjegjës për të hartuar kodet e ndërtimit, duke projektuar infrastrukturën publike dhe objektet. Kodi i parë i projektimit ishte propozuar nga Rusia, me pas KTP (Kushte Teknike Projektimi) ishin prezantuar nga KTP-52 në 1952, KTP-63 në 1963, KTP 1,2,3,4,5,6,7,8,9 në 1978 dhe i fundit KTP-89 në 1989.

Duke u bazuar në këto kode, forca sizmike përcaktohet si më poshtë:

$$E_{ki} = K_E \cdot K_r \cdot \psi \cdot \beta_i \cdot \eta_{ki} \cdot Q_k$$

(Forca sizmike sipas KTP 78)


$$S_k = Q_k \cdot k_E \cdot \beta \cdot m_k$$

(Forca sizmike sipas KTP-N2-89)

Secili nga parametrat e prezantuar në formulën më lartë janë funksioni 4 faktorëve kryesor:

- 1- Kategorisë së truallit e cila në bazë të standarteve kombëtare (KTP) kalifikohen në 3 kategori
 - a. Kategoria I (e fortë)
 - b. Kategoria II (e mesme)
 - c. Kategoria III (depozitime të dobëta)
- 2- Intensitetit të termetit bazuar në MSK-64 i cili mund të gjendet në hartat e siguruara nga instituti i sizmiologjisë të cilat bazohen në dy periudha kohore: harta e vitit 1963 dhe ajo e vitit 1978. Bazuar në këto harta Shqipëria është ndarë në rajonë me intensitet 6,7,8 dhe 9
- 3- Rëndësia e objektit bazuar në funksionin e tyre. KTP i ndan objektet në 5 kategori të ndryshme.
- 4- Numuri i kateve i cili është i rëndësishëm në mënyrën e shpërndarjes së ngarkesës sizmike.

FIG 15- Zonimi Sizmik sipas Intensitetit në 1963 dhe 1978; Zonimi Sizmik sipas Intensitetit të Përdorur që nga 1989



Burimi: IGJEUM


Kodet e ndërtimit pas viteve 90-të

Nga viti 1989 deri në vitet 2000 nuk u vendos asnjë kontroll shtetëror dhe asnjë rregullore ndërtimi edhe pse sektori i ndërtimit në Shqipëri pati një përparim të madh. Në vitin 2001 Ministria e Punëve të Jashtme organizoj një ëorkshop i cili ishte i fokusuar në rëndësinë e Eurokodeve në sektorin e ndërtimit, pas ëorkshop-it për disa vite me radhë një grup inxhinierësh u krijua me qëllim përkthimin dhe përshtatjen e eurokodeve me udhëzimet kombëtare. Krahas punës, këto kode shërbyen vetëm si hartime jo si direktiva për t'u përdorur nga specialistët. Vetëm pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, qeveria shqiptare miratoi versionin origjinal të Eurocode 8 (jo i përkthyer).

Bazuar ne Eurokod 8 projektimi sizmik i objektit bëhet duke përdorur informacionet e listuara me poshtë:

1. Hartat e nxitimit maksimal të truallit (PGA), të cilat jamin vlerat e nxhitimit të shprehura në terma g. Harta PGA për Lezhën është treguar në figurën 48:
2. Kategoria e truallit, e cila bazohet në vlerat e V_s , N_{SPT} ose C_u është si më poshtë:
 - a. Kategoria e tokës A
 - b. Kategoria e tokës B
 - c. Kategoria e tokës C
 - d. Kategoria e tokës D
 - e. Kategoria e tokës E
 - f. Kategoria special S1 and S2

FIG 16- Harta e Nxitimit Maksimal në Bashkinë Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë 2020

Për bashkinë Lezhë harta e shpërndarjes së kategorive të tokës është treguar më poshtë:


FIG 17- Harta e Klasifikimit të Tokës Bazuar në EN-1998 e Bashkisë Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë 2020

Bazuar në të dhënat e mara nxirret spektrin e reagimit elastik dhe më vonë spektrin e projektimit. Spektri i reagimit është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e rrugës se si një sistem me një shkallë lirie reagon nën veprimin sismik.

GRAFIK 5- Shembuj të Spektrit të Reagimi Bazuar në EN-1998



Burimi: EN-1998

Tipologjitë strukturore

Klasifikimi i tipologjive të strukturave bazuar në periudhën e ndërtimit:

Duke filluar që nga 1945 deri në ditët e sotme janë aplikuar disa tipologji të ndryshme strukturash në Shqipëri dhe si pasojë edhe në Lezhë të cilat mund të përmbliken si më poshtë:

1. Nga viti 1945 deri në 1960 strukturat prej murature ishin të përhapura, shumë ndërtesa të ulta ishin ndërtuar duke përdorur këtë lloj tipologjie. Vetëm disa ndërtesa u ndërtuan duke përdorur material të tjera si beton, çeliku apo druri.

FIG 18- Shembuj Struktura nga Viti 1945 deri në 1960



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

2. Nga viti 1960 deri në 1979 shoqëruar me ngjarjet sizmike, gjatë kësaj periudhe u bënë disa ndryshime në strukturat me murturë: cilësia e materialeve ishte shumë më e mirë, element strukturorë të rinj u shtuan, si breza prej betoni të armuar, arkitra në dritare dhe dyer, soleta të paranderura si dhe prej qeramike. Ndërtesa parafabrikat u prezantuan si tipologji për ndërtesa industriale dhe banimi.

FIG 19- Shembuj Struktura 1960-1979



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

- Që nga viti 1979 deri në 1990 përmirësime të mëtejshme u bënë në mënyrë që struktura të reagojë më mirë kundrejt forcës sizmike. Lidhjet ishin më të detajuara mirë, kolona të përfocuara me hekur u shtuan në cepa dhe në kryqëzimin e mureve. Të gjitha kolonat ishin të lidhura me breza anti-sizmik. Së bashku me strukturat prej murature u vazhdua dhe me aplikimin e parafabrikatëve. Në këtë periudhë në Tiranë u ndërtua ndërtesa e parë e larta më konstruksion beton arme, e cila kishte 15 kate dhe ka qenë dhe vazhdon të punojë si hotel.

FIG 20- Shembuj Struktura 1979-1990



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

- Që nga viti 1990 deri në vitet 2000 paraqitet një periudhe e re ndërtimi duke ju referuar tipologjisë strukturore të përdorur për ndërtesat e ulta dhe të larta. Në këtë periudhë betoni i armuar ishte shumë i përhapur dhe nuk po ndërtoheshin më strukturat me muraturë.

FIG 21- Shembuj Struktura 90-2000



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

- Nga viti 2000 e në vazhdim me prezantimin e Eurokodeve u bënë zhvillime të rëndësishme në lidhje me tipologjinë e strukturës, të cilat ishin të fokusuara në klasifikimin që jep ky kod: ndërtesa prej betoni të armuar (rama, mure prerës, sistem bërthamë), ndërtesa prej çeliku, druri dhe ndërtesa të përbëra.

FIG 22- Shembuj Struktura 2000- në vazhdim





Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Klasifikimi i tipologjive sipas sistemit strukturor dhe pozicionimi i tyre

Në përcaktimin e reagimit të një objekti ndaj një ngjarje të rrezikshme është shumë e rëndësishme që objektet të klasifikohen siç duhet në bazë të tipologjive të tyre strukturore. Për rastin e Lezhës tipologjitë dhe shpërndarja e tyre në zonë jepen në hartën më poshtë dhe përmbledhen në Tabelën 30.

TABELA 3- Klasifikimi i Tipologjisë së Sistemit Strukturor

Nr	Tipologjia e sistemit strukturor	Foto
1.	Strukturat ekzistuese me muraturë të papërforsuar <ul style="list-style-type: none"> • Zona “Besëlidhja” • Zona “Grumbullimi” Midis rrugës Kosova dhe bulevardit Gjergj Fishta Përgjatë bulevardit “Nënë Tereza” në Shengjin	
2.	Strukturat ekzistuese me muraturë të përforsuar me breza dhe kolona anti-sizmike <ul style="list-style-type: none"> • Zona “Besëlidhja” • Zona “Grumbullimi” Midis rrugës Kosova dhe bulevardit Gjergj Fishta Përgjatë bulevardit “Nënë Tereza” në Shengjin	

Nr	Tipologjia e sistemit strukturor	Foto
3.	Ndërtesat parafabrikat <ul style="list-style-type: none"> • Përgjatë rrugës Frang Bardhi 	
4.	Ndërtesat me sistem strukturor beton-arme: <ul style="list-style-type: none"> • Rama • Mure • Dual • Lavjerrës i përmbzsus Zona "Besëlidhja" përgjatë rrugës Franz Jozef Strauss Midis "Qender Plazh" dhe "Shengjin Qender"	

Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Për çdo tipologji të përmendur më lart, do të bëhet një analizë dëmtimi për katër veprimet kryesore:

1. Degradimi për shkak të vjetërsisë dhe kushteve atmosferike
2. Dëmtimi nga veprimtaria njerore
3. Dëmtimet nga uljet e themeleve
4. Dëmtimet nga veprimtaria sizmike

STRUKTURAT ME MURATURË TË PA PËRFORCUAR DHE ME MURATURË TË PËRFORCUAR

Degradimi për shkak të vjetërsisë dhe kushteve atmosferike

Ekspozimi i një objekti ndaj agjentëve atmosferik çon në një numur të madh dëmtimesh të cilat mund të listohen si më poshtë:

- Dëmtime nga degradimi i materialeve
- Karbonatizimi, degradimi i sulfatit
- Erozioni
- Degradimi nga ngrirja-shkrirja
- Efektet e sforcimit

FIG 23- Degradimi nga Mirëmbajtja e Ulët; Ngrirja-Shkrirja



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Dëmtime nga aktiviteti njerëzor

Pas viteve 90-të në të gjitha këto struktura janë bërë disa ndërhyrje nga banorët në mënyrë që të fitojnë më shumë hapësirë në banesat e tyre. Ndërhyrjet kanë rezultuar në ndryshime në lidhje me performancën e këtyre objekteve dhe kanë çuar në rritje një potencial të dëmeve. Ndërhyrjet mund të klasifikohen si zgjatime vertikale ose horizontale mbi katet ekzistuese. Një ndërhyrje karakteristike për këtë tipologji janë depozitat e ujit në tarraca dhe përdorimi i ballkonit për qëllime të ndryshme.

FIG 24- Shembuj Ndërhyrje në Ndërtesa me Muraturë që Shkaktuan Dëmtimin e Strukturës



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Dëmtimet nga uljet e themelit

Themelet për këtë tipologji janë themele të tipit tra me material prej betoni ose guri, të cilat mund të pësojnë ulje për shkak të peshës së tyre vetjake dhe kushteve të dheut. Rajoni i Lezhës është më së shumti i karakterizuar nga depozitime të dherave të dobët dhe kjo është arsyeja që disa struktura kanë pësuar ulje diferenciale, që kanë çuar në çarje në muraturë.

FIG 25- Dëmtime nga Uljet Diferenciale



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Dëmtime nga aktiviteti sizmik

Si gjithë territori i Shqipërisë, Lezha gjithashtu është e ekspozuar ndaj tërmeteve me vlera të PGA-së që variojnë nga 0.25g në 0.37g. Efekti që mund të ketë tërmeti në këtë tipologji mund të klasifikohet në dy tipe dëmtimesh:

- Dëmtime i mureve nga forca që veprojnë në planin e vet murit
- Dëmtime i mureve nga forca anësore që veprojnë jashtë planit të murit

FIG 26- Dëmtime nga Aktiviteti Sizmik



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Ndërtesa të parafabrikuara me panele dhe industriale me rama

Megjithëse në Shqipëri, siç e përmendëm edhe në klasifikimin sipas periudhës së ndërtimit, ndërtesat e parafabrikuara janë gjerësisht të përhapura, edhe në Lezhë kjo tipologji ndërtesash është e lokalizuar kryesisht në rrugën Frang Bardhi. Teknologjia konsiston në bashkimin e paneleve të parafabrikuara me saldim dhe përdorimin e elementëve të tjerë të parafabrikuar si tra dhe soleta. Këto objekte janë të prirura ndaj degradimit dhe demtimeve të këtyre elementëve strukturorë, dëmtime të cilat mund ti ndajmë në dy grupe të mëdha: a) strukturorë, kur dëmtimet (çarjet) janë në panelet e mureve dhe/ose soletave dhe/ose në lidhjen e tyre dhe b) jo -strukturorë për shembull çarje në suva. Në këtë studim janë parashikuar rekomandime teknike për organet vendimmarrëse në menaxhimin e rrezikut sizmik që këto struktura mund të pësojnë nga një tërmet i ngjashëm.

FIG 27- Shembuj të Degradimit të Ndërtesave të Parafabrikuara



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Struktura prej betoni të armuar

Dëmtimet në këto struktura janë të lidhura ngushtë me tipologjinë e sistemit të përforcuar. Për shembull, në sistemet me rama orientimi i ramës është faktori kryesor që dikton dëmtimet në nyje dhe në muret ndarës (orientimi i kolonave), në rastin e sistemeve dual ose sistemeve me mure, shpërndarja a gabuar e mureve prerës mund të sjellë probleme në lidhje me përdredhjen e cila mund të mund të prekë stabilitetin struktural të strukturës.

FIG 28- Shembuj të Ndërhyrjeve nga Njerëzit



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

FIG 29- Shembuj të Dëmtimeve nga Aktiviteti Sizmik



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

Në lidhje me degradimin për shkak të veprimeve atmosferike për këtë tipologji janë prezente këto probleme:

- Shtresa mbrojtëse e betonit mund të dëmtohet për shkak të erozionit dhe si pasojë përforcimi do jet i ekspozuar dhe rrjedhimisht mund të gerryhet(korrozioni)
- Degradimi nga procesi i ngrirje -shkrirje
- Karbonizimi – degradimi i sulfatit

FIG 30- Shembuj Dëmtimi i Armaturës



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

FIG 31- Dëmtimet në Ndërtesa prej Betoni të Armuar për Shkak të Tërmetit: Dëmtim i Kolonës; Dëmtim i Mureve Ndarës; Fenomeni i Kolonës së Shkurtër



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

EVIDENTIMI I RREZIQEVE TË MUNDSHME PËR OBJKTET SOCIALE DHE KULTURALE

Objekte të rëndësisë së veçantë (shkolla, stadium, spitale)

Në këtë kategori përfshihen objekte të rëndësisë së veçantë për qytetin të cilat duhet të projektohen duke marrë në konsideratë raste të veçanta. Kategoria e parë janë shkollat.

Kategoria e dytë janë spitalet dhe qendrat shëndetësore, në Lezhë janë 3 spitale me 319 shtretër dhe 92 qendra shëndetësore. Lezha është një bashki që ka një numër të madh monumentesh me vlera historike që duhet të ruhen, të cilët janë: Shna Ndou, kisha Shën Barbull, Shën Mhill, kisha Shën Eufemi etj. kalaja e Lezhës, ura Shkinë, shtëpia e Gjergj Fishtës etj.

FIG 32- Shkolla Fillore në Lezhë (Muraturë e Papërforuar; Dëmtime Strukturore të Murit Mbjajtës (DS5)



Burimi: Merita Guri (2020), foto terreni

3.1.4 Kalendar historik

Më poshtë paraqitet përmbledhja e eventeve sizmike në periudha kohore të ndryshme:

TABELA 4- Kalendar i Eventeve Sizmike, Lezhë

Periudha kohore	Të plagosur	Fatalitete	Ndërtime të prekura	Dëme të tjera	Magnituda	Intensiteti në Lezhë
1 Qershor 1905 (Tërmeti i Shkodrës)	500	200	1500	Dëmtime në pasuri në fshatrat ne JP të Shkodrës	MS=6.6 Richter	I = 8 ballë MKS-1964
18Dh-jetor1926 (Tërmet i Durrësit)	-	-	Shumë ndërtime në Durrës, Kavajë, Shijak	Lëngëzim trualli Durrës-Shijak	MS=6.2 Richter	I = 7 ballë MKS-1964
30 Nëntor 1967 (Dibër-Libraxhd)	174	12	Pa info	Ndikim në 177 fshatra dhe 13 lokalitete	MS=6.6 Richter	I = 5-6 ballë MKS-1964
15 Prill 1979 (Bregdet M.Zi)	382	35	17122 banesa dhe objekte socio-kulturore në rrethin Shkodër-Lezhë 100,000 të pastrehë	Pa info	MS=7.2 Richter	I = 8 ballë MKS-1964
26 Nëntor 2019	3000	51 / 1 në Lezhë	288 të pastrehë në Bashkinë Lezhë / 5200 në Shqipëri 193 banesa të inspektuara, të deklaruara DS4-DS5	Në Bashkinë Lezhë: 2 shkolla jashtë funksioni	MS=6.4 Richter	

Bazuar në kalendarin historik, për sizmicitetin është situata e mëposhtme:

- Periodiciteti: 1 herë në 20-30 vite
- Impakti social: I lartë
- Impakti në mjedisin e ndërtuar: I lartë
- Impakti në mjedis: I ulët
- Impakti në ekonomi: I lartë
- Impakti në kulturë: I mesëm

Nga pikëpamja e lidhjes me evente të tjera, tërmetet mund të shkaktojnë dhe përmbytje, si pasojë e dëmtimeve të infrastrukturës kritike kryesore, si psh. Hidrovore, nënstacione elektrike, ura, etj. Gjithsesi efekti më i drejtpërdrejtë është shkarja e tokës, sidomos në rastet kur kemi tokë kënetore me formacion gjeologjik të dobët.

3.2 GJEOLGJIA, GJEOMORFOLOGJIA DHE HIDROGJEOLGJIA

Gjatë muajit qershor-korrik 2020, "A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000", ka përgatitur studimin e gjeologjik të zonës së bashkisë Lezhë, bazuar në të dhënat ekzistuese të mëparshme dhe vëzhgime në terren. Studimet më të rëndësishme që janë përdorur për përpilimin e këtij raporti janë:

1. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për Zonën e Lezhës, realizuar nga Ndërmarrja Publike e Gjeologjisë dhe Gjeodezisë e Shqipërisë, 1950-1990.
2. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për linjën hekurudhore Laç- Lezhë- Shkodër- Kufi me Malin e Zi, realizuar nga Ndërmarrja Gjeologjike dhe Gjeodezisë e Shqipërisë, 1978-1983.
3. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për Urat e Lezhës, i realizuar nga "Altea & Geostudio 2000", 2004.
4. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për rrugën Lezhë-Shkodër- Hani Hotit, realizuar nga "Altea & Geostudio 2000", 2004-2007.
5. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për Rrugën Milot - Lezhë, realizuar nga "Altea & Geostudio 2000", 2000-2002.
6. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për Rrugën Milot- Rreshen, realizuar nga "Altea & Geostudio 2000", 2004-2005.
7. Studim i inxhinierisë gjeologjike për linjën e re elektrike 400 kë nga Mali i Zi deri në Tiranë, i realizuar nga "Altea & Geostudio 2000" për kompaninë "Dalekovod", 2007-2009.
8. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për Ndërtesat Industriale dhe Sociale në Zonën Lezhës dhe Shengjinit, realizuar nga "Altea & Geostudio 2000", 1996 - maj 2020.
9. Studim gjeologjik, inxhinierik dhe gjeoteknik për hekurudhat nga Vora deri në Hani Hotit, realizuar nga "Altea & Geostudio 2000", Prill 2019 - Maj 2020.

3.2.1 Karakteristikat fizike, gjeologjike dhe gjeodinamike

Zona ku qarku i Lezhës ndodhet në pjesën veri-perëndimore të Shqipërisë. Fillon nga lumi Mati deri në kufirin me Qarkun e Shkodrës dhe përfaqëson pjesën veri-perëndimore të Shqipërisë.

Zona nga Miloti deri në Lezhë paraqet një reliev të sheshtë. Është me origjinë aluviale dhe kënetore dhe në anën lindore të saj është e rrethuar me kodra dhe male me lartësi të ulët ndërsa në perëndim takohet me Detin Adriatik. Kodrat janë bërë nga argjile, ranore dhe rrallë gëlqerore. Shumica e maleve janë prej guri gëlqeror, ato janë të qëndrueshme dhe të zhveshura nga shpatet e vegjetacionit.

Zona nga Lezha deri në kufi me Qarkun e Shkodrës paraqet një reliev të sheshtë dhe një reliev kodrinor. Është me origjinë aluviale dhe kënetore, dhe në pjesën lindore dhe perëndimore është e rrethuar me kodra dhe male me lartësi të ulëta. Kodrat janë bërë nga argjila, ranorë dhe rrallë gëlqerore. Shumica e maleve janë prej guri gëlqeror, ato kanë shpate të qëndrueshme dhe në përgjithësi janë të zhveshur nga bimësia.

Bazuar në të dhënat nga studimet e mëparshme dhe të fundit, fenomenet kryesore gjeologjike dhe tiparet gjeodinamike që karakterizojnë formacionet gjeologjike të hasura në këtë zonë janë:

1. Perajrimi nga kushtet atmosferike;
2. Fenomenet e konsolidimit të depozitave aluviale, lagunës dhe koluviumit;
3. Dukuritë karstike në shkëmbinj të gëlqerorë;

4. Lëvizja dhe rrëshqitja e masave mbuluese të koluviumit dhe e pjesës më të lagur të formimit të shkëmbit të shtratit në drejtim të rrëzimit të relievit.
5. Masat e shkëmbinjve që bien nga pjerrësia

Këto fenomene përshkruhen një nga një më poshtë:

1. Fenomeni i përjarrimit nga kushtet atmosferike është i dukshëm në formacionet rrënjësore (shtrati i shkëmbit) të përbërë nga argjila, ranore dhe konglomeratë. Ato janë depozita të reja me një matricë të dobët argjile, të cilat nën veprimin e agjentëve atmosferikë, zbërthehen në dhe. Ky fenomen është më i theksuar në pjesën kodrinore të zonës (shiko hartën gjeologjike).
2. Fenomeni i konsolidimit të depozitave aluviale, lagunës dhe koluviumit. Aluviumi, laguna, depozitat kënetore, depozitat e koluviumit të një pjese të depozituar nga Vora deri në Han i Hotit përbëhen nga shtresa suargjila të mesme dhe argjilore që përmbajnë lëndë organike, ranore dhe shtresa të rralla zhavori. Shtresat e zhavorit janë pak deri të mesme të konsoliduara dhe, nën veprimin e peshës së duhur, ato konsolidohen në një kohë të shkurtër. Konsolidimi i shtresave të argjilës nën veprimin e peshës së tyre ndodh në një kohë relativisht të gjatë. Prania e lëndës organike e vështirëson dhe zgjat kohën e konsolidimit. Gjithashtu, gjatë procesit të dekompozimit, toka ndryshon vëllimin e saj dhe shkakton një ulje të menjëhershme që ndikon negativisht në qëndrueshmërinë e objekteve të vendosura në këto shtresa. Në zonën e studiuar, këto shtresa janë shumë të pranishme dhe kjo është arsyeja pse ne rekomandojmë që projektuesi t'i kushtojë një vëmendje të veçantë modelimit të themeleve të objekteve të reja që do të ndërtohen në bashkinë e Lezhës. Depozitat kënetore dhe lagunore janë të pranishme në Torovicë dhe Ishull Lezhë.
3. Dukuritë karstike në shkëmbinjtë gëlqerorë. Studimet e mëparshme ekzistuese gjeologjike të kryera për një periudhë të gjatë kohore në zonën e Qarkut Lezhë kanë vërtetuar që fenomenet e Karstit janë shumë të zhvilluara në shkëmbinjtë karbonatikë. Siç u përmend më lart, në shumë raste janë zbuluar shpella karstike të madhësive të mëdha në zonë. Shpellat karstike ose zbrazëtia nuk hasen në zonat e Qarkut Lezhë, të paktën deri në 10.00 m thellësi. Sidoqoftë, nëse gjatë gërmimit haset ndonjë boshllëk për themelet e objekteve të reja, rekomandohet të kryhen studime dhe hetime shtesë gjeologjike.
4. Lëvizja dhe rrëshqitja e masave që mbulojnë koluviumin dhe pjesa më të përjarruar të të bërthamës formuese në drejtim të rënies së relievit. Ky fenomen gjeodinamik negativ është i pranishëm në pjesën kodrinore të zonave ku depozitat e flihit janë të pranishme; në disa lokacione kemi identifikuar deformime të shpateve. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së themeleve të objekteve të reja nga këto rrëshqitje të tokës. Rekomandojmë që të bëhen studime të hollësishme në zonat me rreziqet e rrëshqitjes së tokës për të mbrojtur objektet ekzistuese dhe për të marrë masa inxhinierike për objektet e reja.
5. Rënia e gurrëve dhe shkëmbinjve. Ky fenomen është prezent në Kodrat e Shëngjinit dhe përgjatë rrugës së Torovicës.

3.2.2 Struktura Gjeologjike dhe Hidrogjeologjike

Në këtë seksion, ne do të përshkruajmë përbërjen gjeologjike të formacioneve të zonës duke përdorur të dhëna të mëparshme. Bazuar në të dhënat ekzistuese, ne kemi identifikuar depozitat e mëposhtme:

- *Holoceni i Hershëm (Qh1)*

Depozitat e hershme të Holocenit (Qh1) të përbëra nga depozita lacustrine të argjileve dhe

suargjills te mesme të cilat janë ndërthurur me njëra-tjetrën. Ato janë pak deri mesatarisht të konsoliduara dhe hasen në zonën e sheshtë. (shiko hartën gjeologjike).

- **Holoceni i Sipërm (kQh2)**
Depozitat e Holocenit të Epërm (kQh2) të përbërë nga depozitat suargjila te buta surera dhe torfe. Ato janë pak të konsoliduara dhe hasen në zonën e sheshtë. (shiko hartën gjeologjike)
- **Holoceni i Sipërm (alQh)**
Depozitat e të holocenit të sipërm (alQh) të përbëra nga depozitat aluviale të argjila, surera, rera dhe zhavore. Ato janë pak për tu konsoliduar në mënyrë të moderuar dhe hasen në zonën e sheshtë. (shiko hartën gjeologjike)
- **Depozitat e Holocenit (Q h)**
Depozitat e aluvioneve dhe lagunës përfaqësohen nga depozitat e lumit Lana, Lumi Terkuza, Lumi Zeza, Lumi Derveni, Lumi Mati, Lumi Drini dhe nga disa përrenj malorë të vogla, të përfaqësuar nga zhavore, suargjila, rera, surera suargjila, etj. argjilore dhe rrallë shtresa torfe. Ato përgjithësisht janë të konsoliduara dhe hasen në të gjitha zonat ku kalon linja ekzistuese hekurudhore. Fusha nga Vora deri në Hani Hotit paraqet tre vrime të thella, të mbushura me depozita aluviale, lagunore dhe koluviumi gjatë periudhës së Kuarternarit (depozitat e Holocenit dhe Pleistocenit).
- **Pleistocen-Holocene (c, d, pQp3-h)**
Depozitabrekcie Brekcie. Ato janë të konsoliduara dhe hasen pranë shpateve të kodrave. (shiko hartën gjeologjike)
- **Pleistocen-Holocene.**
Depozitat Pleistocene-Holocene (Qp-h) të përbëra nga depozita të përziera aluviale-dilluviale: rërë, zhavor, surera, popla. Ato janë të konsoliduara dhe hasen pranë shpateve të kodrave. (shiko hartën gjeologjike)
- **Depozitat e Paleocenit (Pg 1-2)**
Depozitat Paleocenit (Pg1-2) përfaqësohen nga flishe, argjile dhe ranore. Ato janë ngjyrë bezhë deri në gri, të çimentuara mirë. Pjesa e sipërme e shtresave ranore dhe argjilore është gërryer. Këto janë depozita rrënjësore dhe drejtimi i rënies së shtresave është në drejtim të kundërt me pjerrësinë e relievit. Prandaj, ato krijojnë kushte të favorshme për stabilitetin e shpateve. Ata kanë një matricë argjilore, janë gri në ngjyrë bezhë, të përjarruar dhe kanë një rezistencë të vogël ndaj faktorëve atmosferike. Filmat e trashë të materialit koluvium shtrihen në këto depozita dhe rrëzë kodrave.
- **Depozitat gëlqerore (Cr2)**
Depozitat gëlqerore (Cr2, δ J 2) përfaqësohen nga shkëmbinj gëlqerorë. Ato janë të bardha deri në gri, të çimentuara mirë. Këto shkëmbinj kanë shumë ndarje, ato janë të gërryera dhe përmbajnë shpella të cilat mund të jenë bosh ose të mbushura me surera zhavorore. Këto shkëmbinj kanë karakteristika të mira si materiale për përdorim të mundshëm si agregate për prodhimin e betonit.
- **Shkëmbinj Ultrabazik (δ J 2)**
Shkëmbinj të ultrabazik përfaqësohen nga shkëmbinj të PERIDOTITES, HARBURGITES dhe PIROKSENE. Ata kanë ngjyrë gri dhe ulliri; janë përjarruar dhe të thyer. Ata formojnë shpate të rregullta dhe janë pjesërisht të mbuluara me një shtresë të hollë koluviumesh. Ata janë të pranishëm pothuajse në të gjithë zonën.

3.2.3 Kushtet Hidro-gjeologjike

Studimet e kryera në zonën e bashkisë Lezhë (matjet e kryera në nëpërmjet shpimeve gjeologjike të kryera në këtë zonë) tregojnë se zona ka disa rezervuarë uji nëntokësor. Bazuar në këto të dhëna, dallohen disa akuiferë komplekse, të cilët janë:

- **Kompleksi i akuiferit të depozitave gëlqerore**

Përbërë nga gëlqerorë, këto depozita ndodhen në zonat kodrinore të bashkisë Lezhë. Karakteristikat hidraulike të këtyre depozitave janë: porozitet i lartë ndërqelizor dhe përshkueshmëri (K). Cilësia e ujit nëntokësor nga këto depozita është e mirë. Pjesa e sipërme duhet të mbrohet nga ndotja dhe uji duhet të merret në një thellësi prej 15.00-20.00m.

- **Kompleksi i akuiferit të depozitave të Paleogenit**

Përbërë nga argjilore, ranore, alevrolite dhe konglomerate, këto depozita ndodhen në zonën kodrinore të të dy pjesëve të fushës së Lezhës. Karakteristikat hidraulike të këtyre depozitave janë: porozitet intergranular i lartë deri në i ulët dhe përshkueshmëri (K). Cilësia e ujit nëntokësor nga këto depozita është e mirë. Pjesa e sipërme duhet të mbrohet nga ndotja dhe uji duhet të merret në thellësi 15.00-20.00m.

- **Kompleksi i akuiferit të depozitimeve Kuarternare**

Përbëhet nga depozitat aluviale dhe koluviumi. Sedimentet aluviale të përbëra nga zhavore, rera dhe surera, gjenden nga fshati Zejmen deri në fshatin Troshan. Karakteristikat hidraulike të këtyre sedimenteve aluviale (shtresa e zhavorrit dhe rërës) janë: porozitet intergranular i lartë deri në mesatar dhe përshkueshmëri e lartë deri mesatare (K). Cilësia e ujit nëntokësor nga këto depozita është e mirë. Pjesa e sipërme duhet të mbrohet nga ndotja dhe uji i marrë në thellësi 15.00m. Shtresat e suargjila te mesme dhe argjilë kanë përshkueshmëri të ulët dhe sasia e ujit nëntokësor në këto shtresa është shumë e ulët.

FIG 33 - Gjeologjia



Burimi: Allkja, S., (2020)

Sipas të dhënave nga studimet ekzistuese në vendndodhjen e objekteve të ndryshme (rezultatet e matjeve në puse të kryera për disa vite, në periudha të ndryshme të vitit, për projekte të ndryshme të shqyrtuara), rezulton se niveli i ujit nëntokësor është i ndryshëm në dimër dhe në verë. Rezulton se në pjesën më të madhe të zonës, niveli i ujit nëntokësor është shumë afër sipërfaqes së tokës (-0,90 deri në -0.80m thellësi). Në rast se do të jetë e nevojshme të gërmohet për gërmime masive për themelet e objekteve të ndryshme, largimi i ujërave nëntokësore nuk është problematik sepse ato janë në sasi të vogla dhe mund të largohen lehtësisht nëpërmjet pompimit.

Rekomandohet që për secilin objekt të ri, përveç studimeve të gjeologo-inxhinierike, të bëhen analiza kimike për ujërat nëntokësorë, sepse në pjesën më të madhe të zonës ujërat nëntokësore janë agresive dhe të rrezikshëm për hekurin dhe betonin.


3.2.4 Rreziqe Gjeologjike dhe Gjeoteknike

Në këtë kapitull do të trajtohet interpretimi i rezultateve të vëzhgimeve gjeologjike dhe gjeoteknike të bëra në terren zonën e bashkisë Lezhë. Problemet kryesore gjeoteknike në zonën e bashkisë Lezhë janë identifikuar bazuar në të dhënat e marra nga studimet ekzistuese dhe inspektimet e fundit të kryera në terren. Çështjet kryesore janë:

- Zonat ku gjenden depozita kënetore me karakteristika të dobëta fizike dhe mekanike.
- Zonat ku janë të pranishme rrëshqitjet e dheut
- Zonat ku bien shkëmbinjtë dhe gurrët nga shpatet

Të gjitha këto çështje do të përshkruhen në detaje nën një nga një.

FIG 34 - Harta e Rrezikut Gjeologjik



Burimi: Allkja, S., (2020)

A. KUSHTET GJEOLGJIKE DHE GJEOTEKNIKE TË ZONAVE KU GJENDEN DEPOZITA KËNETORE ME KARAKTERISTIKA TË DOBËTA FIZIKE DHE MEKANIKE

Bazuar në të dhënat e marra nga studimet ekzistuese dhe vizitat në sit, ne mund të dallojmë dy zona me depozita kënetore. Bazuar në të dhënat e studimeve ekzistuese dhe në studimet e reja në bashkinë e Lezhës, kemi dy vendndodhje ku janë të pranishme depozitat kënetore, siç është ish-kënetat e Torrovicës dhe zona e ishullit të Lezhës. Suargjila, surera, torfe dhe zhavorri i rrallë janë të pranishme në këto zona. Këto depozita kanë veti të dobëta fizike dhe mekanike dhe në rast të tërmeteve ato janë në rrezik të lëngëzimit, e si dhe objektet që ndërtohen në këto depozita janë shkatërruar. Ky fenomen është konfirmuar në 14 Prill 1979 dhe 26.Nëntor.2019. Rekomandohet që në këto zona të kryhen studime gjeologjike e sizmike të zgjeruara.

B. ZONAT KU ËSHTË E PRANISHME RRËSHQITJA E TOKËS

Nga të dhënat ekzistuese dhe studimet e reja gjeologjike dhe gjeoteknike del se në pjesën më të madhe të shpateve të Bashkisë Lezhë është e pranishme rrëshqitja e tokës. Zonat e rrëshqitjes së tokës janë në ato shpate të ndërtuara nga argjila dhe rërë (depozitat flishi), këto janë kryesisht në lindje të bashkisë të Lezhës. Depozitat e flishit janë të mbuluara me depozita deluviale me trashësi 5-6m, shpatet janë të mbuluara me bimësi dhe në muajt me shi ato janë të ngopura me ujë dhe rrëshqasin në drejtimin e poshtëm të shpatit. Gjatë rrëshqitjes ato lëvizin dhe objektet që janë ndërtuar në këto shpate.

Pjesët më problematike që duhet të hulumtohen në detaje gjeologjike, gjenden në pjesën Lindore të qytetit të Lezhës afër fortesës, pjesa nga qyteti i Lezhës deri në kufirin e fshatit Fishtë me Qarkun e Shkodrës dhe pjesa nga fshati Pllanë deri në fshatin Tresh. Ne rekomandojmë që të kryhet një studim i detajuar gjeologjik për të zbuluar shkaqet e këtyre rrëshqitjeve në tokë dhe për të identifikuar masat efektive të nevojshme për stabilitetin afatgjatë të shtëpive individuale të fshatrave në pjesën lindore të bashkisë Lezhë.

C. ZONAT E RREZIKUARA NGA RËNIA E SHKËMBINJVE DHE GURËVE

Janë kryer disa vizita në terren për të vlerësuar kushtet gjeologjike dhe problemet e zonave ku shkëmbinjtë bien nga shpatet. Ne kemi identifikuar dy zona ku shkëmbinjtë bien nga shpatet dhe rrezikojnë rrugët dhe ndërtesat që janë në fund të shpatit. Zonat më të rëndësishme ku është i pranishëm ky fenomen janë:

Në rrugën Balldre-Bushat nga kënetë e Torroviçës për disa vite ka një rënie gurësh në drejtim të shtëpive dhe në rrugë. Nga rënia e gurëve ka pasur dëme materiale dhe njerëzore. Zona ku është ndërtuar qyteza Torroviçe dhe rruga janë në fund të shpatit. Pjerrësia është e mbuluar me bimësi, por një pjesë është pa bimësi, e ndërtuar me shkëmbinj gëlqeror. Nga vëzhgimet sipërfaqësore kemi konstatuar se në shpat ka shumë gurë me dimensione të mëdha 1-2m³ të cilat janë gati të bien. Ky është një fenomen i rrezikshëm që kërcënon jetën e njerëzve që jetojnë atje, është gjithashtu e rrezikshme për automjetet që kalojnë në rrugën për në Torroviçe. Ne rekomandojmë që të bëhet një studim i detajuar gjeologjik për këtë zonë dhe bazuar në të dhënat e marra nga ky studim, të merren masa inxhinierike për të parandaluar rënien e gurëve dhe për të siguruar rrugën dhe shtëpitë që janë në rrugën Balldre Bushat. Pranë Kënetës së Knallës në rrugën Lezhë-Shëngjin ka patur rënie gurësh të cilët kanë bllokuar rrugën për disa ditë. Janë marrë disa masa inxhinierike të cilat kanë stabilizuar kalimin e automjeteve. Ne rekomandojmë që për segmentin e rrugës Lezhë-Shëngjin të bëhet një studim i hollësishëm dhe bazuar në të dhënat e marra nga ky studim për të marrë masa inxhinierike për të siguruar rrugën për një kohë të gjatë.

Këto janë disa nga rreziqet gjeologjike që janë identifikuar në Bashkinë e Lezhës. Kemi ndarë tre lloje dherash dhe shkëmbinjsh që takohen në rrethin e Lezhës.

- Zona me depozita kënetore me karakteristika të dobëta fiziko-mekanike. Këto depozita kërkojnë masa inxhinierike të veçanta dhe studime gjeologjike e sizmike para çdo ndërtimi, qoftë kjo edhe për një ndërtesë njëkatëshe.
- Zonat me depozita lumi dhe liqeni që janë me karakteristika mesatare. Kërkohen studime të hollësishme të inxhinierisë dhe gjeologjisë sizmike, por në këto zona ndërtimet janë më të lehta se ndërtimet në kategorinë e parë.
- Zonat shkëmbore që kanë karakteristika të mira fiziko-mekanike, por në këto zona studime inxhinierike gjeologjike janë të nevojshme për qëndrueshmërinë e pjerrësisë.

3.2.5 Kalendar i historik

TABELA 5- Kalendar i Gjeorrezizqeve Lezhë 2017-2020

Periudha kohore	Dukuria	Zona / Njësia e Prekur	Fatalitete	Të plagosur	Ndërtime të prekura	Ndikim në pasuri	Ndikim në infrastrukturë	Komente
25 Shkurt 2017	Rrëshqitje toke	Zadrimë, Lezhë	-	-		Autobus shkolle i rrezikuar	Shembje e rrugës, bllokim i një korsie	Raportim në media
7 Tetor 2017	Rënie gurësh	Torovicë, Balldren	4	-	-	1 makinë e dëmtuar	-	
15 Mars 2018	Shembje dherash	Zona e Kalasë, Lezhë	-	-	muri i rrugës së Kalasë i shembur		Bllokim i përkohshëm i rrugës	Raportim në media
21 Mars 2018	Rrëshqitje toke				7 ndërtesa të shembura			
30 Mars 2018	Rënie gurësh	Lagjia Varosh, Lezhë	-	-	Rrezikohen banorët	-	-	Raportim në media – fenomen i përhershëm
6 Qershor 2018	Rënie gurësh	Zona e Kënallës, Lezhë-Shëngjin	-	2	-	1 autobus i dëmtuar		Raportim në media
20-30 Nëntor 2018	Rënie gurësh	Fshati Pllanë, Aksi Lezhë-Rubik	-	-	-	-	Bllokim 1 kah lëvizje, 20 ditë gurët pa pastruar	Raportim në media
5 Nëntor 2019	Rënie gurësh	Rruga e Torovicës	-	-	1 Fermë (400 dele) në rrezik	-		Raportim në media
Tetor 2020	Rrëshqitje toke Rënie gurësh	Zona e Kalasë	-	-	Shembje e murit verip-erëndimor të kalasë Rrezik për ndërtesat poshtë	-	-	Raportim në media

Burimi: autorët, bazuar në dokumente studimore dhe fokus grupe

Sic duket nga kalendar i historik, periodiciteti është i lartë, por rastet e fataliteteve janë të ulëta. Më poshtë shfaqen të dhënat bazë nga kalendar i:


- Periodiciteti: Çdo vit, kryesisht pranverë dhe vjeshtë
- Impakti social: I ulët
- Impakti në mjedisin e ndërtuar: I mesëm
- Impakti në mjedis: I ulët
- Impakti në ekonomi: I ulët
- Impakti në kulturë: I lartë

Rrëshqitjet e dheut dhe rënia e gurëve aktivizohen më tepër në raste shirash të rrëmbyer, dhe stuhish breshëri. Gjithashtu ato lidhen me aktivitetet sizmike, sidomos në zonat kënetore me tendence lëngëzimi.

3.3 SISTEMI HIDRIK

Krijimi dhe zhvillimi i rrjetit lumor është i lidhur para se të gjithash me zhvillimin gjeologo tektonik dhe paleogjografik të zonave të cilat ky rrjet i ndërpret. Me daljem mbi ujë të një treve, krijohet dhe rrjeti ujqor fillestar, arteriet kryesore të tij. Toka shqiptare, nga pikpamje gjeologjike është tokë relativisht e re dhe i përket etapes neotektonike të zhvillimit që nis nga mioceni i mesëm, ku fillon dhe formimi i rilievit të sotem. Formimi i luginave lumore të vendit tonë duhet t'i perkasë kësaj etape. Në kuaternar, riaktivizohen së tepermi erozioni thellsinor i lumenjëve dhe luginat thellohen shumë deri në gjëndjen e sotme. Rrjeti i zhvilluar hidrografik përshkon pothuajse të gjithë zonat gjeologo tektonike, kështu deri dhe luginat ndryshojnë shumë midis tyre nga pikpamja e zhvillimit gjeomorfologjik dhe e karakteristikave morfologjike. Sistemi hidrografik i Bashkisë së Lezhës është mjaft i pasur dhe përbëhet nga lumenj e përrrenjë, liqene natyrale e artificiale, burime të shumta ujore.

FIG 35- Sistemi Hidrik në Bashkinë Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Lumi Drin dhe dega e tij lumi Gjader, së bashku me rrjetin kullues, ushqehen nga përrrenjë malor të shumtë si Zalli i Didrit, Kalorit, Vomes, Troshanit, Kallmetit, Merqisë, Grykës, Fildanës. Ndersa ujqat e përrrenjëve Spiten e Zejmen, ushqejnë sistemin kullues të zonës jugore fushore të Lezhës për t'u shkarkuar në detin Adriatik, nëpërmjet hidrovorit të Tales. Përroji i Pllanës e Berzanës, shkarkojnë ujqat e tyre në Lumin Mat, i cili e kufizon nga ana jugore territorin e Bashkisë së Lezhës.

4.3.1 Vështrim historik i përmytjeve nga burimet ujore tokësore

Veçanërisht në gjysmen e dytë të shekullit të 20 (deri rreth viteve 1970) kur u bë drenazhimi për të përftuar tokë bujqësore), e gjithë zona fushore e deltave të lumenjëve Drin e Mat, i është nënshtruar një ekspansioni të egër të aktivitetit njerëzor. Në tokat e përftuara nga kullimi e që

janë jashë zonave të rikonfiguruar si zona të mbrojtura, vërehet të rritet popullsia banuese dhe presioni i saj i cili u bë veçanërisht i ndjeshëm pas viteve 90. Ky territor ka sipërfaqe të konsiderueshme që janë nën nivelin e detit të cilat mbahen nën regjim bonifikimi përmes rrjetit të kanaleve kulluese dhe stacioneve të pompimit.

E gjithë zona fushore e territorit të Bashkisë së Lezhës, si ajo e Zadrimës po ashtu edhe ajo në jug të qytetit të Lezhës deri në bregun e lumit Mat është mjaft e ekspozuar dhe ka një rrezik të lart të përmytjes. Nga vlerësimet e kryera të përmytjeve të mëparshme, rezulton se sistemi lumor përben rrezikun më të madh për përmytjen massive ku rrezikun kryesor e kanë tokat bujqësore, informale e në kuota nën nivelin e detit, (ish kënetat) si në Mabë, Zojz, Gocaj, Torovicë, Ishull-Shëngjin, Barbullojë, Lalm i Ri, Tresh, Zejmën etj. Për tu evidentuar, janë përmytjet e viteve 62-63; 95-96; 2002-2004; 2009-2010; Nëntor 2014, Janar 2016 (Bashkia Lezhë, 2018; Qarku Lezhë, 2018). Gjatë vitit 2017 e më pas, me masat e marra për pastrimin e thellimin e shtratit të lumenjve, kanaleve kryesore, kanale të dyta e të treta ky rrezik është ulur dhe nuk ka pasur përmytjetë banesave, por vetëm raste të qëndrimit të ujit mbi tokë.

Përmytjet, historikisht janë favorizuar nga një serë faktorësh natyrorë e human nga ku përmendim:

- Dobësimi e humbja e funksioneve përcjellese natyrore të prurjeve dhe e aftësisë vetëpastruese të lumit Drin nga ndërpreja e devijimi i tyre për në lumen Buna. Kjo ndërpreja, është bërë me anë të ndertimit të digës së Spatharës në Mjedë të Bashkisë së Shkodrës si pjesë e sistemimi hidrik të fushës së Zadrimës. Po ashtu është bërë dhe ndërprerja e ujrave të Lumit Gjadër, të cilat janë dërguar edhe ato në digën e Spatharës. Por me kalimin e viteve, u vu re edhe impakti negativ i kësaj nderhyrje e cila çon në mbushjen e shtratit të lumit Drin, e bllokimin e kanaleve kulluese nga sedimentet e sjella prej përrenjëve malor.
- Në mënyrë të veçantë në tre dekadat e fundit, u rrit frekuenca e reshjeve intensive, ku pranohet se kur reshjet e rëna arrijnë në 300 ml në një hark kohor prej dy ditësh, sistemi hidrik nuk ka kapacitete për t'i përcjell këto prurje, e për pasojë shoqërohet me daljen e ujrave të lumenjve nga shtrati i tyre duke shkaktuar përmytje.
- Nga mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të perrenjëve malor, sidomos nga amortizimi e dmëtimi i penave mbrojtëse, rritja e erodimit nga prerja pa kriter e pyjeve, rënia e reshjeve intensive në fraksione kohe të shkurtra, kanë ndikuar në rritjen e prurjeve të ngurta duke bllokuar shtreterit e tyre, mbushjen e shpejtë të kanalëve kulluese, dëmtuar infrastrukturën rrugore etj. Kjo situatë ka ndikuar së tëpermi në përmytjet në zonën fushore.
- Levizja e lirë e popullatës bëri që zonat fushore të dominohen nga ndertimet jashtë konturit të fshatrave të kësaj zona duke shtuar një sërë zonash informale e deri në krijimin e fshatit të ri si Barbulloja e Re e Lalmi i Ri. Këto ndërtime ndikuan në prishjen e sistemit drenues të zonës, duke bërë që uji të mbetet në parcela për një kohë të gjatë duke e impaktuar në formën e përmytjes.
- Ndertimi i infrastrukturës së re rrugore si dhe i mjaft objekteve industriale, sociale e të shërbimeve në këtë zona, duke mos marr parasysh ruajtjen e kapacitetit përcjellës të ujrave sidomos në rastet e ndertimit të urave, vendosjes së tumbinove, ndertime mbi ose buzë sistemit kullues, ka rritur në mënyrë të ndjeshme presionin ndaj kësaj zone duke favorizuar përmytjet.
- Para investimeve të fundit, rastet e mosfunksionimeve të hidrovorëve nga amortizimi i tyre, mungesa e energjisë elektrike si dhe e kapacitetit të ulët përballë reshjeve intensive, ka ndikuar në shumë raste në krijimin e përmytjeve në ato zona të cilat mbahen të kulluara nga puna e tyre.
- Në mjaft raste, rritja e baticës detare të shoqëruar nga stuhi që godasin zonën bregdetare,

kanë penguar shkarkimin e ujrave të lumëve në deltat e tyre, duke ndikuar në përmbytjet e zonës fushore.

- Mosmirëmbajtja e për pasojë dëmtimi ose amortizimi i tyre i argjinaturave, rritja e nivelit të rrymave lumore mbi normat e parashikuara si rezultat i reshjeve intensive, e kanë vënë në rrezik për përmbytje, zonën fushore.
- Mospastrimi i rezervuareve artificiale dhe mbushja e tyre (me 2 % të volumit të tyre çdo vit), moskujdesi ndaj digave të tyre, mund të ketë në precedent për përmbytjet në të gjitha banesat e aseteve të tjera që janë në nivelin e këtyre digave.
- Dëmtimi ose mungesa në sistemin e brishtë të sinjalizimit dhe paralajmërimit për përmbytjet, mungesa ose dëmtimi i hidrometrave të nivelit të ujrave në trupin e urave dhe bankinave të lumëve dhe perrenjeve, në hidrovore etj, dhe mungesa e monitorimit, ka ndikuar që komuniteti dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet në këto zona të gjenden në papërgatitur për t'u përballur në rastet e përmbytjeve

Më poshtë paraqiten disa nga përmbytjet kryesore në dy dekadat e fundit dhe dëmet e shkaktuara prej tyre:

Përmbytje në datat 22 deri me 25.09.2002

Në mënyrë të përmblodhur nga situata e përmbytjeve të krijuar nga reshjet e datave 22 deri 25.09.2002 evidentohet:

- Ka dalje nga shtrati të lumit Drin në vëndet: I. Lezhë, I. Shëngjin, Gjadër, Kakarriq, Mapë. Lumi Mat ka dalje nga shtrati në Fushë Kuqe;
- Janë thyer në 3 vende argjiraturat e kanaleve të ujrave të larta të Zejmenit;
- Janë thyer në 3 vende argjiraturat e kanaleve të ujrave të larta të Zadrimës;
- Ka vërshime të perrenjëve të Trashanit, Fishtës, Grykë Manatisë.

Situata me hidrovoret:

- Hidrovori i Tales punon, ka pasur pak ndërprerje (*merr energji në dy drejtime nga Lezha e Laçi*).
- Hidrovori në Ishull Shëngjin nuk ka punuar (*pa energji*).
- Hidrovoret në Balldre ka funksionuar me kapacitet të ulët, niveli i ujrave të Drinit ku shkarkon ujrat është shumë i lartë.
- Hidrovori në Grykë Zezë nuk ka punuar (*ishte i dëmtuar*).

Nga situata e shkatuar nga përmbytjet në datat 21-26 shtator 2002 veçohet:

- Si rezultat i rënies së mbi 200 mm reshje brenda një periudhe kohore të shkurtër janë shkaktuar përmbytje në 15000 ha tokë (vlerësimi ekonomik për rikthim në gjendje normale është 75000 mijë lek). Dëmet e shkaktuara në sistemin energjetik elektrik janë 5776 mijë lek, në infrastrukturë rrugore 108800 mijë lek. Janë dëmtuar argjinatura të kanaleve vaditës e ujëmbledhës me vlerë 454000 mijë lek, në ujësjellës të rrjetit shpërndarës 4550 mijë lek, objekte sociale kulturore 9000 mijë lek, familje të prekura 9300, shtëpi të pabanueshme 160.

Shkaku kryesor i përmbytjeve konsiderohet:

- Fryerja e lumit Drin nga mbathja e shtratit, rritja e nivelit të ujrave dhe reshjeve (*mbi 200 mm reshje në një periudhë kohore të shkurtër*). Ka influencuar shumë në fryerjen e lumit Drin dhe thyerjen e argjiraturës së lumit Gjadër në cili i ka shkarkuar ujrat në lumin Drin (*shkarkimet i ka në lumin Drin në degë që derdhet në Bunë*).
- Bllokimi i kanaleve kulluese nga ndertimet e paligjeshme sidomos në zonat fushore të Bregut të Matës, Shëngjinit. Kjo vërehet qartë sidomos në bllokimin e kanalit kullues Grykë Manati në qytetin e Lezhës, ku si rezultat i ndertimeve brenda argjiraturës është ulur shumë kapaciteti thithës i prurjeve nga shirat dhe në këtë zonë janë bërë përmbytje në objekte banimi e tokë bujqësore.

- Dëmtime të argjinaturave mbrojtëse nga ndërtime të paligjëshme apo shfrytëzimi pa kriter i inerteve në afërsi të ketyre objekteve si rezultat i të cilëve është ndikuar në devijime të shtratit të lumit Mat sidomos në zonën e Bregut të Matës.
- Amortizimi i hidrovoreve, dëmtime e defekte në to e mungesa e rrjeteve të veçanta të furnizimit me energji elektrike të tyre mbasi rrjeti egzistues është i ngarkuar me furnizimin e popullatës. Hidrovorët kanë punuar me kapacitet të ulet ose nuk kanë funksionuar.
- Mospastrimi i kanaleve kulluese nga fërmerët e shoqatat e përdorimit të ujit, ka sjellë mbushjen me lëndë inerte në vite e cila ka ndikuar në mosthithjen e ujrave për kullim në këto sipërfaqe.
- Ndërhyrje e fërmerëve në kanalet kulluese duke bërë punime të panevojshme si ura, gardhe, mbjellje kulturash etj.
- Njësitë e organeve të qeverisjes vëndore nuk kanë kontrolluar cilësitë e investimeve të bëra nga donacione të ndryshme, nga buxheti i shtetit për fondet e akorduara për veprat kulluese.
- Prishja e pritave malore dhe mosinvestimi në të është një nga shkaqet që kanë ndikuar në rritjen e shpejtësisë e sasisë së prurjeve (*me inerte*).
- Dëmtime të mëdha ka pasur ne infrastrukturën e qytetit Lezhë nga prurjet me ngarkesa të mëdha inerte, duke mbajtur të përmbytur një pjesë të lagjes Skenderbeg e Beslidhja e duke paralizuar sistemin kanalizues si dhe 30 shtëpi janë bërë të pabanuara.

Përmbytje në datat 26-29.02.2004

Pasojat e përmbytjeve përshkruhen sipas njësive administrative:

Qyteti Lezhë:

- Në Lagjen “Beslidhja”, janë përmbytur plotësisht 3 shtëpi banimi;
- Në Lagjen “Gurra”, janë përmbytur 12 shtëpi banimi;
- Është bllokuar rruga që lidh Lagjen Shehër në afërsi të Kalasë me qëndren e qytetit, nga shëmbja masive e dherave.
- Në rrugën nacionale Lezhë - Shkodër, pranë ish fabrika e letres është bllokuar kanalit kryesorë i shkarkimit të ujrave si rezultat i prurjeve të inerteve nga mali.
- Problem për qytetin e Lezhës, është pastrimi i lumit Drin,që përmbyt Lagjen “Beslidhja” e Komisariatin e Policisë,si dhe Përroit të Grykes i cili përmbyt teritoret e shkollave të qytetit Lezhë.

Nj. A. Kolsh:

- Në fshatin Manati, janë përmbytur plotësisht 2 shtëpi banimi;
- Në fshatin Barbulloj, janë përmbytur plotësisht 80 shtëpi banimi;
- Në zonën Barbulloj e Re, janë përmbytur 50 ha tokë bujqësore.
- Në Manati, janë përmbytur 5 ha toke bujqësore.
- Ne lagjen Lalm i Ri, janë përmbytur 5 ha tokë bujqësore.
- Digese Rezervuarit në qëndertë fshatit Kolsh, me kapacitet ujëmbajtës 110000m³ ka filluar (*gërryrjen*) shëmbjen dhe paraqet rrezik për zonën posht saj dhe kërkohet ndërhyrje e menjëhershme.
- Prishja e pritave malore dhe e argjiratunave të përrenjëve, ku si pasojë gjatë rreshjeve, sjellin inerte të cilat ndikojnë në bllokime rrugësh, grryrre të tokave bujqësore dhe përmbytje.
- Problem për eliminimin e përmbytjeve në zonen Barbullojë e Re dhe Manati, është pastrimi i kanaleve kulluese.

Nj.A. Baldren:

Përmbytje tokash të mbjella në masen 900 ha, të ndara:

- 800 ha në ish kënetën e Kakarriqit dhe 100 ha në fushën e Gocajve;
- Grryerjete dherave në zonën e Torovicës sollën probleme serioze për disa shtëpi banimi, bllokim të sistemit të ujrave të zeza, bllokim të hyrjeve në katet e para të pallateve, bllokim pjesor të rruges nacionale Lezhë – Shkodër.

Nj.A. Shënkoll:

- Është dëmtuar argjinatura e lumit Mat në zonën Shënkoll në afërsi të Kampit të burgut dhe Tale 1;
- Janë përmbytur në rreth 155 shtëpi banimi në fshatrat Grykë Lumi 1-2, Rrilë, Barbullojë, Tale-2 dhe Shenkollë;
- Është përmbytur 150 ha toke bujqësore;
- Problem për komunitetin është rritja e fuqisë shpërndarëse e nënstacionit elektrik me një transformator më të madh, sepse mungesa e tij shkakton ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike, çfarë do të thotë mos furnizim të vazhdueshëm të Hidrovorit të Talës me energji elektrike, çfarë do të thotë mos furnizim të vazhdueshëm të Hidrovorit të Talës me energji elektrike, çfarë do të thotë mos furnizim të vazhdueshëm të Hidrovorit të Talës me energji elektrike për pasoj, krijohen përmbyte të tokave nga mos thithja e ujrave qësjejin rreshjet.

Nj.A. Ungrej:

- Bllokim të akseve rrugore Kallmet-Ungrej-Rreshën, dhe Kalivaç-Vau-Dëjes, në disa pika për shkak të rreshqitjeve të dherave dhe gurëve;
- Dëmtim i linjave elektrike, shtylla të tensionit të lartë dhe drurit;
- Dëmtim i 15 urave në mes 9 fshatrave të Komunes;
- Dëmtim i 14 dy tokë bujqësore në të gjitha fshatrat e Komunes;
- Dëmtime të kanaleve vaditëse në masën 760 ml;
- Shembje muresh mbajtëse të kanaleve vaditëse në masën 230 m³.

Nj.A. Dajç:

- Në fshatin Gjadër, janë përmbytur 2 shtëpi banimi dhe 365 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Mabë, janë përmbytur 3 shtëpi banimi dhe 60 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Zojz, janë përmbytur 40 ha tokë bujqësore;
- Në fshatin Grash, janë përmbytur 40 ha toke bujqësore;
- Në fshatin Dragushe, janë përmbytur 30 ha toke bujqësore;
- Në fshatin Dajç janë përmbytur 40 ha toke bujqësore;
- Në fshatin Koterr, janë përmbytur 30 ha toke bujqësore;
- Është dëmtuar pjesërisht baza ushqimore e thatë për bagetinë.

Nj. A. Zejmën:

- Janë përmbytur 129 shtëpi banimi;
- Janë përmbytur 1950 ha tokë bujqësore;
- Janë dëmtuar pritat malore në të gjithë faqen e malit Pllanë - Manati.

Përmbytje 10.11.2009

Përmbytje të tokave bujqësore dhe trojeve në fshatin Barbullojë të Nj.A. Kolsh kanë ndodhur nga reshje intensive shirash, erëra të shoqëruara nga dallgëzime të fuqishme në bregdet;

- Reshje intensive të shirave afro 1 javore me ndërpreje, arritën të përmbysin pothuajse të gjithë fshatin Barbullojë, si zonën e truallit ashtu dhe 2300 ha tokë bujqësore. Përveç reshjeve intensive, situata e rëndë u favorizua nga pamundësia e thithjes së ujrave nga Hidrovori i Talës, punonin vetëm 4 pompa me 2.5 m³, ndersa pompa për 10m³, ishte me difekt.

Nga përmbytjet e zhvilluara u shkaktuan gjithashtu këto dëme:

- Shtëpi të përmbytura në Barbullojë;
- Përmbytje e 2300 ha tokë bujqësore, disa prej tyre me kultura në proces;
- Ndërprerje të furnizimit me energji elektrike;
- Vështirësi në shpëtimin e ushqimit e të krerëve të blegtorisë;
- Rrëzime të reja pishash në bregdetin e Kunës;

Përmbytje dt.18.11.2014 në qytetin e Lezhës:

- 2 banesa tek kryqëzimi i kanaleve Përroi i Manatisë, ai Grykës, e L. së Gurrave;
- 1 banesë tek Lagja Frutore;
- 11 banesa tek Lagjia Besëlidhja;
- 16 banesa tek Lagjia Skenderbeg;
- 1 banesë tek Lagjia e Fiqve.

Në këto banesa u demtuan mjaft pajisje e orendi, demë në suvatime etj.

Përmbytje të datës 6 Janar 2016

Në zonën e Bashkisë së Lezhës kanë rënë 90 mm shi gjatë 24 oreve dhe po brenda kësaj periudhë kanë rënë 60 mm shi ne zonën Manati - Milot në nje hark kohor prej vetëm 3 orëve. Ndërsa në 48 orë kanë rënë gjithsej 120 mm.

Si rezultat i këtyrë reshjeve intensive që kulmuan me datën 6 Janar 2016, rezultojnë përmbytje pothuajse në të gjithë zonën fushore të Bashkisë së Lezhës, në një sipërfaqe totale toke bujqësore prej 1500 ha, përkatesisht:

- Njesia Administrative Shenkoll 220 ha;
- Njesia Administrative Zejmen 550ha;
- Njesia Administrative Balldre 450 ha;
- Njesia Administrative Blinisht 180ha;
- Njesia Administrative Dajç 100 ha.

Si rezultat i përmbytjes pati dëme të konsiderueshme në kulturat bujqësore të mbjella si grurë e jonxhë, por dhe degradim të cilesisë së tokës nga erozioni dhe futja e ujrave të kripura në zonën Tale 2. Dëme pati dhe në blegtori në zonën e Zejmenit e të Tales. U përmbytën gjithsej 7 banesa në Njësinë Administrative Zejmën dhe 1 banesë në Njësinë Administrative Shënkoll, ku përveç dëmeve në pajisje e orendi, dy prej tyre patën edhe dëme në anën ndertimore.

Po ashtu, nga rreshjet intensive të rëna me dt. 6 Janar 2016 e për pasojë të daljes nga shtrati të përroit të Zejmenit e të Pllanës, në fshatin Zejmën e Pllanë në Nj.A: Zejmen, u përmbytën:

- 1 banesë u përmbyt totalisht e cila doli jashtë funksionimit;
- 6 banesa në fshatin Pllanë, në të cilat pati dëmtimë në pajisje e orendi si dhe suvatimet e ndërtesave.

Në territorin e Bashkisë së Lezhës, pasojat e përmbytjes i ka ndjerë më shumë fusha e Torovicës, Zadrimës e Bregu i Matës. Në rrezikun e përmbytjes ndikim të madh kanë mënyra si funksionojnë sistemi i kanaleve kryesore(kolektoret) të largimit të ujrave, të kanaleve të dyta e të treta, prandaj e rëndësishme është të mbahet nën kontroll funksionimi i tyre.

Ndërsa në zonën urbane pasojat janë më të ndjeshme në qytetin e Lezhës në lagjen Besëlidhja, Skënderbeg si dhe në qytetin e Shëngjinit, zona e portit në rrezë të malit të Shëngjinit. Pavarësisht nga uljes së rrezikut të prekjes nga përmbytjet, si rezultat i investimeve të viteve të fundit rezulton se përsëri janë me rrezik rreth 20 fshatra dhe 500 shtëpi banimi me rreth 25000 banorë.

Siç vërehet nga të gjitha rastet, përmbytjet nga rritja e prurjeve në lumenjë, përrenjë e kanale si rezultat i reshjeve intensive kanë shkaktuar:

- Dëmtime të pajisjeve e orëndive në banesa ose humbje e plotë e funksionit të tyre.
- Demtim të kulturave bujqësore, e humbje të cilësisë së tokës, demtim të krrevë në blegtori e në bazën ushqimore të saj.
- Paralizimi i përkohshëm i infrastrukturës urbane të qyteteve Lezhës e Shëngjin, dëmtimi i aseteve të mjaft subjekteve që ofrojnë shërbime etj.
- Prishja e infrastrukturës rrugore në shumë segmente të territorin të Bashkisë së Lezhës nga mbushjet me inerte si rezultat i prurjeve të ngurta ose rreshqitjeve të dherave.
- Dëmtime e rrezikime për prishje të urave mbi sistemin ujor.
- Dëmtime të shtyllave të sistemit elektrik.
- Bllokime të rrjetit të ujrave të zeza në zonat urbane.
- Mbushje e nxjerrje jashtë funksionit të sistemit kullues e vaditës në mjaft segmente të këtyre rrjeteve.

Në të gjitha përmbytjet, reagimi i komunitetit lokal e i strukturave lokale ka qënë në përputhje me natyrën e dëmeve të çdo rasti, e vlerësimit të rrezikshmërisë së dëmit, si dhe në vartësi të fondeve e mjeteve të vena në dispozicion. Pushteti vendor ka angazhuar pas rasti mjetet e veta të shërbimit publik si fadrome, kamion, çadra, si dhe fondet financiarë për dëmshperblimet për dëmt në banesa, në përputhje me bazën ligjore për emergjencat civile. Në rastet e dëmeve të mëdha sidomos në rastet e dëmtimeve të argjinaturat lumore janë aktivizuar rast pas rasti dhe forcat e ushtrisë me mjetet e tyre dhe subjektet private. Përballimi i përmbytjeve është organizuar e mbështetur nga shtabet e emergjencave civile ne Prefekturë e Bashki, si dhe nga bashkëpunimi me subjektet që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë së Lezhës, forcat e mjetet e ushtrisë, forcat e MZSH, banorët që ju janë dëmtuara pronat, shoqatat jo fitimprurëse etj.

3.3.2 Kalendar historik

TABELA 6- Ngjarje Historike Përmbytje (evente masive)

Periudha kohore	Zona / Njësia e Prekur	Popullsia e prekur	Ndërtime të prekura	Tokë bujqësore (ha)	Ndikim në infrastrukturë	Komente
Nëntor 1992	Pa info	Pa info	Pa info	840	Thyerje e argjinaturës së lumit Mat dhe Drin	Referuar PPV
Gusht 1995	Ishull Shëngjin	Pa info	Pa info	700	Mos funksionim i H/V në Ishull Shëngjin	Referuar PPV
Shtator 1996	Pa info	Pa info	Pa info	800	Reshje shumë të dendura shiu	Referuar PPV
Tetor 1996	Pa info	Pa info	Pa info	700	Reshje të dendura dhe mosfunksionim i H/V	Referuar PPV
Shkurt 1998	Pa info	Pa info	Pa info	500	Thyerje të kanalit ujërave të larta	Referuar PPV
Dhjetor 2000	Ishull Shëngjin	Pa info	Pa info	300	Thyerje të argjinaturës së detit në Ishull Shëngjin	Referuar PPV
Shkurt 2002	Ishull Shëngjin	Pa info	Pa info	400	Thyerje të argjinaturës së detit	Referuar PPV

Periudha kohore	Zona / Njësia e Prekur	Popullsia e prekur	Ndërtime të prekura	Tokë bujqësore (ha)	Ndikim në infrastrukturë	Komente
22-25 Shtator 2002	Ishull Lezhë, Ishull Shëngjin, Kakarriq	9300 (familje)	160	15000	Dëmtim argjinatura e ujërave të larta në Zejmen	Ndikim në vërshime në Trashan, Fishtë, Grykë Manati
26-29 Shkurt 2004	Lezhë, Kolsh, Balldren, Shënkoll, Zejmen, Dajc, Ungrej	Rreth 1500	386	3650	Dëmtim prita Pllanë, shembje mure vaditëse Ungrej, dëmtim 15 ura Ungrej, Argjinatura Mat, Gerryerje e diges Kolsh, bllokim kanalesh Qytet	Shoqëruar me rrëshqitje dherash në Ungrej e Torovice
Janar 2007				1200		
10 Nëntor 2009	Barbullojë, NJA Kolsh		Disa	2300	Rrezime pisha në Kune, ndërprerje energji	Rreshje shirash 1 jave, kishte defect në HV Tale
Dhjetor-Janar 2010	Tale, Ishull Shëngjin	?	60	8600	Carje e bankines se HV Tale Dëmtim rrjeti elektrik Dëmtim drurësh, kripëzim bimësh dhe toke bujqësore	Baticat detare 1,8 m
Janar 2012	Lezhë qytet			950	Reshje shumë të dendura, Lezhe	Referuar PPV
Janar 2013	Lezhë qytet			700	Reshje shumë të dendura, Lezhe	Referuar PPV
Shtator 2013	Lezhe, Shengjin, Kolsh			850	Reshje shumë të dendura, Lezhe, Shengjin, Kolsh	Referuar PPV
18 Nëntor 2014	Qytet Lezhë	?	31	-	Dëmtime mobiljesh, pasjise, etj	Referuar PPV
6-7 Janar 2016	Shënkoll, Zejmen, Balldren, Blinisht, Dajc, qytet Lezhë	Risk 25000 banorë	7 Risk 500 shtëpi	1500	Ujëra sipërfaqësore disa ditë, dëmtime mobiljesh, infrastrukturë urbane, ura, shtylla elektrike, ujera zeza.	Raportim EC Prefekturë, dalje nga shtrati dhe e përrrenjeve Zejmen, Pllanë

Burimi: autorët, bazuar në dokumente reference dhe fokus grupe

- **Periodiciteti:** Çdo 2 vite (dhe dy herë në vit)
- **Periudha kryesore:** Tetor-shkurt
- **Impakti social:** I lartë
- **Impakti në mjedisin e ndërtuar:** I mesëm
- **Impakti në mjedis:** I ulët
- **Impakti në ekonomi:** I lartë
- **Impakti në kulturë:** I ulët

Sa i takon përmbajtjeve periodike, më poshtë gjendet një klasifikim i tyre sipas shkaqeve kryesore dhe impaktit që kanë (në m² tokë të përmbatur). Përmbajtjet lidhen ngushtësisht me ndryshimet klimatike, ndryshimin e regjimit të reshjeve, si dhe baticat detare. Shkak kryesor i disa llojeve përmbajtjeve janë problemet teknike në infrastrukturë dhe mosfunksionimi i hidrovoreve. Përmbajtjet, nga ana tjetër, shkaktojnë rreziqe të tjera, si shkarja e tokës dhe erozioni, në zonën e Torovicës, dhe në zonën e Pllanës, Zejmenit nga përmbajtjet e ujërave të larta. E rrezikuar si pasojë është edhe zona e Spitalit dhe Kalasë në qytetin e Lezhës.

3.4 RREZIQET NGA NDRYSHIMET KLIMATIKE

Njerëzit në mbarë botën po përjetojnë drejt për së drejti efektet katastrofike të ndryshimeve klimatike si valët e ngrohjes, përmbytjet, stuhite, zjarret dhe thatësitat e tejzgjatura. Tashmë këto po ndikojnë në shëndetin e tyre, nivelin e jetesës, zhvillimin ekonomik dhe sigurinë. Ndërsa ndryshimet klimatike mund t'i atribuohen ndryshueshmërisë natyrore dhe faktorit njerëzor, shkencëtarët bien dakord se emetimi i gazeve me efekt serë është shkaku kryesor i këtyre ndryshimeve sot.

Rritja e përqendrimit të avujve të ujit, dioksidi të karbonit (CO₂), metanit (CH₄) dhe ozonit (O₃) në atmosferë nga veprimtaria njerëzore, si djegia e karburanteve fosile dhe shpyllëzimi, pengojnë rrezet e diellit për të arritur sipërfaqen e tokës si dhe rrezet infra të kuqe (të nxehtësisë) për t'u larguar nga atmosfera duke ndikuar kështu në rritjen e temperaturës ose ngrohjen globale apo ndryshimin e klimës.

Shqipëria, prej dekadash po vuan pasojat e ndryshimit të klimës. Skenarët paraqesin një trend në rritje të këtyre ndryshimeve. Në mënyrë të veçantë zona bregdetare e ajo fushore në tërësi e territorit të Bashkisë së Lezhës është shumë e ekspozuar ndaj variacioneve aktuale të kushteve klimatike. Ngjarjet ekstreme si përmbytjet apo thatësitat po shkaktojnë humbje dhe dëmtime në ekonomi si dhe të habitateve në tërësi. Shpeshësia dhe intensiteti i këtyre ngjarjeve është rritur në vitet e fundit. Reshjet e intensive dhe stuhitë detare, kanë shkaktuar përmbytje nga lumenjtë dhe deti, duke shkaktuar dëme në ekosisteme, popullatën dhe ekonominë. Erozioni i fuqishëm bregdetar, i shkaktuar nga faktorët natyrore e njerëzore, ka çuar gjithashtu në humbjen dhe dëmtimin e habitateve, ka tjetërsuar veçanërisht mjedisin bregdetar dhe ka dëmtuar mjaft asete turistike dhe ekonominë e komunitetit në afersi.

Ndryshimet klimatike nuk mund të trajtohen si një problem i veçantë, por përgjigjet ndaj këtyre ndryshimeve duhet të përfshihen në planet e zhvillimit të të gjithë vendit duke pasur parasysh se ato janë shkaktuar si pasojë e përdorimit nga njeriu i mjedisit dhe burimeve të tij. Për Bashkinë e Lezhës kjo çështje merr rëndësi të veçantë për shkak të ekspozimit të madh të saj ndaj efekteve të ndryshimeve të klimës.

Përshtatja ndaj ndryshimeve të klimës është karakterizuar si një rregullim në sistemet ekologjike, sociale dhe ekonomike në përgjigje të ndryshimeve të vrotuara apo të pritura nga shkaqet klimatike dhe efektet e tyre për të zbutur ndikimet negative të këtyre ndryshimeve ose për të përfitur nga mundësitë e reja. Përshtatja mund të përfshijë si ngritjen e kapaciteteve përshtatëse (formimin e kapaciteteve të individëve, grupeve apo organizatave për t'ju përshtatur ndryshimeve) ashtu dhe zbatimin e vendimeve përshtatëse, p.sh. transformimin e këtyre kapaciteteve në veprime konkrete. Të dyja këto dimensione të përshtatjes mund të zbatohen në përgatitjen për/ose në përgjigje ndaj ndikimeve që gjenerohen nga ndryshimi i klimës. Kështu që përshtatja është një seri e vazhdueshme aktivitësh, veprimësh, vendimesh dhe sjelljesh që informojnë vendimmarrjen rrethëgjitha aspekteve të jetës dhe që reflektohen në normat dhe proceset sociale ekzistuese.

3.4.1 Zjarri në pyje

Pyjet historikisht janë mjaft të rrezikuara nga rënia e zjarreve si nga shkaqe natyrore ashtu dhe humane. Pothuajse çdo vit, në periudhën e nxehtë të verës ndodhin zjarre që përfshijnë sipërfaqe të mëdha pyjesh e kullotash. Bashkia e Lezhës, ka një sipërfaqe prej 18,200 (Bashkia e Lezhës, 2018) ha me pyje dhe 4,250 ha me kullota, sipërfaqe kjo e konsiderueshme në raport me sipërfaqën e territorit në tërësi. Temperatura e larta, mungesa e reshjeve dhe thatësitat e

tejzgjatura, këto karakteristikë për periudhën e verës, të cilat në dekadat e fundit kanë pasur një trend në rritje, i kanë ekspozuar ndjeshëm pyjet nga zjarret. Veç kushteve natyrore, shkaqet kryesore të rënies së zjarreve janë pakujdesia e njerëzve sidomos në rastet e mosvënies në kontroll të zjarreve gjatë djegies së territoreve për përfitim të kullotave. Po kështu rëniet e zjarreve në pyje kanë ndodhur dhe nga djegiet e bimësisë gjatë hapjes së shesheve për ndertime ose djegies së barishteve të këqija gjatë aktivitetit bujqësor.

Rastet e zjarreve në pyje kanë ardhur në rritje në mënyrë të veçantë pas viteve 1991. Ndër ngjarjet më të shënuara për sa i përket sipërfaqës pyjore të djegur e përshkuar dhe dëmit të bërë, evidentohen:

- Në vitin 2010, pati rënie zjarri në zonën pyjore të Malit të Velës, e në Gjash të NjA Kolsh, i cili u shtri në një sipërfaqe të konsiderueshme prej të cilit u bë edhe evakuimi i banorëve të fshatrave të kësaj zonë, për në zona më të sigurta.
- Në verën e vitit 2016, në malin e Shëngjinit, u dogjën sipërfaqe të konsiderueshme në pyje, livadhe e kullota, duke rrezikuar një numër të madh të banesave dhe jetën e qytetarëve. Për ndalimin e shuarjen e zjarrit e shpëtimin e jetës së njerëzve, u angazhuan forcat e mjetet e Bashkisë së Lezhës si dhe ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile në MPB.
- Gjatë verës së vitit 2017 janë djegur sipërfaqe të konsiderueshme pyjore nga rënia e zjarrit në disa vatra si në Bërzanë të NjA Zejmën, dhe në afërsi të fshatrave Torovicë, Malecaj, Kakarriq të NjA Balldre në të cilat është ndërhyrë menjëherë për evitimin e zgjerimit të përhapjes së zjarrit deri në shuarjen e plotë të tij.
- Me 17 Nëntor 2006, nga rënia e zjarrit (në mënyrë aksidentale) në depozitat e karburantit të kompanisë TAÇI OIL, ku veç demit ekonomik përhapje të madhe të naftës me ndikim ndotës në mjedisin ligatinor të Knallës. Rënia e këtij zjarri rrezikoj shumë jetën e forcave zjarrfikse të vëndit tonë dhe nga Greqija të angazhuara. Zbatimi i masave në këtë rast parandaloj përhapjen e zjarrit në ekonominë pyjore të Shëngjinit e të gjithë zonës së banuar në afërsi.

FIG 36- Zjarr në Shëngjin

Burimi: Jak Gjini



Për parandalimin, pakësimin dhe përballimin e dëmëve nga zjarret e mundëshme në pyje, kërkohet:

- Angazhim i vazhdueshëm i strukturave shtetërore të Bashkisë së Lezhës, në Nj. A. të kësaj Bashkie deri në nivelin e kryetarëve të fshatrave për ndergjegjësimin e njerëzve, pasi rreziku i dëmëve nga zjarri mbetet potencialisht i varur nga shkalla e këtij ndergjegjësimi.
- Rritja e nivelit të monitorimit dhe lajmërimit në kohën më të shpejtë, hartimi i një programi


sa më eficient për këtë qëllim.

- Forcimi dhe mbajtja në gadishmëri e shërbimit të MZSH-së, Shërbimit Pyjor, Emergjencave të Mbrojtjes Civile, njesive vullnetare të shuarjes së zjarreve në fshatra etj.
- Kompletimi me mjetet e mbrojtjes nga zjarri të të gjithë objekteve që janë të lidhura me shërbimin pyjor e subjekteve të tjera.
- Identifikimi dhe hartëzimi i rrjetit të infrastrukturës për aksesim të mundshëm të të gjitha ekonomive pyjore nga forcat e MZSH dhe strukturave të tjera, dhe rishikimi i hapjes së koridorëve për këtë qëllim.
- Inkurajimi dhe zbatimi i masave ekzistuese të mbrojtjes nga zjarri si p.sh. barrierat për parandalimin e zjarrit, kullat për monitorimin e pyjeve dhe një sistem patrullimi i përforcuar për pyjet, është çelësi për mbrojtjen e zonave të mëdha nga zjarret.
- Ndjekja e zbatimi i detyrave të planit vendor të veprimit për periudhën e verës.
- Përcaktimi i zonave të sigurta të evakuimit së bashku me rrugët për t'i aksesuar ato, hartimi e testimi i planeve të evakuimit, përgatitja e popullsisë për evakuim;
- Investimet, trajnimi dhe përdorimi racional i teknikes mund të çojë në përballim të situatës përpara se kjo e fundit të mos mund të kontrollohet nga njeriu.
- Kërkimi i ndihmës nga institucionet shtetërore nëpërmjet Institucionit të Prefektit dhe fqinjët për trajnimin e emergjencave nga zjarret kur është e pamundur nga forcat brenda Bashkisë, për arsye të përmasave e shpejtësisë së përhapjes së zjarrit.
- Kontrolli në subjektet institucionale, shtetërore e private mbi masat e marra për mbrojtjen nga zjarret.
- Mosdhënien e lejës së shfrytëzimit për objektet që nuk kanë plotësuar kërkesat për mbrojtjen nga zjarri.

Skenarët e ndryshimeve klimatike të zhvilluara për zonën e deltave të lumenjve Drin e Mat, evidentojnë se rritja e përgjithshme e temperaturës vjetore është me rreth 1.8°C dhe 3.2°C për vitet 2050 dhe 2100 (Le Tissier, et al., 2013), me vlera me të larta sidomos në stinën e verës. Veç kësaj, edhe reduktimi i sasisë së reshjeve me rreth 8% dhe 16% për vitet 2050 dhe 2100 pritet të shkaktojë më shumë ditë të nxehta, thatësira më të shpeshta dhe më të tejzgjatura me rrezik më të madh për zjarre.

FIG 37- Skenarët e Ndryshimit të Temperaturave

Burimi: (Le Tissier, et al., 2013)



Shtim i rasteve të zjarrëve, veç dëmëve që shkakton në ekonomi e ekosistem, shoqërohet dhe me çlirim të CO₂ në atmosferë.

3.4.2 Kalendar i historik i rrezikut nga zjarri

TABELA 7- Ngjarje Historike, Zjarre

Periudha kohore	Zona / Njësia e Prekur	Popullsia e prekur	Ndërtime të prekura	Pyje të prekura	Tokë bujqësore e prekur	Ndikim në infrastrukturë	Komente
17 nëntor 2006	Taci Oil, Shëngjin	-	-	xxx	Ndotja zona ligatinore	Përhapje 480 m jp dhe 120 m gjerësi	Shpërthim 3 depozita benzol, nafte
2010	Mali i Velës, Gjash, NJA Kolsh	-	-	x	-	-	U bë evakuim në kohë I gjithë popullsisë
Verë 2016	Mali i Shëngjinit	-	-	xx	xx	-	Djegje pyje, livadhe, kullota
Verë 2017	Bërganë, NJA Zejmen; Torovicë, Malecaj, Kakarriq, NjA Balldren	-	-	xx	-	-	
Qershor 2018	Kolsh	-	-	x	-	-	Pyll me pisha e shkurre
Korrik 2018	Koder Marlekaj	-	-	x	-	-	Pyll me pisha e shkurre
Nëntor 2018	Lagjia Nënë Tereza Lezhë	-	-	0.3 ha	-	-	
Shkurt 2019	Gocaj, Balldren; Torovicë; Mali i Shëngjinit	-	-	4.2 ha	-	-	Pyje me shkurre
Gusht 2019	Pllanë, Shëngjin	-	-	xx	-	-	5 raste zjarri
16 shtator 2020	Manati	-	-	5 ha	-	-	Afër fshatit, por u izolua në kohë

Burimi: autorët, bazuar në dokumente reference dhe fokus grupe

- **Periodiciteti:** Çdo verë
- **Impakti social:** I ulët
- **Impakti në mjedisin e ndërtuar:** I ulët
- **Impakti në mjedis:** I lartë
- **Impakti në ekonomi:** I lartë
- **Impakti në kulturë:** I ulët

Kalendar i sezonal, bazuar në informacionin e MZSH për periudhën 2016-2019, sugjeron se zonat më të prekura nga zjarri janë Lezhë, Ishull Lezhë; Manati; Dajc, Ungrej, Barbulloje, Gjader, Shëngjin, Balldren, Kolsh, Zejmen, etj. Shpërndarja mesatare e rasteve të zjarrit në vit, është:

- Dhjetor – Shkurt: 14-18 raste
- Mars- Maj: 10-20 raste
- Qershor – Gusht: 16-43 raste
- Shtator – Nëntor: 12-28 raste.

Muajt me më shumë raste zjarri janë gushti, shtatori, korriku dhe tetori. Sa i takon lidhjes me rreziqe të tjera, ky rrezik lidjet direct me ndryshimet klimatike dhe thatësirën.

3.4.3 Borë dhe stuhi.

Mbulimi i territorit të Lezhës me deborë po bëhet gjithnjë e më shumë një dukuri e rrallë dhe përgjithësisht nuk formon shtresë të qëndrueshme. Shtresa maksimale e borës arrin vlerën 5 – 10cm dhe shumë rrallë 15-17cm (Bashkia Lezhë, 2016b), dhe është e paqëndrueshme. NjA Ungrej dhe Kolsh, mund të përballen në pak ditë me reshjet e deborës. Edhe në malin e Velës me lartësi 1172 m mbi nivelin e detit, mali më i lartë në territorin e B. së Lezhës, fare pak herë në vit vërehen reshje bore. Kur reshjet e borës bien në zonat e ulta më e dukëshme bëhet ato në zonat malore të Molungut (NJA-të Kolsh e Zejmen) si dhe ma rrallë në Malin e Rrëncit (NjA Shëngjin).

FIG 38- Foto Lezha Borë



Burimi: Jak Gjini

Përiudhat e rënies së borës zakonisht shoqërohen me temperatura të ftohta që arrijnë në -5 dhe rrallë deri -20°C. Kur trashësia e borës arrin 10cm lartësi dhe bëhet më e qëndrueshme, ngrin dhe formon shtresë akulli deri në 5mm, trashësi e cila është e mjaftueshme për ndërprerjen e trafikut normal dhe bëhet pengesë për zhvillimin e operacioneve të emergjencave civile. Ndërsa rritja e trashësisë në 25-30 cm bllokun tërësisht qarkullimin rrugor të automjeteve në zonat malore.

Reshjet e borës, ngricat, dhe stuhitë, kanë sjellë në mjaft raste bllokimin e rrjetit të infrastruktures rrugore, ngrirje të ujësellsave, dëmtime të linjave të energjisë elektrike, etj. Situata të tilla më ndikim më të madh kanë ndodhur në dimrin e vitit 2010-2011 dhe në Janar të vitit 2016. Ndërsa ngricat në datat 5 deri 10 Janar 2017, bllokuan akset rrugore Troshan-Kashnjet, Lezhë qëndër-Spital, Lezhë - L. Gurra, Lezhë-Kala, dhe të gjithë territorin e Bashkisë si dhe shkaktuan dëmtime të tubacioneve të ujësellsave, pompave të ujit dhe pajisjet e instaluar në to. Po kështu, ky rast u shoqërua edhe me dëme të mëdha në kulturat e mbjella, pemtari e blegtori dhe si rezultat i kohës së keqe u ndërpre procesi mesimor për dy jave. Në Njësinë Administrative Ungrej u vështirsua furnizimi e qarkullimi i banorëve të asaj zone.

Erërat e fuqishme janë tipike për territorin e Bashkisë së Lezhës dhe godasin herë pas here në drejtime të ndryshme në të gjithë shtrirjen e saj. Rrezikshmërinë më të madhe, kanë paraqitur erërat me origjinë kontinentale të drejtimin Jug - Lindje, veçanërisht ato që vijnë nga lugina e

Lumit Mat. Nga erërat e fuqishme, veç dëmëve në konstruksione të ndryshme, banesa e bujqësi, kanë shkaktuar deri ndërprejen e qarkullimit rrugor në një pjesë të segmentit të autostradës Lezhë - Ura e Matit. Në Prill të vitit 2019, si rezultat i erërave të forta, dolën nga rruga disa automjete transporti duke krijuar aksidente.

Me 5 Shtator të vitit 2010, erëra të fuqishme pshtjelluese në formë cikloni, goditën një pjesë të fshatit të Rrilës nga ku u dëmtuan çatitë e një numri të konsiderueshëm banesash.

FIG 39- Foto Dëme të Shkaktuara nga Era



Burimi: Jak Gjini

Ndryshimeve klimatike dhe efektët e tyre po shfaqen edhe me “kapriçot” e motit të cilat po paraqesin një trend në rritje. Një shprehje e tillë ishte edhe rënia e reshjeve të deborës me datën 1 Prill 2020 në të gjithë vendin tonë, përfshi territorin e B. Lezhë në një kohë kur në Lezhë, reshje të tilla bore nuk kishte në asnjë ditë të të gjithë periudhës dimrore të po këtij viti. Reagimi në rastet e reshjeve bllokuese me bore e stuhive nga strukturat e Bashkisë Lezhë ka qënë i pakët për mugesë të forcave e mjeteve të specializuara dhe në raste të veçanta, është detyruar që t’i kërkojë bashkëpunim Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë për Institucionet qendrore, për angazhimin e forcave të ushtrisë si dhe subjekteve private.

Për përballjen me kushtet e rënduara që krijohen nga reshjet e deborës si dhe nga stuhit, kërkohet:

- Marrja e masave paraprake nga Bashkia e Pushteti Qendror për zonat e rrezikuara për bllokim në rast të reshjeve të deborës, për të krijuar rezerva ushqimore dhe materiale fjetje, veshje dhe çadra për të përballuar një periudhë deri në 30 ditë. Sigurimi i rezervave ushqimore mund të bëhet në bashkëpunim me tregtarët e zonës.
- Mbjajtja në gadishmëri e mirëorganizimi i shërbimit të mirembajtjes së rrugëve. Në rastet e bllokimeve nga bora e ngricat, sigurimi e mbajtja në efikasitet të mjeteve borëpastruese, ofrimin e skorjeve e të kripes. Angazhimi i firmave kontraktore në kete drejtim mund të ishte një masë e rëndësishme.

- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të komunitetit për të reaguar e për të kontribuar ndaj këtyre fenomeneve e veçanërisht marrjen e masave paraprake për sigurimin e bazës ushqimore e mjeteve të tjera të jetesës.
- Rritja e efikasitetit të mbeshtetjes e bashkëpunimit të Drejtorisë së Emergjencave të Bashkisë së Lezhës, nëpërmjet Institucionit të Prefektit me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për rastet ekstreme e të paparashikuara.
- Rishikimi e mirmbajtja e sinjalistikës rrugore që paralajmron vendet e mundeshme për ngrica dhe erera të forta.
- Mbajtja në kontroll, simulimi dhe monitorimi i gadishmerisë të të gjithë sistemit të mbrojtjes nga këto fatkëqësi natyrore nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile e Bashkisë së Lezhës në bashkëpunim me të gjithë Institucionet, pjesë përbërëse të Komisionit të Mbrojtjes Civile të kësaj Bashkie.

3.4.4. Kalendari historik i stuhive të erës dhe borës

TABELA 8- Ngjarje Historike, Stuhi Ere/Bore

Periudha kohore	Dukuria	Zona / Njësia e Prekur	Popullsia e prekur	Ndërtime të prekura	Ndikim në bujqësi	Ndikim në infrastrukturë	Komente
Dhjetor 2010- Janar 2011	Stuhi bore	NJA Ungrej	-	-	-	Dëmtim linja elektrike, Ngrirje ujesjelles	
5 Shtator 2010	Stuhi ere	Rrilë, NjA Shenkoll	-	10 Cati të dëmtuara	Dëmtim në kulturat bujqësore	Pa info	Stuhi ne segmentin perëndim-lindje 1 km
8 Maj 2013	Stuhi breshëri	Tale	-	-	Dëmtim te mbjellash, vreshtash, qersh, sera, perime	-	40 minuta stuhi e vazhdueshme
Janar 2016	Stuhi bore					Bllokim aksi Shkodër-Lezhë-Milot	
5-10 Janar 2017	Stuhi bore	Qytet Lezhe; Troshan-Kashnjet	-	-	Ndikim në pemëtari, të mbjella Ndikim në blegtori	Dëmtime të tubacioneve të ujësellsave, pompave të ujit. Bllokim i akseve: _Troshan-Kashnjet _Lezhe-Spital _Lezhe-L.Gurra _Lezhe-Kala	2 javë shkollat e mbyllura
23 Shkurt 2019		Rrile, Gajush				Makinatë dalura nga rruga, aksidente	
Prill 2019						Automjete të dala nga rruga	
1 Prill 2020	Rreshje bore	Qytet Lezhe					
Shtator 2020	Stuhi shiu						

Burimi: autorët, bazuar në dokumente reference dhe fokus grupe

- **Periodiciteti:** Çdo 1-2 vite
- **Impakti social:** I mesëm
- **Impakti në mjedisin e ndërtuar:** I mesëm


- **Impakti në mjedis:** I ulët
- **Impakti në ekonomi:** I mesëm
- **Impakti në kulturë:** I ulët

3.4.5 Avancimi i detit

Për më shumë se një shekull, bregdeti në të dy anët e deltës së lumit Drin e më gjërë, po kalon një proces të fortë të erozionit që po çon në një avancim të vazhdueshëm të detit në pushtim e tjetërsim të terrenit, me një shpejtësi prej 2 deri në 3 metra në vit. Sidomos në tre dekadat e fundit, për shkak të efekteve në rritje të ndryshimeve klimatike, erozioni bregdetar është bërë më agresiv dhe po shkatërron shpejt gjithë mjediset e trashëguara të ligatinave të kësaj delte. Është vlerësuar se nga viti 1936 deri në vitin 1989, deti ka përparuar rreth 400 m në drejtim të vijës bregdetare. Kjo situatë e erozionit lidhet kryesisht me devijimet e lumit Drin, i pari ndodhi në vitin 1854 si rezultat i një permbytje masive, lumi Drin u nda në dy degë, duke krijuar kështu një rrjedhë të re të lumit Drin dhe që nga kjo periudhë shkarkohet përgjatë lumin Buna, rreth 1.5 km pas daljes së këtij te fundit nga liqeni i Shkodres. Më pas, me përfundimin e kullimit të fushës së Zadrimës, këtij lumin si dhe Lumit Gjadër ju nderprenë totalisht prurjet. Në këto kushte, nga mungesa e sedimeve që ushqejnë bregdetin dhe ndikimeve nga efektet e ndryshimeve të klimës, erozioni bregdetar është përkeqësuar në mënyrë të jashtëzakonshme.

Veçanërisht në dekadat e fundit, sistemet natyrore janë përballur me ndryshime më të shpejta klimatike dhe me ngjarje ekstreme me shpeshtësi në rritje. Stuhitë detare tashmë janë kthyer në një dukuri të zakonshme në zonën bregdetare të Bashkisë së Lezhës, pasi në dekadën e fundit po e godasin bregdetin pothuajse çdo vit. Erozioni i fuqishëm bregdetar, i shkaktuar nga faktorë natyrorë e njerëzorë, ka çuar gjithashtu në humbjen dhe dëmtimin e habitateve si dhe në dëme të shumta në ekonominë e komunitetit në afërsi, etj.

FIG 40- Ndryshimi i Vijës Bregdetare



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020),

Në bregdetin e Kunës (Shëngjin), veprimtaria e erozionit bregdetar ka shkatërruar sipërfaqe të konsiderueshme të plazhit dhe kontribuon në destabilizimin e dunave dhe brigjeve lumore në deltën e Lumit Drin e Mat. Vetëm nga viti 1970 e deri tani, llogaritet të jenë eliminuar 362 ha sipërfaqe e bregdetare (plazhe, duna e pyje aluvional etj) të Kune -Vainit. Dëme ka pasur dhe në aktivitetet social ekonomike si bujqësi, turizëm e peshkim,të cilat janë mjaft të rëndësishme për komunitetin e zonës e më gjërë.

Nga ngjarjet më të medha ekstreme klimatike që lidhen me mësymjen e detit në drejtim të tokës, shënohet:

A. PERMBYTJE TË PAZAKONSHME NË TALE TË KOMUNËS SHENKOLL (SOT NJA) LEZHË E DATËS 28.12.2009 -1.01.2010.

Kjo ngjarje e shtrirë në një kohë prej rreth 6 orësh karakterizohet nga baticë me një ngritje vertikale të detit në një lartësi jo të zakonshme, deri në 1.8 m, ndërkohë që batica normale mesatare sipas literatures për këtë bregdet është 30 - 40 cm. Kjo baticë u shoqërua me erëra të forte me drejtim jugperendim-verilindje ose shirok. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, janë shtuar ujrat e lumit Mat, si rezultat i shkarkimeve të bera të Hidrocentraleve të Ulzës e Shkopetit. Per pasojë, ballafaqimi i ujrave të fryra të lumit Mat në grykëderdhje me ujrat e batices detare të fuqishme, favorizuan zhvillimin e përmytjeve në zonat me të ulta e të pambrojtura mirë për këto raste.

Ujrat e detit, tëngritura në nivel baticetëperziera me atotëlumit Mat që vinin nga ana jugore e vendngjarjes, mbuluan plazhin e Talës si dhe këneten pas tij. Ky nivel i ngritur i ujrave, bëri rrjedhjen e tyre në zonën e banuar, duke përmytur nje territor të gjërë dhe duke rrezikuar rreth 20 banesa. Territori i perfshire është zona bregdetare që përfshin plazhin, dunat, ligatinat dhe më pas përmytitëgjithë territorin në drejtimin nga Posta e Policisë Tale, deri në Hidrovor, e zonën e banuar në lindjetësaj. Po kështu, pasi ujrat detare shkaktuan çarjen e bankinës së Hidrovorit të Talës, ato bllokuan dhe shtuan ujrat në magjistralet kulluesetëBarbullojes, Rrilës, Treshit, Spitenit, që sjellin ujën në këtë hidrovor.

Si rezultat i kësaj ngjarje të jashtzakonshme, u shkaktuan:

- Përmytje të mjediseve të jashtme të rreth 20 banesave, dhe rrezikoj demtimin e tyre.
- Demtohet bankina e Hidrovorit të Talës (çarje ne pjesen perendimore të saj)e për pasojë ujrat depertuan në kolektorin kullues Tresh -Hidrovor.
- Si rezultat i ngjarjes, përmytet e gjitha ultësira në Tale, Barbullojë, Rrilë e Treshë. Kjo ultesirë është 50-150 cm (sipas emergjencës civile) nën nivelin e detit. Kjo përmytje u bë nga uji i kripur dhe ndikoj negativisht në cilesinë e tokës dhe në kulturat e mbjella në këto toka, si rezultat i rritjes së kripshmërisë.
- Demtime të argjinatures mbrojtëse në ato segmente që doli uji në drejtim të banesave.
- U rrezikuan dy banesa pasi gjendeshin ne afersi të hidrovorit, në anë tokës së gërryer. Po në afërsi u dëmtu edhe bankina e permendur me lartë.
- U dëmtua rëndë rrjeti elektrik. Si rezultat i marrjes së dherave të tokës u rrezuan 5 shtylla të linjës elketrike si dhe u dëmtu kabli i furnizimitme enrgji elektrike të Hidrovorit.

Në përgjigje të kesaj sítuate, u reagua menjëherë si vijon:

- Strukturat e emergjencave filluan punën për evakuimin e familjeve që rrezikoheshin nga ujrat, por situata u normalizu brenda ditës.
- Bordi i Kullimit nderhyri për hapjen e kanalit të shkarkimit të mbyllur qe u realizu nga firma PACANI. Gjithashtu kjo firmë, mbylli çarjen e hapur me gurë e materiale inerte, në digen e hidrovorit nga ku ishin rrezikuar dhe dy banesa ne afërsi nga rrembimi i dherave. Ne këtë

proces u aktivizuan edhe mjetet e Bordit të Kullimit dhe ato të ushtrisë.

- Specialistët e elektrikut, lidhen me linjen ajrore elektrike hidrovorin por kjo nuk mundësoj hidrovorin që të punojë me kapacitet të plotë.

Kjo situatë u ndoq në vënd nga Prefekti i Qarkut të Lezhës me Komisionin e Emergjencave të po këtij Qarkut, Drejtori i Përgjithëshëm i Emergjencave Civile, përfaqësues nga Drejtorja e Përgjithëshme e Bujqësisë, Drejtues të Policisë e të Ushtrisë dhe drejtues të Njësisë të Qeverisjes Vendore.

FIG 41- Përmytje Detare



Burimi: Jak Gjini

B. PËRMBYTJE TË PAZAKONSHME NGA DETI NE ISHULL SHËNGJIN TË NJA SHENGJIN, LEZHË.

Edhe kjo ngjarje u zhvillua në të njëjtën kohë me atë të Tales, e më të njëjtat karakteristika, si kohëzgjatja prej rreth 6 orësh, baticë me një ngritje vertikale të detit në një lartësi deri në 1.8 m. Kjo baticë cilësohet si rast që nuk mbahet mend nga më të moshuarit.

Me datën 01.01.2010, pas orës 3.00, batica arriti nivelin më të lartë, duke kaluar ujrat e lagunës së Merxhanit tashmë së bashku me ato të detit në baticë të hyra në jug të lagunës (në vendin ku është eliminuar krejtësisht litorali që ndante lagunën me detin, në një gjatësi 750 m) mbi argjinaturë e duke përmytur lagjën Stom të fshatit Ishull Shëngjin. Kjo argjinaturë ishte krejt e amortizuar dhe e dëmtuar dhe ndantë ketë lagje me ujrat e lagunës së Merxhanit. E gjithë vija bregdetare e Kunës deri në Qytetin Shëngjin u godit nga kjo baticë e shoqëruar me dallgë e erë të fortë, duke kaluar e qarkulluar ujrat në drejtim të territorit të zonës së mbrojtur Kunë dhe pjesës hyrësë të saj deri në afërsi të qytetit. Në portin e Shëngjinit anijet e e varkat e ankoruara pothuajse dolën në pjesën e sterës, mbi bankinë.

Si rezultat i kësaj ngjarje të jashtëzakonshme, u shkaktuan:

- Përmbytje të mjediseve të jashtme të rreth 40 banesave, ndersa në 6 prej tyre uji hyri në brëndësi duke dëmtuar orendi e ushqime të këtyre familjeve.
- U rrëzuan një numër i madh pishash (me moshë rreth 50 vjeçare) në pyllin artificial mbrojtës të bregdetit në zonën e mbrojtur të Kunës dhe në hyrje të saj.
- Shtresa të reja rëre u futen në disa vatra të territorit të tokës, si dhe platkon të nxjerr nga deti verehen ne pjesën e bregut.
- Uji i kripur i detit ka qarkulluar dhe ka mbetur për pak kohë në vatra me nivel të ulet pothuajse në të gjithë territorin e Kunës e të hyrjes së saj. Kjo rrezikoj tharjen e bimëve drunore dhe një pjese të vegjetacionit më të ulet të zonës. Ndersa uji i kripur i detit ka qarkulluar në një sipërfaqe të konsiderueshme toke bujqësore duke përkeqësuar seriozisht cilësit e saj prodhuese.
- Ndërprerje të furnizimit me ujë të pijshëm pasi pompat thithëse ishin në puset e përmbytura, ne kufi të lagunës.
- Veshtirsi në shpëtimin e krerëve të blegtorisë e ushqimin e tyre.

Për këtë situatë të krijuar u reaguua mënjëherë:

- Strukturat e emergjencave civile bënë evakuimin e familjeve që rrezikoheshin nga ujrat.
- Bordi i Kullimit, fadroma e Komunës Shëngjin dhe dy kamion të ushtrisë, realizuan mënjëherë ngritjen e argjinaturës në zonat më të ulta. Në ditët në vijim puna vazhdoi me përforcimin e argjinaturës mbrojtëse nga forcat e ushtrisë të repartit të MCR.
- Me datën 4.01.2010, perfaqesues të Emergjëncs Civile të Prefekturës, specialistë të D.SH. Pyjor Lezhë, bënë inspektime në Kune, për të vlerësuar rrezikshmerine e bashkimit të detit me lagunen e Merxhanit në zonën me të eroduar.

Kjo situatë si dhe në rastin e parë, u ndoq në vënd nga Prefekti i Qarkut të Lezhës me Komisionin e Emergjencave të po këtij Qarkut, Drejtori i Përgjithëshëm i Emergjencave Civile, përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithëshme e Bujqësisë, Drejtues të Policisë e të Ushtrisë dhe drejtues të Njësive të Qeverisjes Vendore.

FIG 42- Përmbytje Ishull Shëngjin



Burimi: Jak Gjini

Ngjarje të tilla më përmasa të përafërta e që ndikojnë direkt në avancimin e detit në pushtim të terrenit bregdetar po bëhen mjaft frekuente. Kështu, në muajin Mars të vitit 2018, një stuhi e fuqishme detare goditi veçanërisht bregdetin e Kunës duke eroduar sipërfaqe të konsiderueshme bregdet si dhe dëmtim të pyjeve. Niveli i ujit të detit arriti në atë të trotuarit të rrugës së asfaltuar të Kunës.

FIG 43- Përmytje Detare Shëngjin



Burimi: Jak Gjini

Sipas skenarëve klimatike për zonën, nga një rritje e pritshme e nivelit mesatar të detit (midis 18 cm dhe 59 cm deri në vitin 2100) si edhe për shkak të erozionit të fuqishëm të kësaj zone bregdetare, pritet të humbasë një sipërfaqe e konsiderueshme e lagunës, qe sot luan rol stabilizues në procesin e ujëkëmbimit me detin (Le Tissier, et al., 2013). Këto ndryshime klimatike pritet të sjellin një sërë ndikimesh mbi sistemet natyrore (si dëmtim të ekosistemeve me rendësi globale, zvogëlim e rezervave të ujit të ëmbël si rezultat i depërtimit të ujit të kripur, etj.) dhe për pasojë në një ndikim mbi sistemet sociale-ekonomike për shkak të varësisë së këtyre të fundit nga sistemet natyrore, që mbështesin jetën e komuniteteve lokale.

Bujqësia dhe infrastruktura e turizmit bregdetar janë shumë të ekspozuara ndaj përmytjeve, si nga ato nga deti, ashtu edhe nga daljet stinore të lumenjve nga shtrati (siç u regjistrua në Dhjetor- Mars të viteve 2009-2010). Në bregdetin e Kunes (Shëngjin), veprimtaria e erozionit bregdetar ka shkatërruar sipërfaqe të konsiderueshme të plazhit dhe kontribuon në destabilizimin e dunave dhe brigjeve lumore.

TABELA 9- Skenarët e rritjes së nivelit të detit

Skenarët	2030	2050	2080	2100
A1BAIM (aver)	8cm (5-14cm)	15 cm (7 – 28 cm)	28 cm (12 - 53 cm)	38 cm (15 – 72 cm)
A1FIMI (max)	8cm (5-14cm)	16 cm (9 – 29 cm)	35 cm (15 – 62 cm)	49 cm (21 - 91 cm)
B1IIMA (min)	7 cm (3-13cm)	13 cm (6 - 23 cm)	22 cm (9 - 42 cm)	27 cm (10 – 55 cm)

Burimi: (Le Tissier, et al., 2013)


Për të adresuar me kohë efektet negative të ndryshimeve klimatike nevojiten ndërhyrje urgjente në bazë të studimeve të aplikuara. Kështu, ndërhyrjet e propozuara synojnë parandalimin e e mëtejshëm të erozionit bregdetar nëpërmjet ndërprerjes së transportit të sedimenteve në bregdet. Instalimi i dallgëthyesve që shërbejnë si pengesë për transportin e sedimenteve përgjatë bregut të detit duke rezultuar në ngadalësimin e ndalimin e erozionit dhe riaktivizimit proceseve natyrore të restaurimit të dunave. Për të mbështetur dhe promovuar këtë proces ripërtëritës dhe për të siguruar një rikthim të qëndrueshëm, të plotë, të shpejtë dhe të qëndrueshëm të dunave, do të bëhet ushqimi i plazhit dhe futja e rërës në plazhe, në mënyrë që të plotësohet furnizimi i sedimenteve natyrore me qëllim restaurimin e plazhit dhe krijimin e dunave artificiale.

3.4.6 Thatësira

Si rezultat i ndryshimeve klimatike, edhe territori i Bashkisë së Lezhës është ndikuar nga thatësitat e tejzgjatura dhe valët e nxehtit. Temperaturat e larta, mungesa e reshjeve e për pasojë thatësitat e tejzagjatura të ndodhura për një kohë të gjatë, e kanë goditur disa herë territorin e Bashkisë së Lezhës. Këto raste të shtuara, shenohen si ngjarje ekstreme nga ndryshimet e klimës bazuar në kohëzgjatjen e demin që kanë shkaktuar veçanërisht në bujqësi, pyje e shëndet.

Në dekadat e fundit, thatësira më të medha e të tejzgjatura, kanë ndodhur në periudhën Korrik - Gusht të viteve 1985, 2007, 2008, dhe në periudhën Maj - Gusht 2009. Ndersa valët e të nxehtit, periudha me temperatura të larta të motit gjatë verës po ndodhin pothuajse çdo vitë, kur për Lezhën maksimalja e kesaj temperature ka arritur 40°C. Pa llogaritur dëmët e ndodhura në bujqësi si rezultat i thatësirës, në të tilla raste është reaguar dukë marrë masa shpesh për ujtjen në bujqësi, si dhe në rritjen e kujdesit për një shfrytëzim sa më racional të burimeve ujore.

FIG 44- Rreshjet Vjetore



Burimi: (Le Tissier, et al., 2013)

Sipas skenarëve të ndryshimeve klimatike për zonën e deltave të Lumejve Drin e Mat, krahas rritjes së temperaturës, sasia e reshjeve vjetore pritet të zvogëlohet me rreth 8.1% në 2050 në krahasim me vlerën mesatare shumëvjeçare (1961-2000), si rezultat i zvogëlimit të reshjeve në të gjitha stinët (Le Tissier, et al., 2013). Sipas këtij skenari parashikohet që veç ngjarjeve ekstreme që lidhen me reshjet intensive, edhe thatësitat do të bëhen më të shpeshta. Nga ana tjetër, thatësitat e tejzgjatura do të rrisin veçanërisht rastet e zjarreve në pyje, llojet invasive, rastet me akumulim të lartë të kripës në habitatet e ndryshme bregdetare, frekuencë më të lartë të dëmtuesve dhe sëmundjeve dhe për pasojë ndryshime të përbërjes floristike dhe shoqërimeve bimore të habitateve aktuale.

Përshtatja ndaj ndryshimeve të klimës është karakterizuar si një rregullim në sistemet ekologjike, sociale dhe ekonomike në përgjigje të ndryshimeve të vrojtuar apo të pritura nga shkaqe klimatike dhe efektet e tyre për të zbutur ndikimet negative të këtyre ndryshimeve ose për të përfituar nga mundësitë e reja.


4.5 SISTEMI SHËNDETËSOR DHE PËRBALLIMI I COVID-19 NË BASHKINË LEZHË

3.5.1 Aksesi në shërbime shëndetësore

Analizat më poshtë do të paraqesin distancat në kohë dhe në km nga njësitë administrative drejt Spitalit Rajonal Lezhë dhe drejt QSUT Tiranë. Të dhënat janë nxjerrë nga Google Map dhe analizat janë bërë në periudhë karantine (COVID- 19).

Nga analiza e distancës në km të Njësive administrative drejt QSUT, lëvizin nga 60- 80 km dhe infrastruktura rrugore është e mirë (asfalt) përveç Njesisë administrative Ugrenj e cila ndodhet 94 km dhe ka infrastrukturë të keqe.

FIG 45- Distanca në Km dhe në Kohë e NJ-ve nga QSUT Tiranë




Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Përsa i përket distancës në kohë vërehen të ulta përshkak të karantinës (Covid-19) të cilat janë 65 – 90 minuta kurse në ditë normale me trafik kjo kohë është shumë herë më e lartë sidomos në hyrje të Tiranës. Njësia administrative e Ugrenjt është 120 min larg QSUT Tiranë sepse terreni është i thyer dhe infrastruktura është e keqe deri në NJA Kallmet ku lidhet me infrastrukturën rrugore kryesore që është e mirë (asfalt).

Nga analiza e distancës në km të njësive administrative drejt Spitalit Rajonal të Lezhës lëvizin nga 10- 15 km dhe infrastruktura rrugore është e mirë (asfalt). Duhet theksuar se Njësia Administrative Ungrej është 27 km që përveç distancës të madhe me qytetin e Lezhës këtë distancë e bën akoma më të madhe infrastruktura e keqe dhe terreni i thyer ku shkrimet kjo Njësi Administrative.

FIG46- Distanca në Km dhe në Kohë e NjA-ve drejt Spitalit Rajonal Lezhë




Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Përsa i përket distancës në kohë vërehen të ulta përshkak të karantines (Covid-19) të cilat janë 10-15 minuta kurse në ditë normale me trafik kjo kohë është pak më e lartë (në varësi të trafikut në qytetin e Lezhës). Njësia administrative e Ugrenjt është 52 min larg Spitalit rajonal të Lezhës përshkak të arsyeve që janë shpjeguar më lart.

Analiza më poshtë paraqet distancat në kohë dhe në km nga qendrat e fshatrave drejt qendrës shëndetësore më të afërt. Të dhënat janë nxjerr nga Google Map dhe analizat janë bërë në periudhë karantine (Covid-19). Nga figura më poshtë shohim që njësitë administrative Kolc dhe Shënkoll nuk kanë asnjë qendër shëndetësore. Në veri perëndim të Lezhës janë një sërë fshtrash që nuk kanë akses të mirë nga qendrat shëndetësore sic janë Gramsh, Zojs, Gjadër, Kakariq etj. Në njësinë administrative të Ungrej e cila shtrihet në një territor të thyer dhe infrastruktura është në gjëndje të keqe dhe ka një qendër shëndetësore e cila ndodhet në fshatin Ugrenj. Fshatrat Gjombardhaj, Kashenjet dhe Zimajit ndodhen afërsisht mbi 7.5 km dhe i duhet një kohë afërsisht 25 min për të arritur në qendrën shëndetësore më të afërt. Në njësinë Administrative Zejmen ndodhet një qendër shëndetësore që ndodhet në fshatin Tresh. Fshati Pllan është 6.4 km dhe 9 min larg qendrës shëndetësore por kjo kohë e ulët është si pasojë e cilesisë së mirë të infrastrukturës rrugore. Një njësinë Administrative të Balldrenit të ri, fshati Torovicë ndodhet 15 min dhe 11.6 km larg qendrës shëndetësore që ndodhet në fshatin Balldren. Distanca në kohe është e ulët sepse rruga është e asfaltuar.

FIG 47- Analiza e Distancës së Vendbanimeve nga Qendra Shëndetësore më e Afërt



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

3.5.2 Përballimi i COVID-19 në Bashkinë Lezhë

Shqipëria u prek për herë të parë nga shpërndarja e pandemisë COVID-19 në 9 Mars 2020. Pas kësaj date, qeveria qendrore morri një sërë masash për parandalimin e pandemisë duke përfshirë dhe mbylljen e aktiviteteve ekonomike, aktiviteteve social kulturore etj. Në territorin e qarkut Lezhë janë identifikuar 27 persona të cilët janë prekur nga virusi.

Nisur nga qasja centralizuese për përballimin e pandemisë, ku vendimet dhe masat për përballimin kryheshin nga qeverisja qendrore, roli i qeverisjes vendore ishte shumë i reduktuar. Të gjithë pacientët e identifikuar që kishin nevojë për hospitalizim sillleshin në Tiranë, në spitalet e përcaktuar për COVID, ndërkohë që pacientët e tjerë ishin të detyruar të vetëkarantinoheshin në banesat e tyre. Masat e marra nga qeveria qendrore, protokollat e sigurisë dhe nevoja për distancim social ka shtyrë dhe Bashkinë Lezhë për të ridimensionuar një pjesë të punës. Kësisoj rreth 15% gjatë pikut të pandemisë ka punuar nga shtëpia duke shmangur prezencën në punë, veçanërisht në drejtoritë Integrimi European, Komunikimit dhe Transparencës; Burimet Njerezore; Arsimi dhe Rinia; Turizmi dhe Kultura; Sportet; Taksat dhe te ardhurat. Ndërkohë, për pjesën tjetër të stafit për të cilët prezenca fizike ishte e nevojshme, është kërkuar që të mbahen maska dhe pajisje të tjera mbrojtëse si dhe të mbahen distancat e sigurisë gjatë punës në zyrë.

Përtej masave të marra për mbarëvajtjen e punës brenda institucionit, Bashkia Lezhë është angazhuar dhe në një sërë iniciativash të tjera të cilat kanë ndihmuar komunitetin për

përballimin e pandemisë dhe respektimin e protokollove për parandalimin e shpërndarjes së saj. Nëpërmjet një Urdhëri të Kryetarit të bashkisë është ngritur një grup pune i cili ka bërë identifikimin e grupeve në nevojë të cilët kishin vështirësi në përballimin e situatës si për shembull persona të moshuar, familjet që marrin ndihmë ekonomike, të papunët, familjet me persona me aftësi të kufizuara etj. Identifikimi i grupeve në nevojë ishte një prioritar në mënyrë që më pas të ofrohej mbështetja e nevojshme kryesisht nëpërmjet ndihmave ushqimore apo produkteve higjieno-sanitare. Në periudhën mars-maj janë shpërndarë rreth 700 pako nga bashkia të cilat janë plotësuar nga donacione, rezervat e shtetit dhe blerje të drejtpërdrejta nga bashkia.


Bashkia ka arritur që të shpërndajë ndihma jo vetëm në qytetin e Lezhës por në të gjitha njësitë administrative. Në këtë kuadër ka ndihmuar dhe reagimi i shpejtë për ngritjen e një grupi vullnetarësh. Në bashkinë Lezhë kanë qënë të angazhuar rreth 90 vullnetarë të moshës 30-50 vjeç të cilët kanë ndihmuar bashkinë në kohën e pandemisë duke ofruar asistencë familjeve dhe personave në pamundësi për të dalë nëpërmjet blerje ushqimesh, pagesë dritash, uji, tërheqje kempi apo pensionesh, blerje ilaçesh etj. Vullnetarët gjithashtu kanë ndihmuar bashkinë në shpërndarjen e ndihmave. Grupi vullnetar ka qënë i atashuar pranë bashkisë nga e hëna në të premtë. Vlen të përmendet se përtej grupit të vullnetarëve të angazhuar pranë bashkisë, në procesin e mbështetjes së familjeve dhe personave në nevojë janë përfshirë dhe një sërë organizatash humanitare dhe fetare të tilla si Kryqi i Kuq, Caritas, Eörd Vision etj të cilat kanë ofruar ndihmën e tyre nëpërmjet pakove ushqimore, veshmbatjeve apo dhe duke ofruar shërbime psikologu për përballimin e situatës.

Bashkia Lezhë gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në dizinfektimin e hapësirave të ndryshme të territorit. Kështu, janë dizinfektuar rrugët dhe trotualet kryesore, tregjet publike, spitali dhe territori përreth tij, ndërtesat ku janë identifikuar persona të infektuar me COVID, parqe e lulishte, muze, zyrat e bashkisë etj. Gjithashtu, përtej kësaj, nëpërmjet policisë bashkiake janë kryer kontrole të shpeshta për të garantuar respektimin e protokolleve të sigurisë në tregjet lokale, subjekte dhe në hapësira të tjera publike. Bashkia për të përballuar situatën ka bërë dhe ndryshimet përkatëse në planin buxhetor, duke rialokuar fonde në shërbim të situatës, dhe në paketën fiskale. Në këtë rast janë ulur me 20% tarifa e shërbimeve publike (ndriçim, pastrim, gjelbërim) si dhe është shtuar numri i familjeve të cilat janë pjesë e ndihmës ekonomike.

Nisur nga situata e krijuar dhe paqartësia për evoluimin e shpërndarjes së COVID, Bashkia Lezhë parashikon që do të ketë një rënie në të ardhurat dhe vështirësi në mbledhjen e tyre. Sfidë parashikohet veçanërisht mbledhja e taksave të ndërtesës, truallit, tokës bujqësore dhe të tabelave. Gjithashtu, një tjetër sfidë që parashikohet nga bashkia në përballimin e situatës është dhe gjenerimi i fondeve të mjaftueshme për të mbështetur familjet në nevojë nëse shpërndarja e virusit dhe protokollat e sigurisë apo ri-mbyllja e vendit do të vijojnë. Në terma afatgjatë, bashkia identifikon se rritja e numrit të të papunëve dhe mbyllja e bizneseve mund të jetë një sfidë për komunitetin lokal. Në aspektin e zhvillimit ekonomik, rreziku për rënien e të ardhurave nga sektori i turizmit, i cili është një ndër më kryesorët në periudhën Maj-Tetor, është shumë i madh. Në lidhje me shërbimet të cilat ofrohen nga bashkia, ajo e shikon si sfiduese sektorin e arsimit para-universitar si dhe transportin publik.

ANALIZA E CËNUESHMËRISË ME SHUMË-RREZIQË

4




4.1 ANALIZA E CËNUESHMËRISË SË RREZIKUT SIZMIK

Bazuar në metodologjinë e përcaktuar për vlerësimin e risqeve nëpërmjet përdorimit të GIS është kryer vlerësimi i riskut në Bashkinë Lezhë nga pikëpamja fizike, sociale, ekonomike, mjedisore e kulturore. Për të evidentuar rrezikun janë përdorur indikatorët e mëposhtëm:

- **Cënueshmëria Fizike.** Janë evidentuar ndërtesat të cilat kanë një moshë mbi 30 vjeçare; ndërtesat të cilat janë në zona me potencial të lartë lëngëzimi, zonat informale, infrastrukturat kritike (shkolla, institucione; spitale; etj).
- **Cënueshmëria Sociale.** Janë evidentuar NjA bazuar në të dhënat e Census 2011 të cilat kanë % të lartë të personave mbi 65 vjeç; % të lartë të pensionistëve; % të lartë të PAK; % të lartë të Nj.E.F me ndihmë sociale.
- **Cënueshmëria Ekonomike:** janë evidentuar të gjitha bizneset të cilat ndodhen në ndërtesa të cilat kanë një moshë mbi 30 vjeçare; biznese të cilat gjenden në zona me potencial të lartë lëngëzimi; biznese të cilat gjenden në zona informale; struktura turistike.
- **Cënueshmëria Mjedisore:** N/A.
- **Cënueshmëria Kulturore.** Janë evidentuar të gjithë monumentet në zona me potencial lëngëzimi; janë klasifikuar të gjitha monumentet në varësi të PGA dhe cilësisë së truallit.

Nisur nga elementët e mësipërm është kryer vlerësimi individual për secilin prej tyre:


FIG 48- Analiza e Cënueshmërisë nga Rreziku Sizmik



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

Nga mbivendosja e shtresave të cënueshmërisë fizike, sociale, ekonomike, mjedisore e kulturore, është përgatitur harta përmbledhëse e cënueshmërisë nga rreziku sizmik për territorin e Bashkisë Lezhë:

FIG 49- Përmbledhëse Cënueshmëria nga Rreziku Sizmik



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Bazuar nga analizat e cënueshmërisë, në Bashkinë Lezhë janë të rrezikuara sipas njësisive Administrative:

- Në njësinë administrative Baldren, janë gjithsej të rrezikuara 523 ndërtesa të cilësuar mbi 30 vjet, nga të cilat 225 gjenden në toka me potencial të lartë lëngëzimi; 3 institucione arsimore, 3 institucione fetare dhe 1 monument kulture; 17 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Në njësinë Administrative Blinisht, janë gjithsej të rrezikuara 234 ndërtesa të moshës mbi 30 vjeç; 3 institucione arsimore dhe 1 institucion fetar; 7 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Në njësinë administrative Dajç, janë gjithsej të rrezikuara 736 ndërtesa të moshës mbi 30 vjeç dhe 4 institucione arsimore; 17 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Në njësinë administrative Kallmet, janë gjithsej 299 ndërtesa të rrezikuara mbi moshën 30 vjeçare, 10 prej tyre në toka me potenciale të lartë lëngëzimi; 2 institucione arsimore; 4 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Në njësinë administrative Kolsh, janë të rrezikuara gjithsej 75 ndërtesa të moshës mbi 30 vjeç nga të cilat 5 gjenden edhe në tokë me potencial lëngëzimi të lartë;
- Në njësinë administrative Zejmen janë të rrezikuara 4 ndërtesa të moshës mbi 30 vjeçare
- Në njësinë administrative Shënkoll, janë të rrezikuara 567 ndërtesa të cilat janë të moshës mbi 30 vjeçare dhe nga të cilat 15 gjenden në tokë me potencial të lartë lëngëzimi; 2 institucione arsimore dhe 1 institucion fetar; 17 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Në njësinë administrative Shëngjin, janë të rrezikuara 501 ndërtesa të moshës mbi 30 vjeçare nga të cilat 53 gjenden edhe në toka me potencial të lartë lëngëzimi; 2 institucione arsimore dhe 1 institucion fetar; 84 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Në qytetin e Lezhës, janë të rrezikuara 557 ndërtesa të cilat kanë një moshë mbi 30 vjeç dhe

- nga të cilat 11 gjenden në toka me rrezik të lartë lëngëzimi; 5 institucione arsimore dhe 1 institucion fetar.; 32 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Në total në territorin e Bashkisë Lezhë, nisur nga zonat informale dhe pasiguria për teknikën e ndërtimit, janë të rrezikuara 1732 ndërtesa.


4.2 ANALIZA E CËNUESHMËRISË NGA PËRMBYTJET

Bazuar në metodologjinë e përcaktuar për vlerësimin e rreziqeve nëpërmjet përdorimit të GIS është kryer vlerësimi cënueshmërisë ndaj rrezikut nga përmbytjet në Bashkinë Lezhë nga pikëpamja fizike, sociale, ekonomike, mjedisore e kulturore. Për të evidentuar rrezikun janë përdorur indikatorët e mëposhtëm:

- **Cënueshmëria Fizike.** Janë evidentuar ndërtesat të cilat gjenden në zona me rrezik përmbytje nga stuhitë detare, bllokimi i kanaleve, dalja e lumenjve nga shtrati, vërshimi i përrrenjve, dëmtimi i digave të rezervuareve; zonat informale, infrastrukturat kritike (shkolla, institucione; spitale; ura; etj)
- **Cënueshmëria Sociale.** Janë evidentuar NjA bazuar në të dhënat e Census 2011 të cilat kanë % të lartë të personave mbi 65 vjeç; % të lartë të pensionistëve; % të lartë të PAK; % të lartë të Nj.E.F me ndihmë sociale
- **Cënueshmëria Ekonomike:** janë evidentuar të gjitha bizneset të cilat ndodhen në zona me rrezik përmbytje; tokë bujqësore në zona me rrezik përmbytje; struktura turistike
- **Cënueshmëria Mjedisore:** janë evidentuar zonat e mbrojtura në rrezik përmbytje; monumentet natyrore në rrezik përmbytje; akuiferët të cilët mund të ndoten nga përmbytjet; burimet e ujit të pishëm të cilët mund të ndoten nga përmbytjet
- **Cënueshmëria Kulturore.** Janë evidentuar të gjithë monumentet zona me rrezik përmbytje.

Nisur nga elementët e mësipërm është kryer vlerësimi individual për secilin prej tyre:


FIG 50- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Përmbytjet



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

Bazuar në mbivendosjen e shtresave të hartave dhe analizave të mësipërme është krijuar harta përmblendhëse e cënueshmërisë nga përmbytjet:

FIG 51- Cënueshmëria nga Përmbytjet



Bazuar nga analiza e kryer, në territorin e Bashkisë Lezhë sipas njësive administrative, rrezikohen sa më poshtë:

- Njësia administrative Balldren, janë të rrezikuara nga përmbytja 2192 ha tokë bujqësore; 346 ndërtesa; 2 institucione arsimore dhe 1 institucion fetar; 19 shërbime
- Njësia administrative Blinisht, rrezikohen të përmbyten rreth 91ha tokë bujqësore, ndërkohë që në rrezik janë edhe 118 ha në rast të shkatërrimit të digës së rezervuarit; rrezikohen 5 ndërtesa nga përmbytja
- Njësia administrative Kallmet, janë të rrezikuara nga përmbytjet 113 ha tokë bujqësore; nga shkatërrimi i digës së rezervuarit rrezikohen 303ha tokë bujqësore; rrezikohen 65 ndërtesa dhe 4 shërbime
- Njësia administrative Kolsh, janë të rrezikuara nga përmbytjet 54ha tokë bujqësore, nga shkatërrimi i digave rrezikohen 38ha tokë bujqësore; janë të rrezikuara nga përmbytja 6 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime
- Njësia administrative Shënkoll, janë të rrezikuara nga përmbytjet 1120ha tokë bujqësore; 801 ndërtesa dhe 20 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime
- Njësia administrative Zejmen, janë të rrezikuara nga përmbytjet 555 ha tokë bujqësore; 387 ndërtesa
- Njësia administrative Shëngjin, janë të rrezikuara nga përmbytjet 160ha tokë bujqësore, 15ha tokë bujqësore janë të rrezikuara nga shkatërrimi i digës; 485 ndërtesa janë të rrezikuara nga përmbytjet; 72 shërbime
- Qyteti Lezhë, janë të rrezikuara nga përmbytjet 3ha tokë bujqësore, dhe rreth 1.7ha tokë

bujqësore rrezikohet nga shkatërrimi i digave; janë të rrezikuara 6 institucione arsimore; 49 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime

- Në gjithë territorin e Bashkisë Lezhë, rrezikohen nga përmytjet 1800ha zonë të mbrojtur, kryesisht në pjesën perëndimore.


4.5.3 Analiza e Cënueshmërisë nga Rrëshqitjet e Tokës dhe Rënia e Gurëve

Bazuar në metodologjinë e përcaktuar për vlerësimin e rreziqeve nëpërmjet përdorimit të GIS është kryer vlerësimi cënueshmërisë ndaj rrezikut nga fenomene gjeologjike e gjeofizike (rrëshqitje toke dhe rënia e gurëve/ shkëmbinjve) në Bashkinë Lezhë nga pikëpamja fizike, sociale, ekonomike, mjedisore e kulturore. Për të evidentuar rrezikun janë përdorur indikatorët e mëposhtëm:

- **Cënueshmëria Fizike.** Janë evidentuar ndërtesat të cilat gjenden në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rrëshqitje toke; janë evidentuar ndërtesa në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rënie shkëmbinjsh; janë evidentuar rrugë në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rrëshqitje toke; janë evidentuar rrugë në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rënie gurësh; janë evidentuar institucione dhe infrastruktura kritike me distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rrëshqitje toke dhe rrezik rënie gurësh.
- **Cënueshmëria Sociale.** Janë evidentuar NjA bazuar në të dhënat e Census 2011 të cilat kanë % të lartë të personave mbi 65 vjeç; % të lartë të pensionistëve; % të lartë të PAK; % të lartë të Nj.E.F me ndihmë sociale .
- **Cënueshmëria Ekonomike:** janë evidentuar të gjitha bizneset të cilat ndodhen në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rrëshqitje toke dhe rrezik rënie gurësh.
- **Cënueshmëria Mjedisore:** janë evidentuar zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rrëshqitje toke dhe rënie gurësh.
- **Cënueshmëria Kulturore.** Janë evidentuar të gjithë monumentet në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik rrëshqitje toke dhe rënie gurësh.

Nisur nga elementët e mësipërm është kryer vlerësimi individual për secilin prej tyre:


FIG 52- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Rrëshqitja e Tokës dhe Rënia e Gurëve



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në shtojca)

Bazuar në mbivendosjen e analizave të mësipërme është përpiluar harta përmblledhëse e cënueshmërisë nga rreziku i rrëshqitjes së tokës dhe rënies së gurëve:

FIG 53- Cënueshmëria nga Rrëshqitja e Tokës dhe Rënia e Gurëve



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në shtojca)

Nisur nga analizat e mësipërme, në territorin e Bashkisë Lezhë, për secilën njësi administrative, rrezikohen:

- Në njësinë Administrative Ballëdren, rrezikohen nga rënia e gurëve rreth 80ha tokë bujqësore ku mund të prishen sera, produkte bujqësore dhe të mbjella; rrezikohen 310 ndërtesa, dhe një institucion fetar
- Në njësinë administrative Blinisht, rrezikohen 140 ndërtesa nga rreziku i rrëshqitjes së tokës.
- Në njësinë administrative Kallmet rrezikohen 143 ndërtesa nga rreziku i rrëshqitjes së tokës
- Në njësinë administrative Kolsh rrezikohen nga rënia e gurëve dhe shkëmbinjve 40ha tokë bujqësore; 223 ndërtesa; 13 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime; nga rrëshqitja e tokës rrezikohen 7ha tokë bujqësore; 327 ndërtesa
- Në njësinë administrative Zejmen rrezikohen nga rrëshqitja e tokës 53ha tokë bujqësore; 360 ndërtesa; 71 ha tokë bujqësore nga rënia potenciale e gurëve si dhe 934 ndërtesa
- Në njësinë administrative Ungrej, rrezikohen 83 ndërtesa nga rrëshqitja e tokës
- Në Shëngjin rrezikohen nga rënia e gurëve 4ha tokë bujqësore, 300 ndërtesa, 1 institucion fetar dhe 44 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime; nga rrëshqitja e dheut rrezikohen 10 ndërtesa
- Në qytetin e Lezhës nga rënia e gurëve dhe shkëmbinjve rrezikohen 669 ndërtesa, 2 institucione arsimore, 2 institucione fetare dhe 55 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime; nga rrëshqitja e tokës rrezikohen 553 ndërtesa, 1 institucion arsimor, 4 institucione fetare, 2 monumente kulturore dhe 63 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime.


4.3 ANALIZA E CËNUESHMËRISË NGA ZJARRET

Bazuar në metodologjinë e përcaktuar për vlerësimin e rreziqeve nëpërmjet përdorimit të GIS është kryer vlerësimi cënueshmërisë ndaj rrezikut nga zjarret në pyje dhe nga rreziku nga zjarri në aktivitete ekonomike/ industriale në Bashkinë Lezhë nga pikëpamja fizike, sociale, ekonomike, mjedisore e kulturore. Për të evidentuar rrezikun janë përdorur indikatorët e mëposhtëm:

- **Cënueshmëria Fizike.** Janë evidentuar ndërtesat të cilat gjenden në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik zjarri nga pyjet; Janë evidentuar të gjitha ndërtesat në distancë 60m nga karburantet; janë evidentuar ndërtesat të cilat gjenden në distancë 100, 200 dhe 500m nga depozitat e naftës. Janë evidentuar të gjitha infrastrukturat kritike dhe institucionet të cilat gjenden në distancë 100m, 200m, 500m nga pyjet në rrezik zjarri, 60m nga karburantet dhe 100m, 200m, 500m nga depozitat e naftës.
- **Cënueshmëria Sociale.** Janë evidentuar NjA bazuar në të dhënat e Census 2011 të cilat kanë % të lartë të personave mbi 65 vjeç; % të lartë të pensionistëve; % të lartë të PAK; % të lartë të Nj.E.F me ndihmë sociale.
- **Cënueshmëria Ekonomike:** janë evidentuar të gjitha bizneset të cilat ndodhen në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik zjarri në pyje; në distancë 60m nga karburantet dhe në distancë 100m, 200m 500m nga depozitat e naftës.
- **Cënueshmëria Mjedisore:** janë evidentuar zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik zjarri në pyje; 60m nga karburantet dhe 100m, 200m, 500m nga depozitat e naftës.
- **Cënueshmëria Kulturore.** Janë evidentuar të gjithë monumentet në distancë 100m, 200m, 500m nga zona me rrezik zjarri në pyje; 60m nga karburantet dhe 100m, 200m, 500m nga depozitat e naftës.

Nisur nga elementët e mësipërm është kryer vlerësimi individual për secilin prej tyre:


FIG 54- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Rreziku i Zjarrit



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

Bazuar në analizat e mësipërme dhe në mbivendosjen e tyre është krijuar harta përmbledhëse e cënueshmërisë ndaj rrezikut nga zjarri:

FIG 55- Cënueshmëria nga Rreziku i Zjarrit



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

Nisur nga analizat e mësipërme, në territorin e Bashkisë Lezhë, për secilën njësi administrative, identifikohen rreziqet e mëposhtme:

- Në njësinë administrative Balldren, rrezikohen 748ha tokë bujqësore në afërsi të zonave me rrezik potencial zjarri dhe 1965ha tokë bujqësore në distancë 500m; identifikohen në një distancë 500m nga zonat me potencial zjarri 10 institucione arsimore, 3 institucione fetare, 1 monument kulture dhe 50 aktivitete ekonomike të kategorisë Shërbime; në distancë 200m nga zonat me rrezik zjarri identifikohen 873 ndërtesa ndërkohë që në distancë 500m janë 1288 ndërtesa; janë në rrezik zjarri rreth 200ha hapësirë pyjore
- Në njësinë administrative Blinisht, rrezikohen 430ha tokë bujqësore në distancë 200m dhe 870ha në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; identifikohen 8 institucione arsimore, 5 institucione fetare, 1 monument kulture dhe 15 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime; identifikohen 512 ndërtesa në distancë 200m dhe 733 ndërtesa në distancë 500m. Gjithashtu janë të rrezikuara 56ha tokë pyjore.
- Në njësinë administrative Dajç janë të rrezikuara 254ha tokë bujqësore në distancë 200m dhe 650ha tokë bujqësore në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; janë identifikuar në një distancë 500m nga zona me rrezik zjarri 7 institucione arsimore; 5 institucione fetare; 11 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime; në distancë 200 nga zona me rrezik zjarri gjenden 468 ndërtesa dhe në distancë 500m gjenden 846 ndërtesa;

- Në njësinë administrative Kallmet janë identifikuar në distancë 200m nga zona me rrezik zjarri 235ha tokë bujqësore dhe në distancë 500m 573ha tokë bujqësore; në distancë 500m nga zjarri janë identifikuar 5 institucione arsimore; 1 institucion fetar; 1 monument kulture dhe 11 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime; janë identifikuar 889 ndërtesa në distancë 200m nga zona me rrezik zjarri dhe 1264 ndërtesa në distancë 500m; 270ha pyje janë në rrezik nga zjarri
- Në njësinë administrative Kolsh janë identifikuar 100ha toka bujqësore në distancë 200m dhe 204ha në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; janë identifikuar në një rreze 500m nga zona me rrezik zjarri 4 institucione arsimore dhe 15 aktivitete ekonomike të kategorisë shërbime; janë identifikuar 606 ndërtesa në një distancë 200m dhe 1013 ndërtesa në një distancë 500m nga zonat me rrezik zjarri; janë identifikuar 970ha në rrezik zjarri.
- Në njësinë administrative Ungrej janë identifikuar 779ha toka bujqësore në distancë 200m, 884ha në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; janë identifikuar 5 institucione arsimore dhe 1 monumente kulture; janë identifikuar në një distancë 200m 594 ndërtesa dhe në një distancë 500m janë identifikuar 653 ndërtesa; janë identifikuar 3616ha tokë pyjore
- Në njësinë administrative Zejmen janë identifikuar 220ha toka bujqësore në distancë 200m, 440ha në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; janë identifikuar 6 institucione arsimore dhe 2 monumente kulture; janë identifikuar në një distancë 200m 1178 ndërtesa dhe në një distancë 500m janë identifikuar 1689 ndërtesa; janë identifikuar 1700ha tokë pyjore
- Në njësinë administrative Shënkoll janë identifikuar 3ha toka bujqësore në distancë 200m, 30ha në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; janë identifikuar 6 institucione arsimore dhe 1 aktivitet ekonomik; janë identifikuar në një distancë 200m 13 ndërtesa dhe në një distancë 500m janë identifikuar 15 ndërtesa; janë identifikuar 18 ha tokë pyjore
- Në njësinë administrative Shëngjin janë identifikuar 24ha toka bujqësore në distancë 200m, 92ha në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; janë identifikuar 2 institucione arsimore, 2 institucione fetare, 2 monumente kulture dhe 162 aktivitete ekonomik; janë identifikuar në një distancë 200m 724 ndërtesa dhe në një distancë 500m janë identifikuar 912 ndërtesa; janë identifikuar 340ha tokë pyjore
- Në njësinë administrative Lezhë janë identifikuar 22ha toka bujqësore në distancë 200m, 40ha në distancë 500m nga zona me rrezik zjarri; janë identifikuar 4 institucione arsimore, 4 institucione fetare, 5 monumente kulture dhe 144 aktivitete ekonomik; janë identifikuar në një distancë 200m 144 ndërtesa dhe në një distancë 500m janë identifikuar 9966 ndërtesa; janë identifikuar 42ha tokë pyjore.


4.4 ANALIZA E CËNUESHMËRISË NGA BORA DHE ERA

Bazuar në metodologjinë e përcaktuar për vlerësimin e rreziqeve nëpërmjet përdorimit të GIS është kryer vlerësimi cënueshmërisë ndaj bora dhe era në Bashkinë Lezhë nga pikëpamja fizike, sociale, ekonomike, mjedisore e kulturore. Për të evidentuar rrezikun janë përdorur indikatorët e mëposhtëm:

- **Cënueshmëria Fizike.** Janë evidentuar ndërtesat të cilat gjenden në zona me rrezik potencial të bllokimit nga bora; janë evidentuar rrugë dhe infrastruktura kritike, institucione të cilat gjenden në rrezik të bllokimit nga bora; bazuar në shpejtësinë mesatare të erës dhe në drejtimin e erës janë evidentuar të gjitha ndërtesat të cilat gjenden në zona me shpejtësi ere 4 m/s; 6m/s; 8m/s dhe 10m/s; janë evidentuar të gjitha rrugët dhe infrastruktura të tjera kritike si institucione arsimore, qendra shëndetësore etj të cilat gjenden në zona me shpejtësi ere 4 m/s; 6m/s; 8m/s dhe 10m/s.
- **Cënueshmëria Sociale.** Janë evidentuar Nj.A bazuar në të dhënat e Census 2011 të cilat kanë % të lartë të personave mbi 65 vjeç; % të lartë të pensionistëve; % të lartë të PAK; % të lartë të Nj.E.F me ndihmë sociale
- **Cënueshmëria Ekonomike:** janë evidentuar të gjitha bizneset të cilat gjenden në zona me shpejtësi ere 4 m/s; 6m/s; 8m/s dhe 10m/s. Janë evidentuar të gjitha bizneset të cilat gjenden në zona me rrezik bllokimit nga bora.
- **Cënueshmëria Mjedisore:** janë evidentuar zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës të cilat gjenden në zona me shpejtësi ere 4 m/s; 6m/s; 8m/s dhe 10m/s; Janë evidentuar zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës të cilat gjenden në rrezik bllokimi nga dëborat.
- **Cënueshmëria Kulturore.** Janë evidentuar të gjithë monumentet të cilat gjenden në zona me shpejtësi ere 4 m/s; 6m/s; 8m/s dhe 10m/s; janë evidentuar të gjitha monumentet në zona me rrezik bllokimi nga dëborat;

Nisur nga elementët e mësipërm është kryer vlerësimi individual për secilin prej tyre:


FIG 56- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore nga Era dhe Bora



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

Bazuar në mbivendosjen e analizave të mësipërme është përpiluar harta përmbledhëse e cënueshmërisë nga rreziku i erës dhe bllokimit nga bora:

FIG 57- Cënueshmëria ndaj Rrezikut të Erës dhe Borës



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)


Nisur nga analizat e mësipërme, në territorin e Bashkisë Lezhë janë identifikuar sipas secilës njësi administrative:

- Në njësinë administrative Balldren, janë identifikuar 250ha tokë bujqësore në zonë me shpejtësi ere mbi 8m/s; janë identifikuar 33 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere 6m/s, 37 në zonë me shpejtësi ere 8 m/s dhe 37 në zonë me shpejtësi ere 10 m/s; janë identifikuar 2 aktivitete ekonomike në zonë me shpejtësi ere mbi 8m/s
- Në njësinë administrative Blinisht, janë identifikuar 2 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere mbi 8m/s
- Në njësinë administrative Dajç, janë identifikuar 20ha tokë bujqësore në zonë me shpejtësi ere mbi 8m/s; janë identifikuar 5 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere 8 m/s
- Në njësinë administrative Kallmet, është identifikuar 1 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere 10m/s
- Në njësinë administrative Kolsh, janë identifikuar 67 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere 6m/s, dhe 1 në zonë me shpejtësi ere 10 m/s;
- Në njësinë administrative Zejmen, janë identifikuar 75 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere 6m/s,
- Në njësinë administrative Ungrej, janë identifikuar 33 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere 6m/s,
- Në njësinë administrative Shënkoll, janë identifikuar 1737ha zonë e mbrojtur në zonë me shpejtësi ere 6m/s,
- Në njësinë administrative Shëngjin, janë identifikuar 37 ndërtesa në zonë me shpejtësi ere 6m/s, dhe 7 në zonë me shpejtësi ere 8m/s; janë identifikuar 7 shërbime në zonë me shpejtësi ere 8m/s; janë identifikuar 1825ha zonë e mbrojtur në hapësirë me shpejtësi ere mbi 5 m/s

4.5 ANALIZA E CËNUESHMËRISË NDAJ RREZIKUT TË PANDEMISË

Një tjetër rrezik i vlerësuar në këtë kapitull është ai i pandemive, dhe respektivisht Covid-19. Përsa i përket cënueshmërisë, janë analizuar faktorët sociale dhe ekonomike. Këto analiza janë bazuar në eksperiencën me COVID-19 në Shqipëri. Ndikimi kryesor i pandemisë ka qënë në lëvizshmërinë e njerëzve, nevojën për të mbajtur distancim fizik midis tyre, ndikimin në familjet në nevojë të cilët mund të kenë humbur punësimin si rezultat i mbylljes së pjeseshme të aktiviteteve ekonomike etj.


FIG 58- Cënueshmëria në Aktivitete Ekonomike nga Rreziku i Pandemisë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneksxx)

Siç mund të dallohet nga harta e mësipërme aktiviteti kryesor ekonomik në Bashkinë Lezhë zhvillohet përgjatë aksit të rrugës Milot-Lezhë, në qytetin e Lezhës dhe në Shëngjin ku ndodhet përqëndrimi më i madh i hoteleve dhe shërbimeve turistike. Nisur nga masat e ndërmarra nga qeveria Shqiptare gjatë periudhës së karantinimit të plotë e më pas gjatë periudhës së hapjes, shumë prej këtyre bizneseve kanë qënë të detyruara të mbyllin (në mënyrë të përkohshme) aktivitetin e tyre, dhe më pas të marrin masa të tjera për reduktimin e aktivitetit apo shtimit të kostove për të respektuar rregullat e distancimit fizik e të higjienës. Një tjetër sektor i rëndësishëm është dhe ai i bujqësisë. Edhe pse është ende herët për të kuptuar ndikimin real të pandemisë në këtë sektor, gjatë periudhës së karantinimit një probleme janë vërejtur edhe në këtë sektor. Si në çështje të lëvizjes për të punuar në bujqësi ashtu dhe në çështje të lëvizjes për të dëguar produktin bujqësor pranë konsumatorit.

FIG 59- Cënueshmëria Sociale ndaj Pandemive



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneksx)

Për të kuptuar cënueshmërinë sociale nga rreziku i përmytjes janë përdorur të dhëna të ndryshme si dendësia e popullsisë, pra për të kuptuar zonat ku respektimi i distancimit fizik mund të ishte më i vështirë dhe rrjedhimisht shpërndarja me e lartë. Po ashtu, janë përdorur të dhëna përsa i përket moshës së popullsisë, PAK, persona në moshë të tretë të cilët jetojnë të vetmuar, njësi familjare ekonomike të cilët janë në ndihmë sociale, si dhe distanca nga qendrat e njësive administrative drejt spitalit rajonal të Lezhës, si insitucioni i parë i specializuar ku qytetarët mund të marrin një shërbim përtej kontrollit parësor. Nga ky këndvështrim, njësi administrative Ungrej paraqet zonën me vulnerabilitet më të lartë social nga pandemia duke qënë se kombini i faktorëve të mësipërme ndodh në këtë njësi.

4.6 ANALIZA E CËNUESHMËRISË NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE


Ndryshimet klimatike tashmë janë një fakt dhe çdo autoritet vendor duhet të përgatitet për tu përballur me ndikimet e tyre. Bashkia Lezhë është e prekur dhe parashikohet të preket nga ndikimet negative të ndryshimeve klimatike. Për qëllimi të analizës së cënueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike janë përdorur dy ndikime kryesore:

- Thatësira, rritja e temperaturave, zjarret dhe krijimi i ishujve urban të nxehtësisë
- Rritja e nivelit të detit dhe përmbytjet si rezultat i ndryshimit të regjimit të rreshjeve

Për secilën prej dy pikave të mësipërme është kryer analiza mbi ndikimin në aspekte fizike, sociale, ekonomike, mjedisore e kulturore në territorin e Bashkisë Lezhë (fig.89).

Siç mund të dallohet nga hartat e mësipërme, pjesa më e rrezikuar e territorit të Bashkisë Lezhë, është në ultësirën perëndimore. Ndryshimi i regjimit të rreshjeve dhe rritja potenciale e nivelit të detit do të kenë ndikime të mëdha në këtë hapësirë. Kjo zonë është mjaft sensitive dhe vulnerabël për shkak të karakteristikave të saj të larta mjedisore. Si rrjedhojë, përmbytjet e ardhshme mund të dëmtonin rëndë biodiversitetin e zonës dhe të shkatërronin zonat e mbrojtura. Po ashtu, pjesa perëndimore e Bashkisë Lezhë dallohet për një prodhimtari të lartë e toka pjellore bujqësore.


FIG 60- Cënueshmëria Fizike, Sociale, Ekonomike, Mjedisore, Kulturore ndaj Rritjes së Nivelit të Detit dhe Ndryshimit të Regjimit të Rreshjeve



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

Së fundmi, përqëndrimi më i madh i aktivitetit turistik ndodh në këtë zonë. Pra rritja potenciale e rrezikut ndaj përmbytjeve në këtë hapësirë do të kishte një ndikim katastrofik për këtë hapësirë e si rrjedhojë familje e biznese do të duhej të zhvendoseshin.

FIG 61- Cënueshmëria Fizike, Ekonomike, Sociale, Mjedisore e Kulturore ndaj Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike në Thatësira, Zjarre e Rritje të Temperaturave




Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

Në këtë rast, ndikimi është më kompleks dhe i shtrirë në territor në krahasim me rrezikun ndaj përmbytjeve dhe rritjes së nivelit të detit i cili është i fokusuar kryesisht në ultësirën perëndimore. Ndikimi i thatësirave në bujqësi është shumë i madh, e mund të jetë e nevojshme krijimi i kushteve të reja për vaditjen si dhe në raste ekstreme ndryshimi i kulturave të mbjellave. Duke marrë në konsideratë që bujqësia është një ndër aktivitetet kryesore ekonomike, gjithashtu e lidhur ngushtë dhe me turizmin, atëherë ndikimi socio-ekonomik është shumë i madh në të gjitha njësitë administrative të cilat kanë në fokus të tyre bujqësinë. Po ashtu, rritja e temperaturave dhe e thatësirës është një rrezik konstant për shtimin e zjarreve në pyje. Veçanërisht në kodrat pranë Shëngjinit dhe në njësitë administrative Kolsh e Zejmen. Ngritja e temperaturave dhe thatësira ka një ndikim negativ dhe në hapësira urbane, veçanërisht në ato zona të cilat kanë sipërfaqe të mëdha të ndërtuara e pak gjelbërim. Në këto situatë krijohen kushtet për ishujt urbanë të nxehtësisë. Veçanërisht për moshat e treta apo për persona të cilët kanë vështirësi të tjera dhe nuk përballojnë dot temperaturat e larta, ishujt urbanë të nxehtësisë mund të shkaktojnë dëme të shumta në shëndetin e qytetarëve.

Bazuar në analizat e mësipërme është kryer analiza përmbledhëse e cënueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike:

FIG 62- Harta Përmbledhëse ndaj Ndryshimeve Klimatike




Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020) (hartat e detajuara gjenden në aneks)

4.7 ANALIZA E CËNUESHMËRISË MULTI-RREZIK


Bazuar në metodologjinë e përcaktuar më sipër, janë bërë vlerësimet e rrezikut dhe të cënueshmërisë duke përdorur shumë rreziqe. Për të përfutur këtë lloj analize, fillimisht janë mbivendosur së bashku të gjitha analizat e cënueshmërisë sipas aspekteve respektive fizike, ekonomike, mjedisore, kulturore e sociale. Më pas, hartat e rrezikut multi-rrezik sipas aspekteve të ndryshme janë mbivendosur me ndikimet nga ndryshimet klimatike. Në fund, nga mbivendosja e të gjitha analizave përftohet harta përfundimtare e vlerësimit të rrezikut dhe cënueshmërisë në Bashkinë Lezhë. Procesi i punës mund të dallohet në hartat e mëposhtme (hartat e detajuara janë në aneks).

FIG 63 - Analiza Multi-Rrezik Sociale, Ekonomike, Fizike, Mjedisore, Kulturore



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

FIG 64 - Analiza Multi-Rrezik




Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Si konkluzion, në mënyrë të sintetizuar, nga analizat e vlerësimit të rrezikut dhe të cënueshmërisë, për secilën njësi administrative mund të thuhet sa më poshtë:

Siç mund të dallohet nga më sipër, cënueshmëria më e lartë nga përmbytjet është në njësitë administrative Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Balldren dhe në qytet Lezhë. Cënueshmëria më e lartë nga rrëshqitjet dhe rrëshqitjet e tokës është në zonën e njësive administrative Kolsh, Zejmen, Lezhë dhe në Shëngjin e Balldren përsa i përket rënies së gurrëve. Rreziku më i madh nga zjarret

FIG 65- Konkluzione Analiza sipas Njësive Administrative dhe Rrezikut




Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

është në njësitë administrative Kallmet e Ungrej. Kjo vjen si rezultat i masiveve të mëdha pyjore dhe duke faktorizuar rritjen e thatësirave e të temperaturave si rezultat i ndryshimeve klimatike. Vulnerabiliteti më i madh nga rreziku i erës gjendet në njësitë administrative Balldren, Shënkoll e Shëngjin, ndërkohë që nga dëbora është në njësinë administrative Ungrej. Përsa i përket rrezikut të pandemisë, cënueshmëria më e madhe është në njësitë administrative Ungrej, Kolsh, Zejmen si rezultat i kombinimit të faktorëve moshë populsie, aksesueshmëri dhe ndihmë ekonomike.

VLERËSIMI I RISKUT

5



Ky kapitull bën pikëzimin e riskut për secilin rrezik, bazuar në indikatorët e vlerësuar dhe metodat e shtjelluara të vlerësimit të riskut. Më pas, një qasje multi-risk vendos rreziqet në raport me njëri-tjetrin, nisur nga kalendari sezonal. Për secilin risk, është vlerësuar pikëzimi total sipas formulës së përdorur në metodologji, dhe është hartuar matrica e riskut, e cila shërben si bazë për hartëzimin.

TABELA 10- Tabela Finale e Pikëzimit për secilin Rrezik, nisur nga Indikatorët dhe 4 Komponentët e Riskut

Rreziku	Rreziku (Probabiliteti / Frekuenca)	Ekspozimi (Elementet ne risk)	Cënueshmëria	Kapacitetet
PERMBYTJE	1.50	1.28	1.79	1.27
GJEORREZIQE	1.67	0.79	1.83	1.58
RREZIK SIZMIK	2.00	1.06	1.28	1.39
RREZIK METEOROLOGJIK	2.17	0.92	2.06	1.92
RREZIK ZJARRI	2.17	2.33	1.83	1.67
PANDEMI	2.60	0.58	1.90	2.67
NDRYSHIMET KLIMATIKE	1.92	1.17	1.51	1.00

Burimi: Co-PLAN,2020

Sic shihet nga tabela e mësipërme, për pjesën më të madhe të rreziqeve problemi kryesor është frekuenca e shpeshtë e ngjarjes së tyre. Ekspozimi është mjaft i lartë në rastin e rrezikut nga zjarri, i cili konsideron skenarin kur ka zjarrvënie në gjithë sipërfaqet pyjore. Ndërkaq, në çështje kapacitetesh, duket se ndryshimet klimaterike shfaqin nivel shumë të ulët parapërgatitjeje, bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi mes komuniteteve dhe autoriteteve vendore. Ndërkaq, duke u bazuar edhe në matricën e mëposhtme, risku është konsideruar si produkt i impaktit me probabilitetin. Kapaciteti konsiderohet si faktor ndikues vetëm në disa raste.

TABELA 11- Matrica për Vlerësimin e Rriskut

		Impakti			
		Pa impakt	I Ulet	I Mesem	I Larte
Frekuenca	Shume e larte		I Larte	Shume i larte	Shume i larte
	E Larte		I Mesem	I Larte	Shume i larte
	E Mesme		I Ulet	I Mesem	I Larte
	E Ulet		I Ulet	I Ulet	I Mesem
	Pa frekuenca	Pa risk			

Burimi: Co-PLAN,2020

5.1 RISKU SIZMIK

Risku sizmik do konsiderohet si faktor i probabilitetit, ekspozimit dhe cënueshmërinë, sipas formulës, si më poshtë:

$$R_s = 2 \times 1.06 \times 1.28 = 2.7$$

Pra në një shkallë nga 0 – 5, risku sizmik është i moderuar

5.2 RISKU GJEOLGJIK

Risku gjeologjik do konsiderohet si faktor i probabilitetit, ekspozimit dhe cënueshmërinë, sipas formulës, si më poshtë:

$$R_g = 1.67 \times 0.79 \times 1.83 = 2.42$$

Pra në një shkallë nga 0 – 5, risku gjeologjik është i ulët

5.3 RISKU NGA PËRMBYTJET

Risku nga përmbytjet do konsiderohet si faktor i probabilitetit, ekspozimit dhe cënueshmërinë, sipas formulës, si më poshtë:

$$R_p = 1,5 \times 1,28 \times 1,79 = 3.43$$

Pra në një shkallë nga 0 – 5, risku nga përmbytjet është i lartë

FIG 66- Harta e Riskut Sizmik (I moderuar)



Burimi: Co-PLAN, UNDP, 2020

FIG 67- Harta e Riskut Gjeologjik (I ulët)



Burimi: Co-PLAN, UNDP, 2020

FIG 68- Harta e Riskut nga Përmbytjet (I lartë)



Burimi: Co-PLAN, 2020

5.4 RISKU NGA ZJARRI

Risku nga zjarret do konsiderohet si faktor i probabilitetit, ekspozimit dhe cënueshmërinë, sipas formulës, si më poshtë, duke shtuar një faktor probabilitar $k=0.5$

$$R_z = 2.17 \times 2.33 \times 1.83 \times 0.5 = 4.63$$

Pra në një shkallë nga 0 – 5, risku nga zjarri është shumë i lartë

5.5 RISKU METEOROLOGJIK

Risku meteorologjik do konsiderohet si faktor i probabilitetit, ekspozimit dhe cënueshmërinë, sipas formulës, si më poshtë

$$R_m = 2.17 \times 0.92 \times 2.06 = 4.08$$

Pra në një shkallë nga 0 – 5, risku meteorologjik është shumë i lartë

FIG 69- Harta e Riskut nga Zjarri (shumë I lartë)



Burimi: Co-PLAN, UNDP, 2020

FIG 70- Harta e Riskut Meteorologjik (shumë I lartë)



Burimi: Co-PLAN, UNDP, 2020

5.6 RISKU NGA PANDEMIA

Risku nga pandemia do konsiderohet si faktor i probabilitetit, ekspozimit dhe cënueshmërinë, sipas formulës, si më poshtë

$$R_{pand} = 2.60 \times 0.58 \times 1.90 = 2.88$$

Pra në një shkallë nga 0 – 5, risku nga pandemia është i moderuar

5.7 RISKU NGA NDRYSHIMET KLIMATERIKE

Risku nga ndryshimet klimaterike do konsiderohet si faktor i probabilitetit, ekspozimit dhe cënueshmërinë, sipas formulës, si më poshtë:

$$Rnk = 1.92 \times 1.17 \times 1.51 = 3.37$$

Pra në një shkallë nga 0 – 5, risku nga ndryshimet klimaterike është i lartë

Duke analizuar mbivendosjen e risqeve të sipërpërmendura, mund të evidentohen zonat më problematike në periudhën afatmesme. Për këtë vjen në ndihmë dhe kalendari sezonal:

5.8 KALENDARI SEZONAL

TABELA 12- Tabela e Kalendarit Sezonal

NGJARJET SEZONALE	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	NJA / zona që preken	
RREZIQUET NATYRORE														
Tërmet	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	NJA me toke në rrezik lëngëzimi: Shëngjin, Shënkoll
Përmbytje – bllokim kanalesh / rreshje të shumta / probleme teknike ²	x	x							x		x	x	Mabë, Zojz, Gocaj, Torovicë, Ishull-Shëngjin, Barbullojë, Lalm i Ri, Tresh, Zejmën	
Përmbytje detare	x											x	Kune Vain, Shëngjin, Tale	
Stuhi dëbore	x	x										x	NJA Ungrej, Kolsh Zona malore Mol-ung Mali i Rrencit	
Erë e forte/ stuhi				x					x				Shënkoll, Balldren	
Zjarre ³	18	14	20	10	10	16	31	43	28	26	12	14	Lezhë, Ishull Lezhë; Manati; Dajc, Ungrej, Barbulloje, Gjader, Shëngjin, Balldren, Kolsh, Zejmen, etj	
Zjarrvënie në pyje ⁴	0	4	3	0	0	0	1	6	0	0	0	2		
Rrëzim shkëmbinjsh									x	x	x		Lezhë – Shëngjin – Rana hedhun; Aksi Torovicë –Lezhë;Lagjia Gurrat e Begut, Lezhë; Manati-Tresh – Spiten; Aksi Milot – Rrëshen;	

2 Bazuar në regjistrimet e përmbytjeve madhore të ndodhura 20 vitet e fundit.

3 Llogaritur bazuar në mesataren e zjarreve për periudhën 2016-2019, të regjistruar në inventarin e Drejtorisë së MNZSH, Bashki


4 Numri i zjarreve të rëna në tokë pyjore, për vitin 2019

NGJARJET SEZONALE	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH	NJA / zona që preken
Rrëshqitje dheu			x						x	x	x	x	Fishtë – Troshan
Thatësi							x	x					Gjithë bashkia
Rreshje të dendura									x	x	x		Gjithë bashkia
SEKTORE EKONOMIKE / SOCIALE													
Bujqësi - Periudhë korrjeje						x	x						
Bujqësi - Periudhë mbjelljeje			x	x	x								
Turizëm – Periudhë fluksi të lartë						x	x	x					Shëngjin
Periudhë shkolle	x	x	x	x	x				x	x	x	x	Gjithë bashkia
KUJDESI SHËNDETËSOR													
Pandemia COVID-19 ⁵	0	0	1	14	52	79	83	177	274	373	638 ⁶	?	Gjithë bashkia

Burimi: Co-PLAN,2020

Si përfundim, në këndvështrimin multi-risk, efektet në territor paraqiten në figurën më poshtë:

FIG 71- Harta Multirisk në Territor, Ekspozimi dhe Elementët e Riskuar



Burimi: Co-PLAN,2020


5 Llogaritur si raste aktive, në nivel qarku, për datën 24 të secilit muaj. Data 24 mars është data e regjistrimit të pacientit të parë të infektuar në bashki.

6 Referuar datës 15 nëntor.

Sakaq, në aspekt të riskut vërehet mbivendosje e sipërfaqeve të riskut shumë të lartë, me ato të riskut të lartë. Këto tre risqe (zjarret, përmytjet dhe efektet meteorologjike) evidentohen në Njësinë Balldren, Shëngjin dhe Shënkoll.

Edhe qendra e Lezhës ndikohet nga disa rreziqe të njëhershme, me risk të lartë, të moderuar, shumë të lartë dhe të ulët. Kjo pasqyre e risqeve në Bashki tregon se hapat e ndjekur më tej, për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve, si dhe për hartimin e zbatimin e një plani masash efektiv, janë thelbësore për zhvillimin 'resilient' të bashkisë në periudhën afatgjatë.

FIG 72- Harta Multirisk në Territor, Ekspozimi dhe Elementët e Riskuar



Në vijim detajohen mënyrat e pikëzimit për secilën kategori të riskut.

5.9 DETAJIM I TABELAVE TË PIKËZIMIT

TABELA 13- Probabiliteti i Rrezikut

RREZIKU	Rreziku (Probabiliteti / Frekuenca)						
	Frekuenca normale	Frekuenca e fatalitetit	Periudha e qëndrimit	Probabiliteti	Zgjatja e rrezikut përtej kufirit të tij	Ekspozimi ndaj rrezikut	
PERMBYTJE	2.13	-	1.63	2.25	1.00	2.00	1.50
Blokim kanalesh	3.00	-	1.00	3.00	1.00	2.00	
Përmbytje nga vërshimet e përrrenjve malorë	3.00	-	1.00	3.00	1.00	2.00	
Përmbytje nga bllokimi I kanaleve në zona deprezioni	2.00	-	2.00	3.00	1.00	2.00	
Përmbytje nga vërshimi I përrrenjve kodrinorë dhe bllokimi I kanaleve vaditëse	3.00	-	1.00	3.00	1.00	2.00	
Përmbytje nga rritja e nivelit të ujit dhe shkarkime HEC	1.00	-	1.00	1.00	1.00	1.00	
Permbytje nga rritja e nivelit të Lumit/ Permbytje nga erozioni/ batica detare/ Rreshje të shumta të kombinuara me shkarkime nga Hidrocentralet	1.00	-	1.00	2.00	1.00	3.00	
Rreshje të shumta/depertimi i ujit në shtresat nëntokesore nga fusha e Torovices/ Blokim kanalesh	3.00	-	3.00	2.00	1.00	1.00	
Permbytje nga erozioni/ batica detare	1.00	-	3.00	1.00	1.00	3.00	
GJEORREZIQE	2.50	0.50	1.00	3.00	2.00	1.00	
Rënie gurësh	3.00	1.00	1.00	3.00	2.00	1.00	
Rrëshqitje dheu	2.00	-	1.00	3.00	2.00	1.00	
RREZIK SIZMIK	1.00	3.00	3.00	1.00	1.00	3.00	2.00
Dëmtim ndërtesash mbi 30 vjeçare	1.00	3.00	3.00	1.00	1.00	3.00	
Lëngëzim trualli	1.00	3.00	3.00	1.00	1.00	3.00	
Dëmtim ndërtesa në zona informale	1.00	3.00	3.00	1.00	1.00	3.00	

RREZIKU	Rreziku (Probabiliteti / Frekuenca)						
	Frekuenca normale	Frekuenca e fatalitetit	Periudha e qëndrimit	Probabiliteti	Zgjatja e rrezikut përtej kufirit të tij	Ekspozimi ndaj rrezikut	
RREZIK METEOROLOGJIK	2.00	-	2.00	3.00	3.00	3.00	2.17
Stuhi dëbore	2.00	-	3.00	3.00	3.00	3.00	
Stuhi ere	2.00	-	1.00	3.00	3.00	3.00	
RREZIK ZJARRI	3.00	-	2.00	3.00	3.00	2.00	2.17
Rrezik nga zjarrevënia në pyje	3.00	-	2.00	3.00	3.00	2.00	
PANDEMI	1.00	3.00	3.00	3.00		3.00	2.60
Covid -19	1.00	3.00	3.00	3.00	n/a	3.00	
NDRYSHIMET KLIMATIKE	2.50	-	2.75	2.00	2.25	2.00	1.92
Përmbytje nga rreshjet	3.00	-	2.00	2.00	3.00	2.00	
Thatësira në bujqësi	3.00	-	3.00	2.00	1.00	2.00	
Ishujt e nxehtë urbanë	2.00	-	3.00	2.00	2.00	1.00	
Zjarrvënie nga thatësira	2.00	-	3.00	2.00	3.00	3.00	

Burimi: Co-PLAN, UNDP, 2020

TABELA 14- Vlerësimi i Elementëve të Riskut

RREZIKU	Ekspozimi (Elementet ne risk)												
	Nr ndërtesash në zonën e rrezikut (ose në rrezik)	Infrastruktura në zonën e rrezikut	Ndërtesa shërbimi në zonë rreziku	Zonë industriale në zonë rreziku	Popullsi banuese në zonat e rrezikut	Monumente natyrore të rrezikuara	Sip zona të mbrojtura të rrezikuara	Sip pyje të rrezikuara	Sip bujqësore e rrezikuara	Institucione arsimore të rrezikuara	Monumente kulture të rrezikuara	Ndërtesa me relevancë kulturore (fetare, adm, etj)	
PERMBYTJE	1.88	1.63	1.75	1.13	1.50	0.75	1.50	0.50	2.25	1.25	0.38	0.88	1.28
Bllokim kanalesh	2.00	2.00	2.00	3.00	2.00	1.00	2.00	-	2.00	2.00	-	2.00	
Përmbytje nga vërshimet e përrrenjve malorë	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	-	1.00	
Përmbytje nga bllokimi I kanaleve në zona depresioni	1.00	1.00	1.00	-	1.00	-	1.00	-	2.00	-	-	-	
Përmbytje nga vërshimi I përrrenjve kodrinorë dhe bllokimi I kanaleve vaditëse	2.00	2.00	2.00	1.00	1.00	-	-	2.00	3.00	1.00	-	-	
Përmbytje nga rritja e nivelit të ujit dhe shkarkime HEC	2.00	2.00	2.00	1.00	1.00	-	2.00	-	2.00	1.00	-	1.00	

RREZIKU	Ekspozimi (Elementet ne risk)												
	Nr ndërtesash në zonën e rrezikut (ose në rrezik)	Infrastruktura në zonën e rrezikut	Ndërtesa shërbimi në zonë rreziku	Zonë industriale në zonë rreziku	Popullsia banuese në zonat e rrezikut	Monumente natyrore të rrezikuara	Sip zona të mbrojtura të rrezikuara	Sip pyje të rrezikuara	Sip bujqësore e rrezikuat	Institucione arsimore të rrezikuara	Monumente kulture të rrezikuara	Ndërtesa me relevancë kulturore (fetare, adm, etj)	
Permbytje nga rritja e nivelit të Lumit/ Permbytje nga erozioni/ batica detare/Rreshje te shumta te kombinuara me shkarkime nga Hidrocentralet	2.00	2.00	2.00	1.00	1.00	1.00	2.00	-	3.00	2.00	-	-	1.28
Rreshje te shumta/depertimi i ujit ne shtresat nentokesore nga fusha e Torovices/Bllokim kanalesh	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	
Permbytje nga erozioni/ batica detare	4.00	2.00	3.00	1.00	4.00	2.00	3.00	-	3.00	2.00	2.00	2.00	
GJEORREZIQE	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	-	1.00	-	0.50	1.00	1.00	1.00	0.79
Rënie gurësh	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	-	1.00	-	-	1.00	1.00	1.00	
Rrëshqitje dheu	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	-	1.00	-	1.00	1.00	1.00	1.00	
RREZIK SIZMIK	1.67	0.33	1.67	1.00	1.67	-	0.33	-	0.67	1.67	1.67	2.00	1.06
Dëmtim ndërtesash mbi 30 vjecare	2.00	-	2.00	1.00	2.00	-	-	-	-	3.00	3.00	2.00	
Lëngëzim trualli	2.00	1.00	2.00	-	2.00	-	1.00	-	2.00	1.00	1.00	2.00	
Dëmtim ndërtesa në zona informale	1.00	-	1.00	2.00	1.00	-	-	-	-	1.00	1.00	2.00	0.92
RREZIK METEOROLOGJIK	1.50	1.00	0.50	0.50	1.50	1.00	-	0.50	2.50	1.00	0.50	0.50	
Stuhi dëbore	1.00	1.00	-	-	1.00	-	-	1.00	1.00	1.00	-	-	
Stuhi ere	2.00	1.00	1.00	1.00	2.00	2.00	-	-	4.00	1.00	1.00	1.00	2.33
RREZIK ZJARRI	4.00	3.00	2.00	2.00	4.00	3.00	3.00	3.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Rrezik nga zjarrvënia në pyje	4.00	3.00	2.00	2.00	4.00	3.00	3.00	3.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
PANDEMI	-	-	3.00	-	4.00	-	-	-	-	-	-	-	0.58
Covid -19	-	-	3.00	-	4.00	-	-	-	-	-	-	-	
NDRYSHIMET KLIMATIKE	1.75	1.25	1.00	0.75	3.00	1.00	1.25	1.00	1.75	0.50	0.25	0.50	1.17
Përmbytje nga rreshjet	2.00	2.00	2.00	1.00	2.00	1.00	2.00	1.00	2.00	1.00	-	1.00	
Thatësira në bujqësi	-	-	-	-	4.00	-	-	-	4.00	-	-	-	
Ishujt e nxehtë urbanë	1.00	-	-	-	2.00	-	-	-	-	-	-	-	
Zjarrvënie nga thatësira	4.00	3.00	2.00	2.00	4.00	3.00	3.00	3.00	1.00	1.00	1.00	1.00	

Burimi: Co-PLAN,2020

TABELA 15- Vlerësimi i Cenueshmërisë

RREZIKU	Cënueshmëria											
	Varësia nga ndihma sociale	Mosha e tretë e vetmuar	Vjetërsia e popullsisë	Përqindja e PAK	Distanca mesatare drejt qendrës së bashkisë	Distanca mesatare drejt qendrës së NJA	Punësimi në shërbime	Lëvizjet vajtje-ardhje për vendet e punës	Përqindja e të rinjve në moshë shkolle	Mungesa e sistemit sanitar në familje	Punësimi në bujqësi	
PERMBYTJE	1.75	1.38	1.75	1.75	1.88	1.00					3.00	
Bllokim kanalesh	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Përmbytje nga vërshimet e përrenjve malorë	2.00	2.00	3.00	2.00	1.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Përmbytje nga bllokimi I kanaleve në zona depresioni	1.00	1.00	1.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Përmbytje nga vërshimi I përrenjve kodrinorë dhe bllokimi I kanaleve vaditëse	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Përmbytje nga rritja e nivelit të ujit dhe shkarkime HEC	2.00	1.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	1.79
Permbytje nga rritja e nivelit te Lumit/ Permbytje nga erozioni/ batica detare/Rreshje te shumta te kombinuara me shkarkime nga Hidrocentralet	2.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Rreshje te shumta/depertimi i ujit ne shtresat nentokesore nga fusha e Torovices/Bllokim kanalesh	1.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Permbytje nga erozioni/ batica detare	2.00	1.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
GJEORREZIQE	2.00	2.00	2.50	1.50	2.00	1.00						
Rënie gurësh	2.00	2.00	3.00	1.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	1.83
Rrëshqitje dheu	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	

RREZIKU	Cënueshmëria											
	Varësia nga ndihma sociale	Mosha e tretë e vetmuar	Vjetërsia e popullsisë	Përqindja e PAK	Distanca mesatare drejt qendrës së bashkisë	Distanca mesatare drejt qendrës së NJA	Punësimi në shërbime	Lëvizjet vajtje-ardhje për vendet e punës	Përqindja e të rinjve në moshë shkolle	Mungesa e sistemit sanitar në familje	Punësimi në bujqësi	
RREZIK SIZMIK	1.00	1.00	1.67	1.33	1.67	1.00						
Dëmtim ndërtesash mbi 30 vjecare	1.00	1.00	2.00	1.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	1.28
Lëngëzim trualli	1.00	1.00	1.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
Dëmtim ndërtesa në zona informale	1.00	1.00	2.00	1.00	1.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
RREZIK METE-OROLOGJIK	2.50	1.50	2.00	2.50	2.50	1.50		1.50	1.50		3.00	2.06
Stuhi dëbore	3.00	2.00	2.00	3.00	3.00	2.00	n/a	2.00	1.00	n/a	3.00	
Stuhi ere	2.00	1.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	1.00	2.00	n/a	3.00	
RREZIK ZJARRI	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00						1.83
Rrezik nga zjarrvënja në pyje	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
PANDEMI	1.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00	3.00	2.00	2.00	2.00		1.90
Covid -19	1.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00	3.00	2.00	2.00	2.00	n/a	
NDRYSHIMET KLIMATIKE	1.75	1.75	2.00	1.75	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	2.33	1.51
Përmbytje nga rreshjet	2.00	1.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Thatësira në bujqësi	1.00	1.00	1.00	1.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	3.00	
Ishujt e nxehtë urbanë	2.00	3.00	3.00	2.00	2.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Zjarrvënje nga thatësira	2.00	2.00	2.00	2.00	2.00	1.00	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	

Burimi: Co-PLAN,2020

TABELA 16- Vleresimi I Kapaciteteve

RREZIQET	Kapacitetet						
	Kapacitete të autoriteteve vendore	Kapacitete të komunitetit	Ndërgjegjësim nga Autoritetet vendore	Ndërgjegjësim nga Komuniteti	Koordinim me autoritete rajonale	Koordinim me autoritete kombëtare	
PERMBYTJE	1.38	1.13	1.63	1.25	1.00	1.25	
Blokim kanalesh	2.00	2.00	3.00	1.00	1.00	2.00	
Përmbytje nga vërshimet e përrrenjve malorë	2.00	1.00	3.00	3.00	1.00	1.00	
Përmbytje nga bllokimi I kanaleve në zona depresioni	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Përmbytje nga vërshimi I përrrenjve kodrinorë dhe bllokimi I kanaleve vaditëse	2.00	1.00	2.00	1.00	1.00	2.00	
Përmbytje nga rritja e nivelit të ujit dhe shkarkime HEC	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.27
Permbytje nga rritja e nivelit te Lumit/ Permbytje nga erozioni/ batica detare/ Rreshje te shumta te kombinuara me shkarkime nga Hidrocentralet	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Rreshje te shumta/ depertimi i ujit ne shtresat nentokesore nga fusha e Torovices/ Bllokim kanalesh	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Permbytje nga erozioni/ batica detare	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
GJEORREZIQE	1.00	1.00	2.50	2.50	1.00	1.50	
Rënie gurësh	1.00	1.00	3.00	3.00	1.00	2.00	1.58
Rrëshqitje dheu	1.00	1.00	2.00	2.00	1.00	1.00	
RREZIK SIZMIK	1.00	1.33	1.67	1.67	1.00	1.67	
Dëmtim ndërtesash mbi 30 vjecare	1.00	1.00	2.00	2.00	1.00	2.00	1.39
Lëngëzim trualli	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Dëmtim ndërtesa në zona informale	1.00	2.00	2.00	2.00	1.00	2.00	
RREZIK METEO-ROLOGJIK	1.50	1.00	3.00	3.00	1.50	1.50	
Stuhi dëbore	2.00	1.00	3.00	3.00	2.00	2.00	1.92
Stuhi ere	1.00	1.00	3.00	3.00	1.00	1.00	

RREZIQET	Kapacitetet						
	Kapacitete të autoriteteve vendore	Kapacitete të komunitetit	Ndërgjegjësim nga Autoritetet vendore	Ndërgjegjësim nga Komuniteti	Koordinim me autoritete rajonale	Koordinim me autoritete kombëtare	
RREZIK ZJARRI	1.00	2.00	2.00	1.00	2.00	2.00	1.67
Rrezik nga zjarrvënia në pyje	1.00	2.00	2.00	1.00	2.00	2.00	
PANDEMI	2.00	3.00	3.00	2.00	3.00	3.00	2.67
Covid -19	2.00	3.00	3.00	2.00	3.00	3.00	
NDRYSHIMET KLIMATIKE	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00
Përmbytje nga rreshjet	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Thatësira në bujqësi	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Ishujt e nxehtë urbanë	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
Zjarrvënie nga thatësira	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	

Burimi: Co-PLAN,2020

SHTOJCA 1

KONTEKSTI LOKAL DHE RREZIQET
NË BASHKINË LEZHË



1 POZICIONI GJEOGRAFIK

Bashkia Lezhë ndodhet në pjesën perëndimore të Republikës së Shqipërisë si dhe pjesë e Qarkut të Lezhës. Kjo bashki përbëhet nga 10 njësi administrative të cilat janë: Lezha, Shëngjini, Zejmeni, Shënkolli, Balldreni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi, me qendër Qytetin e Lezhës. Bashkia përbëhet nga dy zona urbane (Lezhën dhe Shëngjinin) dhe 65 fshatra me një sipërfaqe prej 508.9 km².

Bashkia Lezhë kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik dhe me Bashkinë Shkodër, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Bazuar në të dhënat e Regjistrat Civil, kjo bashki ka një popullsi 106,245 banorë. Kryesisht pjesa e ultësirës së Bashkisë Lezhë në 20 vitet e fundit ka pasur një tendencë rritje, kryesisht nga levizjet mekanike, popullsi e ardhur nga zona të thella e veri-perëndimore të vendit. Sa më sipër densiteti i popullsisë në tërësi për territorin e Bashkisë Lezhë rezulton 208.7 banorë/km².

Sa i përket relievit, Bashkia Lezhë në pjesën më të madhe të saj ka një reliev fushor (pjesa perëndimore e Bashkisë), gjithashtu ekstremi perëndimor i saj është i përbërë nga plazhe ranore dhe zona ligatinore siç janë lagunat dhe kënetat. Në pjesën Lindore të saj relievi ka një rritje graduale në lartësi dhe ka tipare kodrinore malore. Bashkia Lezhë karakterizohet nga një variacion peizazhesh natyrore dhe këtë e vërteton relievi ku në disa zona është edhe nën nivelin e detit si dhe pika më e lartë e saj është Maja e Velës (NJA Kolsh) me një lartësi 1170m. Po ashtu bashkia ka një hidrografi mjaft të pasur me praninë e tre Lumenjve Drin, Gjadër dhe Mat si dhe me vijën bregdetare në të gjithë pjesën perëndimore të bashkisë. Bashkia shtrihet në pjesën dërrmuese të vet në një zonë të ulët dhe bregdetare, me lartësi 5 metra mbi nivelin e detit. Si rezultat, një pjesë e territorit të Lezhës vazhdon të kërcënohet nga përmytjet, të cilat shkaktojnë herë pas here dëme të konsiderueshme.

Sa i përket tipareve klimaterike Bashkia Lezhë ka klimë tipike mesdhetare e cila është një klimë tepër e përshtatshme që mundëson kultivimin e varieteteve të ndryshme bujqësore gjithashtu të zhvillimit të sektorit të blegtorisë. Në këtë nënzonë reshjet vjetore kanë vlera që lëkunden ndërmjet 950 dhe 1200mm. Temperaturat minimale absolute marrin vlera nga -3 deri -5°C; vetëm në raste shumë të rralla mund të vrojtohen temperatura më të ulëta se këto vlera. Periudha e ngricave është shumë e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të marrë vlera nga 12 deri 15 ditë në vit. Përsa i përket temperaturave maksimale absolute vlerat e tyre rrallë herë e kalojnë vlerën 35-36°C. Vlera më e lartë e temperaturës maksimale absolute është 39.0°C. Erërat, në përgjithësi fryjnë nga dy drejtime. Gjatë stinës së ftohtë mbizotërojnë erërat nga juglindja dhe veriu ndërsa gjatë periudhës së ngrohtë ato që vijnë nga drejtimi veriperëndim. Shpejtësitë maksimale të erës në këtë zonë gjatë stinës së ngrohtë marrin vlera nga 10 deri 15 m/s dhe gjatë stinës së ftohtë prej 25 deri 30 m/s.

2 POPULLSIA

Në bazë të INSTAT Bashkia Lezhë, është një pjesë e rëndësishme e Qarkut Lezhë. Ky qark ka një popullsi prej 134027 banorë dhe përbën 6% të popullsisë së vendit, e ndarë në 21 njësi administrative (INSTAT, 2011). Popullsia e Bashkisë Lezhë (duke përfshirë të gjitha njësitë administrative të saj) përbën 49% të popullsisë së qarkut, me një numër prej 65633 banorë (INSTAT, 2011).

TABELA 17- Popullsia sipas Njësive Administrative

Njësiti administrative	Popullsia 2001	Popullsia 2011	Ndryshimi 2001-2011 në%	Popullsia 2014	Popullsia 2015	Ndryshimi 2013-2015 në (%)
Balldren	7203	6142	-14,7%	10090	10068	-0,55%
Blinisht	4238	3361	-20,7%	5486	5527	1,28%
Dajç	5183	3834	-26,0%	7072	7121	1,27%
Kallmet	5493	4118	-25,0%	7114	7159	1,82%
Kolsh	4923	4228	-14,1%	6941	7009	1,80%
Lezha	14420	15510	7,6%	29545	29943	2,50%
Shëngjin	6807	8091	18,9%	11991	12097	2,14%
Shënkollë	8894	13102	47,3%	16281	16764	2,92%
Ungrej	3840	1587	-58,7%	3111	3090	-0,96%
Zejmen	6713	5660	-15,7%	9342	9419	1,83%
Total	67714	65633	-3,1%	106973	108197	1,84%

Burimi: INSTAT, 2011

Të dhënat e Regjistrit të gjendjes civile, flasin për një popullsi rreth 43% më të lartë në krahasim me të dhënat e Censurit 2011. Kjo për arsye të lëvizjes brenda vendit, pas vitit '89 nuk shoqëroreshin gjithmonë me procedura të regjistrimit në Regjistrin e gjendjes civile të zonës ku vendoseshin. Gjithashtu, edhe dukuria e emigracionit ndikon në mosparaqitjen e gjendjes reale të popullsisë.

Nga të dhënat e mësipërme vihet re një rënie e fluksit të lëvizjes së popullsisë. Me përjashtim të njësive administrative Balldren dhe Ungrej, të cilat vazhdojnë të kenë ulje të popullsisë, të gjitha njësitet e tjera kanë një rritje të natyrshme të popullsisë. Njësitet administrative Shënkoll, Lezhë dhe Shëngjin, sikurse në statistikat e 2011, vazhdojnë të kenë një rritje më të lartë në raport me pjesën tjetër të njësive administrative të Bashkisë Lezhë.

Përsa i përket strukturës së popullsisë, përveç migrimit, ulja e lindshmërisë dhe vdekshmëria kanë ndikim të rëndësishëm. Sipas të dhënave të INSTAT-it, 21.4% e popullsisë është në moshën 15 vjeç dhe 11.5% është mbi moshën 65 vjeç (INSTAT, 2014). Këto të dhëna tregojnë që grupi i popullsisë aktive 15-64 vjeç zë përqindjen më të madhe. Koeficienti i varësisë (numri i personave nën 14 vjeç dhe mbi 65 vjeç, përkundrejt numrit të personave në moshë aktive 15-64 vjeç) shprehur në përqindje është 49, shifër kjo ndjeshmërisht më e ulët se niveli kombëtar. Kjo nënkupton një zvogëlim të barrës së personave të varur brenda njësive ekonomike familjare.

3 ZHVILLIMI SOCIO-EKONOMIK

3.1 Zhvillimi Ekonomik

Për analizimin e zhvillimit ekonomik janë mjaft të rëndësishme termat makro-ekonomike të cilat tregojnë për zhvillimin e Qarkut të Lezhës si dhe Bashkisë Lezhë si qendra e këtij qarku. Dy të dhënat makro ekonomike të cilat do të analizohen janë PBB (Produkti i Brendshëm Bruto) dhe VSHB (Vlera e Shtuar Bruto). Në terma realë, PBB-ja u rrit me rreth 2.2% në vitin 2015, normë kjo rreth 0.4 pikë përqindjeje më e lartë krahasuar me një vit më parë. Të dhënat tremujore për PBB-në reale sugjerojnë se në vitin 2016 PBB-reale u rrit me rreth 3.36% dhe në vitin 2017 me rreth 3.84% (e dhënë gjysmë finale dhe paraprake).

Përsa i përket kontributit në PBB të Qarkut Lezhë mund të themi se ka një kontribut mjaft të ulët në raport me Qarqet me të zhvilluara siç janë Tirana, Fieri dhe Durrësi. Kontributi i Qarqeve në

PBB tregon qartë dhe nivelin e pabarazisë në zhvillimet ekonomike që kanë qarqet ndërmjet tyre. Lezha ka potencial të mjaftueshme ekonomike dhe infrastrukturore të konkurojë me Durrësin nga pikpamja e zhvillimeve portuale dhe tregtisë.

TABELA 18- Kontributi ndër Vite i VSHB së Qarkut Lezhë në Raport me Totalin

Qarku	2008	2011	2015
Lezhë	3.39%	3.10%	3.31%

Burimi: INSTAT, 2019

Në linja të përgjithshme struktura e VSHB-së nuk paraqet ndryshime domethënëse në kohë. Dallohet qartë që si tek PBB edhe në VSHB Qarku i Lezhës ka një peshë të ulët në kontributin kombëtar. Konkretisht VSHB në vitin 2008 është 3.39 % e totalit në raport me VSHB në nivel kombëtar, në vitin 2011 njih një ulje të konsiderueshme në vlerën 3.10 % dhe më pas në vitin 2015 njih një rritje në vlerën 3.31%. Kjo tregon se kemi një performancë të dobët ekonomike të Qarkut Lezhë dhe se kjo performancë ka tendencë të rritet.

Sa i përket strukturës së VSHB-së në Qarkun Lezhë. Sektori më i zhvilluar është “Bujqësia, gjuetia dhe pyjet, peshkimi” me rreth 32.0% ndaj totalit në vitin 2015. Sektor me rëndësi gjithashtu është edhe sektori “Tregtia me shumicë dhe pakicë, transporti dhe magazinimi, Hoteleria dhe aktivitetet e shërbimit” me rreth 14.5% ndaj totalit të VSHB-së së qarkut për vitin 2015, ndërsa sektorët e tjera kanë vlera më të ulëta në raport me VSHB totale të qarkut. Si sektor terciar është sektori industrial ku në territorin e Bashkisë Lezhë zhvillojnë aktivitetin ekonomik mjaft biznese siç janë fabrikë këpucësh, fabrikë çimento, fabrikë e re tullash, si dhe fabrika e përpunimit të peshkut.

TABELA 19- Ndërmarrjet Aktive në Qark sipas Peshës në Raport me Nivelin Kombëtar në %

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Lezhë	2.8	2.8	2.8	2.9	3	3.2	3.5
Shqipëria	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: INSTAT, 2019

Një faktor tjetër i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik është edhe numri i bizneseve në qark në raport me numrin e bizneseve në nivel kombëtar. Duke u bazuar tek tabela e mësipërme mund të themi se vërehet një tendencë rritjeje e numrit të bizneseve në raport me nivelin kombëtar gjë që tregon që niveli i zhvillimit ekonomik në Lezhë ka tendencë të rritet.

TABELA 20- Aktivitete Ekonomike sipas Sektorit dhe Njësive Administrative

Njësia Administrative	Balldren	Blinisht	Dajç	Kallmet	Kolsh	Lezha	Shëngjin	Shënkollë	Ungrej	Zejmen
Bujqësi peshkim	0	4	0	0	0	6	35	6	0	0
Industri	8	0	6	9	4	93	19	7	0	18
Ndërtim	0	0	0	0	0	54	9	4	0	4
Tregëti	42	19	23	18	15	394	97	47	0	32
Shërbime	27	11	13	12	15	414	116	51	9	30
Total	77	34	42	39	34	961	276	115	9	84

Burimi: Bashkia Lezhë dhe UTS-1, 2016

Numri më i madh i aktiviteteve ekonomike është përqendruar në njësitë Lezhë, Shëngjin dhe Shënkoll, ndërsa njësi me më pak aktivitete ekonomike paraqitet njësia administrative e Ungrejit. Përsa i përket njësisë administrative Lezhë, veprimtaria e secilit sektor të bizneseve është paraqitur në tabelën e mësipërme. Ajo që vihet re është mungesa e aktivitetit të subjekteve bujqësore dhe një numër shumë i vogël i subjekteve ndërtuese. Sektori i industrisë ka patur luhatje shumë të mëdha në vite, duke shënuar kulmin në vitin 2009 dhe pikën më të ulët në 2014. Numri i bizneseve në sektorin e shërbimeve luhatet nga 150 në 225. Ajo që dallon nga situatat e tjera, është rritja e shpjetë e numrit të bizneseve në sektorin tregtar nga viti 2006 në vitin 2010. Pas këtij viti, numri i subjeteve në sektorin tregtar ka patur luhatje të vogla, duke shënuar pikën më të lartë në vitin 2012 dhe atë më të ulët në 2013.

3.2 Bujqësia në Bashkinë Lezhë

Sektori i bujqësisë është kontribuesi më i madh në ekonominë e rajonit. Pavarsisht se ky sektor mbetet jo i mirë-menaxhuar, rreth 60 % e popullsisë në Bashkinë Lezhë jeton në fshat dhe merret kryesisht me bujqësi por ky trend ka tendencë të ulët pra numri i popullsisë rurale është në tkurrje në raport me atë urbane. Fshatarët përdorin tokën kryesisht për të plotësuar nevojat e përditshme; vetëm disa prej tyre përdorin sera. Toka bujqësore është mjaft pjellore me rendimente të larta të produktivitetit. Para viteve nëntëdhjetë, toka bujqësore u drenazhua nga një sistem i menaxhuar mirë, i përbërë nga kanale nëntokësore, kanale të kullimit, stacione të pompimit, system ky që lidhej me lumenjtë e zonës. Ky sistem tashmë është mjaft i dëmtuar dhe situata është pothuajse kritike.

Pavarësisht produktivitetit të lartë dhe kushteve klimatike shumë të favorshme zhvillimin e bujqësisë, territori i kësaj bashkie po përballet vitet e fundit me probleme të përmytjes që po ndodhin rregullisht pothuajse çdo vit, duke i shkaktuar mjaft dëme këtij sektori. Ky rrezik natyror ka shkaktuar ulje në prodhimin e tokave bujqësore, duke i bërë ato më pak pjellore dhe dekurajimin e fermerëve për të kultivuar atë. Lezha ka 18,496 hektarë tokë bujqësore, 19,256 ha pyje, 5,110 Ha Kullota dhe 7169 Ha toke inproduktive (joepunueshme). Toka bujqësore në zonë përfaqëson 53% të tokës bujqësore në të gjithë qarkun dhe 3 % në nivel vendi. Deri tani sipërfaqja e tokës bujqësore në zonë është e copëzuar dhe një fermer (familje), disponon mesatarisht 0.75 ha tokë. Ky tregues është mbi mesataren e qarkut prej 0.6 ha për fermer (familje). Tre janë njësitë në Bashkinë Lezhë me më pak se 1 ha tokë për familje dhe gjashtë të tjerat kanë një madhësi toke ndërmjet 1-2 hektarë. Këta janë tregues shumë të ulët për të mundësuar prodhimin në masë, intensive dhe të mekanizuar të një ferme.

TABELA 21- Numri i Fermave sipas NjA

Njësitë administrative	Numri i fermave
Lezha	-
Shëngjin	880
Zejmen	1850
Shënkollë	3100
Ballëdren	1620
Kallmet	1350
Blinisht	1297
Dajç	1360
Ungrej	290
Kolsh	1470
Total	13217

Burimi: Bashkia Lezhë dhe UTS-1, 2016

Bujqësia është një nga sektorët tipikë e tradicionalë pothuajse në të gjitha njësitë e zonës, por sidomos në njësi të tilla si Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Zejmeni e Shënkollli. Ky mbetet një sector që përbën një burim të qëndrueshëm të të ardhurave për banorë të zonës. Për më tepër, bujqësia mbetet një sector prioritar edhe në nivel kombëtar. Ajo i ka njohur një rritje prej 18,4% në vitet 2007-2011.

Zona e Lezhës dallohet për prodhimtarinë qoftë të bimëve të arave po ashtu edhe pemëtarisë. Struktura e mbjelljeve me bimë arash sip.sh. drithëra buke (grurë e misër), perime (të njoma, të thata, bostane), patate, fasule, kultura industrial (soje) dhe foragjereje, etj.

Tabela e prodhimtarisë së kulturave bujqësore më poshtë tregon se Lezha ka prodhimtarinë më të lartë sa i përket drithërave të bukës në nivel rajoni (70%). Edhe prodhimi i perimeve dhe foragjereve është i rëndësishëm duke qenë se përfaqëson rreth gjysmën e prodhimtarisë rajonale (përkatësisht 53 % për perimet dhe 50 % për foragjeret). Në raport me nivelin kombëtar prodhimtaria varion nga 1% për fasulen dhe pataten, në 2% për perimet, 3% për drithërat dhe deri në 4% për foragjerët.

TABELA 22- Prodhimi sipas Kulturave në Ton

Njësitë administrative	Drith buke	Perime	Patate	Fasule	Kultura industriale	Bimë medicinale	Foragjere
Lezha	-	-	-	-	-	-	-
Shëngjin	1185	1752	162	50	-	1	13829
Zejmen	2973	1655	308	42	-	-	17620
Shënkollë	4427	2307	476	72	-	-	59440
Balldren	4540	5059	288	73	-	-	42005
Kallmet	2680	1132	300	60	-	-	24860
Blinisht	2825	1769	135	60	-	1	25300
Dajç	5590	4238	320	32	1	-	50892
Ungrej	459	325	72	9	-	-	2900
Kolsh	303	1175	15	18	-	1	12250
Total	24317	18474	2076	374	1	4	232629

Burimi: Bashkia Lezhë dhe UTS-1, 2016

Blinishti dhe Dajçi janë studiuar edhe në raport me zonën e Zadrimës. Përsa i përket prodhimtarisë bujqësore në Blinisht, pjesën më të madhe (69%) e zenë foragjeret, por ka gjithashtu edhe misër, grurë e vreshta. Në Zejmen, toka pjellore, klima e favorshme dhe eksperiencia e fermerëve kanë sjellë shtimin e prodhimit të drithërave të bukës (grurë e misër), vreshtarisë dhe frutikuturës. Shtimi i prodhimeve bujqësore është shoqëruar me shtimin e pikave të grumbullim-përpunimit si dhe me sigurimin e tregut për shitjen e tyre. Prodhimet tipike të zones janë; shalqi, patate, mjaltë, luledielli, drithëra buke. Prodhohet rreth 1,472 ton grurë, 1000 ton misër, 26,480 ton foragjere, 75 ton patate, 24 ton fasule, 58 ton fruta dhe 560 ton prodhim vreshtash. Balldreni njihet në prodhimin e drithërave dhe lulediellit, ndërkohë që fusha e Torovicës është e njohur për prodhimin e perimeve.

3.3 Turizmi

Sipas analizës së mësipërme të sektorëve të zhvillimit ekonomik në Bashkinë e Lezhës, sektori i turizmit ka gjithnjë tendencë rritjeje. Në terma ekonomikë kombëtarë, kontributi i turizmit në vlerën e shtuar, ka ndjekur prirje rritëse duke filluar prej vitit 2013. Në terma sasiorë, industritë turistike kontribuan me rreth 32.2 miliard lekë në totalin e vlerës së shtuar në vitin 2017, në rritje

me rreth 15.2% në terma vjetorë (Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2019). Krahas kontributit në vlerën e shtuar në ekonomi, sektori i turizmit potencialisht mund të kontribuojë në mënyrë të qenësishme në nivelin e punësimit dhe përmirësimin e mirëqenies në ekonomitë lokale. Të dhënat tregojnë se përgjatë vitit 2016 industrinë turistike punësuan rreth 30 mijë persona, numër ky rreth 41.3% më i lartë krahasuar me vitin 2015. Për vitin 2016, në industrinë turistike çdo i punësuar shërben rreth 158 shtetas të huaj, raport ky në përmirësim nga niveli prej 94 shtetas të huaj për të punësuar në vitin 2015.

Bazuar në të dhënat më të fundit të disponueshme, numri i njësive akomoduese⁷ në Shqipëri rezulton të jetë dyfishuar duke filluar nga viti 2012. Konkretisht, nga rreth 632 struktura akomoduese në vitin 2012, në vitin 2016 regjistroi rreth 1,242 të tilla. Gjatë kësaj periudhe në vend ishin funksionale rreth 17,692 dhoma, dhe rreth 41,376 shtretër në total. Kapaciteti akomodues rezulton në rritje dhe për vitin 2016 ishte 14.4 shtretër për 1,000 banorë ose 1 shtrat për 112 shtetas të huaj (me net qëndrimi) (Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2019).

TABELA 23- Struktura Akomoduese në Bashkinë Lezhë

Tipologjia	Bashkia Lezhë		
	St. Akomoduese	Nr. Dhomave	Kapaciteti
B&B	-	-	-
Kamping	1	34	68
Bujtina	7	49	98
Shtëpi Pushimi	2	15	48
Hostel	-	-	-
Hotel	108	1365	3168
Kompleks Turistik	2	45	135

Burimi: (Bashkia Lezhë, UTS-01, 2016)

Bashkia Lezhë ka një kapacitet prej 3,517 personash në 120 struktura të deklaruara. Bie në sy numri i lartë i hoteleve (108) ku mund të akomodohen 3,168 turistë në 1,365 dhoma. Në Lezhë ndodhen gjithashtu 7 bujtina, 1 kamping, 2 shtëpi pushimi dhe 2 komplekse turistike.

3.4 Arsimi

Në Bashkinë Lezhë ndodhen 128 objekte arsimore nga të cilat 114 janë publike dhe 14. Arsimi parashkollor ofrohet nga 47 kopshte dhe çerdhe, nga të cilat 8 janë private. Shpërndarja e kopshteve dhe çerdheve publike nëpër njësitet administrative është si vijon: 4 ndodhen në njësitet administrative Balldren, 3 në Blinisht, 1 në njësitet administrative Dajç, 1 në njësitet administrative Kallmet, 3 në njësitet administrative Kolsh, 3 në njësitet administrative Lezhë, 4 në Shëngjin, 4 në Shënkoll, 2 në Ungrej dhe 4 në njësitet administrative Zejmen. Përsa i përket kopshteve dhe çerdheve private, ato janë të shpërndara nga 1 në njësitet administrative Balldren dhe Blinisht dhe 6 në njësitet administrative Lezhë.

Përsa i përket arsimit para-universitar, ndodhet nga një shkollë e mesme publike në njësitet administrative Balldren, Blinisht, Dajç, Kallmet, Shëngjin, Shënkoll dhe Zejmen dhe 2 në njësitet administrative Lezhë. Shkolla të mesme private janë 4 dhe ndodhen në njësitet administrative Lezhë.

⁷ Me struktura akomoduese nënkuptohen: hotele, motele, kampe, streha malore, bujtina dhe struktura të tjera për qëndrime afat-shkurtra.

TABELA 24- Institucione Arsimore në Bashkinë Lezhë

Përshkrimi	Publike	Private	Total
1. Institucione	114	14	128
1.1 Kopshte	47	8	55
1.2 Shkolla 9-vjeçare	55	4	59
1.3 Shkolla të mesme të përgjithshme	11	2	13
1.4 Shkolla të mesme profesionale	1	0	1
2. Numri i klasave(ambjenteve)	588	75	663
2.1 Kopshte	81	20	101
2.2 Shkolla 9-vjeçare	394	42	436
2.3 Shkolla të mesme	113	13	126

Burimi: (Bashkia Lezhë, UTS-01, 2016)

Në qytetin e Lezhës, nga viti 2003 ofrohet edhe edukim profesional me profile kryesore ekonomi-biznes, administrim zyre, TIK, anglisht-frengjisht dhe drejtimi pedagogjik.

3.5 Shëndetësia

Shërbimi shëndetësor në Bashkinë Lezhë ofrohet nga shërbimi shëndetësor parësor dhe ai spitalor. Shërbimi shëndetësor parësor i specializuar mbulon shërbimin e mjekut të familjes, shërbimin pediatrik, konsultor të nënës dhe fëmijës, kardiologji, mikrokirurgji, shërbim minilaboratorik, si dhe shërbim urgjence mjekësore.

Në njësinë administrative Lezhë, ndodhen 2 spitale. Spitali rajonal, i ndodhur në qytetin e Lezhës ofron shërbime në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri, reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Në këtë spital janë 35 mjekë të specializuar, 104 infermierë, 17 staf mjekësor (laborant, farmacist) dhe 100 veta personel ndihmës. Spitali ka 162 shtretër dhe gjatë vitit 2013, numri i pacientëve të shtruar është 7031. Nga pikëpamja territoriale, qendrat institucionet e kujdesit shëndetësor dhe ato arsimore janë shpërndarë si më poshtë:

73- Shpërndarja e Institucioneve të Kujdesit Shëndetësor dhe Arsimor në Lezhë



Burimi: (Bashkia Lezhë, UTS-01, 2016)

4 INFRASTRUKTURA

4.1 Infrastruktura Rrugore

Bashkia Lezhë shtrihet në një pozicion gjeografik të favorshëm për sa i përket infrastrukturave të transportit rrugor ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Kjo bashki ndodhet 64 km larg kryeqytetit të vendit (Tiranës), 47 km larg aeroportit më të madh të vendit (Rinas) si dhe 69 km larg portit më të madh të vendit (Durrësit) . Përsa i përkte lidhjes në veri është 39 km larg Shkodrës. Një nga itinerarët më të rëndësishëm që pritet të ndërtohet dhe të kaloj në periferi (në pjesën perëndimore) të qytetit të Lezhës është:

- Autostrada Adriatiko- Joniane ose Korridori i Kaltër me gjatësi 194.5 km dhe me vlerë 698 milion Euro. Ky segment nuk ka qënë pjesë e hartës së vitit 2015 pra është një nga prioritetet e vitit 2016 .. Korridori i Kaltër fillon në Trieste të Italisë dhe përfundon në Kallamata të Greqisë. Në pjesën Shqipëtare ky korridor kalon në rrugët Shtetërore (SH1 dhe SH4). Nga Hani i Hotit në veri ai kalon në Shkodër, Milot, Fushë-krujë, Vorë, Durrës, Mbrostar, Fier, Levan. Nga Levani kalon për në Tepelenë, Gjirokastër, në pikën kufitare të Kakavijës dhe përfundon në Kallamata (ACP, 2014).

Si pjesë e këtij korridori mund të përmendim Autostradën Thumane- Milot (A1) e cila ka sjellë një impakt pozitiv në uljen e distancës në kohë të Bashkisë së Lezhës me Tiranën dhe Durrësit si dhe Aeroportin e Tiranës. Përsa i përket infrastrukturës kombëtare, në këtë bashki kalon Rruga Shtetërore 1 (SH1) e cila fillon në Tiranë dhe përfundon në Shkodër . Kjo rrugë është 135 km e gjatë. Ky itinerar është pjesë dhe në rrugët Europiane E760 dhe E851. Analiza e infrastrukturës rrugore bazuar te Kodit rrugor i Republikës së Shqipërisë, vlerëson se në Bashkinë Lezhë ka 1216.2km rrugë lineare.

Nga tabela e mësipërme, shohim që shtrirjen më të vogël e zënë rrugët urbane dytësore që ndodhen në qytetin e Lezhës me 10.7 km linear. Ndërsa shtrirjen më të madhe e zënë rrugët lokale, me 1068.1 km linear, të cilat shtrihen në

periferi të qytetit dhe mbizotërojnë në njësitë administrative që kanë karakter rural. Rrugët interurbane dytësore zënë 126.2 km dhe janë shumë të rëndësishme për lidhjen më bashkitë kufitare dhe më tej. Rrugët me karakter rural që shtrihen në periferi të qytetit janë më të prekura nga permbytjet, kryesisht në pjesë perëndimore.

TABELA 25- Infrastruktura Rrugore e Bashkisë Lezhë Sipas Kodit Rrugor

Gjatësia e rrugës (km)	Ekzistuese
Autostradë	10.8
Rruge interurbane dytësore	126.2
Rruge urbane kryesore	0.4
Rruge urbane dytësore	10.7
Rrugë lokale	1068.1
Total	1216.2

Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

FIG 74- Lezha në Raport me Korridoret Kryesore Kombëtare e Rajonale



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

FIG 75- Hierarkia e Sistemit Rrugor



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

FIG 76- Hierarkia e Sistemit Rrugor sipas Kodit Rrugor në Qytetin Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)


Në analizën e infrastrukturës rrugore sipas kodit në qytet mbizotërojnë rrugët urbane dytësore që kanë një gjerësi 8-10 metra. Vetëm një rrugë është urbane kryesore që është e ndarë me trafik ndarës dhe ka një gjerësi 13- 17 metra. Rrugët e tjera që kanë një gjerësi deri në 7 metra janë rrugë lokale.

Gjendja e infrastrukturës rrugore

Kjo analizë merr në konsideratë edhe gjëndjen fizike të infrastrukturës, në aspekt të cilësisë së shtrimit, pranisë së trotuareve, sinjalistikës, etj. Nga ky evidentim rezulton se në Bashkinë e Lezhës vetëm 247.9 kilometra rrugorë janë të shtruar dhe 968.3 kilometra janë të pashtuar pra afërsisht 20 % e totalit të infrastrukturës rrugore. Kjo ndodh për arsye se pjesa më e madhe e rrugëve janë rrugë lokale, pra rrugë në të cilat nuk janë bërë shumë investime. Kjo analizë bëhet akoma më e

rëndësishme në rastin e Bashkisë së Lezhës dukë parë që ka një problematik të rëndësishme sic është përmytja, e cila shkakton dëme në infrastrukturën rrugore dhe kërkohet që investimet në të ardhmen të kenë parasysh këtë problem thelbësor. Rrugët e pashtuara përbëjnë problem akoma

Fig 77- Cilësia e Infrastrukturës Rrugore Bashkia Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Fig 78- Cilësia e Infrastrukturës Rrugore Bashkia Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

më të madh kur përmytjen sepse mund të kemi rreshqitje të dherave dhe bëhen të pakalueshëm për banorët e këyre zonave për një kohë akoma më të gjatë se në rrugët e shtruara me asfalt.

Gjendja e infrastrukture rrugore në qytet është e mirë ku rrugët janë të asfaltuara sidomos brënda unazës së qytetit. Në pjesën perëndimore ku terreni është i thyer jo të gjitha rrugët janë të shtruara dhe përbëjnë problem për banorët që jetojnë në këto zona.

4.2 Infrastrukturat Kritike

Sa i përket infrastrukturave pikësore problematike kemi ura të cilat në të shumtën e rasteve janë të amortizuara këto ura zakonisht ndodhen përgjatë aksit rrugor Pllanë-Manati-Lezhë ka edhe ura te cilat përveç probleme të amortizimit kanë dhe probleme me sasinë e ujit që mund të kalojë në hapsirat poshtë saj. Në shumë raste këto ura behen dhe shkaktare te permytjeve në zona te caktuara si pasoje e këtij problemi dhe këtu permendim urën e aksit kryesor Milot-Lezhë në urëm mbi kanalin kullues kryesor shfaq këtë problem. Si infrastuktura të tjera problematike kemi edhe pika të cilat bashkohen dy trupa ujorë të kanaleve kulluese dhe vaditëse ku shfaqin probleme me mirembajtjen dhe pastrimine tyre.

Nga analiza e infrastrukturës rrugore në Bashkinë Lezhë mund të arrihet në konkluzionet e mëposhtme:

- Bashkia e Lezhës shtrihet në një pozitë gjeografike mjaft të rëndësishme duke parë infrastrukturat ndërkombetare dhe kombëtare që kalojnë në këtë bashki.
- Infrastruktura rrugore në këtë bashki zë 1216.2 km linear ku afërsisht 80 % e mbulojnë rrugët lokale.
- Rrugët bujqësore zënë 45 % të infrastrukturës rrugore dhe shtrihen në ultësirën perëndimore. Bujqësia është një potencial mjaft i rëndësishëm i cili nuk shfrytëzohet në maksimum sepse banorët kanë frikë të investojnë sepse përmytjet janë një fenomen me rrezik të lartë në këtë bashki duke parë që disa zona ndodhen nën nivelin e detit
- Në qytet mbizotërojnë urbane kryesore, urbane dytesore dhe urbane lokale që në nivel bashkie nuk zënë një rol të rëndësishëm (1.7 % të të gjithë infrastrukturës rrugore).
- 20 % e infrastrukturës rrugore është e shtruar me asfalt ku mund të përmendim rrugën nacionale si dhe rrugët qe ndodhen në qytet. 80 % e infrastrukturës përbën problem për zhvillimin normal të qarkullimit duke parë dhe rrezikun e përmytjeve kryesisht në periudhën e dimrit.

4.3 Infrastruktura Ujësjiellës Kanalizime

Furnizimi me Ujë

Rjedhjet kryesore ujore të Bashkisë Lezhë janë Lumenjt Drin i Lezhës, Gjadër dhe Mat si dhe Përrenjt kryesor të Manatisë dhe Vomës. Vlen të përmendim se zona e bregut të Matit dhe furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Lezhës, Shëngjinit, si edhe të gjithë fshatrat e fushës. Rezervat ujore të llogaritura janë rreth 2500 l/sek. Në këtë fushë janë shpuar shumë puse, të cilët me vetërrjedhje japin prurje nga 10 - 60 l/sek të cilat përdoren edhe për vaditjen e tokës bujqësore. Pellgu përfshihet nga depozitimet ujëmbledhëse zhavorrore me trashësi që rritet në drejtim të lumit Mat, deri në 180 - 200 m. Ato janë të mbuluar me një mbulesë argjilore dhe subargjilore me trashësi 45 - 50 m.

Furnizimi i një pjese të konsiderueshme të popullatës me ujë të pijshëm bëhet nga gurra dhe burime, kjo kryesisht në zonën veri-lindore të Lezhës. Pavarësisht ndërhyrjeve të kryera në pjesë të veçanta të tij, rrjeti shpërndarës i ujit të pijshëm në gjithë territorin e Bashkisë Lezhë paraqitet i amortizuar (periudhë gati 50 vjeçare shfrytëzimi) dhe nuk është i shtrirë në të gjitha zonat e banuara. Furnizimi kryhet nga Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime sh.a nga burimet kryesore në Barbullojë, ku ndodhet edhe stacioni i pompimit i përbërë nga katër pompa. Sistemi, përveç rrjetit të jashtëm, përbëhet nga dy rezervuarë secili me kapacitet 4,000m³ dhe prurja maksimale e prodhuar është 400 l/sek. Në qytetin e Lezhës aktualisht është kryer një investim nga KFV për modernizimin e sistemit të furnizimit me ujë, si dhe kanalizimet. Ky projekt do nisë investimet në zonat rurale, si Kallmet, në periudhën 2020-2021.

Rreth 60 % e njësive ekonomike familjare të Njesisë Administrative Shengjin janë me ujë brenda në banesë, ndërsa 27,4% janë me ujë jashtë banese dhe 12,6% furnizohen me puse ose çisternë. Në rreth 15% njësi ekonomike familjare mungon furnizimi me ujë, nga këto 90% njësi ekonomike familjare janë në fshat. Në Shëngjin ka zona që furnizohen me 10 orë ujë në ditë, por në periudhën e nxehtë të verës, uji është mjaft problem, sidomos për qytetin e Shëngjinit (2 orë në dite).

Në zonat urbane, numri i banesave me ujë brenda është 2 herë më i lartë se në zonat rurale. Numri i banesave me ujë jashtë në zonat rurale është 3 herë më i madh se në zonat urbane. Në Ishull Lezhë dhe Ishull Shëngjin më pak se gjysma e fshatrave kanë akses në shërbimin me ujë të pijshëm (një pjesë e tyre me lidhje të paligjshme në rrjet). Duhet theksuar se popullsia me akses në trajtimin e ujit të pijshëm përbën rreth 29,62 % të popullsisë në zona urbane dhe 20% në zonë rurale, që mbulohet nga ujësjellësit urbanë apo ruralë, pra në total rreth 49.62% e popullsisë. Pjesa tjetër e popullsisë furnizohet me burime natyrore apo shpime të vogla.

Kanalizimet

Në qytetin e Lezhës, kanalizimet janë pjesërisht të dëmtuara si pasojë e ndërhyrjeve të kryera nga ndërtimet pa leje. Në zonën e qendrës dhe përgjatë lumit, një pjesë e tyre janë të bllokuara ku në periudhën e shirave çojnë në përmbytje. Kanalizimet nga Varrezat e dëshmorëve deri tek Obelisku, përgjithësisht janë rehabilituar, por ekziston nevoja e një studimi të përgjithshëm, që do të parashikonte ridimensionimin e rrjetit, linja shtesë, dhe lidhjen me impiantin e trajtimit të ujërave urbane të ndërtuar në Shengjin (impiant biologjik), prej nga ujërat e trajtuara do të derdhen në lagunën e Merxhanit.

Shëngjini ka një sistem ujrash të zeza të sistemuar me kolektor rreth 2 km, projekt i financuar prej Bankës Botërore (2005) i cili plotëson nevojat e 50% të popullsisë së zonës. Për shkak të nivelit të ulët të tij derdhja e ujrave të zeza kryhet nëpërmjet një stacioni pompimi nëntokësor në Knallë ku sasia e ujërave të zeza arrin në 380 m³/ditë. Kjo zgjidhje mendohet të ketë ndikime negative për faunën dhe florën e kësaj zone. Pjesa veriperëndimore e Shëngjinit derdh ujrë të zeza nëpërmjet një kanali të mbyllur drejtpërsëdrejti në det (pranë portit), ndërsa pjesa sipër marinës bën derdhjen e ujrave të zeza në përroin që rrjedh në pjesën veriperëndimore, sipër depove të karburantit dhe derdhet në det, në pjesën e portit. Ky përrua ka ujë vetëm në sezonin e vjeshtës dhe të dimrit, ndërsa pjesën tjetër të vitit ai krijon shumë probleme për banorët e kësaj zone nga era e keqe dhe derdhjet e ujrave të përpunimit të peshkut nga Kompania " Rozafa ". Ujërat e ndotura urbane shkarkojnë në ujërat sipërfaqësore 98 % të NBO (Nevojës Biologjike për Oksigjen). Përbërja e ujërave të zeza të Shëngjinit është tipike për shkarkime të këtij lloji, por ngarkesa organike dhe lëndët ushqyese janë në nivele më të ulëta se ato të vendeve të tjera evropiane.

Infrastruktura e sistemit të ujërave të zeza në zonat rurale mungon, në 90 % të rasteve grumbullimi bëhet në gropa septike apo në qendra të vogla, që derdhen në lumin Drin apo kanale të hapur. Në fshatrat Ishull Lezhë dhe Ishull Shëngjin, ujrë të zeza përfundojnë në kanale kullues dhe nëpërmjet tyre ose në lumin Drin ose nëpërmjet hidrovorit të Tales dhe atij të Ishull Shëngjinit derdhen në det. Pjesa fushore mbetet më problematike, ku niveli i ujërave nëntokësore është i lartë, (sidomos pjesa afër kënetave) dhe sistemi i këtyre ujërave del në sipërfaqe pas ngopjes së tokës apo pas shirave të rënë. Mungesa e trajtimit të ujërave urbane (mosvenia në funksionim e impiantit në rastin e Lezhës dhe Shengjinit), përdorimi i të ashtuquajturave gropa septike në zonat rurale, rritja e shkallës së ndotjes së ujërave sipërfaqësore në liqenin e Knallës dhe në ujërat detarë të plazheve, vazhdojnë të japin një impakt negativ si mbi mjedisin ashtu edhe mbi shëndetin njerëzor, duke u bërë pengesë edhe për zhvillimin e resurseve ekonomike, kryesisht të turizmit në Nashkinë e Lezhës.

4.4 Infrastruktura Energji

Bashkia Lezhë furnizohet me energji elektrike nga linja 110 kV e transmetimit (Vau Dejes, Fierze, Shkopet). Konsumi vjetor i energjisë elektrike për qytetin në vitin 2015 ishte 35.4 GW/h. Shërbimi i furnizimit është i vazhdueshëm gjatë 24 orëve për qytetarët dhe bizneset. Infrastruktura kryesore që furnizon me energji elektrike zonën e Lezhës është:

- Nestacioni 110/10kV i Lezhës furnizohet nga dy linja 110kV.
- Nga linja L-110-8/1 (5.6 + 19.8km =25.4km) me seksion percjellsac AÇ-95mm² + AÇ-120mm² te cilat degezohen per nestacionet Bushat i ri dhe Bushat i vjeter. Këto linja e lidhin kete nenstacion me HEC Ashte dhe Vau i Dejes.
- Ndersa ne krahun jugor ky nestacion furnizohet nga linja L-110-7 e cila e lidh me HEC Shkopet nepërmjet zbarave të nestacionit 110kV Laç 2.

Nestacioni i Lezhës është i përbërë nga dy transformator 20MVA 110/10kV. Kapaciteti total i ketij nestacioni eshte 40MVA. Ky nestacion eshte ndertuar ne vitin 1964. Edhe pse gjatë ketyre viteve rimontet dhe shërbimet ndaj këtij nënstacioni kanë qenë të pamjaftueshme. Problematikat e furnizimit me energji në TL për shkak të ndërtimit të tij në ultësirë, ka bërë që nënstacioni te përmytetet disa herë nga vërshimet e ujrave duke bërë që energjia elektrike të ndërpritet për arsye sigurie. Kjo ka shkaktuar mungesë enegjie për kohë të gjatë në këtë qytet edhe pse janë marrë masa provizore për ndalimin e vërshimit të ujrave kjo rrezikshmeri qendron ende.

Furnizimi me energji elektrike TM

Rrjeti TM që furnizon qytetin e Lezhës nis nga nënstacioni 110/10kV ku janë lidhur të gjithë fiderat që furnizojnë qytetin dhe periferinë e tij.

Kryesisht këto linja janë ajrore me përcjellsa alumini të cilat janë tejet të ngarkuara dhe si pasojë në pikat fundore të konsumatorve shfaqen lehtë problemet e rënies së tensionit. Problem i cili shkakton mosfukcionim optimal të pajisjeve elektrike. Problem dytësor me linjat e ngarkuara janë dhe humbjet teknike në rrjet që vijnë si pasojë e mbingarkimit të ketyre linjave.

Linjat e tensionit të mesëm përbehen në 16 fidëra nga të cilat pjesa dermuese është me linjë ajrore. Këto linja në shumicën e rasteve janë demtuar fizikisht dhe në shumë pjesë të qytetit intersektohen me rrugë, godina banimi si dhe me linja të tjera të rrjetit elektrik. Për shkak të nivelit të tensionit aktual 10kV të linjave ajrore të ngarkuara vihen re humbje të tensionit në TM që në momente piku kalojnë 10% ΔU problem që i shtohet dhe humbjeve të tensionit në TU.

Po kështu problemet e mësipërme kanë dhe anën negative të tyre ëe cilat janë humbjet teknike në rrjet. Këto humbje qe llogariten rreth 22%, kanë dhe koston financiare të tyre.

Gjendja aktuale e linjave ajrore paraqitet në kushte të këqija dhe jashtë normave të sigurimit teknik. Në shumë pjesë të trakteve të linjave vihen re kurora bimësh që kalojnë distacën e sigurisë me linjat elektrike, gjithashtu godina banimi shumë afër me këto linja, shtylla të dala nga qendra e rëndesës si dhe izolator të shumëllojshëm për të cilat karakteristikat teknike elektrike dhe mekanike janë të ndryshme. Në vitin e fundit ka patur disa investime dhe plane për përmirësimin e rrjeti elektrik nga Ministria e Energjitikës si dhe OSHE. Investimet parashikojnë të prekin NS 110/10kV si dhe zonën e Shëngjinjit. Kryesisht përmirsimet prekin rrjetin e transmetimit, kabinat elektrike dhe intgrimin e TM 20kV.

Furnizimi me energji elektrike TU

Ashtu si dhe rrjeti i TM dhe rrjeti elektrik i TU është tejet i amortizuar dhe i ngarkuar. Shumica e ketyre linjave perbehen nga linja ajrore me percjelles alumini te shveshur.

Pergjat trakteve te ketyre linjave vihen re lidhje dhe degezime jash kushteve teknike si dhe perdorimi i materjaleve rrethore apo produkte te pa standartizuara per te tilla rrjete.

Probleme kryesore hasin zonat periferike, sic u tha dhe mesiper, duke nisur qe nga humbjet e TM ne transmetim deri ne kabine elektrike. Shtimi i konsumatoreve ka cuar ne nje mbi ngakese te ketyre kabinave sidhe demtimet elektrike te transformatoreve nga faktore elektrik nuk kane gene te ralla. Mos standartizimi i rrjetit transmetues ne TU here pas here eshte bere dhe burim aksidentesh dhe nderhyrjesh te pa ligjshme ne rrjet.

Vihet re diversitet tipologjie produktesh qe perbejne rrjetin shperndares duke nisur qe nga standarti shqiptar (pjesa qe ka ngelur nga rrjeti i trasheguar), produkte te standartizuara nga Europa lindore si dhe produkte EC. Xhuntimet dhe nderhyrjet ne linja jane jashte kushteve teknike ne kontakt me agjentet atmosferik.

4.5 Infrastruktura në shërbim të bujqësisë dhe përbalimin e përmbytjes

Infrastruktura bujqësore luan nje rol kryesor në parandalimin e përmbytjes së tokave bujqësore dhe shtëpive të banimin në afërsi të këtyre tokave në Bashkinë Lezhë. Kjo Infrastrukturë paraqet problematike veta sa i përket mirembajtjes dhe rehabilitimit të tyre. Infrastrukturat bujqësore të kullimit përfshihen: Rezervuarët, Kanalet Kulluese dhe Vaditëse, Argjinaturat mbrojtëse dhe Hidrovoret.

Rezervuarët

Sa i përket Rezervuarëve në Bashkinë Lezhë si dhe gjendjes së tyre janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

TABELA 26- Gjendja e Rezervuarëve në Bashkinë Lezhë

Emri i Rrezervuarit / Digës	Viti i ndërtimit	Treguesit e digës		Vëllimi i projektuar 1000 m ³	Vëllimi faktik (mbushjen me aluvione) në 1000 m ³	Sipërfaqe e kupës ne 1000m ²	Sipërfaqja që ujitet në projekt në Ha				Gjendja e Digës/ rrezervuarit
		Lartësia (m)	Gjatësia (m)				Gjithsej	Rrjedhje të lirë	Me pompa	Sip faktike	
Kallmet	po/1969	17.5	1025	2044	2000	384	820	700	120	340	E mirë
Fishtë	1972	9.5	240	440	420	160	130	130		80	E dobët
Troshan	1970	5.4	110	60	45	60	20	20		20	Mesatare
Petalaj	1974	12.7	225	110	80	34	20	20		20	E dobët
Kashnjet	1972	11	100	428	428	37.5	120	120		60	Mesatare

Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (2017), përpunuar nga autorët

Rezervuari Kallmet: Ndërtuar në vitin 1969 dhe ndodhet në territorin Njësisë Administrative Kallmet, me kapaciteti ujëmbledhës 2,040,000 m³, lartësi të diges 17.5 m, gjatësi të kurorës 1,025 m, sipërfaqe të kupës 384,000m². Në përgjithësi gjendja teknike e rrezervuarit është e mirë po ka probleme me funksionimin e ujëlëshuesit. Popullata që rrezikohet nga përmbytja poshtë diges është rreth 250 familje, sëbashku me banesat dhe pasuritë e tyre.

Rezervuari Fishtë: Ndërtuar në vitin 1972 dhe ndodhet në territorin e Njësis Administrative Blinisht, me kapacitet ujëmbledhës 430.000 m³, lartësi të diges 9.5 m, gjatësi të kurorës 240

m, sipërfaqe të kupës 160.000 m². Gjendja e tij teknike paraqitet e amortizuar me probleme të shumta. Popullata që rrezikohet nga përmbytja poshtë digës është rreth 50 familje, sëbashku me banesat dhe pasuritë e tyre.

Rezervuari Troshan: Ndërtuar në vitin 1970, ndodhet në teritorin e Njesis Administrative Blinisht, me kapacitet ujëmbledhës 60.000m³, lartësi të digës 5.4 m, gjatësi të kurores 110m, sipërfaqe të kupës 60.000m². Diga është në kushte jo të mira teknike, saraçineska e lëshimit të ujit është në gjendje jo të mirë, shkarkuesi është i bllokuar Popullata që rrezikohet nga përmbytja poshtë digës është rreth 80 familje, sëbashku me banesat dhe pasuritë e tyre.

Rezervuari Patalej: Ndërtuar në vitin 1974 dhe ndodhet në teritorin e Njesis Administrative Kolsh, me kapacitet ujëmbledhës 60.000 m³, lartësi të digës 12.7 m, gjatësi të kurores 100 m, sipërfaqe të kupës 34.000 m². Diga është në gjendje të amortizuar teknike. Vepra e lëshimit të ujit është dëmtuar, nuk ka shkarkues katastrofik. Popullata që rrezikohet nga përmbytja poshtë digës është rreth 150 familje, sëbashku me banesat dhe pasuritë e tyre.

Rezervuari Kashnjet: Ndërtuar në vitin 1972 dhendodhet në teritorin e Njesis Administrative Ungrej, me kapacitet ujëmbledhës 428.000 m³, lartësi të digës 11m, gjatësi të kurores 225m, sipërfaqe të kupës 375.000 m². Diga është në gjendje pjesërisht të mirë teknike. Popullata që rrezikohet nga përmbytja poshtë digës është rreth 250 familje, sëbashku me banesat dhe pasuritë e tyre.

Si pasojë e kësaj situate në përmbledhje të gjendjes teknike të rezervuarëve paraqiten këto problematika të përgjithshme:

- mungesa e një punëtori mirëmbajtës e monitorues për një ose dy rezervuar.
- në dëmtimin e pjesëshëm të digave;
- në filtrimet në trupin e digave, si rezultat i dëmtimit të tubacionit të marrjes së ujit;
- në grryrjet në bjeftin e sipërm të digave nga dallgët e ujit;
- në dëmtimin e veprave të lëshimit të ujit, (saraçineskat);
- në dëmtimin e shkarkuesëve katastrofik;
- në zhvillimin e bimesisë në trupin e digave, etj.

Hidrovorët

Gjithashtu infrastruktura mjaft të rëndësishme që lozin një rol kryesor në kullimin e ujit janë edhe hidrovorët, ku në Bashkinë Lezhë ndodhen 5 të tillë. Në tabelën e mëposhtme paraqitet gjendja e tyre.

TABELA 27- Hidrovorët në Bashkinë Lezhë

Emri i Hidrovorit (vendodhja)	Sipërfaqja që kullon në ha	Numri i elektropom-pave në copë	Kapaciteti total i hidrovorit i projektuar në m ³ /sek	Fuqia elektrike e instaluar në kW	Fuqia e elektrom. në kW	Linjat e furnizimit të hidrovoeveve			Tensioni i furnizimit kV
						Total	Në punë	Jashtë pune	
Balltren	3000	5	25.5	1660	1660	2	1	1	10/0.4
Tale	4777	9	27.5	1570	1570	2	1	1	10/0.4
Ishull Shengjin	640	4	3.6	360	360	1	1		10/0.4
Gryke Zeze	550	4	3.9	420	420	1	1		10/0.4
Gocaj	300	2	1.3	110	110	1	1		10/0.4

Burimi: Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, 2017

Nisur nga gadishmëria dhe gjendja e mirë teknike e hidrovorëve, si rezultat i rimondeve të bëra gjatë verës, garantohet plotësisht evadimi i ujrave nga tokat bujqësore dhe në teritorët e banesave të ndertuara në këto zona informale për sezonin vjeshtë-dimër-pranverë.

Gjendja e këtyre hidrovoreve është si më poshtë:

Hidrovori i Gocajt: Ndodhet në territorin e NjA Balldre, ka fuqi të instaluar 110 k/v, numri i pompave 2, fuqit hithëse 1m³/sek me një sipërfaqe të kullimit 300ha si dhe Furnizohet me energji elektrike nga fideri i linjës Lezhë-Gjadër. Ky hidrovor ka ndërprerje të herëpashershme të energjisë elektrike si pasojë se nuk ka linje sekondare për furnizimin e tij me energji elektrike.

Hidrovori i Balldrenit: Ndodhet në territorin e NjA Balldre, ka fuqi të instaluar 1440 k/v, me 5 pompa dhe fuqi thithëse 25m³/sek me një sipërfaqe kulluese 3000ha si dhe furnizohet me energji elektrike me kabull nëntokësorë nga nenstacioni elektrik Lezhë. Ky hidrovor ka problem mosfunksionimin e rrjetit kullues e përcjellës të ujërave për shkak të rënies së nivelit të tokës.

Hidrovori Gryke-Zeze: Ndodhet në tërirtorin e NjA Kolsh, me fuqi të instaluar 420 k/v, me 4 pompa dhe fuqi thithëse 4 m³/sek, me një sipërfaqe të kullimit 550ha. Furnizohet me energji elektrike nga fideri i linjës Lezhë-Gjadër. Ky hidrovor nuk ka linjë sekondare të furnizimit me energji elektrike gjë që është problematike në rast shkëputje të energjisë.

Hidrovori Ishull-Shëngjin: Ndodhet në territorin e NjA Shëngjin, me fuqi të instaluar 775 k/v, me 4 pompa dhe fuqi thithëse 4m³/sek. Sipërfaqja e kullimit 640ha. Furnizohet me energji elektrike nga fideri i fshatit Ishull Shëngjin dhe ai rezervë. Ky hidrovor ka ndërprerje të herëpashershme të energjisë elektrike si pasojë edhe e mungesës së linjës sekondare të energjisë elektrike.

Hidrovori Tale: Ndodhet në teritorin e Njësis Administrative Shënkoll, me fuqi të instaluar 1380 k/v, me 7 pompa dhe fuqi thithëse 30 m³/sek. Sipërfaqja e kullimit 4777ha. Furnizohet me energji elektrike me kabull nëntokësorë nga nenstacioni Rrilë. Vendosja e pompave të reja dhe vendosja e linjës elektrike dytësore, ka *përmirësuar fuqin evakuuese të ujrave*. Ky hidrovor *kullon një territor që është zonë informale* ku janë ndërtuar shumë banesa në fshatrat Barbulloj, Ishull Lezhë, Manati, Tresh Spiten, Rrilë Shënkoll që paraqet problematika të shumta.

Hidrovorët e Bashkinë Lezhë, janë të instaluar në zonat informale, ku sipërfaqja e tokës bujqësore në rreth 7000ha, është në kuatat nen nivelin e detit dhe evakuimi i ujrave për kullimi i tyre nga reshjet, bëhet me ngritje mekanike nga hidrovoret. Për të siguruar premtimin e largimit të ujrave në zonat informale, kërkohet furnizim normal edhe me vendosjen e linjave të dyta të furnizimit me energji elektrike të hidrovorëve. Gjithashtu është e domosdoshme vendosja e linjave direkt me N/stacionin elektrik Lezhë, për hidrovorin e Ishull-Shëngjinit, pasi në rastet e shkëputjes së energjisë elektrike në zonë, rrezikohen nga përmytja mbi 100 banesa në fshatin Ishull-Shëngjin, lagjet Shaljanë dhe ajo Xhenio.

Argjinaturat

Argjinaturat mbrojtëse janë infrastruktura bazë për mbrojtjen dhe parandalimin e përmytjeve dhe si rezultat i kësaj në Bashkinë lezhë kemi shtrirje të gjërë të tyre. Argjinaturat janë 3 llojesh: Argjinaturat Detare të cilat mbrojnë tokën nga ujërat detar; Argjinaturat e lumenjve sidhe argjinaturat e kanaleve kulluese dhe kanaleve të ujrave të larta.

Drejtorja Rajonale e Bordi i Kullimit (Shkodër-Lezhë), në qarkun Lezhë ka në administrim 123.5 km, argjinatura mbrojtëse të lumenjëve, kanaleve të ujrave të larta dhe mbrojtjen nga deti. Në Bashkinë Lezhë sic thamë edhe më sipër kemi 3 lumenj kryesor Drinin, Gjadrin dhe Matin të cilët në pjesë të ndryshme të tyre kanë argjinatura për mbrojtjen e tokës bujqësore.

Lumi Drin: Me gjatësi 23 km në teritorin e qarkut Lezhë, buron në Spathar dhe shtrati i tij infiltron fushen e Zadrimës deri të lagunat në Ishull Lezhë e Shengjin, me derdhje në detin Adriatik. Për mbrojtjen nga përmbytja, janë ngritur argjinatura në Ishull Lezhë e Shengjin me gjatësi 5.5 km, e ndërtuar në vitin 1970. Kjo argjinaturë është pjesërisht në gjendje të mirë si pasojë e amortizimeve në vite.

Lumi Gjadër: Me gjatësi 40.5 km, buron nga bjeshkët e Kashnjetit dhe ka një pellg ujëmbledhës prej 120 km². Bashkohet më lumin Drin në fshatin Gjadër dhe përshkojnë një gjatësi prej 10 km në zonen fushore, duke rrezikuar përmbytjen e saj. Për këtë, në pjesët anesore të tij janë ngritur 10.5 km argjinatura mbrojtëse. Aktualisht gjendja pjesërisht të mirë teknike.

Sa i përket argjinaturave të ujrave të larta ato janë dy: Krajën Lezhë Krajen-Lezhë dhe Tresh-Zejmen si dhe kërkojnë ndërhyrje të herëpashërshme, pas çdo rënie të reshjeve intensive për zhbllokimin nga inertet në grykëderdhjet e përrrenjve malorë. Është emergjente ndërhyrja për pastrimin e argjinaturave të kolektorëve kullues të tokave bujqësore; Gocaj-Balldre, Dajç-Blinisht-Gocaj, Pista Gjadër-Ura Shkinës, Tresh-Rrile Hidrovor Tale dhe Zejmen-Tale-Det.

Argjinaturat e kolektoreve të ujërave në pjerrtesinë premdimore të vagmalëve Krajen-Lezhë-Tresh-Zejmen, Bashkia Lezhë ku kemi një numër të konsiderueshëm përrrenjsh me prurje të mëdha të ujrave gjatë reshjeve që shpesh herë kur intensiteti është i lartë, prekin infrastrukturën rrugore, përmbytjen e banesave, bizneset, rrezikimin e objekteve sociale, si dhe mbushjen më inerte të kolektorëve. Përgjithësisht janë në gjendje të mirë, por kërkohet të nderhyhet pas çdo reshjeve intensive për zhbllokimin nga inertet në grykëderdhjet e përrrenjve malorë.

Argjinaturat e kolektoreve kullues të tokave bujqësore në Bashkinë Lezhë; Gocaj-Balldre, Dajç-Blinisht-Gocaj, Pista e Airodromit Gjader-Blinisht-Ura Shkinës-Drin, Tresh-Rrile-Hidrovor Tale dhe Zejmen-Tale-Det Adriatik, janë në gjendje të mirë.

Argjinatura Torovice, është e mire, por kuata e hidrovorit nuk i përgjigjet evakuimit të ujrave. Hidrovori Balldre është rreth 2 m mbi kuatën e kolektorit përcjedhës të ujrave të kënetës.

Pra aktualisht në Bashkinë Lezhë, gjendja e sistemit të kullimit dhe e veprave mbrojtëse nga përmbytjet nuk është e mirë. Si rezultat i amortizimit në vite, zhvillimit të bimësisë, dekantimit të materialeve të ngurta, gërryerjeve nga vërshimi i përrrenjve malorë dhe pamundësisë financiare për t'i rehabilituar ato në kohën e duhur gjendja ka ardhur duke u vështirësuar. Pritat malore të ndërtuara vite më parë aktualisht nuk funksionojnë sepse janë dëmtuar dhe mbushur nga inertet. Për pasojë, sot kemi bllokimin e kolektorëve, kanaleve të ujërave të larta, kanalet dhe tombinot e akseve të rrugëve nacionale, rurale e komunale etj.

4.6 Kanalet Kulluese dhe Vaditëse

Kanalet kulluese dhe vaditëse janë një ndër infrastrukturën të cilat afektojnë menaxhimin e përmbytjeve në mnëyrë direkte dhe luajnë një rol kryesor në zbutjen apo jo të efekteve të përmbytjeve. Në Bashkinë Lezhë në bazë të vizitave në terren dhe informacioneve nga institucionet gjatësia e kanaleve në total shkon në 1183 km linear ku 12.8% e tyre janë kanale të parë, 28.91% kanale të dytë dhe 58.30% kanale të tretë.

TABELA 28- Kanelet Kulluese dhe Vaditëse sipas Kategorisë në KM linear

Kanale te Pare	151.394	12.79%
Kanale te Dyte	342.252	28.91%
Kanale te Trete	690.142	58.30%
Kanale Total	1183.788	100.00%

Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë 2020, bazuar në intervista në terren, vëzhgime me dron dhe vëzhgime në terren

Sa i përket gjendjes së tyre sipas kategorisë, kanalet e parë sipas rrezultateve nga vizitat në terren , rreth 30% e tyre janë në gjendje mjaft të mirë, rreth 47% e tyre janë në gjendje pjesërisht të mirë sidhe rreth 22% kanë nevojë për rehabilitim. Nga këto shifra të paraqitura mund të thuhet që ka zona të caktuara në territorin e Bashkisë Lezhë të cilat nuk kullojnë ujin e tyre në stinën e lagësht apo nuk vadin tokat në stinën e thatë. Sa i përket kanaleve të dytë vetëm 13% e tyre mund të themi që janë në gjendje të mirë ndërsa, 40% në gjendje mesatarisht të mirë dhe 22.9 % në gjendje të keqe ose të pamirëmbajtura si infrastruktura.

Në kategorinë e kanaleve të treta 2% e tyre janë në gjendje të mirë, 6% e tyre vlerësohen në gjendje pjesërisht të mirë dhe 91.6% vlerësohen në gjendje jo të mirë të cilat kanë nevojë për rehabilitim dhe mirëmbajtje. Në total rrjeti i kanaleve kulluese vaditëse vlerësohet që rreth 8.8% e tij të jetë i mirembajtur rreth 21% të jetë pjesërisht i mirëmbajtur dhe 70% të ketë nevojë për rehabilitim.

Kanalet kulluese dhe vaditëse sipas kategorisë dhe gjendjes së tyre në km linear

TABELA 29- Gjendja e Kanaleve Kulluese dhe Vaditëse

Kanale të Parë		
Te mirëmbajtur	44.325	29.28%
Pjesërisht të mirëmbajtur	72.483	47.88%
Te pamirëmbajtur	34.586	22.85%
Total	151.394	100.00%
Kanale të Dytë		
Të mirëmbajtur	45.714	13.36%
Pjesërisht të mirëmbajtur	136.645	39.93%
Të pamirëmbajtur	159.893	46.72%
Total	342.252	100.00%
Kanale të Tretë		
Të mirëmbajtur	13.913	2.02%
Pjesërisht të mirëmbajtur	43.627	6.32%
Të pamirëmbajtur	632.602	91.66%
Total	690.142	100.00%
Kanale Total		
Të mirëmbajtur	103.952	8.78%
Pjesërisht të mirëmbajtur	252.755	21.35%
Të pamirëmbajtur	827.081	69.87%
Total	1183.788	100.00%

Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë 2020, bazuar në intervista në terren, vëzhgime me dron dhe vëzhgime në terren

Sa i përket ndarjes sipas llojit të kanaleve kulluese apo vaditëse, në Bashkinë e Lezhës si kanale të parë rreth 66% e tyre janë kanale kulluese dhe rreth 34% kanale vaditëse. Kanalet e dytë në masën 18% të tyre janë kullues dhe rreth 82% janë kullues dhe vaditës njëkohësisht. Kanalet e tretë në masën 15% të tyre janë kanale kullues dhe në 85% të tyre janë kanale të përbërë vaditës dhe kullues njëkohësisht.

Kanalet sipas llojit dhe kategorisë në km linearë

TABELA 30- Kanalet sipas llojit

Kanale të Parë		
Kanale Kullues	99.896	65.98%
Kanale Vaditës	51.498	34.02%
Kanale Total	151.394	100.00%
Kanale të Dytë		
Kanale Kullues	61.106	18%
Kanale Kullues/Vaditës	281.146	82%
Kanale Total	342.252	100%
Kanale të Tretë		
Kanale Kullues	106.041	15%
Kanale Kullues/Vaditës	584.101	85%
Kanale Total	690.142	100%

Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë 2020, bazuar në intervista në terren, vëzhgime me dron dhe vëzhgime në terren

Si pasojë e problematikave të kanaleve kulluese në një pjesë të madhe të territorit ndodhin përmbytje të tokave dhe hapsirave bujqësore në pjesë të caktuara të territorit.

TABELA 31- Llojet e Përmbytjeve sipas Shkakut dhe Sipërfaqes në Ha

Shkaku i përmbytjeve	Numri	Sip ne Ha	%
Bllokim kanalesh	6	385.1	4.41%
Përmbytje nga rritja e nivelit të Lumit/Rreshje të shumta të kombinuara me shkarkime nga Hidrocentralet/Bllokim Kanalesh	1	45.6	0.52%
Përmbytje nga erozioni/ batica detare	1	2729.7	31.26%
Përmbytje nga rritja e nivelit të Lumit/Rreshje të shumta të kombinuara me shkarkime nga Hidrocentralet	3	1523.8	17.45%
Rreshje të shumta shiu/Bllokim kanalesh/Vërshim i përrrenjve malor	5	144.6	1.66%
Rreshje të shumta shiu/Bllokim kanalesh/Vërshim i përrrenjve malor/zonë me depresion	1	37.3	0.43%
Rreshje të shumta/Vërshim i ujrave nga kodra/Amortizim i kanalit vaditës	2	5.9	0.07%
Rreshje të shumta/depërtimi i ujit në shtresat nëntokësore nga fusha e Torovicës/Bllokim kanalesh	2	74.5	0.85%
Vërshim i ujrave të përroit nga rreshjet e shumta	10	108.7	1.24%
Zonë me depresion/bllokim kanalesh/rreshje të shumta shiu	10	3677.9	42.11%
Total	41	8733.1	100.00%

Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë 2020, bazuar në intervista në terren, vëzhgime me dron dhe vëzhgime në terren

Në tabelën e mësipërme renditet lloji i përmytjeve nga shkaku i cili e shkakton dhe sipërfaqen që zë në territor. Në masën më të madhe këto përmytje ndodhin në zonat me depresion dhe si pasojë përmytjen edhe si shkak i mosfunksionimit të mirë të kanaleve kulluese, veçanërisht në NjA Zajmen, Tale dhe Ballbren. Ky lloj përmytje zë një sipërfaqe prej 3677 ha dhe rreth 42% të tokave të përmytura. Gjithashtu në një masë të madhe përmytjet ndodhin edhe nga batica detare në zonën e NjA-ve Shengjin, Lezhë dhe Tale me një sipërfaqe prej 2729 ha dhe rreth 31% të zonave të përmytura. Këtu përmendim përmytjen e madhe të vitit 2010 nga batica detare në zonën e hidrovrit të Tales.

Përmytje nga Lumenjtë ndodhin në pjesën e bregut të Matit përgjatë gjithë zonës fushore në NjA Zejmen dhe Tale si dhe në zonën në afërsi të qytetit ku përmyt lumi Drin. Kjo lloj përmytje zë rreth 17.5 % të sipërfaqes. Përmytjet e tjera zakonisht shkaktohen edhe nga rreshjet e shumta dhe vershimet e përrrenjve malore të cilët derdhen më pas në pjesën fushore dhe këtu përmendim zonat afër përrrenjve të NjA Zejmen, Kolsh, Kallmet dhe Blinisht.

5 MJEDISI

Bashkia e Lezhës trashëgon një mjedis natyror të pakrahasueshëm përse i përket larmisë së rilievit, klimës, mikroklimës, faktorëve edafik që kanë kushtëzuar formacione të shumëllojshme pyjore, sipërfaqe të konsiderueshme fushore, zona ligatinore të shoqëruara nga ana përrëndimore me litorale e plazhe të lagura nga deti Adriatik, formacione gjeologjike të pasura me minerale e ujra nëntoksore, si dhe një rrjet të pasur hidrografik.

Përveç inaktivizimit e demolimit menjëherë pas viteve 1990, të objekteve industriale me impakt të rëndë mjedisor si ish fabrika e Letres e që ndikuan pozitivisht në mjedis, rritja e shfrytëzimit të gelqeroreve si dhe e zhavorëve të shtratit të lumit Mat, mbishfrytëzimit i ujrave nëntoksore veçanërisht të akuiferit të zonës së Bregut të Matit, pakësimi i prurjeve të lumit Drin e Mat nga ndërhyrjet në kaskadë, shfrytëzimi pa kriter i pyjeve e për pasoje dhe rritja e erozionit në tërësi e veçanërisht atij bregdetar, rritja e trafikut, ndikuan në një presion të shtuar ndaj mjedisit natyror ose në degradimin e tij. Në mënyrë të veçantë zona e ulët bregdetare po përballlet me intensitet në rritje me efektet nga ndryshimet klimatike si stuhitë detare të shoqëruara me baticë të lartë, përmytjet e zonave të ulta nga lumenjtë e ujrave detare, thatësitat e tejzgjatura, valët e të nxehtë, erërat e fuqishme etj.

Përmirsimet e ligjislacionit mjedisor dhe vendosje e standarteve dhe e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e mjedisit, rritja e kapaciteteve të agjencive ligjëzbatuese në vitet e fundit, hartimi Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Lezhë dhe e "Vleresimit Strategjik Mjedisor" të këtij plani etj, përbëjnë një kontribut të rëndësishëm për të garantuar mbrojtjen e përmirsimin e mjedisit si dhe për një zhvillim të qëndrueshëm në tërësi. Rritja e numrit të OJF-ve mjedisore dhe e rolit të tyre po nxit veçanërisht ndergjegjësimin për çështjet e mjedisit për një jetë më denjtozë e në mirëqenie.


5.1 Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura natyrore që ndodhen në territorin e Bashkisë së Lezhës përbëjnë 15 % të sipërfaqes së saj. Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (AdZM) të Lezhës si pjesë e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të zonave të mbrojtura të Qarkut të Lezhës. Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtur Lezhë ndjek dhe mbikqyr zbatimin e planit të menaxhimit për zonat e mbrojtura të saj dhe drejtohet nga Prefekti bazuar në Vendim Nr. 593, datë 9.10.2018 "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore. Në territorin e Bashkisë së Lezhës ndodhen zonat e mbrojtura natyrore si vijon:

Zona e mbrojtur Kune - Vain - Tale

Zona Kune Vain Tale është zona e parë e mbrojtur e shpallur në vendin tonë në vitin 1940 si rezervat shtetëror gjetitje. Me pas është rishpallur zone e mbrojtur në vitet 1940, 1960, 1977, 1983, 1992 dhe së fundmi në vitin 2010. Për peisazhin me male mbi laguna e plazhin me ujë të qetë dhe mbi të gjitha për faunën e florën e mrekullueshme, kjo zonë është shpallur në vendin e parë në Konferencën Mesdhetare të Algjerit (1988). Ndërsa ndër vite, është vlerësuar si perlë e natyrës shqiptare e privilegj i saj.

FIG 79- Harta e Zonave të Mbrojtura Lezhë



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë, (2020) bazuar në AKZM (2020)

Kompleksi ligatinor Kune - Vain - Tale së fundmi është rishpallur si zonë e mbrojtur në vitin 2010, sipas Vendimit nr.432, datë 28.4.2010 "Për zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar Kune- Vain-Tale, rezervat natyror i menaxhuar, kat. IV sipas IUCN, në të cilën përfshihet edhe zona ligatinore e Tales, me një sipërfaqe totale së bashku me zonën buffer prej 4 393.21 ha. Ekosistemi karakterizohet nga tre lloje kryesore habitatesh: a. detar, b. ligatinor, përfshirë grykëderdhjet, zonat e brigjeve, ligatinat e lagunat dhe c. habitatet jo ligatinore përfshirë këtu pyjet, shkurret dhe zonën e arave ku është praktikuar tradicionalisht bujqësia.

Kompleksi ligatinor Kune - Vain - Tale ka një biodiversitet me vlera të mëdha e të rëndësishme të cilat janë bërë të njohura edhe në Strategjinë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit (NBSAP, 1999). Zona është shpallur "Zonë Veçanërisht e Mbrojtur, ("Specially Protected Area" SPA) në kuadrin e aktivitetit "Specially Protected Areas of the Mediterranean Sea" të Konventës së Barcelonës (RAC-SPA, 1995). I gjithë ekosistemi është i njohur në botë si hapësirë e rëndësishme për shpendët (Important Bird Area - IBA) e si zonë veçanërisht e mbrojtur (SPA), ndërsa Ishulli i Kunes është përcaktuar si zonë strikt e mbrojtur, që i përket kategorisë së parë sipas IUCN. Në zonë janë regjistruar një total prej 330 specie bimësh që i përkasin 58 familieve dhe 199 nënlojeve. Në të gjithë ekosistemin jetojnë rreth 203 lloje shpendësh (330 në shkallë vendi) dhe 40% e tyre janë shpënde ujorë. Këto përbëhen nga dimërues 33%; shtegëtarë 29%; të përhershëm 17%; folezues 21 %.

Po ashtu numurohen 9 lloje amfibësh (15 në shkallë vendi); 25 lloje reptilësh, 60-70% të herpetofaunes (37 vendi); 50 lloje gjitarësh ose 70% e mammalofaunës së vendit tonë; 26 lloje peshqish nga të

cilët 10 lloje janë të përhershëm, 1 migratorë katadrom, e 15 detarë. Insektet janë 57 lloje. Po ashtu janë regjistruar edhe 69 lloje molusqesh, 13 lloje krustacesh e 9 lloje bryozoa.

Me gjithë presionin e madh që ka pasur mbi këtë zonë në këtë periudhë 10 vjeçare të zbatimit të këtij plani menaxhimi, nga subjektet që kerkojnë të zhvillojnë aktivitete turistike, pretenduesit e pronave si dhe pronaret, aktivitetet e peshkimit, subjektet e gjuetise etj, perseri zona e ka ruajtur dhe konsoliduar rëndësinë e saj në të gjithë parametrat e sipërvlerësuar. Mbi te gjitha kjo zonë, si rezultat i permirsimit të administrimit dhe menaxhimit në tërësi të saj, ka rezultuar në ruajtjen e integritetit territorial dhe mbi të gjitha në përmirësimin e dukshëm të tipareve natyrore më primare, për një zonë të mbrojtur si shendetësimin e habitateve dhe rritjen e efektivave dhe llojeve të faunes e të biodiversitetit në tërësi.

Rishikimi i plotë i planit të menaxhimit, është një kërkesë e domosdoshme për vijimin e përpjekjeve për garantimin e integritetit territorial dhe arritjen e qëllimit të mbrojtjes së kesaj trashëgimie natyrore, për zhvillimit e qëndrueshëm të saj e plotësimin e kërkesave të komunitetit dhe aktoreve të interesuar.

Zona e Mbrojtur e Berzanës

Kjo zonë ka statusin "Rezervat natyror i menaxhuar, Kategoria e IV sipas IUCN-se dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 880 ha dhe ndodhet rreth 1.5 km ne veri të urës së Zogut, në anën e majtë të rrugës së vjetër automobilistike Lezhë – Rubik pranë fshatit Bërganë. Zona karakterizohet nga bimësia që i përket brezit të shkurretave mesdhetare dhe në një përqindje të konsiderueshme mbulohet nga shoqërimi bimor i shqopës (*Erica arborea* L.) me maren (*Arbutus unedo* L.). Në zonë ndodhen të shpërndarë dhe grupe ose drurë të veçuar me lis, frashër, panjë etj. Të shpërndarë me një gradë mbulimi të papërfillëshme janë edhe shkurrja e drizës (*Paluirus aculeatus* Lam), dëllinjës (*Juniperus communis*), krifshes (*Phillyrea media* L.) si dhe shkozës (*Carpinus* sp.) Në buzët e poshtme të zonës mund të dallojmë edhe egzemplarë të rrunçës (*Pistacia terebinthus* L.) e konopicës (*Vitex agnus-castus* L). Me një gradë mbulimi të ulët dhe jo me shpërndarje homogjene ndodhen gjithashtu bimësia më e ulët si bari i majasellit (*Teucrium polium* L.), shpëndra (*Helloborus odoratus* E.K.), fieri (*Polipodium vulgare* L.), lulebasani (*Hypericum perforatum* L.), lisra (*Tymus* sp), mendra e egër (*Mentha* sp.) graminore të ndryshme pak të zhvilluara.

Ky ekosistem është strehë e një llojshmërie faunistike të pasur dhe më i rëndësishmi është derri i egër (*Sus scrofa*). Para viteve 1990, popullata e derreve të eger është menaxhuar me qëllim kryesor gjuetinë, duke i trajtuar me ushqime suplementare me drithëra, si dhe krijimin e mjediseve të përshatshme për riprodhim. Zona e Berzanës është pjesë e koridorit ekologjik për këtë specie që lidhet më në veri me malin e Molungut, dhe në jug pas lumit të Matit me zonën e

FIG 80- Harta e Zonimit Kune- Vain- Tale



Burimi: Vendimi nr.432, datë 28.4.2010 "Për zgjerimin e kufijve të rezervatit natyror të menaxhuar Kune- Vain-Tale

Gallatës (rrethi i Kurbinut). Veçanërisht pas viteve 1990, numri i derrave pesoj një rënie drastike deri në individë të veçuar si pasojë e presionit të madh nga aktiviteti i gjuetisë.

Ndersa janë të njohur gjithashtu ujku (*Canis lupus*), lepuri i eger (*Lepus europaeus*), dhelpra (*Vulpes vulpeas* L.), ketri, kunadhja e lakuriqet e nates. Brejtesit janë me evident në zonën e marës. Aviofauna paraqitet me popullata pothuajse konstante e të favorizuara nga lugina që është me i mbrojtur nga erërat e më i ekspozuar ndaj ndriçimit të djellit. Shpëndët grabiqare si falkonjë, hutat, janë të njohur por jo të mbipopulluar. Me shumë bien në sy shpëndët karakteristike të zonave urbane si harabelat, trishtilat e mëllënjat, bufët, trumcakët etj. Zvaraniket janë ato me të zakonshem si hardhuca e mureve, zhapiku etj. Terreni gelqeror në disa vatra dhe luginat kanë favorizuar dhe praninë e disa zvaranikeve e që më të instaluar janë gjarperinje si viperat, (*V. amodytes*, *V. berus*) etj Amfibët në luginë janë shumë të zakonshëm si *Hyla arborea*, *Bombina variegata*, *Bufo viridis*, *Bufo bufo*, etj.

5.2 Monumentet e natyrës

Bashkia e Lezhës është e pasur me objekte natyrore të rëndësishme për sa i përket karakteristikave të veçanta të tyre dhe janë shpallur monumente të natyrës, te cilet bejnë pjesë në kategorinë e III të zonave të mbrojtura sipas klasifikimit të IUCN. Këto monumente kanë një shtrirje të gjërë në territorin e Bashkisë së Lezhës dhe përfshijnë grupe drurësh ose dru të veçuar, gjeomonumente, mjedis me biodiversitet të spikatur, të cilat po i përshkruajmë në vijim.

Rëra e Hedhur

Si më i veçantë i këtij bregdeti, është gjeomonumenti natyror, i rralle në llojin e vet, Rëra e Hedhur. Objekti përfaqëson një mbushje të qëndrueshme me rërë të imët e të zakonshme plazhi, të një pjese shpati bregdetar që arrin në një shtrirje gjatësore rreth 600 m dhe gjarësi 100 m. Kjo mbushje ranore është krijuar nga aktiviteti i erës në drejtim të formacionit shkëmbor bregdetar dhe ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), ekologjike, kulturore, didaktike e turistike. Objekti arrihet nga rruga automobilistike që shkon nga Shengjini drejt Rerës së Hedhur.

FIG 81- Foto Rëra e Hedhur



Burimi: Jak Gjini

Rrapi i Grykës

Rrapi ndodhet në fshatin Grykë, në anën e djathtë të rrugës automobilistike rurale Manati - Kolsh, dhe ka një lartësi mbi 20 m, dhe diametër të bazës me të madh se 2 m. Në afërsi të tij ndodhet kabina elektrike e lagjes si dhe objekte një katëshe dyqan e magazinë. Rrapi ka kurore tipike të llojit bimor që përfaqëson por që dallon nga volumi e lartësia e madhe. Nën vendin nën këtë kurorë, historikisht, mbledheshin burrat e fshatit e më gjërë si për problemet e zakonshme

të fshatit por dhe për ngjarje të rëndësishme. Ketu merreshin vendime për mbeshtetje të luftës së Skenderbeut kundër pushtuesve osmanë e deri në luftën nacional çlirimtare e më pas. Në afërsi ndodhet kroji i lagjës, i njohur për vlerat e veçanta shëndetësore kurative të ujit të këtij burimi. Rrapi i grykës, përfaqëon jo vetëm vlera estetike por dhe historike, biologjike etj.

Rrapet e Kolshit

Ndodhen në fshatin Kolsh, në anën e djathtë në drejtim të rrjedhes, të përroit me të njëjtin emër. Grupi i rrapeve ka një lartësi deri 20 m, dhe diameter të trungjeve deri 1.5 m. Kurorat e tyre ndërthuren hijshëm dhe në periudhen e verës krijojnë një mjedis të këndshëm rilaksi, i preferuar nga banorët, kalimtarët etj dhe për ujrat cilësore të burimit kryesor të fshatit që ndodhet ngjitur me këtë grupim drurësh. Në këtë mjedis, gjatë periudhës komuniste së pas luftes e deri ne vitet 1990, janë vendosur në mënyrë të vazhdueshme kampingje ushtarake stervitore. Ky grupim drurësh ka vlera të veçanta ekologjik e natyrore në përgjithësi, si dhe prezantohet si mjedis pejsazhist tërheqës. Vizitohet lehtësisht nëpërmjet rrugës automobilistike rurale Lezhë - Grykë Manati - Kolsh. Veçanërisht në dy dekadat e fundit ky monument natyror, është kërcënuar seriozisht nga erozioni i shkaktuar nga prurjet e vrullëshme të perroit që kalon në anën lindore të tij, duke rrezikuar edhe shtepiat e fshatit në afërsi. Janë ndërtuar disa herë mbrojtje në formen e veshjes me betonarme në të dy anët e shtratit të perroit, që tani po amortizohet në segmente të caktuara. Në anën veriore të këtij monumenti, ndodhet shkolla dykateshe 9 vjeçare e fshatit, ambulanca dhe një dyqan i vogël.

Shpella e Hutit

Ndodhet në shpatin e malit përballë fshatit të Kolshit, në vëndin e njohur më emrin Frashnjët në një lartësi rreth 150 m mbi nivelin e detit. Kjo shpellë ndodhet në një formacion gelqeror dhe është formuar si rezultat i fenomeneve tektonike e karstike. Shpella ka një hyrje pingule, pak trekëndeshme me një hapje maksimale prej 4 m dhe gjërësi 2.5m. Kjo hyrje zgjerohet menjëherë dhe ka pak diferencë në lartësi me kubënë e shpellës. Pas një zbritje prej 6 m fillon menjëherë dyshemeja e cila zbret me një pjerrësi afërsisht 45 gradë në një gjatësi prej 16 m e gjërësi 6 m. E veçanta e kësaj shpelle është se faqet e saj janë të veshura me forma tepër tërheqëse të stalagmiteve e stalagmiteve duke krijuar një ansambël të mrekullueshëm eskponatësh. Shumëllojshmëria e formave nga depozitimet e kriperat të karbonatit të kalciumit si rezultat i fenomenit të karstit, duke krijuar pamje deri të kristalta e bëjnë këtë shpellë mjaft joshëse për t'u vizituar. Kjo shpellë merr vlera të veçanta speleologjike e estetike. Shpella mund të arrihet nëpërmjet rrugës automobilistike rurale Lezhë - Grykë Manati - Kolsh, dhe ngjitje malore në një shteg të pashënuar në shpatin e malit për në Frashnjët.

Shpella e Sukës së Vogël

Kjo shpellë karstike ndodhet afër majës së Sukës, një kodër e vogël në malin e Rrencit në lartësinë rreth 460 m mbi nivelin e detit, në një formacion me dalje sipërfaqësore të shkembjeve gelqeror. Ka një hyrje të vogël nëpërmjet një hapjeje në formë ovale, me një

FIG 82- Foto Suka e Vogël



Burimi: Jak Gjini

diameter deri 1 m. Shpella hapet menjëherë pas hyrjes në formën e një koridori zbritës prej afërsisht 45 gradësh, deri në 40m gjatësi që duke shkuar drejt fundit arrin deri në një gjërësi 4 m e lartësi 3 m. Pas zbritjes koridori degezohet majtas e cili të çon menjëherë në një sallë kryesore me gjatësi të bazës prej 16 m, gjërësi 10 m e lartësi 5 m. Tavani në të gjithë shpellen ka një harkim të çrregullt si dhe faqet anësore kanë një veshje të dominuar me stalagmite që e bëjnë tërheqëse për sa i përket formave. Shpella prezanton vlera speleologjike, gjeomorfologjike e natyrore në tërësi. Shpella arrihet nepermjet një rrugë kembesoresh që fillon nga qyteti i Shëngjinit në zonën e portit, ngjitje në shpatin malor të Shëngjinit tek vendi i fshatit të vjetër të Malit të Rrëncit, për të arritur tek vendi i njohur me emrin Suka e Vogël.

Dritarja tektonike e Manatisë

Gjëndet në Lindje të fshatit Gryke Manati dhe në afërsi të fshatit të vjetër malor të Manatisë, në lartësi 80 – 600m mbi nivelin e detit. Objekti është krijuar si pasojë e proceseve të nderlikuara gjeologjike ku nënzona tektonike e Spitenit del në brëndësi të zonës tektonike të Krastës. Formacionet karbonatike të kësaj zone formojnë një brahiantiklinal të shtrirë në një gjatësi 1500 m dhe gjërësi mesatare 1000 m. Dritarja tektonike përfaqëson vlera të veçanta didaktike për studentët e gjeologjisë, të gjeografisë dhe për nxënësit e shkollave të mesme. Ky gjeomument arrihet nepermjet rrugës Lezhë - Grykë Manati.

Rivat e Drinit

Ndodhet në anën e djathtë të grykederdhjes së lumit Drin dhe përfaqëson një formacion shkurre me dominancë bimën e marinës (*Tamarix parviflora* DC) e instaluar mbi litoralën ndares së këtij lumi me lagunën e Merxhanit. Ky habitat ligatinor dhe i grykederdhjes është strehë për një komunitet të shumëllojshëm shpëndësh ujor ku dominojnë çafkat e karabullaket. Ky habitat është pjesë e kompleksit ligatinor Kune - Vain - Tale. Objekti përfaqëson vlera të veçanta shkencore, ekologjike e veçanërisht ornitologjike, gjeomorfologjike, didaktike dhe turistike. Ky monument arrihet duke u nisur nga qyteti i Lezhës, ecje në këmbë ose biçikletë përmes shetitores së ndertuar mbi argjinaturen e lumit Drin, në anën e djathtë të tij për në grykderdhje ku ndodhet ky monument.

FIG 83- Foto Rivat e Drinit



Burimi: Jak Gjini

Këneta e Kashtës

Në zemër të Ishullit të Kunes, midis shkurreve e drurëve të shumëllojshëm, ndodhet Këneta e Kashtës, e cila është një monument i rrallë natyror. Ajo ushqehet me ujërat e lagunës së Merxhanit, nëpërmjet një kanali lidhës. Përfaqësohet nga një mjedis kenetor në një gjatësi prej 850 m dhe gjërësi afërsisht rreth 400m me një dinamizëm për sa i përket ndryshueshmërisë së kriptomërisë së ujrave që ka kondicionuar një biodiversitet të spikatur. Me të pranishëm janë

shpendet e ujit me një popullatë të pasur me çafka e karabullakë. Keneta është pjesë e Ishullit të Kunës, e njohur ndërkombëtarisht si zonë IBA. Gjithashtu ky objekt natyror është pjesë e zonës Strikt të Mbrojtur që përfshihet në zonën Kune - Vain - Tale. Siç vërehet, zona ka vlera shkencore ekologjike e veçanërisht ornitologjike, gjeomorfologjike, didaktike etj. Ky monument arrihet nepermjet rrugës automobilistike Lezhë - Kune.

FIG 84- Foto Këneta e Kashtës



Burimi: Jak Gjini

FIG 85- Rrapi i Pirajve



Burimi: Jak Gjini

Rrapi i Pirajve

Ndodhet në lagjen Piraj të fshatit Blinisht, në Njesinë Administrative me të njëjtin emër, në një largësi 1.2 km nga ana e djathtë e autostradës Lezhë - Shkoder. Diametri i trungut është jo me pak se 2.5 m, me lartësi mbi 20 m. Kurora e rrapit është madheshtore e drejtepeshuar në qënder e që lartësohet dhe e bëhet e dukëshme në një mjedis fushor në të cilin mungojnë drurët e tjerë në afërsi. Monumenti ka vlera shkencore, biologjike dhe ekologjike, estetike e didaktike. Veçanërisht në periudhën e nxehtë të verës, vitet e fundit rrapit ka paraqitë shenja dobësimi ose tharje të pjesëshme të degëve. Ndërtimet në afërsi të tij i bejnë jo vetëm një presion pamor jo të këndshëm por dhe e rrezikojnë nga dëmtimi. Gjatë verës, vendi nën kurorën e këtij rrapit, ka shërbyer si vend pushimi për punëtorët e bujqësisë së zonës në afërsi. Ky monument arrihet nëpërmjet rrugës automobilistike Lezhë – Blinisht.

Lisi i Markatomaj

Ndodhet në anën e djathtë të rrugës automobilistike Lezhë - Zejmen, në afërsi të fshatrave Markatomaj e Zejmen, në buzë të shpatit malor të anës lindore të këtyre fshatrave. Lisi ka vlerën e një druri të shejtë për banorët sepse perreth tij janë vendosur varrezat e fshatit. Trungu i tij ka një diametër rreth 0.80 m, ndersa lartësia e kurorës është mbi 15 m. E veçanta e këtij lisi është sepse është i degëzuar që në bazë në dy trungje të cilët ngrihen me degëzime të shumta të nderthurura bukur në mes tyre. E gjitha kurora ka shtrirje horizontale të barabartë me lartësinë e tij. Po ashtu kurora i afrohet terrenit në të gjitha anët në një lartësi vetem 1.3 m. Ky monument ka vlera fetare, por edhe biologjike e estetike dhe është lehtësisht i vizitueshëm nëpërmes rrugës automobilistike Lezhë - Zejmen.

Pylli i Shënmisë⁸ në Kallmet

Ndodhet në një shpat malor afër Kishës së Shënmisë, në lindje të fshatit Kallmet i Vogël të Njesisë Administrative Kallmet. Shtrihet në një sipërfaqe rreth 1 ha, midis lartësisë 400 - 440 m mbi nivelin e detit. Pylli dominohet nga drurë fletorë të përzierë të dushkut, frashërit dhe shkozës. Pylli ka

8 Në gjuhën e popullit, ajo që flitet, njihet me këtë emër, ndersa e shkruar në tekstet fetare është "Shën Eufemia"!

FIG 86- Foto Lisi Markatomaj



Burimi: Jak Gjini

karakteristikat tipike të zonës mesdhetare të ruajtura mjaft mirë ku lartësia maksimale e drurëve arrin 12 m dhe diametër maksimal 45 cm. Në rrezë të shkëmbit gelqëror mbi këtë formacion pyjor, është ndertuar Kisha, në sheshin e së cilës ndodhen dhe dy burime me ujë të ftohtë, njeri prej tyre është brenda ndërtesës së këtij objektit fetar. Ritet fetarë kryhen jo vetem nga fshati Kallmet por dhe nga zona e Zadrimës e më gjërë. Për vlerat historike e fetare, kisha është bërë qënder e rëndësishme pelegrinazhi pothuajse gjithvjetor. Pylli buzë kishës prezanton vlera të veçanta shkencore, edukative, biologjike, estetike dhe turistike. Për të arritur në këtë objekt merret rruga automobilistike Lezhë - Kallmet i Vogël - Kisha e Shënmisë e ku ndodhet dhe pylli.

FIG 87- Foto Pylli i Shënmisë



Burimi: Jak Gjini

5.3 Lumenjtë

Lumi Drin

Është 283 km i gjatë, lumi më i gjatë i Republikës së Shqipërisë, me pellg ujëmbledhës me sipërfaqe 5817 km² dhe prurje mesatare 280m³/sek. Që në vitin 1853⁹, gjatë një plotë të jashtëzakonshme që shkatoj përmbytje të medha, në grykën e Vaut të Dejes ujrë e Drinit u ndanë në dysh, ku veç ujrave që vazhduan në shtratin e vjetër drejt Lezhës për t'u shkarkuar në Detin Adriatik, u formua dhe një degë e re që kaloi nga ana e Shkodrës. Kjo degë e re e lumit Drin, u bashkua me lumin Buna, rreth 1.5 km pasi ky i fundit del nga liqeni i Shkodrës.

Bonifikimi i fushës së Zadrimës e sistemimi i saj që filloi rreth viteve 1950, bëri që të ndajë përfundimisht të gjitha ujrë e lumit Drin që vazhdonin në Lezhë, nëpërmjet ndërtimit të digës së

9 F.Hoxha. Konferenca shkencore "Potencialët ekonomike dhe njëzore të rajonit të Lezhës dhe prioritetet e zhvillimit për të ardhmen".

Spatharës. Po kështu u ndërpre në edhe ujrat e lumit Gjadër dhe u dërguan në digën e Spatharës për të vazhduar së bashku me ujrat e lumit Drin, në lumin Buna. Në këtë digë u mundësua vetëm furnizimi i kanalit ujtitës i zonës së Zadrimës me këto ujra. Ndërsa shtrati i vjetër pas kësaj dige dhe pas fshatit Mjedë të Shkodrës, vazhdon në territorin e Bashkisë së Lezhës në 23 km e fundit të tij, deri në grykëderdhjen në detin Adriatik. Që nga viti 1963,¹⁰ Drini i Lezhës u kthye vetëm në një kanal kullues. Në këto kushte, për rreth 80% të kohës vjetore, lumi Drin i Lezhës është pa prurje, pasi ka një sipërfaqe ujëmbledhese vetëm 455¹¹ km² e që ka të bëjë kryesisht me bledhjen e ujrave të reshjeve nga sipërfaqja e luginës dhe e fushës së Zadrimës.

Në shtratin e lumit Drin është ngritur kaskada më e madhe hidroenergjetike në Shqipëri me 4(katër) hidrocentralet, Fierzë, Koman, Vau i Dejës dhe Ashtë dhe nga menaxhimi i saktë inxhinierik-technik i këtyre kaskadave ulet dhe rreziku i ndikimit të përmytjeve nga këto hidrocentrale. Nga diga e Spatharës në Mjedë, lumi Drin i Lezhës kalon në Zadrimë, dhe gjatë rrugës, merr ujrat e mbetura të lumit Gjadër pas ndërprejes së tyre nga argjinatura ndarëse. Më pas i bashkohen të gjithë ujrat e kanaleve kryesore dhe e përrënjeve që shakrojnë në to, në Kakarriq, Gocaj, Grykëzeze, Balldre, Malesisë së Lezhës, Manati dhe derdhet në detin Adriatik. Gjatë vitit 2017 janë kryer punime për pastrimin, thellimin dhe përmirsimin e argjinatures së tij.

Situata e krijuar ndër vite, nga pakësimi drastik i prurjeve të lumit Drin të Lezhës, ka ndikuar që shtrati i tij të mbushet herë pas herë me sedimente të ngurta që vijnë nga përrënjet e kanalizimet, duke i humbur këtij lumi aftësinë vetëpastruese ose përcjellese të tij. Kjo gjëndje, ka favorizuar përmytje në të dy anët e shtratis nga reshjet intensive si dhe erozionin bregdetar. Dobësimi ekstrem i rrjedhes së tij, duke u kthyer vetëm në një magjistral kullues, ka ndikuar që të rritet edhe niveli i ndotjes së ujrave të tij, pasi këto ujra shërbejnë si ujra pritëse të mjaft shkarkimeve të lëngeta urbane e industriale. Në rrethanat aktuale, shtrati i lumit Drin të Lezhës, duhet të pastrohet herë pas herë për të garantuar mbrojtjen nga përmytjet. Rivitalizimi i lumit Drin, duke risjellë prurjet e veta natyrore të paktën deri në 30 m³/sek¹², do të shoqërohej me përmirsimin e kushteve hidrike, ekologjike e mjedisore në tërësi si dhe do të kontribuonte në zbutjen e erozionit bregdetar.

Lumi Mat

Mati buron nga lartësia e malit të Kaptinës së Martaneshit rreth 1873 m nga niveli i detit. Ky lum është 97km i gjatë me sipërfaqe ujëmbledhëse 2500 km² dhe kufizon nga ana jugore territorin e Bashkisë së Lezhës, në një gjatësi 27km, dhe derdhet në detin Adriatik. Prurjet mesatare vjetore të tij janë 85 - 1003 m³/sek. Lumi Mat, pasi arrin terrenin fushor, është i disiplinuar në të dy anët e shtratis të tij, më argjinatura mbrojtëse. Gjëresi e shtratis të lumit Mat, arrin deri në 1250 në afërsi të Milotiti dhe 1000 deri 1200 m në grykëderdhje. Mirëmbajtja e argjinaturave është një detyrë prioritare për mbrojtjen e zonës fushore në të dy anët nga përmytjet nga ujrat e këtij lumi. Ky lum është më i rëndësishmi për ushqimin me ujra të aquaferëve më të medhej si ai i Bregut të Matit në veri të shtratis të tij, nga ku furnizohet i gjithë sistemi i ujit të pijshëm për qytetet Lezhë e Shëngjin e periferitë e tyre, si dhe aquaferi i Fushë Kuqes në jug.

Uji i Matit shërben për furnizimin e sistemit ujites të të gjithë zonës fushore të Bregut të Matit deri në zonën e Manatisë e Ishull Lezhë më në veri. Kanali kryesor ujites për Lezhën, fillon me veprën marrëse në lumin Mat, në afërsi të urës së Zogut mbi këtë lum, i cili vazhdon në të gjithë kufirin ndarës të zonës malore e kodrinor me atë fushore të zonës drejt veriut sipas fshatrave Pllanë, Zejmen,

10 Medëet Technical reports 1998

11 Medëet Technical reports 1998

12 F.Hoxha. Konferenca shkencore "Potencialet ekonomike dhe njëzore të rajonit të Lezhës dhe prioritetet e zhvillimit për të ardhmen".

Markatomaj, Spiten, Tresh, Manati. Ky kanal lidhet me rrjetin shperndarës ujitës në pika të caktuara për të mbuluar të gjithë sipërfaqen bujqësore. Por ky rrjet është mjaft i dëmtuar nga fregmentarizimi i parcelave bujqësore pas privatizimit, ndertimet e reja, nga ndryshimi i destinacionit përdorues të tokës për aktivitete të tjera. Kjo situatë ka ndikuar në rritjen e shfrytëzimit të ujrave nëntoksore për ujtitje, duke varfëruar aquaferin ujëmbajtës të zonës së fushore në veri të shtratit të lumit Mat.

Me investimet e bëra është ngritur e përmirësuar argjinatura mbrojtëse prej 17 km për rritjen e sigurisë për parandalimin e përmytjeve (Bashkia Lezhë, 2018). Mbi lumin Mat janë ngritur dy hidrocentrale si ai i Ulzes dhe i Shkopetit në rrethin e Matit, të cilët në periudhë të reshjeve me intensitet të lartë, rrisin prurjet e ujit duke arritur niveli i tyre në hidrocentral në pikën kritike. Në këto kushte, bëhet e detyrueshme hapja e portave të shkarkimit duke ndikuar në rritjen e sasise së ujit në shtratin e lumit, gjë e cila përbën rrezik për përmytjen e ultësires bregdetare të Bashkisë Lezhë dhe Kurbin. Ky fenomen e ka rrezikuar në Nëntor të 2016, ku u morën masa të menjëhershme për mbylljen e ngritjen e argjinatures së dëmtuar duke eliminuar kështu rrezikun nga përmytjet.

FIG 88- Foto nga Lumi Matit



Burimi: Jak Gjini

Lumi Gjadër

Lumi Gjadër buron nga Lartësitë e Tërbunit të Pukës dhe Bjeshket e Kashnjetit si dhe ka një pellg ujëmbledhës 120km²dhe është i gjatë 40.5 km, me prurje mesatare vjetore, 8.8 m³/sek. Gjatë bonifikimit të fushës së Zadrimes, dhe pas vitit 1953, shtrati i natyror i këtij lumi u ndërpre me argjinaturë, për devijimin ujrave drejt digës së Spatharës, në Mjedë, për t'u bashkuar me ujrat e lumit Drin që shkojnë drejt lumit Buna. Shtrati i mbetur i lumit Gjadër, tashmë me ujra të nderprera, përshkon fushen e Zadrimes në një gjatesi prej 10km dhe bashkohet me lumen Drin në fshatin Gjadër. Ky shtrat lumi, tashmë shërben vetëm për kullimin e fushave të Zadrimes në këtë zonë. Pakesimi drastik i prurjeve nga kjo ndërhyrje në lumin Gjadër, ka ndikuar në venien në rrezik për përmytje në këtë zonë të Zadrimes, në të dy anët e shtratit të vjetër të këtij lumi. Në këto kushte, zbatohën masa të herë pas herëshme për pastrimin, thellimin e shtratit të tij si dhe rehabilitimin e argjinatures mbrojtëse në të gjithë segmentin fushor.

5.4 Ujërat nëntokësorë

Ujërat nëntokësorë në territorin e Bashkisë Lezhë ndodhen kryesisht në zhavorret ujëmbajtëse të akuiferit të Lezhës, e Fushë-Kuqes. Shfrytëzimi intensiv i këtij akuiferi ka filluar që në vitin 1964 me kryerjen e një sërë shpimesh me rrotullim dhe me goditje në zonën e Fushë Kuqes dhe Adriatikut. Pas vitit 1966 hynë në shfrytëzim edhe shpimet e Milotit nga ku merren rreth 460 l/s. Në këtë mënyrë vetëm nga akuiferi i Lezhës merren rreth 1300 l/s.

Përveç sasisë së ujërave nëntokësorë që merren si në krahun verior të Lumit Mat ashtu dhe në krahun jugor të zonës, një tjetër zonë në perspektivë për marrjen e burimeve ujore suplementare është edhe grykëderdhja e vetë Lumit Mat. Ky akuifer fillon nga bregu i djathtë i Lumit Mat dhe vazhdon deri tek Hoteli i Gjuetisë. Në afërsi të shtratit të lumit Mat, trashësia e zhavorëve arrin deri në 175m, ndërsa më në veri kjo trashësi është më e vogël. Trashësia e zhavorëve në pjesën lindore të rajonit zvogëlohet deri në pykëzimin e tyre dhe në ndonjë rast, si në Manati, ato kontaktojnë direkt me shkëmbinjtë rrënjësore.

Në pjesën verilindore të Ishullit të Shëngjinit, zhavorët, kontaktojnë me gëlqerorët e strukturës antiklinale të Rencit. Në dalje të Lumit Mat nga lugina e thellë erozionale (mbas grykës së Shkopetit), zhavorret e ujëmbajtëse të tij në Milot dalin mbi sipërfaqe dhe duke shkuar drejt perëndimit, veriperëndimit dhe veriut zhyten nën mbulesën suargjillore-suratore dhe ranore, duke formuar shtresat ujëmbajtëse zhavorore me presion. Në afërsi të rrjedhës së Lumit Mat, mbulesa pothuaj mungon fare ose ka trashësi më pak se 2-3m ndërsa në veriperëndim të fushës së Lezhës rritet deri 62-64m. Në akuiferin e Lezhës zhavorret në afërsi të lumit kanë trashësinë maksimale që shkon mbi 175m, ndërsa duke u larguar nga shtrati në drejtim veriperëndimor, brenda zhavorëve, në intervale të ndryshme shfaqen suargjilat.

5.5 Cilësia e ujërave

Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bazohet në tetë parametrat më kryesorë të ndotjes kimike të percaktuara në Direktivën Kuader të Ujit të Be. Sipas kësaj Direktive, ujërat e lumenjve klasifikohen në pesë klasa, ku gjendja e moderuar ose klasa e tretë, konsiderohet si klasa me nivelin minimal të pranueshem të cilësisë së ujërave të lumenjve.

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara. Sipas programit kombëtar të monitorimit, monitorimi bëhet më një një frekuencë 4 herë në vit, për shumicën e treguesve, me institucion përgjegjes për zbatimin e tij, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Të dhënat e siguruara nga ky proces, përdoren në hartimin e Raportit të Gjëndjes së Mjedisit në Republikën e Shqipërisë, në hartimin e informacioneve në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar, si dhe për raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit. Klasifikimi i cilësisë së lumenjve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të percaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE¹³.

Lumi Drini i Lezhë, për parametrat kimikë, monitorohet në një stacion, para derdhjes në det, poshtë urës së qytetit të Lezhës. Nga rezultatet e Monitorimit në stacionit në Lumin Drin, në këtë stacion rezulton:

TABELA 32- Rezultatet e Monitorimit të Ujrave të Lumit Drin në Stacionin e Lezhës

Klasifikimi	Oksigjeni i tretur	NBO ₅	NH ₄	NO ₂	NO ₃	P- total
2014	II	V	IV	II	I	I
2015	I	V	II	I	I	I
2016	I	IV	II	I	I	I
2018	III	II	II	III	III	II

Burimi: AKM (2018)

¹³ Vlerësimi i ekspeditave të realizuara është kryer duke u bazuar në parametrat e Direktivës Kuadër të Ujit për lumenjtë dhe liqenet, si dhe VKM 177 datë. 31.03.2005 - Normat e lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantet e trajtimit për zonat bregdetare.

TABELA 33- Gjendje e Cilësisë së Lumit Drin ndër Vite

	Klasifikimi 2014	Klasifikimi 2015	Klasifikimi 2016	Klasifikimi 2018
Drini Lezhë	V Gjëndje e keqe	V Gjëndje e keqe	IV Gjëndje e varfër	III Gjëndje e moderuar

Burimi: AKM (2018)

Sipas klasifikimit të cilësisë së ujit, të gjitha ujrat e basenit të lumit Drin paraqiten të Klasës së III, gjëndje e moderuar po ashtu edhe e ujrat e Basenit të Lumit Mat. Sipas studimit të kryer¹⁴, në afërsi të grykëderdhjes së lumit Drin, janë hasur nivele të larta të lëndëve organike (proteina 61%, karbohidrate 34%, lipide 5%), deri në 3,5 herë më të larta se parametrat e matur në zonat ku nuk ka aktivitet njerëzor. Të larta janë gjetur edhe vlerat e pigmenteve aktive fotosintetike (0,94 mg/m), ndërsa biomasa bakteriale dhe densiteti i tyre në sedimente paraqiten brenda normave. Funksonimi i pastrimit të ujrave urbane nëpërmjet impiantit të trajtimit ka ndikuar në zbutjen e situatës në lidhje me ndotjen e lumit Drin. Impianti i Pastrimit të Ujrave të Ndotura për Lezhën dhe Shengjinit, ndodhet 300m në të majtë të rrugës kryesore Lezhë Shëngjin dhe në lindje të kënetës së Knallës. Zona e shërbimit e këtij impianti trajtimi është e përbërë prej zonës urbane të qytetit të Lezhës dhe Shëngjinit . Popullsia e së cilës i shërbehet me trajtimin e ujit të ndotur është 30,000 banorë dhe impianti është projektuar për të përballuar një prurje mesatare rreth 1,920 m³/ditë. Teknologjia që përdoret për trajtimin e ujit të ndotur në impiantin e Lezhës është e bazuar në procese me rrugë biologjike. Terreni ku ndodhet impianti është kënetor. Impianti do të zgjerohet në një fazë të dytë për të trajtuar ujin për një popullsi rreth 51,000 banorë.

Impianti është i tipit biologjik me paratrajtim dhe është i pajisur me laborator dhe pajisje moderne për operimin dhe mirëmbajtjen. Impianti i Lezhës realizon trajtimin e ujërave të ndotura deri në nivel sekondar, me anë të metodës biologjike. Përderisa ujërat e ndotura të trajtuara do të shkarkohen në një zonë ujore të ndjeshme, zvogëlimi dhe respektimi i normave të ushqyesve si nitratet, nitritet dhe fosfatet janë jo vetëm të rekomandueshme, por edhe një detyrim për të siguruar një shkarkim ambiental të arsyeshëm dhe të vazhdueshëm, duke bërë një përmirësim të qëndrueshëm të kushteve. Në lumin Drin shkarkohen ujra të përdorura dhe nga disa subjekte si ato të përpunimit të peshkut, thertoret, fermat blegtorale të cilat kanë ndikuar në rritjen e buxhetit të ndotesve në ujrave e lumit Drin.

Për respektimin e standarteve ligjore mjedisore të shkarkimeve të lëngeta në ujrat sipërfaqësore kërkohet:

- Investimë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të trajtimit të shkarkimeve të lëngëta urbane sidomos për lumin Drin që kalon në shumë zona të urbanizuara dhe përfshirjen e të gjithë shkarkimeve urbane për pastrimin në impiantin e trajtimit të ujrave të zeza në afërsi të Knallës.
- Respektimi i standarteve ligjore për shkarkimet e lëngëta në ujrat pritëse sipërfaqësore nga subjektet prodhuese
- Kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes mjedisore të ujrave sipërfaqësore ndihmon në njohjen e gjendjes dhe marrjen e masave për përmirësimin e saj.

1.5.5 Deti Adriatik

Territori i Bashkisë së Lezhës, laget nga ana përdimore nga deti Adriatik në një gjatësi prej 28 km, prej të cileve 6 km janë bregdet shkembor ndërsa pjesa tjetër është zona e Portit të Shëngjinit dhe plazhet ranore me grykëderdhjet e lumejve Drin e Mat. Bregdeti i Bashkisë së Lezhës është pjesë e gjirit detar ndërmjet Shëngjinit dhe Rodonit icili ndër vite mbushej gradualisht

14. Spas Vlerësimit Strategjik Mjedisor, Bashkia Lezhë

me depozitimet lumore. Ky bregdet dallohet për një dinamizëm të fuqishëm të imponuar nga shkaqet natyrore ashtu dhe nga ato me karakter antropogjen. Një rol kryesor në ndryshimin e vijës bregdetare e kanë luajtur tre lumenjtë kryesorë Drin, Mat e Ishëm, por intensiteti i veprimit të tyre ka qenë i ndryshëm në kohë, mbasi ato shpesh janë luhatur në hapësirë dhe në kohë, dukuri kjo që është reflektuar edhe në proceset bregdetare.

Zona fushore e Lezhës ose zona bregdetare, është krijuar nga materialet e ngurta të lumenjve Drin e Mat në grykëderdhjet përkatëse të cilat shpërndaheshin në të dy anët e saj në formën e litoraleve e korridoreve duke formuar një kompleks ligatinor mjaft të pasur. Pas drenazhimit të zonës fushore në jug të qytetit të Lezhës, zona e Ishullit të Lezhës, e Shëngjinit si dhe ajo e bregut të Matit, u formuan sipërfaqe të konsiderueshme tokë sheshtë bujqësore. Pas drenazhimit të zonës fushore në jug të qytetit të Lezhës, nga ana përëndimore e bregdetare e kësaj sipërfaqje, mbeti e pakulluar, zona ligatinore me sjë sistem lagunor të pasur e cila që nga viti 1940 është menaxhuar si zonë e mbrojtur natyrore. Në këtë zonë, spikasin laguna e Merxhanit në veri të lumit Drin, ndersa lagunat Zaje e Cekë në anën jugore të grykëderdhjes së këtij lumi. Në këtë sistem është instaluar një biodiversitet mjaft i pasur si ai floristik dhe ai faunistik.

Shtrati i lumit Drin është luhatur në distanca të medha para sistemimit e drenazhimit të zonës fushore. Pas kësaj periudhe, veçanërisht në zonën ligatinore, verehen gjurmët e spostimeve të shtratit të këtij lumi. Argjinaturat në të dy anët e lumit Drin e Mat mbajnë të disiplinuar rrjedhat e tyre, por njëkohësisht kërkojnë mirëmbajtje të vazhdueshme për të siguruar qëujrat, të mos dalin nga shtrati e të krijojnë përmbytje.

Bregdeti i Bashkisë së Lezhës, prej dekadash është i përballur nga një erozion mjaft agresiv i shkaktuar nga pakësimi drastik i sedimenteve të ngurta të prurjeve të lumit Drin, si dhe nga rritja e frekuencës dhe e fuqisë së stuhive detare që godasin bregun. Konfirmohet nga studimet se zona është mjaft e ekspozuar nga ngjarjet ekstreme të klimës si stuhitë detare të shoqeruara me baticë mbi mesataren shumëvjeçare, përmbytjet intensive apo thatësira të tejzagjatura të cilat po bëhet mjaft frekvente. Vetëm në bregdetin e zonës Kune e Vain, veprimtaria e erozionit bregdetar ka shkatërruar sipërfaqe të konsiderueshme të plazhit dhe ka kontribuar në eliminimin ose destabilizimin e dunave dhe brigjeve lumore.

FIG 89- Foto Deti Adriatik



Burimi: Jak Gjini

Nga vitet 1970 e deri tani, llogaritete të jene eliminuar 362 ha sipërfaqe bregdetare (plazhe, duna e pyje aluvional etj) të zonës Kune -Vain. Dëme ka pasur dhe në aktivitetet social ekonomike si bujqësi, turizëm e peshkim, veprimtari këto mjaft të rëndësishme për komunitetin e zonës e më

gjërë. Si rezultat i këtij erozioni agresiv, është pranuar se deti po përparon në drejtim të tokës më një shpejtësi prej 2.5 m në vit. Një vatër depozitimi me sedimente në anën veriore të bregdetit e Ishullit të Kunës, nuk justifikohet me sasinë emadhe të sedimenteve të eroduar në anën veriore të gryderdhjes së lumit Drin. Ketu, identifikohet njëpërparim i detit në drejtim të lagunës Merxhan prej 200 m vetëm në dekadën e fundit. Avancimi i detit por rrezikon seriozisht jo vetëm asetet turistike të kësaj zonë por dhe komunitetin që vjen me pas, të fshatrave Ishull Shëngjin e Ishull Lezhë, nga përmbytjet të cilat po vijnë edhe nga deti, siç ishte ajo e 1 Janar të vitit 2010. Skenaret për impaktet nga ndryshimeve klimatike të zhvilluara për këtë zonë janë mjaft të frikshme.

FIG 90- Ndryshimi i Vijës Bregdetare



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020), bazuar në llogaritje nga foto ajrore

Për zbutjen e përmirësimin e situatës së tanishme, rekomandimet si dhe fish projektet¹⁵ e prezantuar nga ekspertë të fushës, mund të përmbliidhen në:

- Ndertimin e dallgëthyesve detare dhe njëkohesisht krijimin e dunave artificiale në breg e mbjelljen e tyre.
- Përforzimin e argjaturave mbrojtëse që ndajnë zonën ligatinore ose zonën e mbrojtur nga zona rurale e urbane pas saj si dhe asaj të lumit Drin e Mat, veçanarisht në gryderdhje.
- Ndermarrja e një sërë aktiviteteve të nderhyrjes që kanë të bëjnë me rritjen e shëndetit të ekosistemit të zonës bregdetare, ndalimin e faktoreve ndotës të degradues, shfrytëzimin sa më racional të burimeve natyrore, zbatimin e masave që kanë të bëjnë me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për të gjithë aktivitetet social ekonomike.

Është pranuar jo vetëm nga ekspertët e fushës por dhe nga vendimarrësit lokal se rivitalizimi i lumit Drin, duke risjell prurjet e tij të munguara, deri në 30 m³/sek¹⁶ do të përbente një kontribut të rëndësishëm jo vetëm në përmirësimin e gjithanshën mjedisor dhe në përshatjen e zonës ndaj efekteve të ndryshimeve të klimës por dhe në një përfitim të madh social ekonomik.

15 UNDP, Project proposals based on priority measures to adapt to climate change- Project "Identification and implementation of adaptation response measures to Drini-Mati River Delta".

16 F. Hoxha. Konferenca shkencore "Potenciallet ekonomike dhe njëzore të rajonit të Lezhës dhe prioritetet e zhvillimit për të ardhmen".

Ujrat bregdetarë të larjes, janë të ndikuar nga burime të ndryshme si: shkarkimet urbane, shkarkimet industriale, aktivitetet bujqësore dhe blegtorale, kafshët dhe shpendët e egra si dhe nga vetë banjatorët. Këto ujra përmbajnë mikroorganizma të cilat kur bien në kontakt me njeriun shkaktajnë infeksionetë përgjithësi dhe përmbajnë përzjerje të mikroorganizmave patogjenë dhe jo patogjenë.

Monitorimi mikrobiologjik i ujrave bregdetarë të larjes ka të bëjë me percaktimin e ngarkesës bakteriale të ujrave bregdetarë të larjes në Plazhin e Shengjinit dhe të Tales për 2 për indekset kryesore të ndotjes: *Escherichia Coli* dhe *Enterococcus Intestinalis*. Këto mikroorganizma, në kontakt me njeriun, shkaktajnë infeksione të ndryshme gastrointestinale, infeksione të rrugeve të frymemarrjes, të syve, veshëve, hundës, të lëkurës si dhe infeksione mykotike të cilat janë jo pak të shpeshta tek banjatorët.

Plazhi i Shengjinit, monitorohet në 5 pika, përkatësisht tek Ish Kabinat, Hotel Doro, Hotel Kristian, Bar Restorant Gjahtari dhe pika e monitorimit në Kune (Klubi Ekologjik Lezhë, 2018). Nga të dhënat e referuara gjatë vitit 2018, por dhe e viteve të mëparshme, vlerësohet se në të gjitha stacionet e monitorimit, prania e *Escherichia Coli* dhe e *Enterococcus Intestinalis*, në ujërat e larjes, është nën normen e lejuar duke i klasifikuar¹⁷ këto ujëra të një cilësie të shkëlqyeshme, ndersa vetëm tek pika pranë Hotel Doro, për praninë e *Enterococcus Intestinalis*, vlerësohet e cilësisë së mirë.

Edhe plazhi i Tales, po frekuentohet shumë në vitet e fundit dhe është shumë i preferuar nga një numër në rritje i pushues vepër natyrën dhe qetësinë që ofron. Nga monitorimi mikrobiologjik i këtij plazhi në tre stacione, kampionimi si hyrja qëndore tek Palmat - djathtas, në qëndër të hyrjes - tek Antena, hyrja qëndore- majtas tek Bar Restorant USA, rezultojnë së cilësia e ujrave është nën nivelin e normes së lejuar duke i klasifikuar këto ujëra të një cilësie shumë të mirë. Po kështu dhe nga inspektimi higjieno – sanitar për të dy plazhet, është vënë re që ka një sistemim të bregut, pastrim të rëres si dhe prani të dushëve publike.

5.6 Gjendja në Mjedis

Marrëdhia e mjedisit natyror e atij urban të Lezhës më larminë e specifikat që ka, me faktorin antropogjen si pjesë e këtij mjedisi, dhe ekspozimi ndaj ndryshimeve të klimës, ka ndikuar në një shumëllojshëri të problematikave mjedisore. Agjensia Kombëtare e Mjedisit, zbaton programin kombëtar të monitorimit të mjedisit në Republikën e Shqipërisë, në të cilin përfshihen dhe një numër i konsiderueshëm indikatorësh mjedisor për Bashkinë e Lezhës, rezultatet e të cilit i publikon në një frekuencë njëvjeçare në Raportin mbi Gjëndje e Mjedisit. Analizimi i gjëndjes së mjedisit ndihmon në identifikimin e ndotjes së ujërave dhe ajrit, shpërdorimin e burimeve, humbjen dhe degradimin e tokës, energjinë e nevojshme që harxhohet, si dhe lidhjen që kanë qytetet me zhvillimet periferike etj si dhe ndihmon në marrjen e masave rehabilituese e përmisuese për një zhvillim të qëndrueshëm.

Biodiversiteti, sipërfaqet e gjelberta

Veçoritë klimatike, pozicioni gjeografik, relievi dhe faktorët hidrologjikë, gjeologjikë dhe pedologjikë të territorit të Bashkisë së Lezhës, kanë favorizuar një larmi të konsiderueshme të habitateve natyrore dhe që ofrojnë kushte për ekzistencën e një flore e faune të spikatur. Në afërsi të qytetit të Lezhës ndodhen përgjithësisht të gjitha tipet e ekosistemeve dhe të habitateve

17 Klasifikimi është kryer sipas VKM me nr. 797, datë 29.09.2010 për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujrave të larjes", në përshtatje me Direktivën 2006/7/KE, datë 15 Shkurt 2006 "Për administrimin e cilësisë së ujrave të larjes".

të shumtë që përfaqësojnë vendin tonë (dhjetra km ekosisteme detare e bregdetare me duna të shumta rëre, ligatinat e Kunes, Vainit, Tales, lumejt Drin e Mat e deltat e tyre, liqeni i Knallës). Shkurret mesdhetare, gjethëgjera e konifere dhe pyje te përzier, kullotat dhe lugina te zonave malore e kodrinore afrojnë shumëllojshmëri të bimëve e kafshëve.

Ndër dëmet në biodiversitet mund të përmendën humbja e copëzimi i habitateve, dëmtimi, varfërimi dhe degradimi i ekosistemeve dhe i habitateve, shqetësimi e përndjekja e kafshëve të egra në natyrë, prishje nga rrëshqitjet dhe erozioni, ndertimet pa leje etj. Gjatë viteve të tranzicionit, florës spontane të Bashkisë Lezhë i janë shkaktuar dëme të konsiderueshme. Janë dëmtuar në mënyrë të theksuar vegjetacioni me shegë të eger të shpateve, dushqeve si dhe pyllzimeve me me pishe e akacie. Kritike paraqitet gjendja nga shfrytëzimi intensiv i bimëve mjekësore dhe etero-vajore si sherbela e trumza për për eksportin e tyre.

Pakësimi i sipërfaqeve publike të gjelbërta nga zhvillimi i shpejtë urban veçanërisht pas viteve 1990, dëmtimi e fragmentimi i habitateve, shkarkimet ndotëse, dendësimi i zhvillimit urban e i aktiviteteve në qytet, kanë ndikuar në paksimin drastik të popullatave faunistike veçanërisht të shpëndeve të ujit e të pasurive ihtike si dhe të llojeve të tyre. Megjithë përmirsimet në menazhimit të aktiviteteve të peshkimit si dhe të zonave të mbrojtura në tërësi, përsëri biodiversiteti vuan pasojat nga peshkimi dhe gjuetia e pakontrolluar në vitet e tranzicionit.

Hapësirat e gjelbërta përbëjnë disa nga vlerat e mëdha të qëndrave urbane të Bashkisë së Lezhës, veçanërisht nga ana ekologjike. Sfida më e madhe në këtë periudhë është ruajtja nga dëmtimet dhe ndertimet pa leje. Kërkohet në të ardhmen marrja në mbrojtje dhe menaxhimi i kurorës së gjelbërt të qytetit të Lezhës, krijimi i një identiteti sa më të përtaft me atë që i ka dhuruar natyra, ku më rëndësi të veçantë është marrja e sipërfaqeve të terrenit në mbrojtje e krijimi i një parqeve natyrore, në periferi të qytetit, mbi lagjen Nënë Tereza si dhe në kodrën e Kalasë së këtij qyteti.

FIG 91- Biodiversiteti



Burimi: Jak Gjini

AKM, monitoron për biodeversitetin gjëndjen e monumentet natyrore, gjëndjen e disa specieve aromatiko-mjeksore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje si dhe gjëndjen e shendetit dhe e vitalitetit në pyje por për këto fusha nuk është i përfshirë territori i Bashkisë së Lezhës.

Kërkohet në vazhdimësi:

- Përmirsimi i habitave, pakësimi i ndotjeve dhe i presioneve të tjera ndaj mjedisit natyror si dhe ndërmarrja e veprimtarive që rikthejnë llojet e gjallërojnë popullatat faunistike e si rezultat cilësinë e mjedisit duke e bërë atë më tërheqës, më të shëndetshëm e rilaksues.
- Ndergjegjësimi i komunitetit për sjellje më miqësore ndaj mjedisit është një komponënt tjetër mjaft i rëndësishëm për një jetesë më denjtoze e në mirqënie.

Toka

Menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj mbetet një ndër sfidat mjedisore mjaft të rëndësishme. Zënia e tokës me ndërtimet në infrastrukture prodhojnë ndikime të gjëra të pakthyeshme, e që kanë të bëjnë me një ndryshim në përdorimin e saj. Toka bujqësore dhe pyjet, pësojnë shkaterrime të parikthyeshme nga ndërtimet e reja. Këto ndikime sjellin humbjen e përherëshme të funksionit të tokës për prodhime bujqësore.

Veçanërisht pas viteve 1990 ndodhën tjetërsime të konsiderueshme të tokavë bujqësore e sipërfaqeve pyjore etj, nga aktiviteti ndertimor dhe nga zhvillimi i pakontrolluar urban. Këto ndikime kanë qënë mjaft të shprehura në zonën fushore në jug të qytetit të Lezhës, zona e bregut të Matit. Strategjia territoriale e Bashkisë së Lezhës (2016) bën një analizë të hollesishme të zhvillimit të territorit duke përcaktuar dhe vënë nën kontroll zonat e lejuara për ndertime në të ardhmën.

Pas demolimit të ish fabrikës së Letres dhe mbylljes së landefillit në veri të qytetit të Lezhës, nuk vlerësohet asgjë tjetër në territor ne nivelin e hotspotit në aspektin e ndotjeve të tokës. Ndersa erozioni bregdetar në zonën Kune - Vain - Tale po tjetëron sipërfaqe të konsiderueshme mjedis ligatinor në mjedis detar, asgjëson plazhe e formacione dunash të mbetura, pyje bregdetara, e po rrezikon mjaft asete turistike e infrastrukurore. AKM bën monitorimin e tokës në stacionin në Ishull Lezhë, (Al. 490, me koordinata 41° 45'10" N 19°35'31" E) për treguesit pH, LO, N, P dhe konfirmohet përshtatshmëria e tokave për një shumëllojshmëri kulturash bujqësore në vartësi dhe të kushteve klimaterike (AKM, 2018). Nga ky rezultat rekomadohet për fermerët e këtyre zonave se duhet të tregojnë kujdes me praktikat agronomike për të mos ndikuar në degradimin e tokës. Veç kësaj, në tërësi për mbrojtjen e tokës, kërkohet respektimi i standerteve mjedisore të shkarkimeve nga aktivitetet industriale e veprimtaritë e tjera me ndikim në mjedis, zbatimi i kushteve të lejes mjedisore, e forcimi i kontrollit e monitorimit.

Ajri

Ndotja e ajrit është një ndër rreziqet më të medha mjedisore. Shkarkimet ndotëse në ajër kanë ardhur në rritje në rritje në kushtet e një trafiku të rënduar në vendin tonë si dhe nga burime të tjera të aktiviteti human dhe burime natyrore. Ndotja e ajrit ndikon në shëndetin human, ekosistem, dhe kontribuon fuqishën në ndryshimet klimatike. Emetimet e ndotesve të ajrit transferohen në distanca të largëta.

Nga monitorimet e cilësisë së ajrit, rezulton se në territorin e bashkisë Lezhë nuk ka "pika të nxehta", mjedisore, që kanë të bëjnë me shkarkime potenciale në ajër. Nga matjet e kryera ne 4 pika të qytetit të Lezhës, për PM10, NO2, SO2, O3 dhe Benzenin, konfirmohet se nuk ka tejkalim të normave me përjashtim të kryqëzimit për Shkoder ku kemi tejkalim të PM10 afërsisht me 10% (Klubi Ekologjik Lezhe, 2018).

Nga aktivitet potenciale industriale që mund të ndikojnë në ndotjen e ajrit në territorin e Bashkisë së Lezhës, evidentojmë:

- Fabrike çimentos, Gocaj, NJ.A. Balldre, që gjatë procesit të punës mund të çlirojnë sasi të konsiderueshme të CO, SO2, NOx dhe gjithashtu të ndikojnë në rritjen e sasisë së grimcave

të pluhurit në ajër me diametër 10 mikrometer ose edhe më të vogël.

- Fabrikë e tullave, gjatë zhvillimit të aktivitetit mund të çlirojnë sasi të mëdha monoksid karboni (CO), okside të squfurit (SO_x), okside të azotit (NO_x) si edhe grimca të pluhurit në ajër me diametër 10 mikrometër ose edhe më të vogël (PM10).
- Aktivitet e shfrytëzimit të gurit gelqëror kanë mundësi potenciale për të ndikuar negativisht në mjedis natyror, jo vetëm në pejsazh e biodiversitet etj por edhe në ndotjen e ajrit sidomos nga emetimet grimcave të pluhurit me diametër 10 mikrometer (PM10).
- Në territorin e B. së Lezhës gjenden 2 pika të mëdha të përpunimit të mermerit te cilat mund të ndikojnë negativisht në mjedis kryesisht nga pluhurat e krijuara gjatë procesit të punës.
- Subjektet që ushtrojnë aktivitet e sipërpërmendura vetmonitorojnë shkarkimet në mjedis në AKM e DRM, në zbatim të detyrimeve ligjore, e kërkesavë të lejes mjedisore.

Për qytetin e Lezhës, nuk ka të dhena në lidhje me shkarkimet industriale e ndikimet e tyre. Pozicioni gjeografik i aktiveveve industriale si dhe kushtet klimaterike, sidomos drejtimi i erës në juglindja në periudhën e ftohtë dhe veriperendim në periudhën e ngrohtë, bën që qyteti të mos jetë i ndikuar nga këto shkarkime. Rezultatet e monitorimit të treguesve cilesisë së ajrit në mjediset urbanë të qytetit të Lezhës, konfirmojnë respektimin e normave ligjore të lejuara, konfor standarteve të Bashkimit Europian.

Zhurmat

Sipas legjisllacionit të OBSH (Organizata Botërore e Shendetësisë), zhurma mjedisore përcaktohet si: "Një tingull i jashtëm i padëshiruar dhe demshëm, i shkaktuar nga veprimtaritë njerëzore kryesisht por edhe natyrore". Rritja e rimit të urbanizmit, zhvillimi i transportit, shtimi i aktiveve të sherbimit social si dhe rritja e përdorimit të makinerive dhe pajisjeve në aktivitete të ndryshme, kanë ndikuar në një gjenërim të shtuar të zhurmave në mjedis në mënyrë të veçantë në tre dekadat e fundit.

Bashkitë janë përgjegjëse për sigurimin në nivel vendor të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Në këtë fushë (ndotjes akustike), Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2017-2020 (Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2017) parashikon reduktimin e ndotjes akustike me 30% në zonat kryesore urbane krahasuar me vitin 2012 ku vlerat mesatare të zhurmës:

- Gjatë ditës të reduktohen nga 70 dB(A) në 56 dB(A)
- Gjatë natës të reduktohen nga 55 dB(A) në 45 dB(A)

Linjat kryesore të transportit të njerëzve kryhen kryesisht me fugonë dhe me autobuzë. Këto linja shtrihen pothuajse në të gjithë territorin e Lezhës e cila përshkohet nga 130.45 km rrugë kombëtare (ose 44.5 përqind të rrjetit kombëtar qëpërshkon bashkinë), 80 km rrugë rajonale dhe 282.5 km rrugë komunale (ose 68 përqind të rrjetitkomunal të qarkut) (Bashkia Lezhë, 2019).

TABELA 34- Numri i Automjeteve në Bashkinë Lezhë

Nr.	Emertimi	Gjithsej 2008	Gjithsej 2009
1	Autovetura	264828	281236
2	Mikrobuza, autobuza	6645	6594
3	Kamiona+ A.T.P.	79054	79905
4	Makineri Bujqësore	1987	1969
5	Motomjete	18329	20874
6	Rimorkio	7217	7403

Burimi: Bashkia Lezhë (2019)

Po ashtu, Bashkia e Lezhës përshkohet dhe nga segmenti hekurudhor Vorë- Shkodër me dy stacione qëndrimi brenda këtij territori, Lezhë e Baçel. Sektori i shërbimeve publike (disko, bare, klube nate, kafene, restorante, lokalet që organizojnë ceremoni dasmash, evente të tjera familjare e sociale etj.)përbën një burim tjetër potencial të gjenerimit të zhurmave në mjedis. Po kështu aktivitetet e ndryshme të shërbimeve si dhe ato ndertimore e industriale që përdorin pajisje e makineri të tilla si gjeneratorët e tipeve dhe madhësive të ndryshme, pajisjet e shpimit të betoneve, asfalteve (matrapik, çekiçet pneumatike, trapanet etj), pajisje të prerjes së metaleve dhe drurëve (sharrat, zmerilues etj.), pajisjet e presimit, vibrimit, rulimit,eskavatorët, vinxhat, etj, janë kontributorë të gjenerimit të zhurmave në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka realizuar për vitin 2018 “Monitorimin e zhurmave urbane në qytete të ndryshme” përfshirë për herë të parë dhe qytetin Lezhë. Monitorimi është realizuar për dy tregues LAeq ditën dhe LAeq natën (niveli mesatar ekuivalent i zhurmës) në dy stacione monitorimi dhe të dhënat mesatare të monitoruara janë paraqitur në formë tabelare si vijon:

TABELA 35- Rezultatet e Monitorimit të Zhurmave në Qytetin e Lezhës

Stacionet e monitorimit	LAeq Ditën	LAeq Natën
Kryqëzimi L.Gurra	60.09	47.32
11 Janari	62.37	51.45
Norma	55	45

Burimi: AKM, (2018b)

Bashkia e Lezhës ka hartuar planin e veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis (Bashkia Lezhë, 2019) i cili parashikon marrjen e masave për reduktimin e tyre dhe respektimin e standarteve ligjore në këtë drejtim.

Ndër rekomandimet kryesore për zbutjen e zhurmave në mjedis, evidentojmë:

- Zbatimin e kerkesavë teknike e ligjore e forcimin e kontrollit, për të gjithë llojet e mjeteve motorrike transporteve, përmirsimin e infrastrukturës së transportit e mbullimi i të gjithë rrejtit me sinjalistikën për zhurmat.
- Zbatimi i masave që lidhen me liçensimin mjedisor e të gjitha aktiviteteve si dhe respektimin e standarteve ligjore për zhurmat, forcimi i kontrollit e monitorimit.

Uji

Bashkia e Lezhës disponon një mjedis natyror mjaft të pasur me burime ujore për plotësimin të gjitha nevojave për përdorim. Impaktet me potenciale në mjedisin ujor në tërësi lidhen me zhvillimin e sektoreve kyç që ndikojnë në funksionimin natyror të baseneve ujore si ujësjellës/kanalizimet, vaditja, bujqësia dhe blegtoria në përgjithësi, industria ushqimore dhe përpunuese, shërbimet dhe turizmi, shëndetsia etj. Përmirsimet në menaxhimin e ujrave të pijshëm në Bashkinë e Lezhës, ka ndikuar në një përdorim ma racional të burimeve ujore dhe në parandalimin e ndotjeve. Nga monitorimi ditor i cilësisë së ujit të pijshëm për cilsistë fizikokimike e bakteriologjike nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor nuk ka konfirmime për raste të ndotjeve në rrjetin e furnizmit me ujë të pijshëm.

Nga monitorimi i cilësisë së ujrave nëntoksore, nga AKM për Basenit e Matit në 7 stacione¹⁸ dhe që i përkasin territorit të Bashkisë së Lezhës rezulton me tregues jo te mire kimik, stacionet:

¹⁸ Basni i Matit me Kod AI200, dhe stacionet: Stash R, stash PML, st. Shengjin, 45 H. Gjuetise, 50 Barbulloje, 2S Rrile, B. Bargjanës, me frekuence matjesh 2 here ne vit.

- Lezhë - Barbullonjë, me përmbajtje mbi normë të Na. dhe përmbajtje nën normë të Ca e Mg e Fp.
- Shëngjin - I. Lezhë, përmbajtje në rritje të Fe e NH₄, dhe përmbajtje nën normë të Ca e Mg e Fp.
- Rrilë, përmbajtje mbi normë të Na, Mg, Cl, SO₄ Fp, Mp, Mth, - shtresat e poshtme ujembajtëse, ujë jo i pijshëm.
- Hoteli i Gjuetisë, përmbajtje mbi norme të Na, Cl, NH₄. Dhe përmbajtje nën normë të Ca e Mg e Fp.

Po kështu në disa stacione vërehet njëpërmbajtje e lartë mbi atë të rekomanduar të disa treguesve të Cl, Mg, Na, SO₄ si dhe zona që mbulohen prej tyre me përmbajtje të natriumit Na, klorit Cl, sulfatëve SO₄ mbi normë. Këto shpime shfrytëzojnë shtresat ujembajtëse të thella dhe nuk shfrytëzohen për ujë të pijshëm.

Nga monitorimi nuk vërehen ndotje masive. Në disa shpime në faza të ndryshme të monitorimit shfaqet prezenca e NO₂, NH₄, të cilat janë raste që përsëriten dhe lidhen kryesisht nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare (st. nr. 46 H.Gjuetisë – Lezhë).

Funksionimi i impiantit të trajtimit të ujrave të zeza në afërsi të Knallës që i shërben zonës urbane të qytetit të Lezhës dhe Shëngjinit ka ndikuar në uljen e nivelit të ndotjes së ujrave të lumit Drin. Popullsia së cilës i shërbehet me trajtimin e ujit të ndotur është 30,000 banorë dhe impianti është projektuar për të përballuar një prurje mesatare rreth 1,920 m³/ditë dhe pritet që në vitet e ardhshme të rritet kapaciteti.

Për përmirsimin e metejshëm të treguesve të cilësisë së ujrave, rekomandohet:

- Sh.A. Ujësjiellës Kanalizime Lezhë, të zbatojë zonat e rreptësisë sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit për mënjanimin e ndotjeve të ujrave nëntoksore.
- Institucionet që administrojnë basenat ujore dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit të kontrollojë, monitorojë e ndalojë depozitimin, hedhjen e mbeturinave urbane në shtretërit e lumëve për ruajtjen e cilësisë së ujrave nëntoksore, pasi këto janë dhe zonat e ushqimit të akuiferëve ujembajtës.

Administrimi e menaxhimi i mbetjeve

Mbetjet janë produkt i metabolizmit të një qyteti, kur ky i fundit konceptohet si një organizëm i madh i gjallë e që ka nevojë për energji dhe burime për të funksionuar. Fluksi i mbetjeve në këtë proces ka të bëjë me sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen.

Shërbimi i grumbullimit e evadimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit të Bashkisë së Lezhës dhe Shëngjinit si dhe të gjitha Njesive Administrative, me përjashtim të asaj të Ungrejt. Në territorin e Lezhës shërbimi ofrohet në nivel 80 - 100%. Venddepozitimi i mbetjeve për këtë Bashki ndodhet jashtë territorit të bashkisë së Lezhës, në Landfillin e Bushatit të Bashkisë së Shkodrës. Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg (qytete) dhe 0.4 kg (fshatra). Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara siç është qyteti i Lezhës. Sasia e mbetjeve të gjeneruar në këto, në zonën urbane, arrin vlerat 1,745 - 5,085 ton/mbetje për km² në vit. Sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme të gjeneruara për vitin 2018 në spitalet shtetërore të Lezhës është 8976.4 kg (Bashkia Lezhë & UTS-01, 2016b).

Kompanitë e pastrimit, mbi bazën e marrveshjeve që bazohen dhe në dokumentat strategjik për mbetjet janë të detyruara të investojnë në drejtim të riciklimit të mbetjeve. Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e bashkisë Lezhë është përafërsisht 78.6%, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 47%, 15% plastika dhe 12% letra. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye

se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin e këtij procesi. Gjenerimi i mbetjeve urbane në Bashkinë e Lezhës për vitin 2018, është si vijon:

TABELA 36- Sasia e Mbetjeve Urbane

Nr	Llojet e mbetjeve	Sasia , kg
1	Mbetjeve organike shtepiake	16 347 500
2	Mbetje inerte	3.950.000
3	Spitalore jo te rrezikshme	7200
4	Mbetje plastike	1.944.000
5	Qelqi	3.198.000
6	Metaliqe	557.000
7	Driri	1.100.000
8	Leter e karton	2.248.000
9	Bateri jashte perdorimit	16.750
10	Vajra të përdorur	12 000
11	Nga produktet e kafsheve	30.000
12	Elektrike e elektronike	3000
13	Të depozituara ne landfill	24.118.250

Burimi: Bashkia Lezhë & UTS-01, 2016b

Peisazhi

Territori i Bashkisë së Lezhës dominohet nga peisazhenatyrrore e urbane tërheqëse. Larmia e rilievit, rrjeti hidrik i pasur, mjediset ligatinore, monumentet natyrore e kulturore, objektet arkeologjike e historike, ekspozimi i me detin Adriatik etj janë pjesë të vlerave të pakrahasueshme të peisazhit dhe e vetë identitetit të kësaj Bashkie. Krahas saj, në përmirsimin e peisazhit urban është ndikuar pozitivisht nga ndërtimi i shetitores (pedonales) në të dy anët e lumit Drin, (në argjinaturat mbrojtëse të shtratit të tij). Lidhja e pedonales (shetitores me parkun arkeologjik të vëndvarrimit të Skenderbeut), dizajnimi i urës së qarkullimit të automjeteve mbi lumin Drin, marrja në mbrojtje e zonës buffer rreth kalasë e krejt zonës arkeologjike, zgjidhja e ndriçimit në disa nga këto mjedise, influencojnë në përmirsimin e dukshëm të peisazhit urban të qytetit njekohesisht influencojnë në rritjen e kënaqësisë e komoditetit e banoreve dhe vizitoreve për këtë qytet. Rikualifikimit i sheshit kryesor të qytetit, parkut arkeologjik e atij të gjelbert ka ndikuar në rritjen e vlerave të peisazhiste të qytetit të Lezhës. Krahas zhvillimeve që synohet të ndodhin në harmoni me mjedisin natyrorë, zhvillimi i pakontrolluar urban nëdisat vatra të qytetit Lezhë e Shëngjin si dhe në mjaft zona informale, mosrehabilitimi i vendeve nga shfrytëzimi i gurit gelqeror ose i karrierave të zhavorëve, prerja pa kriter e pyjeve, hedhja e mbetjeve urbane në disa përrënjë e kanale etj, ka ndikuar negativisht në vlerat e peisazhit.

6 ZHVILLIMI URBAN

6.1 Tipologjitë hapësinore

Qyteti i Lezhës karakterizohet nga nje miks tipologjish hapësinore e ndërtimore, duke qenë i rrethuar nga sistemi kodrinor në anën lindore, dhe i ndarë nga shtrati i Drinit në pjesën perëndimore të qendrës së qytetit. Territori urban ka një miks mes kompaktësisë në zonën qëndrore dhe në disa zona periferike, dhe shpërhapjes urbane në tokë bujqësore e kodrinore në

zonat e tjera. Në aspekt tipologjik në qytetin e Lezhës dallohen 4 zona kryesore:

ZONA MIKSE QËNDRORE

Kjo zone karakterizohet nga ndërtesa gjatësore kolektive të lartësisë 4-5 kate, si dhe ndërtesa të kolektive të tipit kullë të pas viteve 2000, me variance lartësie nga 4 në 10 kate. Kjo zone ofron hapësira relativisht të bollshme dhe përshkruhet nga rrugë automobilistike në gjithë perimetrin dhe brendësinë e saj.

ZONA KODRINORE ME BANESA KOLEKTIVE

Kjo zone karakterizohet nga ndërtimi në terren kodrinor, me tipologji mikse kolektive të tipit kullë, dhe individuale. Përgjithësisht aksesit në zone është i vështirë, dhe afërsia e ndërtesave nga njëra tjetra e lartë

ZONA FUSHORE ME NDËRTESA INDIVIDUALE

Kjo zone karakterizohet nga ndërtesa të ulëta të lartësisë 2-3 kate, të pozicionuara në mënyrë kuadratike ose lineare përgjatë rrugëve kryesore. Këto zona paraqesin rrezikshmëri të ulët në rast fatkeqësish, për shkak të pranisë së oborreve, por kanë distance të madhe nga zonat qendrore

ZONA INFORMALE

Kjo zone ka të njëjtat karakteristika me zonën fushore me ndërtesa individuale, por janë informale, në proces legalizimi, dhe densiteti i ndërtimit është më i lartë. Në këto raste problematika kryesore lidhet me procedurat ligjore për zhdëmtim dhe rehabilitim të pronës.

6.2 Densiteti i banimit

Përgjithësisht qyteti i Lezhës ka densitet të ulët, me intensitet mesatar 1.5. Zona e tipologjisë mikse qendrore arrin intensitet 3.5, ndërsa zonat e tjera mesatarisht nga 0.8 në 1.5.

Në nivel propozimesh në Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lezhë mban intensitet të njëjtë, dhe propozon disa ndërhyrje infrastrukturore, si dhe pedonalen anës lumit.

Gjithsesi standardet bazë për sigurimin e hapësirës së gjelbër, hapësirës publike, terreneve sportive, parkimit nuk zbatohen për gjithë territorin. Këto standarde kanë qenë pjesë e rregullores së planifikimit, tashmë të shfuqizuar. Treguesit respektive ishin:

- Terren sportiv: 1,6 m²/banor
- Gjelbërim: 2,5 m²/banor
- Struktura e hapësira publike: 2 m²/banor
- Parkim: 6 m²/banor

Ndërkohë, edhe standardet mbi distancat ndërtesë-ndërtesë nuk zbatohen në gjithë territorin. Aktualisht, kjo distance në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit llogaritet si:

$$D = NrK_1 + NrK_2 + 2m$$

FIG 92- Evidentimi i Tipologjive Hapësinore në Qytet



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

Më poshte paraqitet vlerësimi i respektimit të distancave për zonën me tipologji mikse qendrore. Qartësisht në pjesën më të madhe, distancat ruhen, sepse densiteti i ndërtimit nuk është i lartë. Gjithsesi, në disa grupime banesash, këto distanca minimale nuk respektohen:

- në zonën afër Policisë Bashkiake
- në afërsi të Hotel Liss
- në grupin e banimit pas Katedrales
- në zonën kodrinore pranë spitalit

Kështu, zona të tilla rrezikohen nga evente të mundshme sizmike, për shkak të efektit domino të rënies së ndërtesave, aksesin më të dobët në to nga mjetet e emergjencës, si dhe mundësive më të kufizuara të evakuimit.

Përvec kësaj, treguesi i distancës mundëson edhe një performancë energjitike më të mirë të lagjes, si dhe kushte të mira diellëzimi e intimiteti. Prandaj, është e nevojshme të sigurohet zbatimi i standardit minimal të distancave, dhe përmirësimi eventual i këtij standardi në vlera më të larta, si psh: matje me këndin 45gradë.

E njëjta gjë vlen për standardet e planifikimit, të cilat janë totalisht të shfuqizuara.

6.3 Lidhshmëria aksiale

Aspekti i lidhshmërisë është analizuar nëpërmjet sintaksës hapësinore aksiale. Kjo metodë analizon në mënyrë automatike numrin e pikave të ndërprerjes së çdo linje¹⁹, duke i atribuar atij numri një ngjyrë. Linjat përcaktohen nga largësia maksimale që mund të përshkruhet mes dy pikave, pa pengesa fizike mes tyre. Në këto lloj analizash, të përdorshme gjerësisht në studime morfologjike në 2 dhjetëvjeçarët e fundit, aksesueshmëria më e mirë tregohet me ngjyrë të kuqe e ajo më e dobët me ngjyrë blu. Në thelb kjo analizë mat numrin e akseve që ndërthurren e një aks të dhënë, dhe vazhdimësinë e këtij aksi, pa hasur në ndërprerje fizike.

FIG93- Vlerësimi i Ruajtjes së Distancës Ndërtesë-Ndërtesë: Tipologjia Mikse Qendrore



Burimi: MetroPOLIS, Co-PLAN, UNDP, Bashkia Lezhë (2020)

FIG 94- Analiza e Lidhshmërisë Aksiale në Qytetin e Lezhës



Burimi: autorët, përpunuar në Depthmax (UCL)

19 Hillier B, 1996 Space is the Machine: A Configurational Theory of Architecture (Cambridge University Press, Cambridge)

Analiza e kryer për qytetet e Lezhës tregon se kemi dy kategori rezultatesh: lidhshmëri aksiale e mirë dhe normale për zonën qendrore të qytetit, si dhe lidhshmëri të dobët për pothuajse gjithë pjesën tjetër të qytetit. Kjo lidhet kryesisht me faktin se qendra ka një rrjet kuadratik rrufor, që bashkon akset kryesore (bulevardin dhe unazën) në mënyrë të plotë. Bulevardi kryesor rezulton të jetë rruga më e aksesueshme e qyteteve në studim, pasi me të lidhen pjesa më e madhe e akseve të tjera të qytetit. Duhet theksuar se kjo analizë cilëson në mënyrë relative aksesueshmërinë e një aksi në raport me gjithë akset e tjera të të njëjtit qytet. Kjo do të thotë që kushtet e largimit në raste emergjence janë më të larta vetëm në qendër, por nuk kanë vazhdimësi lineare më tej.

Ky vlerësim evidenton edhe 'analizën e zgjedhjes', pra probabilitetin e përzgjedhjes së rrugës optimale për të arritur një destinacion i caktuar në raport me pika të tjera të hapësirës. Duke konsideruar se qendra ka edhe hapësira evakuimi, kjo analizë rezulton positive për qytetin. Në terma të përgjithshme, nga lidhshmëria aksiale kuptojmë që:

- Zonat me ndërtesa gjatësore, të densiteteve të ndryshme, ofrojnë lidhshmëri më të lartë se zonat mikse
- Rrjeti kuadratik i rregullt gjithashtu ofron lidhshmëri më të mirë në nivel qyteti
- Pavarësisht se ofrojnë përshkueshmëri të ulët, zonat me vila, kur pozicionohen në pjesë qendrore të qytetit, krijojnë lidhje të mira dhe rrjet kuadratik të rregullt
- Zonat me tipologji ndërtesash gjatësore mikse me vila e kulla përgjithësisht krijojnë lidhshmëri të dobët dhe integrim të pakët hapësinor

Përvec analizës së lidhshmërisë aksiale, e cila i referohet kryesisht rrugëve të përshkueshme me automjete, nëpërmjet sintaksës mund të analizojmë dhe hapësirat, lidhur me përshkueshmërinë e territorit në këmbë dhe


Kjo analizë bëhet në nivel lagjeje ose kompleksesh banimi. Më poshtë paraqiten rezultatet për lagjen e stadiumit, për 3 nivele: lidhshmëria hapësinore, integrimi hapësinor, si dhe shikueshmëria hapësinore.

FIG 95- Lidhshmëria Hapësinore (Connectivity)



Burimi: autorët, përpunuar në Depthmax (UCL)

FIG 96- Integrimi Vizual (Visual Integration) dhe Zgjedhja e Distances më të Shkurtër (Through Vision)



Burimi: autorët, përpunuar në Depthmax (UCL)

Lidhshmëria hapësinore tregon numrin e lidhjes së një qelize në hapësirë me qeliza të tjera ngjitur me të. Pra tregon hapësirat më të bollshme, më të hapura, që lejojnë më tepër njerëz të qëndrojnë dhe nuk formojnë bllokime qarkullimi. Në rastin konkret, zonat e evakuimit pranë stadiumit janë më të sigurta se shëtitorja anës Drinit, apo rruga kryesore.

Kjo analizë vlerëson integrimin visual nga një hapësirë në gjithë hapësirat e tjera të lagjes. Në rastin konkret, duket se nuk ka bllokime vizuale te dukshme ne zonen afër stadiumit. Kjo bën që në raste rreziku, ndjesia e evakuimit të sigurt është e lartë. Gjithashtu zonat me vizibilitet më të lartë janë të përshtatshme për vendosjen e sinjalistikave të ndryshme për qytetin, për raste rreziku.

Së fundi, kjo analizë vlerëson pikën që arrihet më shpejt nga gjithë hapësirat e tjera të zones (mesatarisht). Në këtë rast, dallohen pozitivisht rrugët dhe shëtitorja, ndërkohë që sërish rrethrotullimi pranë stadiumit rezulton zona më e lehtë për t'u arritur nga kjo lagje. Sigurisht, në këto analiza përzgjedhja e kornizës së references është shumë e rëndësishme dhe duhet të paraprihet nga analiza aksiale në nivel qyteti, për të evidentuar zonat respektive të komunikimit.

6.4 Vlerësimi i hapësirave

Integruar me analizën e sintaksës hapësinore, është e nevojshme të bëhet një vlerësim i arritshmërisë reale të hapësirave në kushtet e emergjencës (evakuim dhe strehim i përkohshëm). Në këtë rast janë marrë në konsideratë hapësirat publike: zona përballë bashkisë dhe fusha e sportit anës stadiumit. Nëse analiza e sintaksës hapësinore vendoste theksin mbi hapësirën e përshkueshme në tërësi, përfshirë rrugët, pra supozon një skenar ku rrugët nuk do kenë trafik të vazhdueshëm automobilistik, kjo analizë merr në konsideratë skenarin e funksionimit të rrugëve normal, dhe përdorimin për evakuim e strehim provizor vetëm të hapësirave publike. Nga kjo analizë rezulton se në 5 minuta ecje, një popullsi rreth 500 banorë mund të arrijë në njërën nga këto hapësira. Sic duket mbulimi është mjaft i ulët, gjë që kërkon adaptimin e hapësirave të tjera në qytet për këtë synim.

6.5 Zonat informale

Në territorin e bashkisë Lezhë janë të miratuara me Vendime të KRRTRSH-së pesë zona informale me një sipërfaqe totale 300ha. Për secilën prej tyre më poshtë jepet në përshkrim i shkurtër në lidhje sipërfaqen, vendodhjen e saktë etj.

Zona informale Kodër Marlekaj

Sipërfaqja e zonës informale: 80 ha. Në periudhën e miratimit të kësaj zone ishin të evidentuara 737 ndërtime informale, kryesisht 1-3 kate. Nga 524 objekte për të cilat ishte kryer procesi i vetë-deklarimit më poshtë jepet grupimi i tyre sipas destinacionit të përdorimit:

- 493 objekte informale me destinacion banim
- 10 objekte informale me destinacion banim dhe social-ekonomik
- 21 objekte informale me destinacion social-ekonomik

Territori i zonës informale është kryesisht pronë publike (75.4 ha) dhe një pjesë e vogël për të cilën disponohen çertifikat e pronësisë (4.6 ha).

Zona informale Balldre i Ri

Sipërfaqja e zonës informale: 58 ha. Në periudhën e miratimit të kësaj zone ishin të evidentuara 485 ndërtime informale, kryesisht 1-3 kate. Nga 183 objekte për të cilat ishte kryer procesi i vetë-deklarimit më poshtë jepet grupimi i tyre sipas destinacionit të përdorimit:

- 119 objekte informale me destinacion banim
- 54 objekte informale me destinacion banim dhe social-ekonomik
- 10 objekte informale me destinacion social-ekonomik

Territori i zonës informale shtrihet në një terren kodrinor, 60 m mbi nivelin e detit dhe përfshihet në zonën kadastrale 8831.

Zona informale “Ish Frutorja”

Sipërfaqja e zonës informale: 21 ha. Në periudhën e miratimit të kësaj zone ishin të evidentuara 90 ndërtime informale, kryesisht 1-3 kate. Territori i zonës informale shtrihet në pronë private dhe përfshihet në zonën kadastrale 8632.

Zona informale “Shëngjin 1”

Sipërfaqja e zonës informale: 15 ha. Shtrihet brenda njësisë administrative Balldren dhe kufizohet: Në periudhën e miratimit të kësaj zone ishin të evidentuara 102 ndërtime informale, kryesisht 1-3 kate. Territori i zonës informale shtrihet në një terren fushor, në vazhdim të kryqëzimit të rrugëve nacionale Tiranë-Lezhë dhe Lezhë-Shëngjin.

Zona informale “Barbullojë”

Sipërfaqja e zonës informale: 125 ha. Në periudhën e miratimit të kësaj zone ishin të evidentuara 243 ndërtime informale, kryesisht 1-3 kate. Nga 225 objekte për të cilat ishte kryer procesi i vetë-deklarimit më poshtë jepet grupimi i tyre sipas destinacionit të përdorimit:

- 207 objekte informale me destinacion banim
- 2 objekte informale me destinacion banim dhe social-ekonomik
- 13 objekte informale me destinacion social-ekonomik

Territori i zonës informale shtrihet në një terren fushor.

FIG 97- Arritshmëria e Hapësirave Publike



Burimi: autorët, bazuar në ASIG

7 TRASHËGIMIA KULTURORE DHE HISTORIKE

Bashkia Lezhë disponon një sërë asetesh kulturore e historike. Qyteti i Lezhës, qendër e Bashkisë është themeluar në vitin 385 para erës sonë. Gjatë gjithë historisë ilire dhe më vonë, ky qytet ka luajtur një rol të veçantë historik. Pozicioni gjeografik që ka qyteti i Lezhës me rrethinat ka bërë që ai që në lashtësi të jetë një ndër qendrat tregtare e politiko ushtarake të rëndësishme. Është kjo arsyeja që pikërisht në këtë qytet, në momente të caktuara të historisë sonë, janë bërë aktivitete politike e kulturore të nivelit të lartë kombëtar, si: “Lidhja e Lezhës” më 1444, “Kuvendi i Arbrit” në 1703, etj. Prezenca e Urdhrit Franceskan në Lezhë, e themeluar nga vetë Shën Francesku i Asizit në vitin 1220, i shtohet historisë dhe kulturës së qytetit.

Vendvarrimi i heroit kombëtar Gjergj Kastrioti. Lezha ka një trashëgimi të pasur etnokulturore, historike, arkeologjike dhe etnografike. Në të ndodhen shumë vende dhe monumente historike me interes për t’u vizituar. Memoriali “Gjergj Kastrioti” Skënderbeu (ku vizitorët mund të shohin emblemat e familjeve feudale shqiptare dhe një kopje të shpatës dhe përkrenares së Skënderbeut); (Kisha e Shën Nikollës, Kuvendi i Besëlidhjes dhe Vendvarrimi I Skënderbeut), Kalaja e Lezhës (Kështjella Arbërore), Nimfeumi (Shëngjini i sotëm) etj. dhe shumë objekte kulti si Kisha e Shën Gjon Kryepremi (mbajtur Kuvendi i Arbrit), Kisha e Eufemisë (shek. XII) Kisha e Shën Nunciatës, etj. përbëjnë atraksione shumë të rëndësishme për zhvillimin e turizmit kulturor në këtë zonë.

Kalaja e Lezhës është një nga vlerat e spikatura monumentale e historike të qytetit. Origjina ilire e saj dhe gjurmët e arkitekturave ilire, romake, bizantine dhe osmane e bëjnë atë një objekt interesant për t’u vizituar. Aty ka shumë objekte interesante për t’u vizituar si rrënojat e ndërtesave osmane brenda kalasë, xhamia, kulla në murin juglindor me një hark romak dhe kulla ilire në murin jugor. Gjithashtu Ura e vjetër e qytetit (1926) e ndërtuar mbi lumin Drin dhe shtëpia e Mlikajve (1910, një banesë tipike qytetare e Lezhës, ofrojnë vlerat e tyre arkitekturore, historike dhe kulturore.

Vlen të përmendet se mungon informacioni i detajuar në lidhje me gjendjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Për një vlerësim më të detajuar është e nevojshme informacioni në lidhje me restaurimin e tyre dhe gjendjen në të cilën këto objekte ndodhen.

8 ANALIZA E FINANCIVE VENDORE NË BASHKINË LEZHË

Me qëllim evidentimin dhe vlerësimin e situatës financiare të bashkisë Lezhë u përdorën të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet për nivelin e parë të qeverisjes vendore (bashkitë) të disponueshme në portalin për financat vendore www.financatvendore.al. Të dhënat e paraqitura në këtë portal burojnë nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe janë të dhëna faktike dhe janë të disponueshme për periudhën 2010-2018.

Burimet financiare totale (nga transfertat ndërqeveritare²⁰ dhe nga burimet e veta vendore²¹) në dispozicion të Bashkisë Lezhë gjatë periudhës së konsideruar kanë ndjekur në përgjithësi prirje

20 Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përfshijnë të ardhurat nga: taksat e ndara, transfertën e kushtëzuar, transfertën e pakushtëzuar dhe specifike (sektoriale).


21 Të ardhurat vendore përfshijnë të ardhura nga: taksat dhe tatime, tarifa, të ardhura nga asetet vendore, dividendë, fonde ose asete të KSHP-ve, donacione dhe hua.

TABELA 37- Lista e Plotë e Monumenteve Kulturore dhe Trashëgimisë Historike

Nr.	Emri i monumentit	Vendi
1	Gërmadhat e Malit Te Shëlbuem (AKROLIS)	Mali I Shelbumit
2	Muret e Qytetit Antik Lis	Lezhë
3	Kisha e Shna Ndout Vendvarrimi I Skenderbeut	Lezhë
4	Rrenoajat e Ures Plakagjonit	Fshati Rraboshtë
5	Kisha e Shen Barbulles	në fshatin Pllanë
6	Ura e Shkinës	fshatin Piraj
7	Kisha e Shen Aleksandrit	Boikon Spiten
8	Kisha e Shen Venerandës	Balltren
9	Rrenoajat e Kishes Se Shen Stefanit	Blinisht
10	Kisha e Shen Mhillit	Nenshat
11	Banesa Shtetore (Ish Sali Bajram Zekës)	Varosh Lezhë
12	Banesa Shtetore (Ish Esat Mlikës)	Lezhë
13	Banesa e Geg Prendit	Patalej
14	Banesa e Ndue Frrokut	Ishull-Lezhë
15	Kalaja e Lezhës	Lezhë
16	Kisha e Shën Eufemisë	Kallmet
17	Kisha e Kuvendit të Arbërit	Merqi
18	Katedralja e Kallmetit	Kallmet

Burimi: Instituti I Monumenteve të Kulturës, 2020

ritëse, ndikuar ndjeshëm prej fondeve nga transfertat e ndërqeveritare (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara). Në periudhën 2010-2018, burimet financiare totale në dispozicion të bashkisë Lezhë janë luhatur nga një nivel minimal prej rreth 1.0 miliardë lekë në vitin 2012 në një nivel maksimal prej rreth 1.6 miliardë lekë në vitin 2018. Pas një rritje me rreth 15.9% në terma vjetorë në vitin 2017, rritja e burimeve financiare u moderua në rreth 8% në vitin 2018. Rritja e burimeve financiare në dispozicion të bashkisë Lezhë gjatë vitit 2018 u përcaktua nga zhvillimet pozitive në të ardhurat nga burimet e veta vendore dhe nga transfertat ndërqeveritare.


GRAFIK 1- Ecuria e Burimeve Financiare në Periudhën 2010-2018

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Mesatarisht, gjatë periudhës 2010 – 2018 transfertat ndërqeveritare përfaqësuan rreth 77.2% të burimeve financiare totale në dispozicion të bashkisë Lezhë. Të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa, tarifa dhe të tjera) përfaqësuan mesatarisht rreth 22.8% të burimeve financiare totale. Pesha e kësaj kategorie ndaj totalit të burimeve të financimit paraqitet e luhatshme nga viti në vit, duke shënuar një nivel prej rreth 24.6% në fund të vitit 2018.

Të ardhurat nga burime të veta vendore përbëjnë një element të rëndësishëm në buxhetin vendor, dhe raporti i tyre ndaj burimeve financiare totale mund të përdoret dhe si tregues i autonomisë financiare të bashkisë. Duke filluar prej vitit 2016, të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike rezultojnë më të larta se të ardhurat nga burimet e veta vendore, duke sinjalizuar për një nivel të ulët të autonomisë vendore. Nisur nga sa parashikuar në dokumentin e PBA-së 2020-2022, të ardhurat nga burimet e veta vendore vlerësohet të pësojnë rritje gjatë vitit 2020 dhe të mbeten thuajse në të njëjtat nivele në vitet 2021 dhe 2022.²²

GRAFIK 3- Burimet Financiare sipas Kategorive



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga burimet e veta vendore paraqiten të luhatshme nga viti në vit. Pas një rritje të theksuar me rreth 43.1% në terma vjetorë gjatë vitit 2014 (përcaktuar nga rritja e të ardhurave nga taksa e pronës dhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja), të ardhurat në këtë kategori shënuan rënie në dy vitet pasardhëse. Për vitin 2018, ky burim të ardhurash kontribuoi me rreth 393.1 milionë lekë në buxhetin e bashkisë Lezhë, vlerë kjo në rritje me rreth 23.1% krahasuar me vitin e mëparshëm. Rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore kontribuoi pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga burimet e veta vendore gjatë periudhës në analizë.


Të ardhurat nga taksat vendore shënuan një vlerë prej rreth 241.6 milionë lekë në vitin 2018 (niveli më i lartë i shënuar në periudhën 2010-2018), në rritje me 11.7% në terma vjetorë. Kontributin kryesor në këtë drejtim e dhanë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me përkatësisht me rreth 143.5 milionë lekë (+25.9% krahasuar me një vit më parë).

Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare të bashkisë Lezhë rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale duke sugjeruar për një varësi të lartë financiare nga transfertat ndërqeveritare. Ndër transfertat ndërqeveritare, peshë të rëndësishme zenë dhe transfertat e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara (rreth 42.3% ndaj

22 Burimi: PBA 2020 – 2022, www.financatvendore.al

burimeve financiare totale). Transfertat e kushtëzuara nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale kontribuuan me rreth 524.7 milionë lekë në burimet financiare totale të bashkisë Lezhë (duke përfaqësuar rreth 32.8% të burimeve financiare totale). Këto fonde shkojnë kryesisht për buxhetet familjare (ndihma ekonomike) dhe individët në nevojë. Përmasa e kësaj transferte mund të përdoret dhe si një sinjal i tërthortë për nivelin e varfërisë dhe të punësimit në territorin e bashkisë Lezhë.

GRAFIK 3- Të Ardhurat nga Taksat (gr. majtas) dhe nga Tarifat Vendore (gr. djathtas)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Ministria përgjegjëse arsimin kanalizoi rreth 95 milionë lekë në vitin 2018 në bashkinë Lezhë.

Në përputhje me zgjerimin e burimeve financiare në dispozicion, shpenzimet e kryera nga bashkia Lezhë ndoqën prirje rritëse gjatë periudhës së konsideruar. Mesatarisht, rreth 75.3% e fondeve të disponueshme në periudhën 2010-2018 u përdor për mbulimin e shpenzimeve korrente dhe rreth 24.7% për mbulimin e nevojave për shpenzime kapitale. Ndër vite, pesha duket të jetë spostuar më së shumti në kahun e shpenzimeve korrente, ku kategoria e shpenzimeve të personelit luan rolin kryesor. Në fund të vitit 2018 u shpenzuan në total rreth 1.6 miliardë lekë, 90.8% cilave rezultojnë të jetë alokuar për shpenzime korrente. Ndër shpenzimet korrente, në rritje vjetore me rreth 17.6% rezultojnë shpenzimet për personelin. Në të kundërt, shpenzimet kapitale shënuan një vlerë prej rreth 142.3 milionë lekë, në rënie me rreth 37.8% në terma vjetorë.

Në ndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve, qëllimit të përdorimit të fondeve në dispozicion apo programeve buxhetore²³, struktura e shpenzimeve të bashkisë Lezhë rezultojnë të dominohet nga shpenzimet për funksionet: “mbrojtja sociale”, “arsimi” dhe “strehimi dhe komoditeti i komunitetit” ku në të cilin përfshihen shpenzime për strehimin vendor, zhvillimin e komunitetit, ndriçimin publik, furnizimin me ujë dhe kanalizime etj.

23 Shpenzimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore klasifikohen sipas natyrës ekonomike dhe sipas qëllimit të përdorimit të tyre (funksionit apo programe) në përputhje me standardet ndërkombëtare të zhvilluara nga Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD), të publikuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

GRAFIK 4- Struktura e Shpenzimeve (gr. majtas); Ecuria e Shpenzimeve Kapitale (gr. djathas)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në përgjithësi, burimet financiare në dispozicion të bashkisë Lezhë kanë qenë në rritje, ndikuar ndjeshëm nga transfertat ndërqeveritare. Përmirësimi i performancës në kahun e të ardhurave të veta vendore dhe shfrytëzimi më eficient i asetëve në dispozicion do të përmirësonte performancën financiare të Bashkisë Lezhë dhe do të zbuste deri diku varësinë e saj nga transfertat ndërqeveritare. Kjo e fundit do të krijonte hapësirë për ndërmarrjen e investimeve strategjike në mënyrë të pavarur si dhe kontributin në parandalimin dhe përballimin e nevojave apo rreziqeve nga katastrofat natyrore. Nga ana tjetër, nevojitet një lloj eficientimi në përdorimin e burimeve financiare (veçanërisht ulje e shpenzimeve korrente) në dispozicion duke prioritarizuar investimet me ndikim të gjerë në jetën e komunitetit dhe territorit nën administrim.

Ligji Nr. 45/2019 “Për emergjencat civile” përcakton buxhetin që duhet të vendoset në dispozicion për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë:

- Buxheti kombëtar i mbrojtjes civile duhet të jetë një linjë e veçantë buxhetore në buxhetin e shtetit dhe buxhetin vjetor të ministrive.
- Për të zvogëluar riskun e fatkeqësive, për të rritur mbrojtjen civile, dhe në përputhje me përgjegjësitë përkatëse, bashkitë duhet të vendosin në dispozicion të paktën 4 përqind **të buxhetit të tyre vjetor në lidhje me transfertat e kushtëzuara qëndrore. Ata gjithashtu mund t'i kushtojnë burime shtesë financiare këtij funksioni, duke u mbështetur në burime të tjera të të ardhurave.**
- Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile ka krijuar një Fond bazuar në legjislacionin e prokurimit publik për raste urgjente që mund të mbështesë bashkitë sipas kërkesës.

Gjithsesi, ky fond prej 4% i buxhetit, i përcaktuar në ligjin e mësipërm, vendoset në dispozicion vetëm si përgjigje ndaj fatkeqësive dhe nuk është pjesë reale e buxhetit vendor aktualisht, si për Bashkinë Lezhë, ashtu dhe për bashki të tjera.

REFERENCA

- ACP, (2014). Korridori i Kaltër, (online) <http://acp.al/projects/169/Korridori-i-kalter>, [Aksesuar: 27/07/2020]
- AKM, (2018). Raporti i Gjendjes në Mjedis 2018, Tiranë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- AKM, (2018b). Monitorimi i zhurmave Urbane në qytete të ndryshme, Tiranë: AKM
- AKPT & MZHU, (2016). Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit, Tiranë: AKPT
- AKPT & MZHU, (2016b). Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, Tiranë: AKPT
- AKZM, (2020) Harta e Zonave të Mbrojtura, (online) http://akzm.gov.al/qgis2ëeb_2019_05_13-09_58_25_161000/index.html [Aksesuar: 27/07/2020]
- Aliaj, Sh., 2004. Seismic source zones in Albania. *Albanian Journal of Natural & Technical Sciences*, Nr. 2, 133-147
- Aliaj, Sh., 2006. The Albania orogen: convergence zone between Eurasia and the Adria Microplate, in *N. Pinter et al., (eds.), The Adria Microplate: GPS Geodesy, tectonics and hazards*, 133-149.
- Aliaj, Sh., Sulstarova, E., Muço, B., Koçiu, S., 2000. Seismotectonic Map of Albania in scale 1:500.000. Seismological Institute Tirana
- Aliaj, Sh., Adams, J., Halchuk, S., Sulstarova., E., Peçi, V. and Muço, B., 2004. Probabilistic seismic hazard maps for Albania. *13th World Conference on Earthquake Engineering. Vancouver, Canada, August 1-6, 2004, Paper NO 2469*.
- Aliaj, Sh., Koçiu, S., Muço, B., Sulstarova, E., 2010. Seismicity, Seismotectonics and Seismic Hazard Assessment in Albania. Publication of Academy of Sciences of Albania. Tirana, 2010.
- Aliaj, Sh., 2012. Neotektonika e Shqipërisë. Shtypshkronja KLEAN Tirane.
- Altea & Geostudio 2000, (2002). The geological, engineering and geotechnical survey for the Milot - Lezha Road. Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2004). The geological, engineering and geotechnical survey for Lezha Bridges, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2005) The geological, engineering and geotechnical survey for Milot-Rreshen Road, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2007) The geological, engineering and geotechnical survey for Lezhe- Shkoder- Hani Hotit Road, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2009) The geological engineering survey for the new electrical line 400 kV from Monrenegro up to Tirana, performed by "Altea & Geostudio 2000" for the company "Dalekovod", Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Altea & Geostudio 2000, (2020). The geological, engineering and geotechnical survey for the railway from Vora up to Hani Hotit, Tiranë: Altea & Geostudio 2000.
- Bashkia Lezhë, UTS-01, (2016) Plani i Përgjithshëm Vendor, Lezhë: Bashkia Lezhë
- Bashkia Lezhë, UTS-01, (2016b) Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit të Përgjithshëm Vendor, Lezhë: Bashkia Lezhë
- Bashkia Lezhë, 2018. *Plani i Emergjencave Civile*, Lezhë: Bashkia Lezhë.
- Bashkia Lezhë, 2019. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis të Bashkisë së Lezhës, Lezhë: Bashkia Lezhë
- Charleston A., (2008), "Seismic Design for Architects". Elsevier Ltd Jordan Hill, Oxford
- Davoudi, S., 2019. Resilience, Uncertainty, and Adaptive Planning. *Annual Review of Territorial Governance in the Western Balkans*, 1(1), pp. 120-128.
- Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance, Part 1: General rules, seismic actions and rules for buildings. CEN 2003
- Guri M. (2015) "Kerkime mbi teknika bashkekohore per perforcimin e ndertesave me murature". PhD thesis
- Informal Meeting of EU Ministers Responsible for Urban Matter, 2016. *The EU Urban Agenda Pact of Amsterdam*, Amsterdam: European Union.

- INSTAT, 2011. Censusi i Popullsisë dhe Banesave, Tiranë: INSTAT
- INSTAT, 2014. Popullsia dhe Dinamikat e Saj, Horizonte të Reja Demografike?, Tiranë: INSTAT
- INSTAT, 2019. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, Tiranë: INSTAT
- Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, 2017. Evidentimi i Rreziqeve Natyrore në Shqipëri, Tiranë: IGJ
- Instituti i Monumenteve të Kulturës, 2020. Lista e Monumenteve të Kulturës në Shqipëri
- Lancellota, R., 2006. Geotechnical Engineering, Turin: Department of Structural Engineering, Technical University of Turin
- Le Tissier, M. et al., 2013. *Identification and Implementation of Adaptation Response Measures in the Drini – Mati River Deltas*, Tiranë: UNDP.
- Look, B., 2006. Handbook of Geotechnical Investigation and Design Tables, Neë York: Taylor & Francis
- Klubi Ekologjik Lezhë, 2018. Buletini mjedisor i Lezhës 2018, Lezhë: Klubi Ekologjik Lezhë.
- Kondi I. (2013) "Perdorimi i fibrave polimere (Fiber reinforced polymer- FRP) per perforcimin dhe pershtatjen sizmike te strukturave beton arme". PhD thesis
- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2019. Strategjia e Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit, Tiranë: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.
- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2019b. Draft Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2017-2020, Tiranë: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit
- Muço, B., 1994. Focal mechanism solutions of earthquakes for the period 1964-1988. *Tectonophysics*, 231.
- Muço, B., Kiratzi, A., Aliaj, Sh., Sulstarova, E., Koçiu, S., Peçi, V., Scordilis, E., 2004. Probabilistic Seismic Hazard Assessment in Albania. *NATO Science for Peace Programme, Final Report about the Project "Seismotectonics and Seismic Hazard Assessment in Albania"*
- Qarku Lezhë, (2018). Plani i Emergjencave Civile, Lezhë: Qarku Lezhë
- RAC-SPA, 1995. Protocol Concerning Special Protected Areas and Biological Diversity in the Mediterranean, Tunis: RAC-SPA.
- Sadigh K., C.-Y. Chang, J.A. Egan, F. Makdisi, and R.R. Youngs (1997). Attenuation relationships for shallow crustal earthquakes based on California strong motion data. *Seismological Letters* 68 (1), 180-189.
- Spudich, P., Joyner, W.B., Lindh, A.G., Boore, D.M., Margaris, B.M. and Fletcher, J.B., 1999. SSEA99: A revised ground motion prediction relation for use in extensional tectonic regimes. *Bulletin of the Seismological Society of America* 89 (5), 1156 -1170.
- Sulstarova, E., Muço, B., Aliaj, S., Kuka, N., & Duni, L. (2003). Tërmetet, Rreziku Sizmik dhe Rreziku Sizmik në Shqipëri. Tiranë: IGJEUM
- Sulstarova E., Muço B., Koçiu S. (2006). Katalogu i tërmeteve të Shqipërisë me $M_s \geq 4.5$. Arkivi i Institutit Szimologjik, Tiranë.
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2017. Studim Gjeologjik për Digat e Rezervuarëve, Tiranë: SHGJSH
- Shkupi, D., Aliaj, Sh., Muço, B. Lleshi, B., Mylius H.G., Toloczyki, M., 2005. The Geohazard Map of Albania, scale 1: 200 000. Tirana 2005
- Toto, R., 2020. Building Resilience for Local Governments in Albania: Legal and Institutional Challenges. *MetroPOLIS, Co-PLAN Resilience Series, Policy Paper*, 1(1).
- Toto, R. et al., 2020. Reagimi i Qeverive Vendore ndaj Emergjencës së COVID-19 në Shqipëri: Janar 2020-Prill 2020. *MetroPOLIS, Co-PLAN Resilience Series, Policy Paper*, 1(3).
- UN Habitat, 2016. *Axhenda e Re Urbane*, Tiranë: Shqipëroi: Ministria e Zhvillimit Urban.
- UNDRR, 2019. *Global Assessment Report on Disaster Risk Reduction*, Geneva: United Nations Office for Disaster Risk Reduction (UNDRR).
- UNISDR, 2015. *Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015–2030.*, Geneva: United Nations Office for Disaster Risk Reduction.

REFERENCA LIGJORE:

Ligje:

Ligj Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
Ligj Nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar
Ligj Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen Civile"
Ligj Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut"
Ligj Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar
Ligj Nr. 91/2013, dt 28/02/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"
Ligj Nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar
Ligj Nr. 9385, dt 4/05/2005, "Për pyjet dhe shërbimin Pyjor", i ndryshuar
Ligj Nr. 9244, dt. 17/06/2004, "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore", i ndryshuar
Ligj Nr.24/2017 "Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit"
Ligj Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
Ligj Nr. 9290, dt 7.10.2004 "Për Produktet e ndërtimit" i ndryshuar me Ligjin nr.9825, datë 1.11.2007 'Për disa ndryshime në Ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit"
Ligj Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar
Ligj Nr. 124/2015 "Për Efiçencën e Energjisë", i ndryshuar
Ligj Nr. 116/2016 "Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave"
Ligj Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme",
Ligj Nr. 8378, datë 22.7.1998 i Kodit Rrugor të Republikës Së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.10 488
Ligj Nr.8102, datë 28.3.1996 Për Kuadrin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura; i azhurnuar me: Ligjin nr.9352, datë 03.03.2005; Ligjin nr.9584, datë 17.07.2006 (i ndryshuar me ligjin nr.9845, datë 17.12.2007); Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008

VKM

VKM Nr. 686, 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar
VKM Nr. 408, dt 13/05/2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar
VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Akte Normative

Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore" i miratuar me Ligjin nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"

Shtojca

Shtojca 1- Komisioni Mbrojtjes Civile Bashkia Lezhë
Shtojca 3- Raporti Gjeologjik dhe Sizmiologjik
Shtojca 4- Raporti Inxhinieri Strukturor mbi Cënueshmërinë e Strukturave nga Rreziku Sizmik
Shtojca 5- Material i Detajuar Hartografik

